

UNIVERSITETI I EVROPËS
JUGLINDORE



FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE
DHE KOMUNIKIMIT

CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

Programi: Gjuhë dhe letërsi shqipe

Tema e disertacionit të doktoratës:

AREALI GJUHËSOR I ISTOGUT ME RRETHINË

KANDIDATI:

Ma. sc. Sejdi Gashi

MENTORI:

Prof. dr. Mustafa Ibrahim

Korrik 2018, Tetovë

PËRMBAJTJA

Përmbajtja.....	2
Abstrak.....	15
Disa fjalë për autorin.....	19
Bibliografia e autorit Sejdi Gashi.....	19
Hyrje.....	23
Objekti i studimit.....	23
Qëllimi i studimit dhe motivimi i temës.....	24
Metodologjia e punës.....	24
Baza teorike e punimit.....	25
Struktura e punimit.....	26
Adresimi i punimit.....	28

Kreu I

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR ISTOGUN ME RRETHINË...29

1. Komuna e Istogut.....	29
Shtrirja gjeografike.....	29
Emri Istog dhe e kaluara historike.....	29
Formimi i qendrës administrative të Istogut.....	32
Kushtet klimatike.....	32
Bujqësia.....	32
Arsimi dhe kultura.....	33
Popullsia.....	34
Fiset dhe vëllazëritë.....	36
Fshatrat.....	37
Banja.....	37

Baica.....	37
Belica.....	38
Bellopoja.....	38
Caralluka.....	39
Cërkolezi.....	39
Cerrca.....	40
Dobrusha.....	41
<i>Dragoleci</i>	41
Dreja.....	42
Dubova e Vogël.....	42
Dubrava.....	43
Gurrakoci.....	43
Istogu.....	44
Istogu i Poshtëm.....	45
Kamenica.....	45
Kaliçani.....	45
Kashica.....	46
Kërnina.....	47
Koshi.....	47
Kovraga.....	48
Lluga.....	48
Llukavci i Begut.....	49
Llukavci i Thatë.....	49
Lubova.....	49
Lubozhda.....	50
Mojstiri.....	51
Muzhevina.....	51
Orrobërda.....	52
Osojani.....	52

Padalishta.....	53
Polana.....	53
Prekalla.....	53
Prigoda.....	54
Rakoshi.....	55
Serbobrani.....	55
Shalinovica.....	55
Shushica.....	56
Sineja.....	57
Staradrani.....	57
Studenica.....	58
Suhogërlla.....	58
Tomoci.....	59
Trubuhoci.....	59
Tuqepi.....	60
Uça.....	60
Veriqi.....	61
Veriqi i Ri.....	61
Vrella.....	62
Zabllaçi.....	63
Zallçi.....	63
Zhakova.....	63
Studimet e derisotme për Istogun.....	64

Kreu II

FONETIKA	67
2. Tiparet fonetike.....	67
Theksi.....	67
Sistemi zanor.....	68
Gjatësia e zanoreve.....	68
Zanoret e shkurtra.....	68
Zanoret e mesme.....	69
Zanoret e gjata.....	69
Nazalizimi dhe denazalizimi i zanoreve.....	70
Reduktimi i zanoreve.....	71
Zanorja a	71
Dallime të kushtëzuara me zanoren a	72
Zanorja e	72
Dallime të kushtëzuara lidhur me zanoren e	73
Zanorja ë	73
Dallime të kushtëzuara me zanoren ë	74
Zanorja i	74
Dallime të kushtëzuara me zanoren i	75
Zanorja o	75
Dallime të kushtëzuara me zanoren o	75
Zanorja u	75
Dallime të kushtëzuara me zanoren u	76
Zanorja y	76
Dallime të kushtëzuara me zanoren y	77
Diftongjet dhe togjet zanore.....	77
Togu ie (je/je)	77
Grupi ye	78
Togu ae	78

Togu oe	78
Togu ue	78
Sistemi bashkëtingëllor.....	79
Bashkëtingëllorja h	80
Kalimi i bashkëtingëllores h në f	81
Bashkëtingëlloret k, g	81
Bashkëtingëlloret q, gj/ ç, xh	82
Bashkëtingëllorja j	84
Bashkëtingëllorja nj	85
Bashkëtingëlloret l, ll	86
Kalimi (jotizimi) i bashkëtingëllores l në j	87
Bashkëtingëlloret r, rr	87
Bashkëtingëlloret s, z	88
Bashkëtingëlloret sh, zh	89
Bashkëtingëlloret c, x	90
Bashkëtingëlloret t, d, n	91
Bashkëtingëlloret th, dh	92
Bashkëtingëlloret f, v	93
Bashkëtingëlloret p, b, m	94
Grupet e bashkëtingëlloreve.....	95
Grupet kl, gl	95
Grupet lk, lg	96
Grupi mb	96
Grupi ng	97
Grupi ngj/nxh	97
Grupi fsh	97
Grupi nx	97
Grupi pl	97
Grupi ts	98

Grupi <i>mj</i>	98
-----------------------	----

Kreu III

DUKURITË FONETIKE	99
3. Ndërrimet (ndërkëmbimet) e tingujve.....	99
Metafonia (umlauti)	99
Apofonia.....	99
Kontraksioni.....	100
Shurdhimi.....	100
Sonorizimi.....	100
Asimilimi.....	101
Disimilimi.....	101
Rënia e tingujve.....	102
Metateza.....	102
Elizioni (elidimi)	103
Aglutinacioni (përngjitja)	103
Palatalizimi.....	104
Reduktimi.....	104
Kontraksioni i zanoreve.....	104
Kontraksioni i bashkëtingëlloreve.....	105
Analogjia.....	105

Kreu IV

MORFOLOGJIA	106
4. Tiparet morfologjike.....	106
Emri dhe format e tij.....	107
Kategoria e gjinisë.....	107
Gjinia mashkullore.....	108
Gjinia femërore.....	109
Gjinia asnjëse.....	110
Emrat ambigjenë.....	110
Kategoria e shquarsisë dhe e pashquarsisë.....	111
Kategoria e numrit.....	111
Shumësi i emrave mashkullorë.....	112
Shumësi me a	112
Shumësi me e	113
Shumësi me mbaresë zero.....	113
Shumësi me palatalizim.....	114
Shumësi i emrave femërorë.....	114
Shumësi i emrave asnjës.....	115
Rasat.....	116
Rasat gjinore e dhanore.....	117
Rasa kallëzore.....	117
Rasa rrjedhore.....	118
Rasa thirrore.....	119
Lakimi.....	119
Nyjat.....	124
Mbiemri.....	125
Shkallët e mbiemrit.....	127
Numërori.....	127
Përemri.....	128

Përemri vetor.....	129
Përemri vetvetor.....	130
Përemri dëftor.....	131
Përemri pyetës.....	133
Përemri i pacaktuar.....	134
Përemri pronor.....	135
Folja.....	138
Mënyra dëftore.....	138
Koha e tashme.....	138
Foljet e mi- konjugacionit (<i>jôm, kôm, thôm</i>)	141
Koha e tashme e formës (diatezës) pësore.....	142
Koha e pakryer.....	142
Koha e kryer e thjeshtë.....	143
Koha e kryer.....	144
E kryera e plotë (më së e kryera)	145
Koha e kryer e tejshkuar.....	145
Koha e ardhme.....	146
Mënyra lidhore.....	146
Mënyra kushtore.....	147
Mënyra habitore.....	148
Mënyra dëshirore.....	149
Mënyra urdhërore.....	150
Format e pashtjelluara të foljes.....	151
Pjesorja (participi)	151
Paskajorja (infinitivi)	152
Përcjellorja (gjerundi)	153
Fjalët e pandryshueshme.....	153
Ndajfolja.....	153
Ndajfolja e vendit.....	154

Ndajfolja e kohës.....	154
Ndajfolja e mënyrës.....	155
Ndajfolja e sasisë.....	155
Parafjalët.....	156
Lidhëza.....	157
Pjesëzat.....	158
Pasthirrmat.....	160
Onomatopetë.....	161

Kreu V

FJALËFORMIMI	163
5. Tiparet fjalëformuese.....	163
Fjalët e parme.....	163
Fjalë jo të parme.....	164
Parashtesimi.....	164
Parashtesa <i>ç</i>	165
Parashtesa kaca/kaça	165
Parashtesa kala	166
Parashtesa kara	166
Parashtesa m	166
Parashtesa mí	166
Parashtesa n	166
Parashtesa nër	167
Parashtesa pă	167
Parashtesa păra, për	167
Parashtesa për	168
Parashtesa stër (stër)	168
Prapashtesimi.....	169
Prapashtesa a:t (-atë)	169

Prapashtesa <i>a:v</i> (-avë) <i>ăvt</i>	169
Prapashtesa <i>ăç</i> (<i>a:ç</i>)	170
Prapashtesa <i>acăk</i>	170
Prapashtesa <i>ăj</i> (<i>a:j</i>)	170
Prapashtesa <i>ăk</i>	170
Prapashtesa <i>ăn/ a:jk</i>	171
Prapashtesa <i>â°r/a:r/are</i>	172
Prapashtesa <i>ăz</i>	172
Prapashtesa <i>c</i>	172
Prapashtesa <i>e:sh</i> (<i>eshë</i>)	173
Prapashtesa <i>éc</i>	173
Prapashtesa <i>hâ°ne</i>	173
Prapashtesa <i>i:c</i> (<i>icë</i>)	173
Prapashtesa <i>i:n</i> (<i>inë</i>)	174
Prapashtesa <i>i:sht/ isht</i>	174
Prapashtesa <i>i:t</i>	175
Prapashtesa <i>im/i:m</i>	175
Prapashtesa <i>lí</i>	175
Prapashtesa <i>llăk</i>	176
Prapashtesa <i>m</i>	176
Prapashtesa <i>í</i>	176
Prapashtesat <i>ők, -óle, -øj</i>	176
Prapashtesa <i>tár</i>	177
Prapashtesa <i>tóre</i>	177
Prapashtesa <i>u:k</i> (<i>ukë</i>)	177
Prapashtesa <i>û:η</i> (<i>ungë</i>)	177
Prapashtesa <i>üşh/u:sh</i>	178
Prapashtesa <i>nïk</i>	178
Prapashtesat <i>t</i>	178

Prapashtesa z	179
Formimi parashtesor-prapashtesor i fjalëve.....	179
Paranyjëzimi.....	179
Kompozimi (përbërja)	180
Kompozitat këpujore.....	180
Kompozitat përcaktore.....	180
Përngjitja (aglutinimi)	181
Konversioni.....	181

Kreu VI

SINTAKSA	183
6. Tiparet sintaksore.....	183
Paskajorja në vend të lidhores.....	183
Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën.....	185
Rreth përdorimit të disa parafjalëve.....	186
Parafjala pa	186
Parafjala për	186
Parafjala ka^h	187
Parafjala me	187
Parafjala për (prej)	187
Funksioni sintaksor i lidhëzave.....	187
Lidhëza në (ose)	188
Lidhëza nënrenditëse po (pra)	188
Lidhëza ka^h(nga)	188
Lidhëza sa	188
Lidhëza kur	188
Përdorimi i urdhërores së foljes.....	189
Përcaktori themelor (tre/tri)	189
Funksioni i përemrave vetorë.....	189

Kreu VII

TEKSTE DIALEKTORE	190
Úku plāk.....	190
Bója e léprit.....	191
Grúja da:n pleçni:n.....	191
Magári i pri:n devês.....	192
Musafírt e Ramadan Shabâ°nit.....	193
Shóçit i dës bába.....	194
Nastradini e mre:ti.....	194
Për mú ru:jt pej dâ°meve e fatkeçsíve (<i>bestytني</i>)	196
Kijet e vjédhun.....	196
Dy zllázën.....	198
Musafíri.....	198
Nĩ pleçní e Ramadan Shabâ°nit.....	199
Kush pe pĩ tâ°mlin?	200
Grúja e vé shkon bárrse te búrrí tjetër.....	200
Kâ°nga e Rèxh Mehmétit.....	202
Lúla jo:n, lúle veróre.....	203
Ani káj moj çí:k , káj me mâ°ll.....	203
Lúlja jo:n çka dõn dóra?	204
Hajdĩn Ága kmishën me nĩ ví.....	204
Káj moj Shkúrte lage prênĩn.....	205

Kreu VIII

FJALORTH DIALEKTOR	206
8. Leksiku.....	206
Përfundime.....	282
Simbolet fonetike.....	294

Shkurtesat për literaturën e konsultuar.....	294
Shkurtesat tjera.....	295
Bibliografia.....	299

AREALI GJUHËSOR I ISTOGUT ME RRETHINË

Abstrakt

Në këtë punim të disertacionit të doktoraturës me titull "*Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë*" kemi për qëllim të paraqesim një pamje sa më të plotë mbi arealin gjuhësor të Istogut, si njëra prej të folmeve më periferike të gegërishtes verilindore. Studimin e kemi konceptuar në tetë njësi tematike (krerë) siç janë: 1. *Të dhëna të përgjithshme për Istogun me rrethinë*, 2. *Fonetika*, 3. *Dukuritë fonetike*, 4. *Morfologjia*, 5. *Fjalëformimi*, 6. *Sintaksa*, 7. *Tekste dialektore* dhe 8. *Fjalorth dialektor*, ku secili kre është njësi në vete, që merr në vështrim aspekte dhe probleme të caktuara gjuhësore, në lidhje të pashkëputshme me temën në shqyrtim.

Studimet dialektologjike në fushë të shqipes tashme kanë një traditë të gjatë dhe të pasur, me ç'rast janë bërë hulumtime natyrash të ndryshme nga fushat gjuhësore si: fonetika dhe fonologjia, morfologjia, fjalëformimi, leksiku, por më pak studime janë ndërmarrë nga fusha e sintaksës dialektore të shqipes. Dialektologët prej kohësh kanë pohuar dhe ripohuar, se gjuha e gjallë e popullit është gurrë e pashtershme për pasurimin e një gjuhe, prandaj njohja dhe studimi i dialekteve sipas metodave të mirëfillta shkencore, përbën shtyllën qendrore për vijimin dhe zhvillimin e studimeve edhe në rrafshet e tjera gjuhësore si: fonetika, morfologjia, sintaksa e padyshim edhe semasiologjia dhe frazeologjia e gjuhës. Studimi i dialekteve është i rëndësishëm së veçantë edhe për historinë e gjuhës, sepse me të drejtë është shprehur: Anton Meje "*nuk ka histori gjuhe pa dialektologji...*".

Në vazhdë të kësaj që u tha, kemi vepruar edhe ne, pra gjatë punës sonë, kemi bërë përpjekje t'i marrim në shqyrtim ato tipare dhe dukuri gjuhësore të të folmes së Istogut që janë me interes për dialektologjinë dhe për gjuhësinë shqiptare përgjithësisht, githëmonë duke synuar objektivitetin dhe korrektësinë.

Përveç punës në terren, kemi konsultuar edhe literaturë të nevojshme teorike si: monografi mbi të folmet fqinjësore dhe jofqinjësore të Istogut, studime të specializuara dialektologjike, fjalorthë dialektorë, fjalorë të gjuhës shqipe, gramatika të shqipes si dhe tekste dhe materiale të tjera profesionale.

Lëndën gjuhësore të vjelë në terren e kemi analizuar mbi bazën e parimeve, kritereve dhe metodave shkencore, të njohura në studimet shqiptare të kësaj natyre, prandaj duke vepruar kështu i kemi pasur më të qarta dhe më të lehta trajtimet, analizmet dhe interpretime mbi nocionet si: *dialekt, e folme, veçori dialektore, veçori fonetike, tipare morfologjike, fjalëformim, mënyra fjalëformuese, leksik dialektor, leksik krahinor, leksik autokton, huazime* dhe nocione të tjera të ngjashme.

Për punimin e këtij studimi jemi mbështetur në një literaturë mjaft të pasur, që e kemi shënuar te pjesa e bibliografisë.

Përpos *Udhëzuesit për mbledhjen e fjalëve dhe të shprehjeve të gjuhës shqipe*, të hartuar nga IGJL, ASHSH, për punët praktike jemi mbështetur në *Pyetësin* e përgaditur nga ASHSH dhe në *Udhëzuesin për mbledhjen e leksikut dhe frazeologjisë së shqipes*, përgaditur nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, ndërkaq gjatë punës praktike në terren, kryesisht i kemi zbatuar tri metoda pune:

- metodën e bashkëbisedimit me subjektet e caktuara;
- metodën përmes pyetësorëve (bazuar në pyetësin e ADGJSH-së);
- metodën e vrojtimit të drejtëpërdrejtë (duke vrojtuar në mënyrë aktive, dhe duke iu shtruar pyetje bashkëbiseduesve).

Gjithëherë jemi përpjekur që subjektet të jenë të zgjedhur, sipas kritereve dhe rregullave, tashmë të njohura në studimet e kësaj fushe.

Fjalët çelës: *gjuha shqipe, dialektet, gegërishtja verilindore, Istogu, fonetika, dukuritë fonetike, morfologjia, fjalëformimi, sintaksa, tekstet dialektore, fjalorthi dialektor, leksiku autokton, huazimet, pyetësor dialektologjik, subjekte.*

THE LINGUISTIC AREAL OF ISTOG WITH THE SURROUNDING

Abstract

In this paper of the doctoral dissertation titled "The linguistic areal of Istog with the surrounding", we intend to present a complete view on the linguistic areal of Istog, as one of the most peripheral language of Northeastern Geghe. We have conceived the study in eight thematic units (headings) such as: 1. General data on Istog and its surrounding, 2. Phonetics, 3. Phonetic phenomena, 4. Morphology, 5. Word formation, 6. Syntax, 7. Dialectal texts and 8. Dialect Glossary, where each head is a unit in itself, which surveys at certain aspects and language problems, in relation to the topic.

Dialectal studies in the Albanian language already have a long and rich tradition, where different kinds of linguistic research have been conducted, such as phonetics and phonology, morphology, word formation, and lexis, but few studies have been undertaken in the field of dialectal syntax of the Albanian.

Dialectologists have long claimed and reaffirmed that the living language of the people is a never-ending fountain for the enrichment of a language, hence the recognition and study of dialects according to the proper scientific methods constitutes the central pillar for the continuation and development of studies in other linguistics phases such as phonetics, morphology, syntax and obviously semasiology and phraseology of language. The study of dialects is of particular importance also to the history of language, because as it is rightly stated by Anton Meje "there is no history of language without dialectology ..."

We have worked according to the above mentioned statement, so during our work, we have attempted to consider those traits and linguistic phenomena of Istog folk that are of interest to dialectology and Albanian linguistics in general, intentionally aiming at objectivity and correctness.

In addition to field work, we also consulted theoretical literature such as monograph on Istog / Istog neighboring and non-neighboring dialects, specialized dialectological studies, dialectal glossaries, Albanian language dictionaries, grammar and other professional texts and materials.

We have analyzed the language subject in field on the basis of the principles, criteria and scientific methods, known in Albanian studies of this nature, so in doing so we had clearer and simpler treatments, analyzes and interrelations on notions such as : dialect, spoken language, dialectical specifics, phonetic features, morphological traits, word formation, word formation methods, dialect lexis , district lexis, autochthonous lexis, borrowings and other notions of this type.

For the purpose of this study, we have relied on a very rich literature that we have listed in the bibliography section.

In addition to the Guidelines for Supplying Albanian Words and Expressions, drafted by IGJL, ASHSH, for practical work, we have relied on the Questionnaire prepared by the ASHSH and on the Guide on Albanian Language lexis and phraseology gathering , prepared by the Institute of Albanology in Prishtina, while during field work, we mainly implemented three working methods:

- method of conversation with certain subjects;
- method through questionnaires (based on the ADGJSH questionnaire);
- direct survey method (by actively observing, and asking questions to interlocutors).

We have always tried to choose the subjects according to the criteria and rules already recognized in the studies of this field.

Key words: Albanian language, dialects, northeastern Geghe, Istog, phonetics, phonetic phenomena, morphology, word formation, syntax, dialectal texts, dialect glossary, autochthon lexis, borrowings, dialectical questionnaire, subjects.

Disa fjalë për autorin

Sejdi Gashi u lind më 30.01.1985 në Istog (Prigodë). Shkollën fillore dhe të mesmen i përfundoi në vendlindje. Studimet themelore universitare i përfundoi në drejtimin e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Në të njëjtin fakultet i përfundoi edhe studimet pasuniversitare-Master, në programin: Gjuhë shqipe (drejtimi shkencor) dhe e mori titullin: Master i shkencave të filologjisë.

Po ashtu, më 2008 i përfundoi studimet themelore universitare për shkenca politike dhe administratë publike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku ishte student i dalluar dhe bursist i këtij fakulteti.

Në vitin 2015 i regjistroi studimet e doktoraturës në Universitetin e Evropës Juglindore, Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, programi: Gjuhë dhe letërsi shqipe.

Bibliografia e autorit Sejdi Gashi

Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës (1916-17), në: *Gjuha shqipe* 1/2012, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 37-43.

Vlerësim apo përçudnim i shqipes standarde nga nxënësit e Prishtinës - shkaqet dhe pasojat, në: *Gjuha shqipe* 1/2013, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 101-106.

Mbi rrjedhat e planifikimit gjuhësor dhe të statusit të gjuhëve zyrtare në Kosovë gjatë viteve 1999-2009, në: *Gjuha shqipe* 1/2015, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 93-99.

Thimi Mitko - gjuhëtar, leksikolog e leksikograf i veçantë, në: *Gjuha shqipe* 2/2015, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 61-70.

Komisia Letrare Shqipe në Shkodër themeltare për shqipen standarde, në: *Gjuha shqipe* 3/2016, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 145-151.

Raportet shqipe standarde-dialekt te nxënësit dhe studentët e disa institucioneve të arsimit të mesëm dhe atij universitar në Kosovë, në: *Gjuha shqipe* 1/2017, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 121-136.

Begzad Baliu, *Hulumtime Albanologjike*, Shtëpia botuese “Era”, Prishtinë, 2015 (recension) në: *Gjurmime albanologjike* - seria e shkencave filologjike 44/2014, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 317-319.

Prurje leksikore dhe leksikografike në fushë të shqipes, në: “Java e Albanologjisë 6/ 2015 (kronikë shkencore) në: *Gjurmime albanologjike*- seria e shkencave filologjike 45/2015, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 330-332.

Areali gjuhësor i Istogut sipas Defterit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, në: *Gjurmime albanologjike* - seria e shkencave filologjike 46/2016, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 317-338.

Kontaktet gjuhësore në Kosovë, pozita e shqipes sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në: *Albanologji* 4/2014, Vëllimi. I, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 251-256.

A po cenohet shqipja nga procesi i globalizimit apo nga vetë shqipfolësit? në: “Albanologji” 5/2014, vëllimi I, fq. 497-501.

Materiale leksikore nga e folmja shqipe e Istogut me rrethina, në: *Albanologji* 6/2015, vëllimi I, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 267-274.

Mbi disa funksione të kohës së ardhme të foljes në shqipen standarde, në: *Filologji* 20/2013, KDU 821.18 (05); 811.18 (05), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, fq. 325-394.

Kontaktet gjuhësore, dygjuhësia dhe shumëgjuhësia në shërbimet publike në Kosovë, përparësitë dhe të metat si dhe pozita e shqipes sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në: *Kërkime gjuhësore*, vëllimi II, 2013, Qendra e Studimeve Albanologjike, Insituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, fq. 401-405.

Koha e ardhme e foljes në shqipen standarde, aspekti kohë, mënyrë dhe modalitet, në: *Buletin Shkencor* (Universiteti “Fan S. Noli” - Korçë). Viti XVIII, nr. 5/2013, ISSN: 2078-7111, fq. 42-50.

Metodat bashkëkohore për mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollat e Prishtinës, në: Revistën “Univers” 17/2016, ISSN: 2414-8784, fq. 108-119.

Linguistic planning and the status of official languages in Kosova during the years 1999-2009, in Journal: *Littera et Lingua*, ed. St.Climent University of Sofia Sofie, 03.12.2016. ISSN 1312-6172 (<http://www.slav.uni-sofia.bg/naum/lilijournal/2015/12/3-4/sgashi>).

On some features of the linguistic areal of Istog with surroundings, in: *Linguistic Anthropology Journal*, Vol. 2, No. 79: Nov 6, 2017. (<http://ssrn.com/abstract=3057383>).

Some words formations in the Istog language area as a testimony of the autochthony of the albanian language, In: XVIII’ th International Conference in Balkan Studies: *The Balkans –variety in diversity*: Sofia University “St. Climent Ohridski”, Sofia, 20.04.2018.

Rruga e fomimit të shqipes letrare në Kosovë, në: “Java e Shkencës”, MASHT (përmbledhje kumtesash), Prishtinë, 2012, ISBN: 978-9951-16-047-6, fq. 301-304).

Mbi disa veçori semantike në leksikun e veprës së Mitrush Kutelit, në përmbledhjen: *Mitrush Kuteli në 100-vjetorin e lindjes* (Konferencë shkencore), Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. 2017, ISBN: 978-9928-245-17-5, fq.144-151.

Ngecjet e shqipes standarde në administratën publike në Kosovë, Akademi Jubilare me rastin e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.2012, ISBN: 9928146151, , fq.126-130.

Reka e Epërme përballë asimilimit gjuhësor e kombëtar, në: “Jeta Arbëreshe” 2014, viti i botimit XIII, nr.77, fq.73-74.

Komuna e Istogut



Hyrje

Objekti i studimit

Studimet dialektologjike në fushë të shqipes tashmë kanë një traditë të gjatë dhe të pasur, me ç'rast janë bërë hulumtime natyrash të ndryshme nga fushat gjuhësore, si: fonetika dhe fonologjia, morfologjia, fjalëformimi, leksiku, por më pak studime janë realizuar nga fusha e sintaksës dialektore të shqipes. Kështu, pra në të shumtën e rasteve, autorët në studimet e tyre janë orientuar mbi të folmet e zonës a krahinës së tyre të origjinës, prandaj në këtë mënyrë është arritur të studiohen shumica e të folmeve shqipe, por natyrisht si në çdo punë a veprimtari, edhe këto studime, herë-herë kanë hasur në sfida natyrash të ndryshme.

Për sa u përket studimeve dialektologjike në Kosovë, meritojnë të përmenden studiuesit e brezit më të moçëm, siç janë: Idriz Ajeti, Hilmi Agani, Latif Mulaku, Mehdi Bardhi, Mehmet Halimi, Fadil Raka, Zijadin Munishi, Rexhep Ismajli, për të vijuar me dialektologët, si: Ragip Mulaku, Tafil Kelmendi, Bajram Mehmetaj, Adem Hajdaraj, Imri Badallaj, Qemal Murati, Mehmet Ahmetaj, dhe studiuesit e brezit më të ri, si: Naser Pajaziti, Bagzad Baliu, Haki Hysenaj, Fridrik Dulaj, Naim Berisha, Abdurrahim Maxhuni etj.

Dialektologët e përmendur, por edhe të tjerë që nuk po i përmendim këtu, prej kohësh e kanë pohuar dhe ripohuar, se gjuha e gjallë e popullit është gurrë e pashtershme për pasurimin e vazhdueshëm të standardit të shqipes, prandaj, njohja dhe studimi i dialekteve të shqipes, sipas metodave të mirëfillta shkencore, përbën shtyllën qendrore për përvijimin e studimeve edhe në rrafshet e tjera të gjuhësisë, si: fonetika, morfologjia, sintaksa, e padyshim edhe semasiologjia dhe frazeologjia e gjuhës. Studimi i dialekteve është i rëndësishëm së veçantë edhe për historinë e gjuhës, sepse me të drejtë është shprehur Anton Meje: *“nuk ka histori gjuhe pa dialektologji...”*.

Në vazhden e kësaj që u tha, jemi përpjekur që të veprojmë edhe ne, pra gjatë hartimit të këtij disertacioni të doktoratës me titull: *“Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë”*, kemi bërë përpjekje të marrim në shqyrtim ato tipare dhe dukuri gjuhësore që janë me interes për dialektologjinë dhe për gjuhësinë shqiptare përgjithësisht. Jemi të vetëdijshëm se kjo ndërmarrje jona studimore nuk është pa të meta për faktin se e folmja e Istogut për herë të parë po bëhet objekt trajtimi në një punim si ky i yni, prandaj, në këtë drejtim ka hapësirë për përmirësime dhe plotësime të mëtejshme.

Qëllimi i studimit dhe motivimi i temës

Përmes këtij punimi synojmë të paraqesim një pamje sa më të plotë dhe sa më tërësore mbi arealin gjuhësor të Istogut, si një prej të folmeve më periferike të gegërishtes verilindore (një prej të folmeve më skajore të mbarë shqipes).

Arsyet që na kanë shtyrë të përcaktohem për temën me titull: *“Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë”*, janë të shumta, por dy janë kryesore:

Origjina ime familjare nga një fshat i komunës së Istogut, pra dëshira dhe vullneti që pak a shumë të kontribuojë për të mirën e vendlindjes sime, dhe, arsyeja e dytë është se, duke qenë i punësuar në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në Degën e Gjuhësisë, sektori i dialektologjisë më ka nxitur të merrem me temën e tillë.

Metodologjia e punës

Pas sigurimit dhe konsultimit të literaturës teorike në lidhje me objektin e studimit, jemi pajisur me pyetësorët, përkatësisht me *Udhëzuesin për mbledhjen e fjalëve dhe të shprehjeve të gjuhës shqipe*, të hartuar nga IGJL, ASHSH. Për punët praktike jemi mbështetur në *Pyetësorin* e përgatitur nga ASHSH dhe në *Udhëzuesin për mbledhjen e leksikut dhe frazeologjisë së shqipes*, përgatitur nga Instituti Albanologjik i

Prishtinës. Pas këtyre hapave i jemi rrekur punës në terren, me qëllim të vjeljes së lëndës gjuhësore, me ç’rast këtu, përgjithësisht kemi zbatuar tri metoda pune:

- metodën e bashkëbisedimit me subjektet e caktuara;
- metodën përmes pyetësorëve (bazuar në pyetësorin e ADGJSH-së);
- metodën e vrojtimit të drejtpërdrejtë (duke vrojtuar në mënyrë aktive dhe duke iu shtruar pyetje subjekteve të intervistuar).

Gjithëherë jemi përpjekur që, subjektet t’i përzgjedhim sipas kriterëve dhe kushteve tashmë të njohura nga studimet dialektologjike shqiptare, ndërkaq kujdes të veçantë u kemi kushtuar teknikave dhe metodave të përdorura gjatë komunikimit me subjektet në terren.

Kështu, e kemi parë të udhës që me subjekte të zhvillojmë biseda të natyrës private, p.sh.: si është shëndeti i tij dhe i anëtarëve të familjes, si qëndrojnë me gjendjen ekonomike dhe sa po mund ta sigurojnë mirëqenien e tyre, pastaj për të korrat e për të lashtat, për blegtorinë e pyetje të tjera të kësaj natyre. Kemi vepruar kështu, duke menduar se subjektet do ta ndjejnë vetën më të lirshëm dhe do të shprehen në formë krejt natyrale dhe pa asnjë hezitim. Pasi kemi përfunduar bisedat e tilla, atëherë jemi orientuar në tema më konkrete. Gjatë bisedave, përmes vrojtimit dhe incizimit me diktafon të posaçëm, kemi bërë regjistrimin e materialit gjuhësor.

Gjithashtu kemi vënë në përdorim edhe pyetësorët, me ç’rast subjekteve të caktuara, pyetjet ua parashtronim sipas interesit tonë. Gjithë materialin e vjelë e kemi regjistruar në diktafon, por sipas mundësive kemi mbajtur edhe shënime.

Baza teorike e punimit

Për përfundimin sa më të suksesshëm të këtij punimi, përveç punës në terren, kemi konsultuar edhe literaturë të nevojshme teorike, si: monografi mbi të folmet fqinjësore dhe jofqinjësore, studime të specializuara dialektologjike, fjalorthë dialektorë,

fjalorë të gjuhës shqipe, gramatika të shqipes si dhe tekste dhe materiale të tjera profesionale, të nevojshme për punën tonë.

Trajtimi i lëndës gjuhësore të vjelë në terren është bërë mbi parime, kritere dhe metoda shkencore, të njohura në studimet shqiptare të kësaj natyre. Bazuar në këto kritere i kemi pasur më të qarta dhe më të lehta vështrimet, analizimet dhe interpretimet mbi objektin e studimit.

Për hartimin e këtij disertacioni të doktoratës jemi mbështetur në një literaturë mjaft të pasur, të cilën e kemi shënuar te pjesa e bibliografisë së këtij punimi.

Struktura e punimit

Ky punim është strukturuar mbi bazën e tetë kapitujve (krerëve), ku secili prej tyre paraqet njësi në vete, sepse nëpër ta merren në vështrim aspekte dhe çështje të caktuara gjuhësore nga Treva e Istogut, të gjitha këto në funksion të tërësisë përmbajtjesore të këtij punimi.

- Në kapitullin e parë të punimit me titull: *Të dhëna të përgjithshme për Istogun me rrethinë*, e kemi prezantuar trevën e Istogut, duke filluar nga *shtrirja gjeografike, karakteristikat shoqërore dhe ekonomike të zonës, e kaluara historike e Istogut, mbi etimologjinë e topikut Istog, arsimi, kultura, popullsia, fiset dhe vëllazëritë* si dhe kemi bërë paraqitjen e 52 fshatrave, shoqëruar me të dhëna patronimike, toponomastike, historike dhe demografike.

- Në kapitullin e dytë të punimit e kemi përfshirë fushën e fonetikës që përfshin: *theksin, sistemin zanor* me karakteristikat përkatëse, sistemin

bashkëtingëllor, togjet zanore, diftongjet dhe grupet e bashkëtingëlloreve.

- Në kapitullin e tretë kemi paraqitur dukuritë fonetike që veprojnë në të folmen e Istogut, siç janë: *Metafonia (umlauti), apofonia, kontraksioni, shurdhimi, sonorizimi, asimilimi, disimilimi, rëniet e tingujve, metateza, elizioni (elidimi), aglutinacioni*

(përngjitja), palatalizimi, reduktimi, kontraksioni i zanoreve, kontraksioni i bashkëtingëlloreve dhe në fund, analogjia.

- Në kapitullin e katërt zë vend fusha e morfologjisë që përshin: *pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (sistemin emëror, sistemin mbiemëror, sistemin foljor, disa përemra, disa numërorë etj.), si dhe pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, siç janë: ndajfoljet, lidhëzat, nyjat, pasthirrmat, onomatopetë etj.).* Për të gjitha pjesët e ligjëratës janë dhënë shpjegimet përkatëse, shoqëruar me shembuj ilustrues.

- Në kapitullin e pestë kemi bërë fjalë për fjalëformimin si një prej shtyllave kryesore dhe mjaft të rëndësishme për pasurimin e gjuhës. Së këndejmi kemi përmendur këto mjete fjalëformuese: *Parashtesat, prapashtesat, parashtesat dhe prapashtesat njëkohësisht, paranyjëzimi, kompozimi (përbërja), përngjitja (aglutinimi) dhe konversioni.* Për secilin tip të fjalëformimit kemi dhënë shpjegimet përkatëse, shoqëruar me shembuj ilustrues.

- Në kapitullin e gjashtë të punimit është trajtuar pjesa e sintaksës, e cila krahasuar me pjesët e tjera të sistemit gjuhësor në rrafshin dialektor paraqet më pak tipare dalluese. Kjo pjesë e punimit përbëhet nga këto nënpjesë: *Paskajorja në vend të lidhore; përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën; rreth përdorimit të disa parafjalëve; funksioni sintaksor i lidhëzave; përdorimi i urdhërores së foljes; përcaktori themelor (tre/tri) dhe në fund, funksioni i përemrave vetorë.*

- Në kapitullin e shtatë të punimit i kemi paraqitur disa tekste dialektore (krahinore) me qëllim që të vihet në dukje gjuha e gjallë e folësve të këtij krahu të shqipes, e cila më së miri mund të hetohet në stilin rrëfimor (kallëzimor).

- Në kapitullin e tetë, pra në pjesën e fundit të punimit e kemi paraqitur një fjalorth dialektor që përbëhet prej rreth 1800 njësis lexikore, përmes të cilit shpaloset një pjesë e thesarit leksikor të kësaj hapësire shqipfolëse.

- Në pjesën përfundimtare të punimit janë paraqitur shenjat fonetike, shkurtesat për literaturën e përdorur, shkurtesat e tjera si dhe bibliografia e konsultuar.

Adresimi i punimit

Punimi synon të sjellë një kontribut sado modest në studimet dialektologjike shqiptare, dhe si i tillë, mendojmë se do t'u shërbejë të gjithë atyre që në një formë a tjetër merren me studime gjuhësore të shqipes, veçmas dialektologëve.

Përmes këtij punimi synojmë të sjellim një vështrim përmbledhës mbi të folmen e Istogut, duke plotësuar kështu numrin e studimeve monografike mbi të folmet e shqipes, por edhe të ofrojmë kontributin tonë modest në mesin e studimeve të dialektologjisë shqiptare.

Në fund të kësaj pjese hyrëse gjej rastin t'i falënderoj kolegët e mij të punës nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, të cilët gjithherë më kanë ndihmuar dhe më kanë këshilluar pa u kursyer.

Një falënderim të veçantë ia shpreh mentorit tim, prof. dr. Mustafa Ibrahimit, i cili çdoherë më ka këshilluar, më ka nxitur dhe më ka motivuar që punimi të jetë sa më i plotë dhe sa më përmbajtësor.

Në fund fare, jo për nga rëndësia, por për nga radha, një falënderim të veçantë i shpreh familjes sime, e cila në çdo kohë dhe çdo rrethanë u gjend pranë meje.

Mirënjohje dhe falënderime të përbotshme i shpreh babait tim të ndjerë, udhërrëfyesit kryesor të jetës, të orientimit dhe të rrugëtimit tim profesional e jetësor.

Kreu I

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR ISTOGUN ME RRETHINË

Komuna e Istogut

§ 1. Shtrirja gjeografike.- Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriperëndimore të Kosovës (pjesa veriore e Rrafshit të Dukagjinit). Territori i saj është i hapur në të gjitha anët, me përjashtim të veriut, ku kufizohet me vargmalet e Moknës, me lartësi deri në 2.155 metra. Nga verilindja kufizohet me komunën e Zubin Potokut, nga lindja me komunën e Skenderajt, në jug kufizohet me Klinën, nga jugperëndimi dhe perëndimi si kufi ka komunën e Pejës, kurse në pjesën veriore kufizohet me Malin e Zi (komuna e Rozhajës) dhe me Serbinë (Sanxhaku-komuna e Tutinit) dhe ka një sipërfaqe prej 453.84 km².

Pjesa fushore e komunës së Istogut, përmban toka pjellore, që përshkohen nga tre lumenj relativisht të mëdhenj për rrethanat ujore të Kosovës. Lumi më i madh është Drini i Bardhë, ndër lumenjtë më të mëdhenjë në Kosovë (rreth 30 m³ ujë në sekondë. Me mjaft prurje ujore është edhe burimi (lumi) i Vrellës, ndërkaq gjatë pranverës dhe vjeshtës, janë bukur të furishëm edhe lumenjtë si: *Bujena*,

Kujafçi, Shushica, Përroni i Sudenicës e ndonjë tjetër, të cilët shpesh vërshojnë fushat përreth, duke i pasuruar ato me lym prej nga zhvillohet flora dhe fauna mjaft e pasur.

§ 2. Emri Istog dhe e kaluara historike. - Për sa i përket etimologjisë së emrit Isg, qysh herët, por edhe në ditët tona janë dhënë mendime të ndryshme, në të shumtën

etimologji popullore, prandaj edhe pa mbështetjen e nevojshme shkencore. Rrjedhimisht, një nga këto pohime është se topiku Istog përvjen nga emri *shtog* (llojë druri) aq i dendur në këto anë, sidomos në pjesën e sipërme të qytetit të Istogut, mirëpo mendojmë se këtij pohimi dhe të tjerëve si ky u mungon mbështetja dhe argumentimi i nevojshëm shkencor, prandaj ato duhet marrë me rezervë.

Sipas nesh, topiku Istog përvjen nga një antroponim, rëndom siç ka ndodhur te shqiptarët, kur kihet të bëhet me emërvendet, siç është edhe ky i joni. Mendim të njëjtë shpreh edhe gjuhëtari Qemal Murati, kur thekson se topiku Istog “rrjedh nga një emër vetjak homonim” (Murati 2014:41-42). Studiuesi Murati, duke u mbështetur në shënimet e historianit Konstantin Jireček (Jireček 1962:343), përmend patronimin *Stoche* (familje trogirase): *Romanus Stoche* 1259, *Marinus Stoche* 1270, *Maurus Stoche* 1272, që sipas tij, kishte dhënë një patronim me të njëjtin emër, porse në rastin e Istogut, fjalës *Stoche* i është paravënë një *i*-protetike, sipas ligjeve të turqishtes, njëlloj si te Shkup-*Yskup*, Pejë-*Ipek*, Shkodra –*Iskodra* etj. (Murati 2014:42).

Bazuar në gjetjet arkeologjike mund të thuhet se Treva e Istogut ka qenë e banuar që nga kohët e lashta, me një vazhdimësi të pandërprerë ilire-arbërore-shqiptare, pra është dëshmuar se këto hapësira janë banuar se paku që nga periudha dardane. Në të mirë të kësaj flet edhe studiuesi Jahja Drançolli, kur thekson se treva e Istogut “ruan dëshmi e monumente arkeologjike nga fillimet e neolitit (6000-2600 p. e. sonë), kohë kjo kur u ngritën edhe vendbanimet e para, si Rakoshi....etj.” (Drançolli 2008:29).

Vjetërsia dhe autoktonia truallsore e Istogut është marrë në shqyrtim edhe nga studiuesi Ukë Xhemaj, i cili pohon se “me pervijimësi të një ekumeneje me rëndësi në rrugën antike e, i banuar me popullatë dardane që nga antika na paraqitet fshati Rakosh, i përmendur edhe në dokumentet e shkruara të mbretit Urosh Nemanja I më 1253, i cili, Istogun ia dhuron Manastirit të Stonit afër Dubrovnikut.” (Xhemaj 2003:65). Po ashtu, “gjurmë të cilizimit të hershëm iliro-dardan në këto treva janë hasur bri rrugës së lashtë, që gjatë mesjetës, por edhe më herët ka shërbyer si urë lidhëse nga bregdeti

Adriatik për në Plevle- Rozhajë-Kullë e Istog, për të vazhduar tutje në drejtim të qytetit të Mitrovicës e deri në Nish” (Čerškov 1969:74).

Nga ana tjetër, zbulimi i shumë varrezave tumulare dardane dhe ekzistimi i shumë rrugëve antike që përshkonin territorin e kësaj treve, dëshmojnë për lashtësinë dhe autoktoninë e saj shqiptare. Në vazhdë të kësaj që u tha, janë me interes të përmenden edhe gjetjet arkeologjike nga vendbanimi romak në fshatin Studenicë, rreth 7 km në perëndim të Istogut si dhe lokaliteti antik në Ilixhë (Banjë) rreth 15 kilometra në jugperëndim të Istogut në të cilin u zbulua një altar kushtuar Eskulapit Higis dhe Telesforit, që flet për kulturën antike të ndërtimit në këto anë.

Përkitazi me këto gjetje, studiuesi Emil Čerškov (Čerškov 1969:49) pohon se në Banjë të Istogut shtrihet një vendbanim i madh antik, por që edhe në ditët e sotme nuk është gërmuar dhe zbuluar plotësisht.

Në shumë pjesë të trevës së Istogut, ekzistojnë gjurmë të vendbanimeve të vjetra, që në popull quhen gjytete, kështjella, gradishta, kala etj. që shtrihen në kodrinat dhe majet e afërta, si në: Suhogërllë, Banjë, Sine, Lubozhdë, Vrellë, Mojstir etj. (Osmani 2004: 20).

Për qytetërimin e kohës së paleolitit në trevën e Istogut dëshmon edhe Zef Mirdita (Mirdita 1972:10), ndërkaq gjatë neolitit të vonë, e njohur ndryshe si kultura e Vinçës, përmendet fshati Rakosh i Istogut, njëri prej vendbanimeve të rrëzës së bjeshkës.

Në dokumentet e mëvonshme, përkatësisht në vitin 1314, Istogu përmendet në krisobulat kishtare të Stefan Uroshit III. Në këtë dokument përmendet rruga Istog-Bellopojë, ndërkaq më 1348 Istogu është i regjistruar në kartën e Stefan Dushanit, në Manastirin e Shenjësorëve Mihail dhe Gabriel afër Prizrenit.

Për sa i përket periudhës osmane, Istogu si vendbanim, fillimisht përmendet në Defterin e Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, me emrin *Istranmeshi* dhe kishte 10 shtëpi e 8 beqarë (Pulaha 1974:300).

Rreth tre shekuj më vonë, pra më 1761 Istogu përmendet në regjistrin e Manastirit të Deviqit (Devički Katastig) jo si vendbanim, por vetëm si emër lumi, ndërkaq si fshat përmendet në Fjalorin e Vuk Karagjiqit të vitit 1830. (Elezović 1932: 343).

§ 3. Formimi i qendrës administrative të Istogut.- Gjatë sundimit osman, rrethi i Istogut e kishte statusin e kazasë dhe i takonte Sanxhakut të Pejës, ku bënë pjesë edhe kazaja (komuna) e Gjakovës, ajo e Beranës (Ivangradit) dhe e Gucisë.

Në kuptimin e sotëm administrativ, Istogu është themeluar më 1913, pas pushtimit të Kosovës nga ana e ushtrisë serbo-malazeze. Po atë vit, është bërë regjistrimi i popullsisë si dhe caktimi i kufijve administrativë (në 4 komuna): Istog, Gjurakovc, Rakosh, Vrellë.

Kufijtë e sotëm komunalë, afërsisht përputhen me ata të dikurshmit. Më 30 prill 1924, me anë të një dekretligji, Istogu u shpall qytezë, me ç'rast fitoi edhe tiparet dhe funksionet e qendrës administrative. (Grup autorësh 1973:70).

§ 4. Kushtet klimatike.- Treva e Istogut, kryesisht dominohet nga klima kontinentale e mesme, pra me dimra të gjatë e të ftohtë e me verë të nxehtë e me mjaft reshje. Në këtë plan, një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm luajnë edhe faktorët lokalë siç janë: lartësia mbidetare, shtrirja e vargmaleve dhe e luginave si dhe distanca relativisht e afërt me pellgun e lumit Drini i Bardhë edhe me detin Adriatik. Fushat shtrihen në pjesët më të ulta të lartësisë mbidetare në Kosovë, vetëm 350-400 metra. Përmes luginës së Drinit të Bardhë depërtojnë rrymat e ngrohta të klimës mesdhetare. Ndeshja e këtyre rrymave ajrore me malet e larta të Moknës, bën që Istogu të goditet nga erëra veriore, më të fuqishme në Ballkan, të cilat, shpesh fryejnë rrëmbyeshëm deri në 150 km/h. duke shkaktuar dëme të konsiderueshme. Karakteristikë e këtyre erërave të forta është se më shumë godasin fshatrat rrëzë bjeshkëve, por edhe ata të fushës, në thellësi jo më shumë se dhjetë kilometra. (Osmani 2004: 15).

§ 5. Bujqësia.- Sipërfaqet relativisht të mëdha të pyjeve në territorin komunës së Istogut kanë mundësuar jo vetëm plotësimin e nevojave të banorëve vendës për lëndë drusore, por edhe zhvillimin e industrisë së drurit (**Çavolli1997:352**). Bjeshkët e Istogut janë mjaft tërheqëse dhe të përshtatshme për zhvillimin e turizmit malor.

Pjesa veriore e trevës së Istogut karakterizohet për zonat e larta kodrinore-malore që kufizohen me vargmalet e *Bjeshkëve të Thata* me një lartësi mbidetare rreth 2.155 m.

Klima e volitshme, burimet e pasura të ujit si dhe tradita e banorëve vendas rreth punëve të bujqësisë ka bërë që Istogu me rrethinë të njihet për rendimente të larta në prodhimin e kulturave bujqësore siç janë: misri, gruri, tërshëra, thekra, elbi, domatet, specat, shalqini, trangujt, mollët e shumë kultura të tjera bujqësore. Edhe blegtoria, si pjesë shumë e rëndësishme e bujqësisë është mjaft e zhvilluar në këto anë, veçmas kohëve të fundit, ku janë gritur mjaft ferma bujqësore të standardve evropiane, për mbajtjen dhe kultivimin e kafshëve shtëpiake si: lopët, delet, dhitë etj.

§ 6. Arsimi dhe kultura.- Për sa i përket arsimimit, rrethi i Istogut ashtu sikurse edhe pjesa më e madhe e Kosovës, parë historikisht, qëllimshëm është anashkaluar dhe nëpërkëmbur, jo vetëm gjatë sundimit osman, por edhe gjatë atij serb. Mungesa e hapësirave të përshtatshme shkollore, mësimdhënësit e papërgatitur për këtë punë, por edhe pengesat e caktuara politike, për vite me radhë ishin probleme që nuk gjetën zgjidhjen e duhur, prandaj marrë parasysh këtë gjendje, hapja e një shkolle të mesme u vonua mjaft shumë, u desh të pritej deri në vitin 1963, ndonëse edhe në këtë kohë mësimet zhvilloheshin serbo-kroatisht, ndërkaq 4 vjet më vonë filluan edhe mësimet në gjuhën shqipe.

Sot, Istogu si qendër komunale, ka dy shkolla të mesme, gjimnazin si dhe shkollën e mesme profesionale (në Gurakoc). Ka një shkollë fillore, bibliotekën e qytetit, muzeun arkeologjik, sallën e teatrit si dhe palestrën sportive, që është në ndërtim.

Arsimi parashkollor është i organizuar në dy (2) klasë, kurse në mbarë territorin e Komunës së Istogut, ekzistojnë 13 institucione parashkollore, kurse numri i çerdheve është 5. (Të dhëna DKA-së në Istog për vitin shkollor 2017/2018).

Për sa i përket institucioneve të arsimit fillor, në Istog ekziston një shkollë fillore , 10 shkolla amë në fshatra dhe 14 paralele të ndara, pra numri i përgjithshëm i shkollave fillore dhe i atyre të mesme të ulëta është 25. (Të dhëna për vitin shkollor 2017).

Në Istog ekziston pallati i kulturës “Adem Jashari”, ku zhvillohen aktivitete të ndryshme me karakter kulturor e shoqëror. Në përgjithësi ky pallat është funksional, por ka disa resorë që nuk funksionojnë për arsye të mungesës së buxhetit, kurse teatri i qytetit, që dikur ishte në punë, tani më nuk funksionon.

Prej shoqërive kulturore-artistike, më e njohura është SH.K.A. “Selman Kadria”. Nga ana tjetër ekziston edhe Muzeu Arkeologjik i qytetit që është i vendosur në pallatin e kulturës dhe është relativisht i pasur me eksponate. Numri i eksponateve është 280 kurse gjendja e tyre është e kënaqshme.

Istogu ka një traditë të gjatë edhe në sferën letrare e kulturore, përgjithësisht. Ekzistojnë disa grupe letrare, shumica prej tyre veprojnë në kuadër të shkollave.

Për sa i përket sportit, mund të thuhet se ekziston një numër solid i klubeve të regjistruara dhe që janë aktive, ndërkaq gjendja e infrastrukturës sportive është mesatare.

Në të gjitha shkollat janë të asfaltuara terrenet sportive, ekzistojnë dy salla sportive në kuadër të shkollave, kurse stadioni i qytetit është në gjendje të kënaqshme.

§ 7. Popullsia.- Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 , komuna e Istogut ka 39. 154 banorë dhe dendësi popullsie prej 86,5 banorësh/km². Prej banorëve, 36.157 ose rreth 93% janë shqiptarë, shumica të besimit islam, ndërkaq një pjesë e vogël e popullsisë i takojnë besimit të krishterë (katolik). Po ashtu në Istog, jetojnë pak serbë (134); boshnjakë(1142), egjiptianë (1544), romë (39), turq (10) dhe të tjerë të padeklaruar (64).

Të dhënat historike dëshmojnë se, Istogu gjithëherë është banuar me shumicë shqiptare. Në dobi të kësaj flasin edhe dy regjistrimet e popullsisë, të organizuara nga Mbretëria Serbe, Kroate, Sllovene (SKS). Sipas regjistrimit të parë, pra më 1913 rrethi i Istogut ka pasur 18.000 banorë, prej tyre mbi 90 % shqiptarë, kurse sipas regjistrimit të dytë të vitit 1921, rrethi i Istogut kishte 20.159 banorë, prej tyre 14.501 shqiptarë dhe 5.658 serbë. Ndryshimet më të mëdha demografike në dëm të etnisë shqiptare kanë ndodhur midis viteve 1918-1941, por edhe më 1956, kohë kjo kur filloi dëbimi masiv i shqiptarëve, fillimisht në emër të të ashtuquajturës “Reforma agrare” e më vonë si pasojë e “Aksionit” famëkeq për mbledhjen e armëve. Sipas të dhënave historike, vetëm gjatë viteve 1918- 1956, rreth 30 % e popullsisë shqiptare e këtyre anëve, është dëbuar dhunshëm nga tokat stërgjyshore dhe në vend të tyre janë sjellur familje kolonësh serbë e malazezë.

Në lidhje me këto që thamë, studiuesi Noel Malcolm shprehet se: “ndalimi i gjuhës shqipe dhe mohimi i ekzistencës së shqiptarëve, madje edhe si pakicë kombëtare, nuk ishin forma të vetme të presionit mbi shqiptarët e Kosovës, sepse ekzistonte edhe një program i kolonizimit” (Malcolm 2011:347).

Në të vërtetë, kolonizimi, ishte bërë në emër të reformës agrare, me ç’rast bujqve shqiptarë u merreshin tokat dhe të njëjtat u jepeshin falas kolonëve të ardhur, pra zyrtarisht thuhej se programi i kolonizimit ishte produkt i reformës, kurse e vërteta ishte ndryshe. Pra, prurjet e shumta të kolonëve sllavë nga rrethi i Toplicës, Novi Pazarit dhe pjesët e tjera, bëri që struktura demografike e Istogut të pësojë ndryshime të theksuara.

Në tabelën e mëposhtme po paraqesin fshatrat dhe numrin e familjeve të kolonëve serbë, malazezë e boshnjakë, të cilët u vendosën në pronat shqiptare, të pushtuara nga pushteti serbo-sllav gjatë viteve 1918-1941.

Fshati		Nr.i fam.sllv.	Fshati		Nr. i fam. sllv.
1.	Baica	27	19.	Muzhevina	6
2.	Banja	42	20.	Orrobërda	97
3.	Bellopoja	14	21.	Prekalla	1
4.	Caralluka	5	22.	Prigoda	11
5.	Dobrusha	234	23.	Rakoshi	32
6.	Dragolevci	7	24.	Serbobrani	30
7.	Dreja	4	25.	Shalinovica	20
8.	Dubrava	103	26.	Staradrani	9
9.	Gurrakoci	33	27.	Studenica	4
10.	Istogu	15	28.	Suhogërlla	2
11.	Kaliçani	28	29.	Shushica	70
12.	Kashica	3	30.	Tomoci	5
13.	Kërnina	37	31.	Tuçepi	39
14.	Kovraga	31	32.	Uça	1
15.	Lluga	1	33.	Veriqi	62
16.	Llukavci i Begut	8	34.	Vrella	16
17.	Llukavci i Thatë	2	35.	Zallçi	25
18.	Lubova	84	36.	Zhakova	7

§ 8. Fiset dhe vëllazëritë.- Në rrethin e Istogut, ashtu si edhe në trevat e tjera të Kosovës, varësisht elementeve të caktuara shoqërore, zuri vend ndarja sipas fiseve, element ky që dita-ditës po humb kuptimin dhe rëndësinë që kishte dikur.

Mbi bazën e fisit dhe organizimit fisnor, në rrethin e Istogut është emërtuar një zonë e vogël etnografike e njohur si *Gashi*, ndonëse “*pjesëmarrja dominuese e fisit Gash në popullsinë e këtyre fshatrave është si faktor i emërimit të kësaj njësie etnografike*”..., por “*që nuk mohon pjesëmarrjen edhe të pjesëtarëve të fiseve të tjera në bashkëjetesë*” (Xhemaj2003: 23). Fiset kryesore janë: *Krasniqi, Gashi, Shala, Berisha, Kelmendi, Bytyqi, Kastrati, Shoshi, Hoti*, por edhe fiset më të vogla si: *Morina, Kabashi, Thaçi, Kuçi, Kryeziu e Sopi*.

§ 9. Fshatrat.- Kryesisht janë të tipit të dendur, por ka edhe të atillë që janë të shpërndarë në lagje. Mënyra e jetesës dhe organizimi arkitekturor është i formës së përzier, ndërkaq në raste fare të rralla jetesa, shtrirja e objekteve dhe organizimi arkitekturor i tyre, është i organizuar sipas përkatësisë fisnore. Janë të rralla lagjet, që banohen vetëm nga pjesëtarët e një fisi.

Komuna e Istogut, sipas organizimit aktual administrativ ka 51 fshatra siç janë:

§ 10. Banja.- Bashkësi lokale, rreth 15 kilometra në jugperëndim të Istogut. Patronimet : *Bacaj, Mulaj, Sutaj, Hetemaj, Gashi, Dreshaj, Elshani, Sylaj, Morina, Mavraj, Bicaj*, etj, ndërkaq mikrotoponimet më të përmendura janë: *Uji i Tharbt, Bregu i Ilinxhes, Gorromeli, Te ekonomia, Kërrshi i Ilinxhës* etj. Ky vendbanim gjatë mesjetës përmendet në Deferin e Sanxhakut të Shkodrës të 1485, me emrin *Bana*, dhe kishte 54 shtëpi, 2 beqarë dhe 4 të veja (**Pulaha 1974:204**). Në shekujt XVII-XIX, këtu filloi kolonizimi serbë dhe u intensifikua, veçmas, ndërmjet dy Luftërave Botërore, me ç'rast në pronat shqiptare dhunshëm u vendosën 42 familje kolonësh serbë e malazezë (**Obradoviq 2005:327**). Më 1948, Banja kishte 43 shtëpi me 158 banorë. Më 1981 kishte 228 shtëpi me 1171 banorë (614 shqiptarë, 18 serbë, 137 malazezë, 291 myslimanë, 111 të tjerë). Në regjistrimin e dhunshëm serb të vitit 1991 në Banjë qenë regjistruar 29 serbë, 151 malazezë, 361 myslimanë, 2 jugosllavë, 142 romë, 63 egjiptianë dhe 1 të tjerë. Shqiptarët e bojkotuan këtë proces të imponuar nga regjimi i ndhunshëm serb. (**Osmani 2004:70**).

§ 11. Baica.- Shtrihet buzë rrugës automobilistike Pejë-Gurrakoc, rreth 17 km në jugperëndim të Istogut. Patronimet kryesore: *Maksutaj Loxha, Ukaj, Lutaj, Morina, Kastrati, Leskova* si dhe disa familje myslimane (boshnjake), ashkali dhe malazezë , ndërsa mikrotoponimet më në zë janë: *Lugu i Drinit, Muvraku, Dylybregu, Ara e Spahisë, Osoja, Arat e Gata, Dydeshi, Homniku* etj. Në analet e shkruara, fillimthi, me emrin *Balic*,

përmendet në DRSSH¹ 1485 dhe kishte 9 shtëpi, 2 beqarë dhe 2 të veja (Pulaha 1974:63). Ndërmjet viteve 1914-1945, në këtë fshat u sollën 27 familje kolonësh serbë e malazezë (Obradović 2005:326-327).

Më 1905 Baica kishte 20 shtëpi shqiptare, kurse më 1921 numëronte 40 shtëpi me 193 banorë. Më 1948 kishte 58 shtëpi, kurse më 1981 kishte 94 shtëpi me 710 banorë (555 shqiptarë, 1 serb, 42 malazezë, 110 myslimanë, 2 të tjerë). Më 1991 janë regjistruar 108 boshnjakë dhe 13 malazezë, kurse është refuzuar plotësisht nga popullsia shqiptare. (Osmani 2004:72).

§ 12. Belica.- Fshat rreth 13 kilometra në juglindje të Istogut. Etnikisht është fshat i përzier, me popullsia serbe dhe shqiptare. Patronimet shqiptare: *Mulaj* dhe *Halitaj*, kurse mikrotoponimet kryesore janë: *Balega*, *Kopitja*, *Kuçishta*, *Çeshmja*, *Dragalli*, *Orrnica*, *Buçalla*, *Bashtja*, *Otava*, *Shtabi* etj. Në burimet e shkruara, ky fshat, me emrin *Bjeliça* fillimisht përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 20 shtëpi, 5 beqarë dhe 1 të ve. (Pulaha 1974:302).

Më 1961 kishte 72 shtëpi me 529 banorë (72 shqiptarë, 435 serbë, 7 malazezë, 15 të tjerë), ndërsaq më 1981, fshati numëronte 81 shtëpi me 565 banorë, prej tyre 120 shqiptarë, 417 serbë, 10 malazezë, 17 myslimanë, 1 të tjerë. Më 1991 janë regjistruar vetëm 339 serbë (Osmani 2004:75-76).

§ 13. Bellopoja.- Shtrihet rreth 8 kilometra në juglindje të Istogut dhe aktualisht shumë pak i banueshëm nga popullsia shqiptare (vetëm familja *Aliu*), kurse të tjerët janë serbë, bonjakë dhe ashkali. Kolonizimi sllav këtu filloi qysh në shek. XVII- XIX, kohë kjo kur prej këtij fshati dhunshëm u shpëngulën shumë familje shqiptare. Disa nga mikrotoponimet: *Pamuku*, *Batallaku*, *Imerovica*, *Drenjani*, *Joshe*, *Çesta*, *Orrnica*, *Drumina*, *Lokava* etj. (Stijović 1982:292).

¹ Deferi i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës.

Në burimet e shkruara, fillimisht përmendet në kartën e mbretit Uroshi I (1254-1264) e pastaj edhe në kristobulën kishtare të mbretit Dushan të vitit 1348 (**Stijović 1982: 292**). Më 1893 me emrin Bellopojë- Podgur përmendet në sallnamet e Vilajetit të Kosovës (**Osmani 2004:77**). Ndërmjet viteve 1929-1931 në këtë fshat u sollën 14 familje kolonësh sllavë, me rreth 59 anëtarë. (**Obradović 2005:319**).

Më 1921, Bellopja kishte 22 shtëpi dhe 187 banorë. Më 1948 kishte 31 shtëpi e 175 banorë, ndërkah më 1981 ekzistonin 46 shtëpi me 283 banorë, prej tyre 69 shqiptarë, 197 serbë, 2 malazezë, 13 myslimanë, 2 të tjerë. Në regjistrimin e dhunshëm të vitit 1991 janë regjistruar vetëm 140 serbë, 2 malazezë dhe 1 egjiptian (**Osmani 2004:78**).

§ 14. Caralluka.- Vendbanim fushor rreth 15 km në jugperëndim të Istogut. Patronimet: *Rugova, Podrimaj, Sutaj, Sylaj, Xhemaj, Pepaj*, etj., si dhe disa familje serbe dhe ashkali, ndërkah nga mikrotoponimet veçohen këto: *Kroni i Carrallukës, Livadhet e Zajmit, Fushat, Kraishta e Sutit, Ara e Plakut, Arat e Rexhmehmetve, Livadhi i Stanit etj.* Në dokumentet e shkruara, fillimthi, me emrin *Çirnalug*, përmendet DRSSH të vitit 1485 dhe asaj kohe kishte 6 shtëpi e 2 beqarë (**Pulaha 1974:246**). Edhe këtu shteti serb, dhunshëm solli familje kolonësh serbë e malazezë (**Obradović 2005:319**).

Më 1903 kishte 4 shtëpi serbe dhe të tjerat shqiptare, ndërkah më 1921, ky fshat kishte 14 shtëpi e 150 banorë. Më 1948 numëronte 19 shtëpi dhe 178 banorë, ndërsa më 1981 kishte 110 shtëpi me 817 banorë (669 shqiptarë, 42 serbë, 6 malazezë, 98 myslimanë, 2 të tjerë). Në vitin 1991 ishin regjistruar vetëm 5 serbë, 7 malazezë dhe 26 myslimanë. (**Osmani 2004:107**).

§ 15. Cërkolezi.- Fshat, etnikisht i përzier, rreth 12 km në verilindje të Istogut. Patronimet shqiptare janë: *Mahmutaj, Balaj, Ymeraj, Sadrijaj, Jasharaj*, kurse mikrotoponimet kryesore janë: *Gradina, Prilepi, Te Gropa e Uçalive, Rubniku, Mella, Vërbica, Kroni i Vërbices, Kurilla, Shpella e Oshlakut, Kërrshina, Kape, Livadhet e Hânit*,

Lipa, Boronjaku, Samari, Shpella e Klysyres etj. Në burimet e shkruara fillimisht përmendet në Kartën e Princeshës Milica të vitit 1395, i regjistruar si pronë mbretërore që i ishte bërë dhuratë Manastirit të Shenjtë. Në dokumentet osmane, ky fshat, me emrin *Cërkolaz* përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 40 shtëpi, 6 beqarë dhe 1 të ve (Pulaha 1974:2000). Më 1689, emri *Zrkolez* shënohet në një hartë austriake, kurse në vitet 1766-1779 përmendet në regjistrin e Manastirit të Deviqit. (Stijović 1982:337). Më 1921 kishte 35 shtëpi e 339 banorë. Në vitin 1948 numëronte 69 shtëpi me 503 banorë, ndërkaq më 1981 kishte 90 shtëpi, 630 banorë (303 shqiptarë, 326 serbë, 1 malazezë). Në regjistrimin serb të vitit 1991 janë shënuar vetëm 194 serbë dhe 1 malazez (Osmani 2004:88).

§ 16. Cerrca.- Shtrihet përgjatë dy anëve të rrugës Istog- Vrellë, rreth 2 km në perëndim të Istogut. Patronimet: *Rugova, Hasanaj, Kaliqani, Haskaj, Rexhaj, Blakaj*, kurse mikrotoponimet janë: *Gropat e Kaçakve, Corrovoda, Drushtimi, Golaku, Gurrat e Bardha, Dyrekt e Kullave, Sorodoli, Bajshe, Kralica, Lugu i Zajmit, Lluga, Koroniqet, Golina, Shpellat Binake, Karamuçolle, Maja e Cerrc's, Guri i Kuq, Livadhet e Buta, Kashkavalli, Kroni i Morrave, Shpellat e Golakut, Rosuja* etj.

Në burimet e shkruara, përmendet më 1348 në kartën e mbretit Dushan si dhe në Manastirin e Shenjtërorëve Gabriel e Mihajl afër Prizrenit (Novaković 1912: 682). Me emrin *Çerniça* përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 16 shtëpi, 2 beqarë dhe 1 të ve (Pulaha 1974:242). Edhe këtu, shteti serb solli mjaft kolonë serbë e malazezë (Obradović 2005:323). Më 1905 kishte 35 shtëpi shqiptare, kurse më 1921 kishte 46 shtëpi me 410 banorë. Më 1948 kishte 81 shtëpi, me 632 banorë; më 1981 ishin 180 shtëpi me 1410 banorë (1382 shqiptarë, 23 serbë, 3 të tjerë). Më 1991 janë regjistruar 19 banorë serbë, 1 malazez dhe 50 romë, kurse shqiptarët refuzuan këtë proces të manipuluar politikisht (Osmani 2004:90).

§ 17. Dobrusha.- Shtrihet buzë magjistrales Pejë-Mitrovicë, rreth 10 km në jugperëndim të Istogut. Patronimet kryesore janë: *Muçaj, Maxharraj, Tuzi, Demaj, Hajdaraj, Berisha, Mulliqi, Dreshaj, Nikçi, Morina, Pacaj, Elshani, Mehmetaj, Selimaj* si dhe disa familje kolonësh boshnjakë, serbë e malazezë. Mikrotoponimet kryesore janë: *Vuçari, Te Bunari, Kroni i Hajdutit, Epodrum, Kanali i Maxharrit, Ledina, Valla, Lluga, Bregu, Kërla* etj.

Në dokumentet shkrimore, për herë të parë përmendet më 1326 në kartën e Stefan Dushanit, kurse me emrin Dobrushnica përmendet edhe në Kartën e Car Dushanit të vitit 1348, ndërkaq me emrin *Dobroshi i Madh* përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 20 shtëpi, 4 beqarë dhe 1 të ve. (Pulaha 1974:189).

Pas Luftës së Parë Botërore, pushteti serb këtu solli shumë kolonë serbë e malazezë, pra rreth 234 familje kolonësh (Obradović 2005:321) duke u bërë kështu kolonia e dytë më e madhe në pjesën e Dukagjinit Verior.

Më 1921 kishte 80 shtëpi me 396 banorë. Më 1948 ishin 187 shtëpi me 876 banorë, kurse më 1981 numëroheshin 290 shtëpi, me 1852 banorë (285 shqiptarë, 17 serë, 270 malazezë, 1265 myslimanë, 15 të tjerë (Osmani 2004:101-102).

§ 18. Dragoleci.- Vendbanim fushor rreth 3 km. në juglindje të Istogut. Patronimet : *Avdijaj, Hysenaj, Kajtazi, Kastrati, Cakutaj, Ujupaj (ashkali)* dhe një familje serbe, ndërsa mikrotoponimet kryesore janë: *Dushkaja, Rosule, Medreza, Agraxha, Jazi i Begut, Progonet, Kroni i Sasit, Verrishta, Livadhet e Gata, Joshe, Në Grykë t' Livadheve* etj. Me emrin Dragolec përmendet më 1348 në Kartën e Shenjtërorëve Gabriel e Mihail të Prizrenit dhe asaj kohe ky fshat kishte 80 shtëpi, nga të cilat 15 të forta (Stijović 1984:237). Me emrin *Dragonofc* është i shënuar në sallnamet e Vilajetit të Kosovë të vitit 1893. Midis dy Luftërave Botërore, këtu u sollën 7 familje kolonësh serbë e malazezë (Obradović 1985:323). Më 1905 fshati kishte 15 shtëpi serbe e 4 shqiptare. Më 1921 kishte 60 shtëpi me 377 banorë. Më 1948 ekzistonin 85 shtëpi me 455 banorë. Më 1981 u

shënuan 140 shtëpi, me 887 banorë (439 shqiptarë, 406 serbë, 6 malazezë, 1 mysliman, 35 të tjerë), (Osmani 2004:98).

§ 19. Dreja.- Shtrihet rreth 10 km në juglindje të Istogut. Patronimet: *Zagraxha, Zeqiraj, Imeraj, Gashi, Malaj, Pukaj, Dedaj, Raça, Rraci, Kapiti, Abazaj, Kosovalija, Noshaj*, kurse mikrotoponimet më të njohura janë: *Trolli i Vjetër, Kroni n'Ulicë, Arat te Rrahi, Livadhi i Din Imerit, Lluga e Becit, Kodrat e Kokajve, Kujaççi, Kodra e Malishganit, Livadhet e Thata, Lluga e Vidhit, Bunari i Avdisë*, etj. Në burimet e shkruara, për herë të parë, me emrin *Dren*, përmendet në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893.

Ndërmjet viteve 1914-1945 këtu u sollën 4 familje kolonësh malazezë (Obradović 2005:320). Më 1921 fshati i përmendur kishte 12 shtëpi dhe 60 banorë. Më 1948 kishte 31 shtëpi me 197 banorë. Më 1981 kishte 50 shtëpi me 438 banorë (12 serbë, 2 malazezë, 10 myslimanë) e më 1991 ishin shënuar vetëm 14 serbë dhe 11 egjiptianë (Osmani 2004:98).

§ 20. Dubova e Vogël.- Shtrihet buzë bregut të Drinit të Bardhë, rreth 8 km në jugperëndim të Istogut. Patronimet: *Bacaj, Daci, Kelmendi, Lajçi, Demaj, Hasaj, Mehaj* si dhe disa familje boshnjake dhe malazeze, kurse mikrotoponimet kryesore janë: *Seishta, Rroshet, Ara e Verrit, Orashkë, Livadhi i Demë Hysës, Batmoni*, etj. Fillimisht, në dokumentet e shkruara, përmendet në kartën e princeshës Milica në vitin 1395, e cila, këtë fshat ia kishte bërë dhuratë Manastirit të Shën Pantelejit (Novaković 1912:520). Më 1485 fshati përmendet në DRSSH dhe kishte 9 shtëpi, 3 beqarë dhe 1 e ve (Pulaha 1974:280). Midis dy Luftërave Botërore këtu u vendosën 7 familje kolonësh serbë e malazezë (Obradović 2005: 325).

Më 1905 kishte 20 shtëpi. Më 1921 flitet për 121 banorë. Më 1948 kishte 268 shtëpi dhe 160 banorë. Më 1981 kishte 48 shtëpi me 346 banorë (310 shqiptarë, 30 malazezë, 6 myslimanë), kurse më 1991 ishin regjistruar vetëm 1 banorë serb dhe 18 malazezë (Osmani 2004:104).

§ 21. Dubrava.- Vendbanim fushor, rreth 2 km në lindje të Istogut. Patronimet: *Ibrahimaj, Bajramaj, Avdijaj, Sylaj, Kajtazaj* si dhe disa familje boshnjake, ashkali, rome, malazeze e serbe. Mikrotoponimet kryesore: *Raveci, Udha e Drenicës, Rakita, Jellashi, Kllaqunari* etj. Në analet e shkruara, fillimisht, me emrin *Dobrina* përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 10 shtëpi e 3 beqarë (Pulaha 1974: 66).

Në vitet e dy Luftërave Botërore, në pronat shqiptare të këtij fshati u vendosën 122 familje kolonësh sllavë (Obradović 2005:323-324), duke u shndërruar kështu, në një ndër kolonitë më të mëdha sllave në Istog dhe më gjerë.

Më 1942 kishte 471 banorë. Më 1948 kishte 99 shtëpi me 439 banorë; në vitin 1981 kishte 175 shtëpi me 1374 banorë (742 shqiptarë, 54 serbë, 87 malazezë, 222 myslimanë, 269 të tjerë, kryesisht romë). Në regjistrimin e 1991, të cilin e refuzuan shumica shqiptare, në këtë fshat u regjistruan 82 serbë, 64 malazezë, 81 myslimanë, 71 jugosllavë, 169 romë, 117 egjiptianë (Osmani 2004:99).

§ 22. Gurrakoci. -Një prej 4 bashkësive lokale të komunës së Istogut, me shtrirje përgjatë dy anëve dhe kryqëzimit të rrugëve magjistrale Pejë-Mitrovicë dhe Istog-Klinë, rreth 7 km në jug të Istogut. Patronimet: *Fetahaj, Kabashi, Osmanaj, Ferati, Palokaj, Musolli, Jahaj, Bajramaj* , disa familje ashkali dhe serbë, kurse mikrotoponimet kryesore janë: *Ledina e Fetahve, Gurrat e Kocit, Jazi i Gogës, Shavarinat, Vorret e Kqija, Livadhi i Madh, Arat e Shushicës, Lluga, Batallaku, Kroni i Ukëbajramve, Kodra e Peqinve, Bostanishta, Mesir, Terazije, Gusari, Qulina, Lisi i Kish's* etj. Në dokumentet e shkruara, fillimisht përmendet në DRSSH të vitit 1485, me emrin *Gjerbçishta* dhe kishte 17 shtëpi e 4 beqarë. Më vonë, me emrin Gurakoz përmendet në një hartë ushtarake austriake të vitit 1689. Në vitet 1914-1945 u sollën 33 familje kolonësh serbë dhe malazezë (Obradović 2005:319-320).

Kah fundi i shek. XIX, Gurrakoci kishte 40 shtëpi shqiptare (katolike e myslimane). Më 1921 kishte 90 shtëpi me 790 banorë. Më 1948 fshati përbëhej nga 205 shtëpi me

1235 banorë, kurse më 1981 kishte 437 shtëpi me 3106 banorë (2334 shqiptarë, 466 serbë, 261 malazezë, 27 myslimanë, 18 të tjerë), (Osmani 2004:114).

§ 23. Istogu.- Qendër komunale, buzë Malit të Moknës, në pjesën veriore të Rrafshit të Dukagjinit. Patronimet kryesore: *Bytyçi, Bujupaj, Buleshkaj, Bajra, Hysenaj, Jahaj, Ferati, Haxhijaj, Gashi, Blakaj, Gorani, Gusturani, Ademaj, Demiraj, Alushaj, Nimanaj, Jakupi, Kelmendi, Gegolli*, ndërsa mikrotoponimet janë: *Livadhet e Istogut, Prroni i Çaushtit, Lugu i Këzaqës, Lugu i Markut, Livadhet e Strellcit, Lugu i Plepave, Kërrshi i Vneshtës, Livadhet e Synesë, Kërrshi i Epërm, Çuka e Vogël, Kërrshi i Samarit, Livadhet e Zheginës, Kërrshi i Sokolit, Kodra e Koron's, Kërrshi i Burimit, Selillat Kërrshi i Ravnit, Ledina e Gjenovaçës, Bira e Arush's, Çuka e Madhe , Livadhi i Avdylit etj.* Për herë të parë në burimet e shkruara, përmendet në vitin 1314 në kartat e Stefan Dushanit. Po ashtu, më 1348 shënohet në kartën e mbretit Dushan të manastirit të Shenjëtorëve Mihail dhe Gabriel afër Prizrenit (Radovanović 1959:175), kurse në burimet Osmane, përmendet në DRSSH të vitit 1485 , me emrin *Istranmeshi* dhe kishte 10 shtëpi e 8 beqarë (Pulaha 1974:300).

Në vitet 1926-1929 në pronat shqiptare të Istogut u vendosën 15 familje kolonesh serbë e malazezë (Obradović 2005:323). Më 1921, Istogu kishte 112 shtëpi dhe 508 banorë Më 1948 numëronte 335 shtëpi me 2074 banorë. Në vitin 1981 kishte 804 shtëpi me 4478 banorë (2044 shqiptarë, 1318 serbë, 194 malazezë, 153 myslimanë 409 të tjerë). Më 1991 janë regjistruar 1191 banorë serbë, 211 malazezë, 31 myslimanë, 3 kroatë, 10 jugosllavë, 51 shqiptarë, 576 romë, 21 egjiptian dhe 7 të tjerë (Osmani 2004:84).

§ 24. Istogu i Poshtëm.- Vendbanim fushor, rreth 1 km nga qendra e Istogut. Patronimet: *Sylaj, Hulaj, Ademaj, Bajra, Kurtaj, Llapi, Alihajdari, Buleshkaj, Dekaj, Hysenaj, Delijaj, Arifaj, Mehmetukaj*, ndërsa mikrotoponimet janë: *Lenishta, Arat e Alihajdarve, Baltaku, Arat e Sylajve, Selishta, Rrosheli, Lluga, Arat e Gata, Prroni i Çaushit, Arat te Qoshi, Krivaça, Medreza, Janilla, Grezda, Arat e Malit, Te Huli, Bërzhaku, Muleci*.

Më 1921 këtu ishin 88 shtëpi me 527 banorë. Më 1948 ky fshat numëronte 62 shtëpi me 444 banorë, ndërkah në vitin 1981 kishte 195 shtëpi me 1633 banorë (1452 shqiptarë, 130 serbë, 8 malazezë, 46 myslimanë, 2 të tjerë). Më 1991 qenë regjistruar 108 serbë, 8 malazezë, 46 myslimanë, 7 jugosllavë dhe 30 romë (Osmani 2004:86).

§ 25. Kamenica.- Vendbanim tipik fushor, rreth 8 km në jug-perendim të Istogut. Patronimet: *Metaj dhe Lipaj*, kurse mikrotoponimet më të njohura janë: *Ura e Delisë, Ara e Hasan Agës, Ura e Devollit, Temali, Livadhi i Vogël, Ara mi Kullë, Orrnica, Anej Prronit, Livadhi i Poshtër, Lisat e Ahme' Vuthit, Prroni i Kumllës* etj.

§ 26. Kaliçani.- Vendbanim kodrinor, i koncentruar në lagje me lidhje të afërta gjaku, rreth 12 km në perëndim të Istogut. Patronimet: *Zogaj, Metaj, Ukaj, Sejda, Arifaj, Selmanaj, Cakutaj, Osmanaj*. Përveç, patronimeve, për lëndën e onomastikës një interes të veçantë paraqesin edhe mikrotoponimet, që në Kaliçan janë mjaft të shumtë si: *Roga e Shalës, Podi i Gjongeg's, Dydeshti, Arat e Buj's, Livadhi i Gjok's, Fusha e Hasapalit, Livadhi i Markut, Koroniku, Hakanishta, Lugishta e Palgjonit, Kërrshi i Gjongeg's, Kërshi i Paplek's, Bira e Arush's, Brini i Lecit, Kroni i Magjupit, Lugishta e Hasapalit, Shpella e Kadi:s, Llezet, Merleket, Kroni i Zanave, Kroni i Az's, Shkalla e Kaliçanit, Kroni i Zabelit, Mali i Tapave, Brrakat, Rudaku, Çafa e Zhigut, Lugu i Shtjerrave, Gropa e Nuses, Lugu i Belegut, Livadhi i Kish's, Lisi i Kaçamakut, Hithat, Gërbiba, Lugu i Kuajve, Xhuherja, Kallaba, Gropa e Shoshanit, Rrgalla, Bregu i Kik's, Xhuherja, Gurt e Arush's* etj. Në

burimet e shkruara, me emrin *Dolina Kaliçani*, ky fshat përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 3 shtëpi e 2 beqar (**Pulaha 1974:306**).

Në *Dydesht* (mikrotoponim në Kaliçan) janë vendosur 10 familje kolonësh malazezë, kurse në pjesën më qendore të fshatit janë vendosur edhe dy familje të tjera sllave (**Obradoviq 2005:326**). Nga dhuna serbe, shumë shqiptarë të këtij fshati janë shpërngulur në drejtim të Egjiptit, Sirisë, Turqisë, Bosnje dhe Hercegovinës dhe të Shqipërisë.

Më 1921 fshati kishte 39 shtëpi me 382 banorë. Më 1948 numëronte 64 shtëpi me 524 banorë, ndërkajmë 1981 kishte 123 shtëpi me 1068 banorë (prej tyre 10 malazezë). Më 1991 këtu u regjistruan vetëm 4 malazezë (**Osmani 2004:120**).

§ 27. Kashica.- Vendbanim fushor, rreth 15 km në jugperëndim të Istogut. Patrinimet: *Nurçaj, Brahimaj, Shoshi, Berisha, Kelmendi, Krasniqi*, ndërsa mikrotoponimet kryesore janë: *Jalloshat, Livadhi i Madh, Ara e Madhe, Poilla, Seishta, Ostrika, Shavarina*, etj. Fillimisht, me emrin *Kshica* përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 7 shtëpi e 2 beqarë (**Pulaha 1974:281**). Në vitet 1770-1780 është i shënuar në regjistrin e Manastirit të Deviçit .Ndërmjet viteve 1914-1945 në këtë fshat janë vendosur 3 familje kolonësh serbë e malazezë (**Obradoviq 2005:326**).

Më 1921 ky fshat kishte 31 shtëpi me 237 banorë. Më 1948 numëroheshin 48 shtëpi me 287 banorë. Më 1981 kishte 83 shtëpi me 771 banorë (727 shqiptarë, 18 serbë, 9 malazezë, 14 myslimanë, 3 të tjerë), ndërkajmë në regjistrimin e vitit 1991 qenë regjistruar vetëm 1 dhe 10 boshnjakë. (**Osmani 2004:105**).

§ 28. Kërnina.- Vendbanim kodrinor, rreth 12 kilometra në lindje të Istogut.

Patronimet: *Çitaku, Hasanaj, Sylaj, Shala, Boletini, Memaj, Metaj, Alidemaj, Dani*, ndërkaq mikrotoponimet më të njohura janë: *Starasella, Llazova, Lisi i Orlit, Belibregu, Shpia e Miftar Kushës, Sejshita, Zabeli, Buçuku, Gjinxheri, Bregu, Te Kisha e Lluguçit, Kroni i Maxhupit, Lugu i Gjâñë, Broçishta, Gubafci, Osmonica, Kalanica, Ceroviku, Çukafci, Tërshovina, Banishori, Kodra, Arat e Gata, Stojefci, Begllaça, Berishta, Lugu i Mllakut, Arat e Rexh's, Te Kroni i Rakoshit, Rrushet e Memiçve, Otava, Arat e Mdhaja, Zhdrella* etj. Në burimet e shkruara, ky fshat, fillimisht përmendet në DRSSH të vitit 1485, me emrin *Kërnina* dhe kishte 5 shtëpi, 1 beqar e 1 të ve (**Pulaha 1974:332**). Ndërmjet dy Luftërave Botërore, në pronat shqiptare të fshatit janë vendosur 37 familje kolonësh serbë e malazezë (**Obradović 2005: 316**).

Më 1921 *Kërnina* kishte 560 banorë (40 familje shqiptare me 500 anëtarë dhe 10 familje serbe me 60 anëtarë). Më 1948 fshati kishte 72 shtëpi me 533 banorë, ndërkaq më 1981 ekzistonin 122 shtëpi dhe 808 banorë (614 shqiptarë, 169 serbë, 44 malazezë). Regjistrimi i dhunshëm serb i vitit 1991 në këtë fshat, flet për 137 serbë dhe 26 malazezë (**Osmani 2004:122-123**).

§ 29. Koshi.- Vendbanim, rreth 20 km në juglindje të Istogut. Patronimet : *Delijaj, Ukaj, Frrokaj, Paloku, Oroshaj, Gojani, Neziraj (ashkali), Oprashka, Maleshaj (ashkali)* dhe disa familje serbe, kurse mikrotoponimet janë: *Bakaça, Bregu i Samarxhisë, Zabeli, Broçishta, Jazbina, Kosharniku, Ledina, Bregu, Utrina e Deviçit, Te Kisha, Vragovci, Llokve, Te Lisat, Ara e Madhe, Valloga, Llojza, Oprashka, Manove*.

Ky fshat, fillimisht përmendet më 1314 në kristobulën e Stefan Dushanit dhe mbretit Milutin (**Stijević 1982:396**), ndërkaq më 1485 me emrin *Kush*, përmendet edhe në DRSSH. Ako kohe ky fshat kishte 55 shtëpi, 11 beqarë, 3 të veja (**Pulaha 1974:287**).

Më 1921 fshati kishte 27 shtëpi dhe 200 banorë. Më 1948 numëronte 68 shtëpi dhe 501 banorë, ndërkaq më 1981 kishte 122 shtëpi me 808 banorë (227 shqiptarë, 554 serbë, 1 malazezë 26 myslimanë) (Osmani 2004:123).

§ 30. Kovraga. -Vendbanim fushor, rreth 6 km në juglindje të Istogut. Patronimet janë: *Blakaj, Belegu, Vërbiqi, Lucaj, Salihu, Gjocaj, Loshaj, Osmanaj, Haxhijaj*. Prej mikrotoponimeve veçojmë: *Shushica, Mi Vadat, Nër Vadat, Çymyraça, Rrahishta, Errnica, Podina e Korrag've, Bunari te Karaulla, Hajdone , Brexhet*, etj. Ky fshat, në burimet e shkruara, me emrin *Kovaliqa* fillimisht përmendet në DRSSH të vitit 1485 ku kishte 8 shtëpi, 1 beqar e 2 të veja (Pulaha 1974:252) .

Ndërmjet viteve 1914-1945, në pronat shqiptare të këtij fshati, pushteti solli 31 familje kolonësh serbë e malazezë (Obradoviq 2005:319). Në fund të shek. XIX, *Kovraga* kishte 10 shtëpi, prej tyre 4 ishin kulla.

Më 1921 fshati kishte 42 shtëpi dhe 348 banorë. Më 1948 numëronte 84 shtëpi dhe 513 banorë, ndërkaq më 1981 kishte 156 shtëpi me 1084 banorë (622 shqiptarë, 229 serbë, 29 malazezë, 174 myslimanë, 30 të tjerë). Më 1991 ishin shënuar 429 serbë dhe 1 jugosllav (Osmani 2004:127).

§ 31. Lluga. -Vendbanim fushor, i tipit të shpërndarë, rreth 6 km në jug të Istogut. Patronimet: *Balaj, Hysenaj, Zekaj, Hajdinaj, Metalijaj, Kukleci, Ibërdemaj, Imeraj, Blakaj, Sejday, Përgjegjaj, Meshi (Morinë)* etj., kurse mikrotoponimet janë: *Ara Nër Dardhë, Orrnica, Zabeli, Bashkallaku, Livadhi i Bëkut, Shavarina, Litecet*, etj. Më 1921, fshati Lluge kishte 21 shtëpi me 226 banorë.

Më 1948 fshati numëronte 34 shtëpi me 321 banorë, ndërkaq më 1981, kishte 60 shtëpi dhe 620 banorë shqiptarë (Osmani 2004:166).

§ 32. Llukavci i Begut.- Vendbanim fushor, rreth 5 km në jug të Istogut.

Patronimet:*Blakaj, Rugova, Visoqi, Curri, Shabanaj, Berisha, Gërguri, Mehaj, Goruzhda, Zhabolli, Llumnica* si dhe disa familje boshnjake, serbe e malazeze. Mikrotoponimet: *Rrahi, Zallina, Arat e Kronit, Baltaku, Prroni i Zhezhnicave, Bishti i Maxhupit, Ara Nër Kumlla, Arat te Frashnat, Verrishta, Livadhet e Egra* etj. Ky fshat, me emrin që ka sot , për herë të parë përmendet në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893. Edhe në këtë fshati, pushteti sero-sllav, në pronat shqiptare vendosi 8 familje kolonësh, kryesisht malazezë (**Obradoviq 2005:322-323**).

Më 1921 Llukavci i Begut kishte 77 shtëpi me 651 banorë. Më 1948 numëronte 121 shtëpi me 881 banorë, ndërkaq më 1981, kishte 144 shtëpi me 1181 banorë (970 shqiptarë, 86 serbë, 32 malazezë, 8 turq, 79 myslimanë, 6 të tjerë). Më 1991, janë shënuar vetëm 97 serbë, 19 malazezë, 99 myslimanë, 17 shqiptarë dhe 31 romë (**Osmani 2004:74**).

§ 33. Llukavci i Thatë.- Fshat i banuar kryesisht me jo shqiptarë, rreth 11 km në juglindje të Istogut. Në këtë lokalitet janë gjetur mbishkrime të kohës romake (**Mirdita 1981: 259**). Për herë të parë përmendet në DRSSH të vitit 1485 me emrin *Llukavaq* dhe kishte 7 shtëpi, 4 beqarë dhe 1 të ve (**Pulaha 1974:298**). Ndërmjet dy Luftërave Botërore, në pronat shqiptare, pushteti serb me shumicë ka vendosur kolonë serbë e malazezë (**Obradoviq 2005:320**).

Më 1921 ky fshat kishte 20 shtëpi dhe 170 banorë; më 1948 numëronte 43 shtëpi me 271 banorë, ndërkaq në vitin 1981 kishte 53 shtëpi me 326 banorë (121 shqiptarë, 147 serbë, 13 malazezë, 47 myslimanë, 8 të tjerë), kurse më 1991, këtu qenë regjistruar vetëm 85 serbë, 4 malazezë dhe 7 egjiptianë (**Osmani 2004:129**).

§ 34. Lubova.- Vendbanim kodrinor, rreth 18 km në jugperëndim të Istogut.

Patronimet: *Kajtažaj, Hajdaj, Ademaj, Haxhijaj, Morina*, si dhe disa familje boshnjake, serbe- malazeze dhe ashali. Mikrotoponimet: *Arat e Qarrit, Kroni i Mirë, Arat mi Shpi, Lisi i Zë's, Kroni i Bek's, Arat e Bashit, Arat e Gata, Rrahije, Arat n' Breg* etj. Ndërmjet dy Luftërave Botërore, pushteti serb, siç vepronte rëndom, edhe në Lubovë solli 84 familje kolonësh serbë e malazezë (Obradović 2005:325).

Sipas regjistrimit të vitit 1921, Lubova kishte 21 shtëpi me 221 banorë. Më 1948 kishte 81 shtëpi me 469 banorë, derisa në vitin 1981 numëronte 142 shtëpi me 1091 banorë (623 shqiptarë, 4 serbë, 146 malazezë, 318 myslimanë (boshnjakë). Në egjistrimin e vitit 1991 janë shënuar 6 serbë, 67 malazezë, 227 myslimanë, 1 rom, 23 egjiptianë (Osmani 2004:161-162).

§ 35. Lubozhda.- Vendbanim rreth 4 km në perëndim të Istogut.

Patronimet: *Idrizaj, Osaj, Pepaj, Lajçi, Duraku, Dautaj, Kadaž, Janužaj, Sejdižaj, Qetinaž, Zeqiraj, Meshi*, ndërsa mikrotoponimet kryesore janë: *Pollaçeri, Lugu i Dragiçit, Gradina, Shimeku, Kralica, Bradet, Kroni i Kodres, Kanica, Prekaça, Llugat e Mdha, Batallina, Peshnjeva* etj. Në burimet e shkruara, ky fshat, me emrin *Luboshta*, fillimisht përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 10 shtëpi (Pulaha 1974: 271). Po me këtë emër përmendet edhe në sallnamet e Vilajetit të Kosovës më 1893. Midis dy Luftërave Botërore këtu janë vendosur 11 familje kolonësh serbë e malazezë (Obradović 2005: 232). Më 1921 Lubozhda kishte 47 shtëpi me 333 banorë. Më 1948 numëronte 85 shtëpi me 612 banorë, ndërkaq më 1981 kishte 177 shtëpi dhe 1353 banorë (1085 shqiptarë, 203 serbë, 50 malazezë, 2 myslimanë, 13 të tjerë). Më 1991 u regjistruan 154 serbë, 28 malazezë, 8 romë dhe 16 egjiptianë (Osmani 2004:144).

§ 36. Mojstiri.- Fshat kodrinor-malor rreth 4 km. në lindje të Istogut. Patronimet kryesore: *Zekaj, Abazi, Alushaj, Beqiraj, Nekaj, Musaj* si dhe disa familje kolonësh serbë e malazezë. Mikrotoponimet: *Hormoqi i Rexh's, Starasella, Kërrshi i Zi, Tuma, Shtreznica, Liseca, Repishta, Tocila, Radusha, Gllama, Jerebi, Livadhi i Çerkës, Padina, Livadhi i Madh, Striminofci, Pravalia, Rudina, Samari, Kroni i Polan's, Kërshi i Kuq, Shipoti, Kroni i Mihanës, Shkoza, Vraci, Cibreni, Jela* etj. Në dokumentet e shkruara, me emrin *Mostir*, përmendet në DRSSH të vitit 1485. Ishte i ndarë në dy pjesë, pra ishte pronë e dy feudalëve, njëra pjesë me emrin *Mostër*, që kishte 64 shtëpi, 10 beqarë dhe 2 të veja, ndërsa tjetra me emrin *Mostir* me 25 shtëpi e 2 beqarë (**Pulaha 1974:65**).

Më 1921 Mojstiri kishte 21 shtëpi me 190 banorë. Më 1948 numëronte 37 shtëpi me 233 banorë, ndërkaj në vitin 1981, kishte 38 shtëpi me 311 banorë (225 shqiptarë, 86 serbë). Në regjistrimin e vitit 1991, qenë shënuar vetëm 37 banorë serbë (**Osmani 2004:131**).

§ 37. Muzhevina.- Vendbanim fushor, me toka pjellore, rreth 4 km. në jugperëndim të Istogut. Patronimet: *Bardheci, Vuthaj, Ahmetaj, Alimetaj, Jahaj, Balaj, Gashi, Selmanaj, Shala, Dema, Bajramaj, Veselaj, Vekaj, Sylaj, Myrtaj, Dushi, Kolaj, Kurtaj, Sefaj, Qorraj, Shpatollaj*, si dhe disa familje serbe e malazeze. Mikrotoponimet kryesore të fshatit janë: *Livadhet e Egra, Livadhet e Buta, Livadhi i Madh, Arat te Stani, Tërshevina, Lluga e Vogël, Botena, Mi Vade, Rrahishta, Jazi i Gog's, Progomet, Zallina*, etj. Në dokumentet e shkruara, fillimisht përmendet në DRSSH të vitit 1485, me emrin *Muzevanja* dhe kishte 13 shtëpi e 1 beqar (**Pulaha 1974: 243**), ndërkaj më 1893 me emrin *Muzhovina* është i regjistruar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës . Midis dy Luftërave Botërore, në pronat shqiptare të fshatit u vendosën 6 familje kolonësh malazezë (**Obradoviq 2005:323**).

Më 1921 Muzhevina kishte 40 shtëpi e 279 banorë. Më 1948 numëronte 67 shtëpi me 436 banorë, ndërkaj më 1981 kishte 110 shtëpi dhe 895 banorë (710

shqiptarë, 167 serbë, 16 malazezë, 2 myslimanë), kurse më 1991 u regjistruan vetëm 119 banorë serbë dhe 18 malazezë (Osmani 2004:133).

§ 38. Orrobërda.- Vendbanim i tipit të shpërndarë rreth 13 kilometra në perëndim të Istogut. Patronimet: *Pacaj, Zogaj, Hakaj, Miranaj, Turkaj, Mulaj, Hoxhaj, Avdijaj, Maksutaj, Muzlijaj*, kurse mikrotoponimet e fshatit janë: *Zhigu i Hafizit, Vorri i Malsorit, Balta e Thive, Liqeni i Syl'Zeqirit, Kroni i Dydeshit, Harkanoll , Bregu i Kish's, Lugu i Mllakisë, Livadhi i Zek's, Ledinat, Bunari i Kaurrit, Çenxha, Drenova, Prroni i Keq, Luginisht, Dubovci, Prroni i Shevarit, Fanxhe, Gurbuti, Kroni i Sahitit, Xhyzeli* etj. Në burimet e shkruara, me emrin *Butin Brek*, së pari përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 20 shtëpi, 2 beqarë e 2 të veja (Pulaha 1974:295). Po kështu, përmendet edhe në dokumentet e Patrikanës së Pejës më 1543.

Në vitet 1924-1934 në këtë tokat shqiptare të fshatit u sollën 12 familje kolonësh serbë e malazezë (Obradović 2005:324). Ky fshat në vitin 1918 kishte 30 familje me 495 banorë. Më 1948 kishte 67 familje me 467 banorë, ndërkaq më 1981 numëronte 105 familje me 936 banorë (927 shqiptarë, 2 malazezë, 6 myslimanë, 1 të tjerë). Më 1991 ishin regjistruar vetëm 8 banorë myslimanë, sepse siç dihet, procesi ishte bojkotuar nga popullsia shqiptare (Osmani 2004:64).

§ 39. Osojani.- Vendbanim, i banuar kryesisht me serbë e malazezë, rreth 18 km në juglindje të Istogut. Popullsia shqiptare e fshatit është zhvendosur prej kohësh. Mikrotoponimet: *Drenja, Korman, Përlina, Qelia, Bregu i Haxhisë, Ara e Demirajve, Bara, Ara e Kajtazit, Kallilla, Breqa, Çeremida, Arrnica, Bresja, Lesha, Llokva, Beglluci, Bunça, Brodi, Josha, Nerezina, Bogashica, Bregu, Villovishite, Rudenica, Saç, Çuka,, Çulina, Dunjiçe, Kunja, Piskulliça, Vir, Llopçak, etj.* Ky fshat, në dokumentet shkrimore për herë të parë përmendet në vitin 1314, në kartën e mbretit Millutin (Stijović 1982: 349-358).

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1921, Osojani kishte 34 shtëpi me 279 banorë. Më 1948 numëronte 64 shtëpi me 498 banorë, ndërkaq në vitin 1981 kishte 105

shtëpi me 628 banorë (602 serbë, 23 malazezë, 1 shqiptar, 1 jugosllav, 1 tjetër) (Osmani 2004:136).

§ 40. Padalishta.- Vendbanim kodrinor, i tipit të shpërndarë, rreth 13 km në lindje të Istogut. Patronimet: *Ahmetaj, Imeraj, Fetahaj, Loshaj*. Mikrotoponimet: *Ata te Molla e Kuçe, Kroni i Logut, Bunari i Dërvishit, Gujafçi, Ara n' Rrafsh, Fusha e Madhe, Kisha, Kodrat, Mellat, Lugu i Vraniçit, Ara te Zabeli, Lugu i Dervishit, Ara e Ozmânit, Kunguleci, Livadhet e Epërme, Lugat, Lugu i Çitakve, Trolli i Hall's Razë, Ara e Broçit, Ku Shëmet Toka, Bunari i Keç, Vau, Xhadja, Vneshta, Zabeli, Ograxha*. Përmes këtij fshati kalon lumi Kujafç, i cili merret si kufi ndarës- administrativ midis komunës së Istogut dhe asaj të Skënderajt.

Ndërmjet dy Luftërave Botërore, në këtë fshat u vendos një familje kolone serbe (Obradoviq 2005:319). Më 1921, Padalishta kishte 15 shtëpi me 144 banorë. Më 1948 kishte 30 shtëpi me 317 banorë, ndërkaj në vitin 1981 numëronte 74 shtëpi me 716 banorë shqiptarë (Osmani 2004:137).

§ 41. Polana.- Vendbanim, kodrinor-malor, rreth 25 km në juglindje të qytetit të Istogut ku jetojnë vetëm pak familje shqiptare, të besimit të krishterë (Pjetraj dhe Dodaj). Mikrotoponimet: *Hamarishta, Bara, Bregu, Zabeli i Zajmit, Konoplishta, Uji i Maxhupit, Sokaku*, etj. Fillimthi, në burimet e shkruara, me emrin *Bolani*, përmendet në kartën e mbretit Millutin të vitit 1314. Më 1921, Polana kishte 13 shtëpi e 133 banorë. Më 1948 numëronte 31 shtëpi me 244 banorë, ndërkaj në vitin 1981, përbëhej prej 48 shtëpive me 295 banorë (19 shqiptarë, 331 serbë, 3 malazezë). Më 1991 në fshat u regjistruan vetëm 127 serbë dhe 6 shqiptarë. (Osmani 2004:109).

§ 42. Prekalla.- Vendbanim rreth 11 km. në jug të Istogut. Patronimet: *Hoxhaj, Hasanaj, Zemaj Blakaj, Osmanaj* si dhe disa familje të komunitetit ashkali .

Mikrotoponimet: *Rrahi i Azllan Nek's, Lugu i Imerajve, Shkalla e Kasapit, Lugu i Mullinit, Livadhi i Ilirve, Ledina e Kresnesh've, Shpia e Kërstneshe, Tokat e Tishukve, Kroni i Mullinit t' Isniçit, Mullini i Hysen Sadikut, Livadhi i Madh, Te Drini, Mullini i Melve, Çepuraku, Bregu, Ledina e Tishuk've* etj. Për sa u përket burimeve të shkruara, ky fshat fillimisht përmendet në vitin 1893 në sallnamet e Vilajetit të Kosovës.

Midis dy Luftërave Botërore këtu është vendosur një familje kolone serbe (Obradović 2005:323). Më 1921 Prekalla kishte 44 shtëpi me 366 banorë. Më 1948 fshati numëronte 59 shtëpi dhe 436 banorë, ndërkah më 1981 kishte 84 shtëpi me 618 banorë (430 shqiptarë, 165 serbë, 12 malazezë, 11 të tjerë). (Osmani 2004:139).

§ 43. Prigoda.- Vendbanim fushor, i tipit të shpërndarë, rreth 6 km në jugperëndim të Istogut. Patronimet: *Gashi, Dreshaj, Zeqiraj, Kabashi, Blakaj, Sadikaj, Mehaj, Shabanaj, Gorqaj*, si dhe dy familje boshnjake (*Čallaković*). Mikrotoponimet: *Ner Jaze, Shovarina, Ramadane, Zabeli i Feks, Arat e Gata, Torrovaça, Rosula, Mujaheri, Meretë, Sudureku, Gurina, Orrnica, Zallina, Arat e Vrell's* etj. Për sa u përket dokumenteve të shkruara, ky fshat, me emrin *Prikoda*, për herë të parë përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 6 shtëpi, 2 beqarë e 1 të ve (Pulaha 1974:242), ndërkah me emrin *Përgoda*, me 15 shtëpi, 2 beqarë dhe 3 bashtina, përmendet në Defterin Osman të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1582 (Rexha 2001: Tapu Kadastra Arsivi Ankara, nr.59.).

Me emrin *Bragoda*, shënohet në një hartë të ushtrisë austriake të vitit 1689. Midis dy Luftërave Botërore, në pronat dhe shtëpitë shqiptare të fshatit u sollën dhe u vendosën 11 familje kolonësh serbë e malazezë (Obradović 2005:325).

Sipas regjistrimit të vitit 1921, Prigoda kishte 40 shtëpi, me 275 banorë. Më 1948, kishte 49 shtëpi me 343 banorë, ndërsa në vitin 1981, fshati numëronte 70 shtëpi me 702 banorë (646 shqiptarë, 1 serb, 3 malazezë, 51 myslimanë, 1 të tjerë). Më 1991 në Prigodë u regjistruan vetëm 48 banorë serbë, kurse banorët shqiptarë refuzuan regjistrimin. (Osmani 2004:141).

§ 44. Rakoshi.- Vendbanim i tipit të shpërndarë, buzë rrugës Pejë- Mitrovicë, rreth 12 km. në lindje të Istogut. Patronimet: *Hajrizaj, Haxhijaj, Muhaxhiri, Balaj, Tafilaj, Shala*, etj., kurse mikrotoponimet janë: *Selishta, Stodorek, Mella, Trollishta, Rrahina, Shavarina, Tefiç, Zmijanik, Smolica* etj. Në burimet e shkruara, Rakoshi, fillimthi përmendet në vitin 1253, kohë kjo kur mbreti serb Urosh Nemanja I, këtë fshat ia kishte dhuruar Manastirit të Stonit në Dubrovnik (**Stijović 1979: 302**). Rakoshi përmendet edhe në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 18 shtëpi, 7 beqarë dhe 2 të veja (**Pulaha 1974:243**). Midis dy Luftërave Botërore, si kudo tjetër nëpër Kosovë, edhe këtu u vendosën familje kolonësh serbë e malazezë (**Obradović 2005:317-318**).

Më 1921 Rakoshi kishte 29 shtëpi me 272 banorë. Më 1948 numëronte 66 shtëpi me 535 banorë, kurse në vitin 1981 kishte 104 shtëpi me 823 banorë (770 shqiptarë, 29 serbë, 23 malazezë, 1 mysliman). Më 1991 në këtë fshat u regjistruan vetëm 20 serbë dhe 16 malazezë (**Osmani 2004:143**).

§ 45. Serbobrani.- Vendbanim i tipit të shpërndarë, buzë magjistrales Pejë- Mitrovicë, rreth 18 km. në jug të Istogut. Ky fshat, me emrin Serbobran, është pagëzuar nga administrata e dhunshme jugosllave, sipas Serbobranit të Baçkës në Vojvodinë, ndërkaq, deri vonë, banorët shqiptarë e emërtonin me emrin *Sovllak*.

Në vitin 1925, në këtë fshat u vendosën 30 familje kolonësh malazezë, të ardhur nga Mali i Zi dhe serbë të ardhur nga Serbia e Vojvodina (**Obradović 2005:320**). Sipas regjistrimeve, më 1948 fshati kishte 35 shtëpi me 181 banorë, ndërkaq në vitin 1981 kishte 55 shtëpi me 333 banorë (81 shqiptarë, 47 serbë, 135 malazezë, 63 myslimanë, 7 të tjerë). Më 1991 u regjistruan vetëm 25 serbë, 78 malazezë, 13 myslimanë , 10 jugosllavë, 32 shqiptarë, 7 romë dhe 19 egjiptianë (**Osmani 2004:66**).

§ 46. Shalinovica.- Shtrihet rreth 15 km në jug të Istogut. *Patronimet: Zeqiraj, Bajramaj, Desku, Berbati, Kerolli, Karcelli (Hasanaj)*, si dhe disa familje serbe e malazeze. Mikrotoponimet: *Stupe, Samërdan, Boka e Kuçe, Kujaççi, Kamenica, Mali i*

Zagraxhve (Zagraxhe), Toka e Kapitve, Livadhet e Thata, Kulla e Kabashve, Shpijat e Salizeçirve, etj. Në dokumentet e shkruara, ky fshat fillimisht përmendet më 1314 në Kartën e Mbretit Stefan, i cili ia kishte dhuruar Manastirit të Banjskës. Me emrin *Shalnoviça* përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 21 shtëpi e 5 beqarë (**Pulaha 1974:309**). Në vitin 1924, këtu janë vendosur 20 familje kolonësh sllavë (**Obradoviq 2005:318**), ndërkaq disa familje shqiptare (familja Kabashi, Gashi, Dulaj, Maleshaj) janë shpërngulur për në Shqipëri.

Më 1921, fshati kishte 32 shtëpi me 358 banorë. Më 1948 numëronte 43 shtëpi me 230 banorë, kurse më 1981 kishte 52 shtëpi me 381 banorë (109 shqiptarë, 116 malazezë, 42 myslimanë). Më 1991 janë regjistruar vetëm 102 serbë dhe 93 malazezë (**Osmani 2004:70**).

§ 47. Shushica.- Vendbanin kodrino-malor, rreth 8 km në lindje të Istogut. Patronimet: *Sadikaj, Nimanaj, Abdylaj, Salihaj, Osmanaj, Metaj, Selimusaj, Mulaj, Zekaj, Ibrahimaj, Halilaj, Jahaj*. Mikrotoponimet: *Vojdulli, Bregu i Hâ^onit, Vorret e Katunit, Kërshi i Ramës, Arat e Dubravës, Te Kisha, Kroni i Popit, Rrepishta, Kërrshi i Palit, Luxhet, Kroni i Alçikit, Boavica, Kërrshi i Fazlisë, Kroni i Vojdullit, Kërshi i Vogël, Mokna, Livadhet e Selibresë, Trolli i Sejdi Sakës, Soishta, Arat e Metovite, Prrojet, Lumbregu, Lepishta* etj. Në burimet e shkruara, fillimisht përmendet në Kartën e Mbretit Uroshi I (vitet 1254-1265). Me emrin *Sushiqani* përmendet në Krisobulën kishtare të Manastirit të Deçanit të vitit 1330.

Shushica përmendet më 1348, në Kartën e mbretit Dushan, i cili ia kishte bërë dhuratë shenjtorëve Mihail e Gabriel (**Novaković 1912:464**) ndërkaq, me emrin *Shushiça* përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 28 shtëpi, 5 beqarë e 5 të veja (**Pulaha 1974:202**). Ndërmjet dy Lyftërave Botërore, ky fshat u kolonizua me rreth 70 familje serbe e malazeze (**Obradoviq 2005:318**).

Më 1921 *Shushica* kishte 85 shtëpi dhe 702 banorë. Më 1942 kishte 812 banorë (414 meshkuj dhe 398 femra). Më 1948 numëronte 160 shtëpi me 1139 banorë, kurse

më 1981 kishte 195 shtëpi me 1723 banorë (1672 shqiptarë, 13 serbë, 38 malazezë). Më 1991 janë regjistruar vetëm 9 serbë, 6 malazezë dhe 4 kroatë (Osmani 2004:111-112).

§ 48. Sineja.- Fshat, rreth 4 km në lindje të Istogut. Patronimet: *Avdijaj* si dhe disa familje serbe e malazeze. Mikrotoponimet: *Kodra e Krekcit, Bregu, Kodra e Bardhë, Çuka e Madhe, Rudina, Vekshi, Kungullari, Rudeshi, Lugu i Madh, Kroni i Imerit, Rudina e Vogël, Vorret e Kuçit, Rrafshi, Ruishta, Mali i Rrallë, Llokva, Kërrshi i Sokolit, Guri i Shiut, Çelijat, Çuka e Madhe, Bunari i Kadrisë, Çerepi, Pavlaçët, Bregu i Madh, Kroni i Shelnjes, Shkalla e Madhe, Prroni i Keq, Shkalla e Vogël, Selishta, Lugu i Hânit, Kroni i Mihanës, Lugu i Hulit, Balushat, Lugu i Gatë, Vuça, Gropa e Egër* etj. Në burimet e shkruara, fillimisht përmendet më 1348 me emrin *Sinainci*, në kartën e mbretit Dushan, dërguar Manastirit të Shën Gabrielit dhe të Mihajlit afër Prizrenit (Osmani 2004:145), ndërkaq në DRSSH të vitit 1485 përmendet me emrin *Suniça* (Pulaha 1974:406).

Më 1921, fshati kishte 53 shtëpi dhe 302 banorë. Më 1948 numëronte 63 shtëpi me 510 banorë, ndërsa më 1981 kishte 77 shtëpi me 549 banorë (189 shqiptarë, 356 serbë, 1 malazez 2 të tjerë). Më 1991 u regjistruan 236 serbë, kurse banorët shqiptarë për shkak të rrethanave politike, refuzuan regjistrimin. (Osmani 2004:145).

§ 49. Staradrani.- Fshat i tipit fushor, rreth 11 km në jugperëndim të Istogut. Patronimet: *Berisha, Elshani, Mavraj, Etemaj, Grabofci, Thaçi* etj. Mikrotoponimet: *Gurina, Llugat, Derbeshi, Krivaça, Pavada, Rija, Seishta, Prëka, Llazina, Raxhevc* etj.

Në dokumentet e shkruara, me emrin *Stara Andovrani*, fillimisht përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 12 shtëpi, 2 beqarë, 1 të ve (Pulaha 1974:334). Ky fshat, deri vonë banohej vetëm nga shqiptarët, por pas vitit 1928 filloi vendosja e kolonëve serbë e malazezë, në fillim u vendosën 9 familje e më vonë edhe familje të tjera (Obradović 2005:320).

Më 1921, fshati kishte 40 shtëpi me 445 banorë. Më 1948 numëronte 91 shtëpi me 706 banorë, ndërsa më 1981 kishte 129 shtëpi me 1605 banorë (1585 shqiptarë, 4

serbë, 16 malazezë). Në regjistrimin e vitit 1991 u shënuan vetëm 3 banorë serbë, kurse të gjithë banorët shqiptarë e refuzuan këtë proces. (Osmani 2004:94).

§ 50. Studenica.- Vendbanim i tipit të grumbulluar në lagje, rreth 7 km në perëndim të Istogut. Patronimet: *Sadikaj, Maxharraj, Zeqiraj, Sefaj, Balaj, Maksutaj, Ramqaj, Sejdiqaj, Shoshi, Kuçi, Muçaj, Vuthaj*, ndërsa mikrotoponimet e fshatit janë: *Lugu i Paplek's, Lugu i Mahall's, Lugu i Kalluxherit, Bregu i Balic's, Pusi i Ilixhës, Bregu i Theknës, Kërrshi i Paplek's, Kroni i Kalluxherit, Prroni i Bicit, Pusi i Naçit, Kroni i Than's, Kroni i Hasahoxh's, Lugu i Laknave, Kroni i Çarrit, Gurra e Zek's, Fanxhet, Gurishta, Bregu i Lâ⁹m's, Kroni i Sekllës, Bosanishta, Gubavicat, Livadhet e Hoxh's, Bregu i Kish's* etj.

Është një prej qendrave me rëndësi të veçantë arkeologjike. Në burimet e shkruara, fillimisht përmendet në kristobulat e Stefan Uroshit II (1292- 1302) i cili ia kishte bërë dhuratë Manastirit të Hilandarit (*Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë 1962:138*), kurse me emrin *Studenica*, përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 13 shtëpi, 4 beqarë e 1 të ve (Pulaha 1974:324-325). Deri në prag të dy Luftërave Botërore këtu jetonin vetëm shqiptarët, por ndërkohë, pushteti serb në pronat e shqiptarëve dhunshëm solli 4 familje kolonësh malazezë (Obradović 2005:326).

Më 1921 Studenica kishte 40 shtëpi dhe 445 banorë. Më 1948 numëronte 83 shtëpi me 706 banorë, ndërsa më 1981 kishte 130 shtëpi, me 1571 banorë (1570 shqiptarë, 1 mysliman), (Osmani 2004: 117).

§ 51. Suhogërlla.- Vendbanim kodrinor i tipit të grumbulluar, rreth 14 km në verilindje të Istogut. Patronimet: *Kamberaj, Loshi, Tafaj*, ndërsa mikrotoponimet janë: *Livadhet e Epra, Guri i Madh, Rrasat, Lugu i Marës, Fusha e Dardhës, Sapaçi, Ara e Ali Uk's, Kroni i Lugut, Kroni i Rexh's, Ara e Xhenazës, Lugu i Mirkut, Xhyteti, Vorri i Ganës, Gryka e Kujafçit, Krojt e Kish's, Gomuret, Kroni i Kadisë, Kroni i Kamerit, Gertë Varg, Kroni i Llug's, Fierina, Beleçi, Vorret e Jahudive, Guri i Gozhdës , Mella, Hordupi, Kroni i Smajlit* etj. Në burimet e shkruara, ky fshat përmendet në fund të shek. XIII - XIV dhe

asaj kohe ishte qendër e *Rrethit të Suhogërllës*. Më 1314 fshati përmendet në Krisobulën e Stefan Dushanit .

Në vitet 1925 – 1938 këtu janë vendosur 2 familje (me 11 anëtarë) kolonesh serbë (**Obradoviq 2005:319**). Më 1905, Suhogërlla kishte 59 shtëpi (32 shqiptare e 24 serbe). Më 1921, numëronte 58 shtëpi me 398 banorë. Më 1948 kishte 80 shtëpi me 603 banorë, ndërkaq në vitin 1981 kishte 118 shtëpi me 981 banorë (923 shqiptarë, 58 serbë). Më 1991 ishin regjistruar 17 banorë serbë, kurse shqiptarët refuzuan të regjistroheshin (**Osmani 2004:148**).

§ 52. Tomoci.- Vendbanim fushor, i koncentruar në lagje me lidhje të afërta gjaku, rreth 4 km në jug të Istogut. Patronimet: *Shatri, Imeraj, Selmanaj, Xhemaj, Salihaj, Bardhaj, Sylaj, Lulaj, Lubeniqi, Kabashi, Shabanaj, Mehaj, Rexhaj, Llabjani* (egjiptas), si dhe dy familje malazeze, kurse mikrotoponimet e fshatit janë: *Knet e Tomocit, Te Vaga, Therrat e Tomocit, Jazi i Maxhupit, Gumuraça, Batuni, Razori, Terezi, Tëraska, Jazi i Gog's, Livadhet, Sharajeva, Poillat, Bregu* etj. Për sa i përket dokumenteve të shkruara, së pari ky fshat, me emrin *Otomanika* përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 32 shtëpi, 5 beqarë e 1 të ve (**Pulaha 1974:161**). Ndërmjet dy Luftërave Botërore, në *Tomoc* u vendosën 5 familje kolonësh malazezë (**Obradoviq 2005:319**).

Më 1921 Tomoci kishte 50 shtëpi me 340 banorë. Më 1948 numëronte 48 shtëpi dhe 414 banorë, ndërkaq më 1981 kishte 156 shtëpi me 1429 banorë (1347 shqiptarë, 70 serbë, 11 malazezë, 1 të tjerë). Më 1991 janë regjistruar 52 serbë, 21 jugosllavë, 11 shqiptarë, 22 romë dhe 8 egjiptianë. Shumica shqiptare refuzuan të regjistroheshin (**Osmani 2004: 157**).

§ 53. Trubuhoci.- Fshat, rreth 14 km në jug të Istogut. Patronimet:

Çetaj, Osmanaj, Bajraktari, Mehmetaj, Blakaj, Hasanaj, Hasi, Mushaku, kurse mikrotoponimet janë: *Arat e Hoxh's, Arat e Bajraktar've, Zabelet e Ramë Çet's, Te Lisi i Kish's, Orrnica, Livadhet, Mi Vada* etj. Në dokumentet shkrimore, me emrin *Trbuhovci*,

për herë të parë përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 24 shtëpi, 6 beqarë e 2 të veja (**Pulaha 1974:289**). Më 1905 Tomoci kishte 40 shtëpi. Më 1921, kishte 37 shtëpi me 291 banorë. Më 1948 numëronte 36 shtëpi me 333 banorë, ndërkaq më 1981 kishte 75 shtëpi me 830 banorë (**Osmani 2004:160**).

§ 54. Tuqepi.- Vendbanim kodrinor, rreth 12 km në lindje të Istogut. Fshat i banuar me popullsi jo shqiptare. Toponimet: *Begllak, Brod, Bunari, Prroni i Madh, Zhdrella, Zatra, Paskalica, Pojatishta, Plluzhevina, Rosule, Selishta, Topola, Çulina*, etj. Për të parën herë, në dokumentet shkrimore përmendet në regjistrin e Stefan Milutinit të vitit 1314, kurse më 1485, me emrin Tuçep përmendet në DRSSH dhe kishte 50 shtëpi, 5 beqarë, 2 të veja (**Pulaha 1974:218**) .

Midis dy Luftërave Botërore, këtu në pronat shqiptare dhunshëm u vendosën 39 familje kolonësh serbë e malazezë (**Obradović 2005:316-317**), ndërkaq para vitit 1913 fshati banohej vetëm nga shqiptarët. Rreth vitit 1918 ata janë dëbuar nga mbretëria serbe, dhe nuk dihet gjë për fatin e tyre.

Më 1921 Tuçepi kishte 22 shtëpi me 193 banorë. Më 1948 kishte 34 shtëpi me 259 banorë, derisa më 1981, fshati përbëhej prej 64 shtëpish me 350 banorë, ndërkaq më 1991, fshati kishte 323 banorë (**Osmani 2004:159**).

§ 55. Uça.- Vendbanim kodrinor, rreth 16 km në lindje të Istogut. Patronimet: *Hajzeraj, Alidemaj, Kajtazi, Arifaj, Myrtaj, Balaj, Selmanaj, Behlulaj, Muzlijaj, Bajraktari, Ymeraj, Hysenaj, Haxhijaj, Ferataj, Hetemaj*, kurse mikrotoponimet janë: *Kërrshi i Sharraxhive, Kroni i Bardhë, Kroni i Mehmet Dem's, Kroni i Shëjtit, Kroni i Ftoft, Jezeri me Ujë, Prroni i Moknes, Kroni i Rupës, Krojet e Kçija, Fusha e Madhe, Jezeri Çi Flet, Lipa, Kurilla, Arat Mi Katun, Kodra e Keçe, Kërrshat e Blinave, Kroni i Lip's, Maja e Madhe, Kërrshat e Verdhë, Arat N' Bria, Fanxhe, Smonica, Rrahina, Vorret e Mdha, Kërrshi* etj. Në burimet e shkruara për herë të parë përmendet në vitet 1254-1264 në kartën e mbretit Urosh I Nemanja (**Novaković 1912:150**), ndërkaq në dokumentet osmane, me emrin

Oça-Uça përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 15 shtëpi e 3 beqarë (**Pulaha 1974:230**).

Në vitet 1923-1953, në pronat shqiptare të fshatit janë vendosur disa familje kolonësh malazezë (**Obradoviq 2005:318**), kurse familje të tëra shqiptare (Halitaj, Bardhi, Idrizi, Tali, Smajllaj) dhunshëm u shpërngulen në Shqipëri dhe Turqi (**Osmani 2004:164**).

Uça më 1918 kishte 60 familje shqiptare me 700 banorë. Më 1948 numëronte 83 shtëpi me 725 banorë, ndërkaq vitin 1981 ishin regjistruar 124 shtëpi me 1160 banorë (1147 shqiptarë, 13 serbë). Më 1991 janë regjistruar vetëm 17 serbë (**po aty**).

§ 56. Veriqi.- Vendbanim fushor rreth 9 km në juglindje të Istogut.

Patronimet: *Delijaj, Muslijaj, Ibrahimaj, Sylkaj, Boletini, Haxhijaj, Geci, Loshi, Dakaj, Bushi, Kaqkini, Ramaj, Balaj, Igrishta* si dhe disa familje boshnjake, serbe e malazeze. Mikrotoponimet e fshatit janë: *Kaluxherovica, Makva, Joshe, Kodra e Jaklinës, Drejana, Shushica, Bllakaçi, Çerhane, Bakçina, Çesta, Llojze, Karaulla, Trojani, Arrnica, Kuka* etj.

Në aktet e shkruara, ky fshat, fillimisht përmendet në regjistrin e Stefan Dushanit të vitit 1316, kurse 1348 përmendet në kartën e Car Dushanit (**Zadužbine Kosova 1987:414**). Me emrin *Veriq*, përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 21 shtëpi, 4 beqarë, 3 të veja (**Pulaha 1974:319**). Që nga viti 1925, në pronat shqiptare të fshatit u vendosën 62 familje kolonësh sllavë (**Obradoviq 2005:317**).

Më 1921 Veriqi kishte 21 shtëpi me 155 banorë. Në vitin 1948 kishte 65 shtëpi me 334 banorë, kurse në vitin 1981 numëronte 76 shtëpi me 554 banorë (211 shqiptarë, 129 serbë, 5 malazezë, 186 myslimanë, 23 të tjerë), (**Osmani 2004:166**).

§ 57. Veriqi i Ri.- Vendbanim i ri, i formuar pas Luftës së Parë Botërore, në jug të Veriqit. Banorët e parë shqiptarë janë vendosur këtu në vitin 1954. Ky fshat, më 1948

kishte 28 shtëpi, me 131 banorë. Më 1981 kishte 3 familje shqiptare me 19 banorë (Osmani 2004:167).

§ 58. Vrella.- Vendbanim i tipit të dendur, rreth 7 km në perëndim të Istogut.

Është më i madhi fshat në komunën e Istogut dhe njëri prej më të mëdhenjëve në mbarë Kosovën. Patronimet: *Dreshaj, Bicaaj, Maraj, Mavraj, Haxhiaj, Demaj, Rugova, Maxharraj, Blakaj, Dakaj, Berisha, Vuthaj, Ferizaj, Sadrijaj*, kurse mikrotoponimet janë: *Lugu i Madh, Leskoviku, Prroni i Keq, Shpella e Dhive, Kërrshi i Kuq, Loxhe, Kërrshi i Rxumë, Shpella e Barutit, Kungullari, Gurra e Sefisë, Lugu i Shkoz's, Pehari, Mi Udhat, Mali i Djegun, Te Krojzit, Guri i Çaplës, Papurina, Ku u Vra Halil Osmani, Tedeli, Pâjat, Ahi i Pushimit, Kroni i Met's , Shtrashniku, Vorri i Nuses, Rrahijet, Lugu i Butë, Te Bira e Arush's, Shpella e Hoxh's, Prrojet, Lâoma e Dakaj, Prroni i Bicit, Ara e Ferizit, Shavarina, Kodra e Dyn's, Bira e Hutit, Shkalla e Selman Keçit, Te Hazir Dajt* etj. Në burimet e shkruara, Vrella përmendet më 1397 me ç'rast nga ana e princeshës serbe Milica, fshati i ishte bërë dhuratë Manastirit të Deçanit (**Zadužbine Kosova 1987: 418**). Në burimet Osmane, përmendet në DRSSH të vitit 1485 me emrin *Vorodka* dhe kishte 16 shtëpi, 6 beqarë e 2 të veja (**Pulaha 1974:162**), kurse me emrin e sotëm, pra *Vrella*, përmendet në Defterin e Shkodrës të vitit 1582, që i takonte Kazasë së Pejës dhe kishte 43 shtëpi, 14 beqarë dhe 3 bashtina (**Rexha 2001: Tapu Kadastra Arsivi Ankara, nr.59.**).

Në vitet 1928-1938, në pronat shqiptare të fshatit dhunshëm janë vendosur 53 familje kolonësh sllavë, me 239 anëtarë (**Obradoviq 2005:326**) ndërkaq, nga dhuna e pushtetit serb shumë familje shqiptare të këtij fshati u shpërngulën në Siri dhe në Turqi (**Osmani 2004:154**).

Vrella më 1905 kishte 60 shtëpi. Më 1921 numëronte 93 shtëpi dhe 790 banorë. Më 1948 kishte 147 shtëpi me 1359 banorë, ndërkaq më 1981, kishte 312 shtëpi me 2603 banorë (2600 shqiptarë, 2 serbë, 1 malazez). (**Osmani 2004: 108**).

§ 59. Zabllaçi.- Vendbanim fushor që përshkohet nga Lumi Istog, rreth 13 km në jug të Istogut. Patronimet: *Balaj, Mehmetaj, Ahmetaj, Dervishaj*, kurse mikrotoponimet janë: *Lluga e Madhe, Jazi i Gog's, Livadhet te Ura e Gurit, Glipce, Bahçe, Bishtaçe, Bare*. Banorët e fshatit, që të gjithë janë të ardhur nga komuna e Deçanit. Më 1921, Zabllaçi është regjistruar si lagje që kishte 10 shtëpi e 40 banorë. Më 1948 kishte 21 shtëpi dhe 196 banorë, ndërkaq më 1981 këtu u regjistruan 45 shtëpi dhe 492 banorë , prej tyre 491 ishin shqiptarë dhe 1 malazez. (Osmani 2004:108).

§ 60. Zallçi.- Vendbanim i tipit të shpërndarë rreth 12 km në juglindje të Istogut. Patronimet: *Ibrahimaj, Ukaj, Mulaku, Shalaj, Kelmendi* si dhe disa familje ashkali dhe serbe e malazeze. Mikrotoponimet janë: *Vorret e Turqve, Shpati, Kodra, Ura e Gurit, Vorret e Shkive, Livadhet e Thata, Kuklica, Xhelbzina, Kodra* etj. Në burimet e shkruara me emrin *Zhaleç*, fillimisht përmendet në DRSSH të vitit 1485 dhe kishte 29 shtëpi e 6 beqarë (Pulaha 1974: 255). Në vitet 1917-1945 nga dhuna serbe u shpërngulën familjet shqiptare (*Sogojeva, Zagraxha, Shala, Dragidella* etj.) dhe u vendosën në Shqipëri dhe në disa vende të Kosovës.

Më 1905 Zallçi kishte 14 shtëpi shqiptare dhe 8 shtëpi serbe. Më 1921 numëronte 98 shtëpi me 593 banorë. Më 1948 kishte 93 shtëpi me 542 banorë, ndërkaq në vitin 1981 fshati përbëhej nga 124 shtëpi, me 868 banorë (251 shqiptarë, 195 serbë, 81 malazezë, 327 myslimanë, 14 të tjerë), (Osmani 2004:170).

§ 61. Zhakova.- Vendbanim kodrinor rreth 13 km në lindje të Istogut.

Patronimet: *Hajrizaj, Brahimaj, Hysenaj, Idrizaj, Salihaj, Sejdiqaj, Mehmetaj*. Mikrotoponimet janë: *Malet e Vogla, Ara e Rxume, Zabeli i Izlâmit, Prroni i Zhakovës, Prrocka, Arat e Batriçit, Logjet, Mali n' Shpat, Livadhi i Shpatit, Mi Shavarina, Livadhi te Vorret, Osmonica, Javori, Mâja e Madhe, Kosharishta, Livadhi i Çelun , Ograje, Stropci, etj.*

Në dokumentet shkrimore për herë të parë ky fshat përmendet më 1331 në kartën e mbretit Dushan, i cili ia kishte bërë dhuratë Manastirit të Hilandarit (**Novaković 1912:444**). Më 1485, me emrin *Zakova*, përmendet në DRSSH dhe kishte 21 shtëpi e 3 beqarë (**Pulaha 1974:218**). Ndërmjet dy Luftërave Botërore, në pronat e shqiptarëve të fshatit, dhunshëm u vendosën 7 familje kolonësh serbë e malazezë (**Obradović 2005: 318**).

Më 1918 Zhakova kishte 260 banorë (7 familje shqiptare me 60 banorë dhe 18 familje serbe me 200 banorë). Më 1948 kishte 74 shtëpi me 507 banorë, ndërkaq në vitin 1981 kishte 86 shtëpi me 519 banorë (302 shqiptarë, 214 serbë, 2 malazezë, 1 të tjerë). Më 1991 në këtë fshat janë regjistruar 164 banorë serbë dhe 2 malazezë (**Osmani 2004:92**).

§ 62. Studimet e derisotme për Istogun.- Të gjitha studimet gjuhësore, veçmas ato nga fusha e dialektologjisë janë të rëndësishme së veçantë, sepse përmes tyre mundësohet rindërtimi i të kaluarës së një gjuhe. I njëjti po kaq të madhe është edhe studimi i idiomës gjuhësore të Istogut, marrë parasysh faktin se, kjo anë e Kosovës, deri me tani është trajtuar fare pak, veçmas nga rrafshi gjuhësor.

I pari autor që në një mënyrë e mori në shqyrtim të folmen e rrethit të Istogut është serbi Vuk Karagjiqi i cili, më 1830 bëri mbledhjen e disa këngëve popullore nga Gurakoci. Kështu, Karagjiqi “ *të gjitha këto ia dërgoi së bashku me komentin përcjellës shkencëtarit sloven Jernej Kopitarit në Vjenë, për t’i shfrytëzuar në studimet e tij krahasuese ballkanologjike*” (**Pllana 1977:209**).

Më vonë, në këto materiale të Karagjiqit janë mbështetur edhe studiues të tjerë siç janë: albanologu i njohur gjerman, J. G. Von Han; historiani gjerman Leopold Ranke, i cili ka shkruar edhe mbi poezinë popullore, udhëpërshkruesi francez i Turqisë Evropiane, Ami Bue (Boué), pastaj Xhon Bauringu (John Bowring), gjuhëtari dhe studiuesi anglez i poezisë popullore të popujve të ndryshëm si dhe sllavisti P.J. Shafariku. (**Pllana 1977:216**).

Për sa i përket punës së Karagjiqit rreth mbledhjes së materialeve folklorike në Gurakoc e rrethinë, mund të thuhet se puna e tij ishte me mjaft të meta, bazuar nga fakti se ai nuk ishte njohës i mirë i shqipes, megjithëkëtë, puna e tij luajti një rol të

rëndësishëm, sidomos në gjysmën e shekullit XIX, duke u përdorur si referencë për studimet që do të vijonin.

Përveç J. Kopitarit, materialet folklorike nga Gjurakovci (Gurakoci) u morën në shqyrtim edhe nga Franjo Mikloshiq, në studimet e tij ballkanologjike, për të vijuar me ballkanologun Vatroslav Jagiq, dhe fare në fund Norbert Jokli, i cili materialet i botoi në terësi duke i shoqëruar me një koment të gjerë filologjik.

Treva e Istogut, nga aspekte dhe këndvështrime të ndryshme (gjeografik, historik, etnografik, onomastik, e dukshëm më pak nga rrafshi gjuhësor) është marrë në shqyrtim edhe nga autorët e poshtëshënuar:

Sadik Bicaj me punimin e tij *“Tipat dhe mënyrat e fjalëformimit në mikrotoponiminë e Istogut me disa fshatra*, botuar në pëmbledhjen me titull: *“Artikuj gjuhësorë praktikë”*, Prishtinë, 1996. Në këtë punim studimor, autori Bicaj ka trajtuar tipat dhe mënyrat e fjalëformimit në mikrotoponiminë e disa fshatrave të Istogut, megjithëkëtë ky është vetëm një punim dhe, si i tillë është i pamjaftueshëm për të ofruar të dhëna të bollshme dhe gjithëpërfshirëse për të folmen e këtyre anëve.

Në kuptimin etimologjik, Istogu si toponim është marrë në shqyrtim nga gjuhëtari Qemal Murati, në një punim të tij të vitit 2014 me titull *“ Disa patronime dhe toponime të Kosovës në vështrimin etimologjik”*, botuar në GJA, SSHF. 43 (Murati 2014:14-42). Këtu autori Murati, ofron të dhëna me interes për sa i përket etimologjisë së toponimit Istog, por për shkak të natyrës së punimit, ai nuk zgjerohet përtej kësaj problematike.

Disa toponime, veçmas ato me prejardhje greko-bizantine si p.sh.: *Mojstir, Sine etj.* kanë gjetur hapësirë trajtimi në librin me titull *“Onomastikë dhe identitet”*, (studime), të gjuhëtarit Begzad Baliu, botuar nga shtëpia botuese “Era”, në Prishtinë më 2002.

Një autor tjetër, në studimet e të cilit zë vend e folmja e Istogut, veçmas fusha e leksikut është studiuesi Abdullah Zymberi. Ky gjuhëtar, në veprën e tij *“Fjalor popullor me rreth 20000 fjalë”*, botuar në Prishtinë më 2005, ka regjistruar një numër fjalësh të rralla nga kjo e folme, megjithëkëtë fjalori i studiuesit Zymberi, nuk paraqet gjithanshëm thesarin leksikor nga kjo e folme.

Nga ana tjetër, treva e Istogut, nga fushat jashtëgjuhësore (nga spekti etnografik, historik, demografik, gjeografik e social- ekonomik) është marrë në shqyrtim nga autorët dhe veprat si në vijim:

Ukë Xhemaj në veprën e tij *“Etnokultura shqiptare në Podgur (monografi etnologjike)”*, Instituti Albanologjik-Prishtinë, 2003. Në këtë monografi shkencore në mënyrë mjaft shteruese, autori merr në trajtim aspektin etnografik të një treve të veçantë etno-gjeografike të Kosovës siç është Podguri, pjesë e së cilës është edhe Istogu me rrethinë. Siç është e kuptueshme nga vetë titulli i kësaj vepre, aspekti gjuhësor nuk ka qenë caku i këtij studimi.

Një vështrim tjetër studimor, që prek probleme nga aspekti gjeografik, historik dhe ekonomik i Istogut, është edhe punimi *“Varošica Istog u Metohijskom Podguru”*, Zbornik radova Geografskog Instituta, Beograd, 1979 e autorit Milovan Radovanović, por edhe ky punim nuk paraqet ndonjë interes gjuhësor.

Treva e Istogut, vështruar historikisht, sidomos zhvillimet rreth shpërnguljes së dhunshme të shqiptarëve të këtyre anëve dhe zëvendësimi i tyre me kolonë serbë e malazezë, është trajtuar nga studiuesi Milovan Obradović në veprën e tij *“Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë (1918-1941)”*, botuar nga Instituti i Historisë, Prishtinë, 2005. Studiuesi Obradović në këtë vepër paraqet të dhëna mjaft të plota, të argumentuara mirë dhe me shumë interes për sa i përket kolonizimit serb të Kosovës, përfshirë këtu edhe Istogun me rrethinë.

Prej autorëve që kanë shkruar për Istogun është edhe Jusuf Osmani në veprën e tij *“Vendbanimet e Kosovës- Burimi (Istogu)”*, vëll. 12, Prishtinë, 2004. Në këtë studim, autori Osmani sjell të dhëna të ndryshme si: historike, arkeologjike, demografike e social-ekonomike, por mungojnë shënimet me interes gjuhësor.

Në vazhdë të kësaj që u tha, ekzistojnë edhe disa autorë, që në punimet e tyre e kanë trajtuar trevën e Istogut, por duke qenë se janë studime jashtëgjuhësore, nuk e shohim të arsyeshme t'i përmendim këtu.

KREU II

FONETIKA

Tiparet fonetike

§ 63. Theksi.– Një ndër çështjet më të rëndësishme të fonetikës së shqipes është edhe theksi, i cili në ditët e sotme mund të qëndrojë në rrokje të ndryshme, por në të shumtën e ka vendin në rrokjen parafundore, prandaj fjalët janë paraoksitone.

Për sa i përket natyrës së theksit në të folmen e Istogut me rrethinë, është me interes të theksohet se ai nuk përbën ndonjë dallim në krahasim me grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore, pra edhe në Istog theksi është dinamik. Në vazhdë të kësaj që u tha, disa fjalë të gurrës orientale, që në gjuhën burimore dalin me theks fundor, në të folmen në shqyrtim dalin me theks parafundor, p.sh.: *páre* (nga *paré*), *dájre* (*dajré*), *ága* (*agá*), *xhenâ²:ze* (*xhenazé*), *tenxhére* (*tenxheré*), *penxhére* (*penxheré*), *tenéçe* (*teneçé*) etj. Po ashtu, lëvizja e theksit nga pozicioni fundor tek ai parafundor hetohet edhe te fjalët e gurrës sllave, veçmas te disa toponime dhe mikrotoponime. p.sh.: *Staraséll* (*Staraselló*)², *Studeníc* (*Studenicá*), *Kashíc* (*Kashicá*), *Prigód* (*Prigodá*) etj., pra në trevën gjuhësore të Istogut fjalët e tilla dalin me theks parafundor, ashtu sikurse në pjesët e tjera të gegërishtes verilindore.

Me theks parafundor shqiptohen edhe një dorë emrash të gjinisë femërore të gurrës orientale, që dalin me zanoren - *é* të theksuar, p.sh.: *Emíne*, *Feríde*, *Hatíxhe* etj. Nga ana tjetër, me theks fundor dalin fjalët e gurrës orientale të tipit: *sefá*, *sevdalí*, etj, si dhe fjalët e tjera të tipit: *burní*, *budallakí*, *hajní*, *kurvní*, *çikní*, *pleçní* etj. Te një vistër fjalësh, kemi vënë re se theksi është zhvendosur nga tema e fjalës në prapashtesën përkatëse, p.sh.: *xhānarí*, *mīlicí*, *puntorí*, *bostā²nxhí*, *specāxhí*, *laknāxhí* etj. Lëvizja e

² Mikrotoponim në malet e fshatit *Mojstir*.

theksit vihet re edhe te disa fjalë të përbëra, me ç'rast theksi kalon nga fjala e parë në të dytën, p.sh.: **vetülltrásh, gojômél, krymádh, veshgát** etj. Kur kemi të bëjmë me fjalët që përmbajnë grupin zanor **-ue**, kemi vënë re se në të shumtën e rasteve theksi bie në elementin e parë, për shkak të reduktimit të grupit zanor, p.sh.: **prrrú, grú, shtú, smú, shíu, thíu, nxíu** etj. Në këtë plan, edhe përemri vetor i vetës së tretë njëjës **-aj**, del me theks paraoksiton **gǵj**, pra këtu theksi nuk kalon te zanorja **-i**, por mbi zanoren **-a**.

§ 64. Sistemi zanor.- Areali gjuhësor në trajtim është pjesë e gegërishtes verilindore, dhe duke qenë kështu, sistemi tingullor i saj përgjithësisht përkon me këto të folme. Kështu, pra, kjo idiomë gjuhësore përmban gjashtë zanore të theksuara (**a, e, i, o, u, y**) dhe një zanore të patheksuar (**ë**) e cila në shumë raste ka pësuar reduktim, sidomos kur ajo është në pozicion të pa theksuar, pra kur gjendet midis dy bashkëtingëlloreve, por edhe në rastet kur është në pozitë fundore.

Një ndër veçoritë e sistemit fonetik të së folmes në trajtim është hundorëzimi (nazalizimi i zanoreve), mirëpo vihen re edhe raste të caktuara kur një zanore e mirëfilltë hundore është denazalizuar. Kështu, në këtë plan vërehen ndryshime në mënyrën e shqiptimit të zanores **-a** hundore dhe zanores së pa theksuar **-ë**. Po ashtu, hetohen edhe ndryshime për sa i përket gjatësisë së zanoreve si dhe mënyrës së artikulimit të togjeve zanore dhe të diftongjeve.

§ 65. Gjatësia e zanoreve.- Ashtu si në pjesën më të madhe të të folmeve të gegërishtes verilindore, edhe në Istog dëgjohen tri seri zanoresh.

§ 66. Zanoret e shkurtra.- Më së shumti ndeshen në rrokje të tipit të mbyllur: **plëp, lög, līs, dǵsh, fǵerr, lög, shtög, lǵgt, mǵs** etj. Zanore të shkurtra ndeshen edhe në rrokje të tipit të hapur, te foljet e mënyrës urdhërore, p.sh.: **hǵ, punǵ, kallxǵ, kcǵ, pǵ** etj.

Me zanore të shkurtër dalin edhe këto trajta dhe pjesë të ligjëratës:

- nyjat e përparme (*i, e, të*), p.sh.: *ĩ mi:r, ě mi:r, tẽ mi:r*);

- disa mbaresa, pjesë përbërëse të trajtave foljore si: *lexoni, knojshă, hajshě, msovă, knofshĩ*;

- disa pjesë të pandryshueshme të ligjëratës siç janë:

-parafjalët (*tě, mě,*)

-ndajfoljet (*kăh, něr*)

-lidhëzat (*dhě, ě*)

-pjesëzat (*sě, ů*)- (shih Mulaku 2005:30). Ndryshime të caktuara vihen re edhe te fjalët e tipit, *za:ll, cérkač*³ etj., të cilat dalin me rrokje të mbyllur, por zanoret i kanë të gjata ose të mesme.

§ 67. Zanoret e mesme.- Dalin në rrokje të hapura, në mes të fjalës: *djáli, grúni, kėrri, tėrri, i vógli, tėrjela, thėsi, thėrra, lógu, shtógu, lágu, máti prágu, krúj, blúj, lívroj, lívdoj* etj.

§ 68. Zanoret e gjata.- Këto zanore për nga natyra e tyre janë pak më komplekse. Ato janë përfutur për shkak të pozitës së tyre në fund të fjalës, pra kur ato gjenden në rrokje të hapur: *tepsi:, kusi:, raki:, shpi:, kojshi:, vlla:, ka:, ha:, pi:* etj., mirëpo vihen re edhe në këto raste:

1) Në rrokje që përfundojnë me bashkëtingëlloret *l, ll, r*. p.sh.: *ka:l, za:ll, kuma:r, katuna:r, kulma:r, ba:r, tu:ll, pe:l, shke:l* etj.

2) në emrat e pashquar të gjinisë femërore, kur bjen *ě*-ja fundore, p.sh.: *shpa:t, bu:k, thi:k, lo:p, to:k, gro:p, fu:sh* etj.

3) te pjesoret e foljeve, si p.sh.: *berti:t, kosi:t, prashi:t* etj, si dhe në aoristin sigmatik: *pa:sh, dha:sh, la:sh* etj .

4) te mbiemrat: *i ho:ll, i tra:sh, i mi:r, i bu:t, i smu:t* etj.

³ Krua me pak ujë.

Zanoret e gjata ndeshen edhe në rastet kur kemi të bëjmë me shkrirjen e dy zanoreve, p.sh.: **me: pa: (me e pa), me: sha: (me e sha), me: pru:/ me e pru** (Zymberi 1973:79-80). Me zanore të gjatë dalin edhe disa emra vetjakë, p.sh.: **Ru:sh, Mâ:l, Ra:m**, mirëpo kur ata shoqërohen me patronime, atëherë zanorja e gjatë kalon në të shkurtër, (**Rûsh Mehmetja, Măl Sokoli, Răm Alija**) etj.

Është me interes të vihet në dukje fakti se zanoret e gjata takohen më shpesh tek ato fjalë të cilat gjatë zhvillimit (evoluimit) historik të tyre kanë pësuar rënie të ndonjë tingulli ose rrokjeje, prandaj forma e tyre e sotme është e ndryshme nga e kaluara. p. sh. **me tfillu;** në disa raste edhe: **me ftilu** (nga: **met ftiluem**), **me shi:t (me shitun), me knu: (me këndumun/ me knumun/** etj). Kur jemi të numri i njëjësive leksikore, që përmbajnë zanore të theksuar ose të pa theksuar, përgjithësisht, duhet thënë se numri i fjalëve me një zanore të theksuar është më i madh se ai i llojit tjetër. Gjatësia e zanoreve ndikon në dallimin e gjinisë së emrave, p.sh.: **plak** (m)- **pla:k** (f) etj., po ashtu gjatësia, në disa raste mundëson në dallimin e emrave nga pjesorja e foljeve p.sh.: **pshtësh** (emër/lloj ushqimi) dhe **pshe:sh** (pjesorja e foljes) etj.

§ 69. Nazalizimi dhe denazalizimi i zanoreve.- Dialekti i gegërishtes në dallim nga toskërishtja në vete përmban, përveç zanoreve gojore edhe ato hundore. Zanore të tilla (gojore dhe hundore) gjallojnë edhe në Istog me rrethinë. Kështu, kjo vatër gjuhësore përmban këto zanore hundore: **â, î, ê, û, ý**, të cilat ndeshen në këto raste:

- kur pas zanores ka ekzistuar një bashkëtingëllore hundore, e cila ka rënë, p.sh.: **mullî, fshî, lpî, pê, hû, gû.**

- kur pas zanores gjenden bashkëtingëlloret hundore: **n, m**, p.sh: **nâna, sâna, brýma, frýma, fshî, gatûn, shkrûn** etj. Edhe emrat “**mentë** dhe **dhentë** theksohen si: **mêt, dhêt** , ngjashëm si në të folmen e Shalën së Bajgorës, por që dallon nga e folmja e Moravës së Epërme e ndonjë tjetër (Zymberi 1973:80).

Hundorësia në këtë të folme është e llojit primar dhe sekondar. Ja disa shembuj: **Nâna, bâna, sâna, thâna, rrfâna, dhâmi** etj. Në shembuj e dhënë dhe në të tjerë

të këtij lloji, zanorja hundore **â** del me nuancë labializimi dhe për këtë shkak e kemi shënuar kështu (**â^o**).

Zanorja hundore **-ê** shqiptohet me një intensitet mesatar të hundorësisë. p.sh.: **flêj, têrshâ^on, gêrshâ^on** etj., ndërkaq zanorja hundore **-î** vihet re te fjalët e tipit: **hî** (hiri i zjarrit) **fî, sinî** etj. Prania e zanoreve hundore (**â,ê,î,û,ÿ**) nuk është e natyrës absolute, sepse siç thamë, ekzistojnë edhe përjashtime, p.sh.: labializimi i zanores hundore **â** në **â^o** etj. Nga ana tjetër, kur kemi të bëjmë me zanoren **-ë**, ajo është vetëm e tipit gojor. Ndodh kështu për shkak të natyrës specifike të kësaj foneme të shqipes.

§ 70. Reduktimi i zanoreve.- Reduktimi i zanoreve nënkupton shkurtimin e kohëzgjatjes së theksimit të tyre, qofshin të theksuara ose jo, pra në këtë rast kemi të bëjmë me ndryshimin e tonalitetit të tingujve. Procesi në fjalë është karakteristikë e dialektit të gegërishtes dhe si i tillë është i pranishëm edhe në gjeografinë gjuhësore të Istogut.

§ 71. Zanorja a.- Kjo fonemë, përgjithësisht del ashtu si në të folmet e tjera të gegërishtes, mirëpo pëson edhe disa ndryshime. Kështu, p.sh.: te banorët e fshatit Lluga dhe të fshatit Muzhevinë (të ardhur kryesisht nga komuna e Deçanit), **â**-ja hundore, në mjaft raste është labializuar në zanoren **-o**. p.sh.: **nona (nâ^ona), koma (kâ^oma)**, ndërkaq te disa fjalë tjera, zanorja **a** kalon në zanoren hundore- **ê** dhe zanoren **-i**. p.sh.: **nêlt (nalt), plêst (plast), livroj(lavroj), shiloj (shaloj)** etj. (Zymberi 1973: 80-81).

Zanorja **-a** është e llojit të hapët, me timbër të hollë hundorëzimi, kurse te një dorë fjalësh ka pësuar ndryshime, p.sh.: **a>e: rrah-rreh, jap-jep** etj. Parë nga aspekti historik, kalimi i zanores **-a** në **-e** është i vonë dhe siç mund të shihet nga shembujt e dhënë, ky ndryshim ka ndodhur nga ndikimi i bashkëtingëlloreve dridhëse dhe atyre qiellzore (**r, j, l**) kur gjenden në pozicione të afërta, kurse te disa fjalë të gurrës orientale, zanorja **a** në pozitë fundore del e tipit të hapët dhe me timbër të hollë hundorëzimi, p.sh.: **halá, dynjá, çirá** etj., ndërkaq te fjalët me burim sllav, sipas gjasave në të kaluarën-**a** ka kaluar në **ë** dhe së fundmi **ë**-ja fundore ka rënë nga përdorimi, dhe si

rezultat i kësaj ka ardhur te zgjatja e zanores në rrokje të mbyllur p.sh.: **Studen*i:c*** (**Studenica**), **Bai:c** (**Baica**), **Vre:ll** (**Vrella**) etj. Zanorja **-a**, del e gjatë në këto raste:

1. në fund të fjalës me rrokje të hapur: (**vlla:**, **ka:**, **shka:** etj.)
2. te fjalët e gurrës orientale të tipit (**seva:p**, **xheva:p**, **hesa:p** etj.)
3. te foljet e tipit (**ka:**, **tha: la:**, etj.).

Në paradigmen e lakimit, në rasën emërore, zanorja **-a** e kryen funksionin e mbaresës së shumësit, përkatësisht të morfemës **-ë**, p.sh.: te shumësi i disa emrave mashkullorë të tipit: **msu:sa**, **profesora**, **inxhinjera**, **helikoptëra** etj.

§ 72. Dallime të kushtëzuara me zanoren *a*.- Te disa fjalë, zanorja **-a** kalon në **-e**, e në disa të tjera në zanoret hundore **-ê** dhe **-ô**, p. sh.:

- a) **a>e**: **krevet** (**krevat**), **lejthi** (**lajthi**);
- b) **a>ê**: **nêlt** (**nalt**), **lêrg**-(**larg**) etj.
- c) **a>ô**: **kôm** (**kam**), **jôm** (**jam**) etj.

§ 73. Zanorja *e*.- Në të folmen në shqyrtim nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, por edhe nga vetërishtes verilindore, por edhe nga vetë shqipja standarde. Megjithëkëtë, vihen re raste të rrëgjimit të kësaj zanorjeje, p.sh.: mënyra dëftore, koha e tashme, veta e dytë shumës, diateza pësore: **la^hni** (**laheni**), **mso^hni** (**mësoheni**), **lidhni** (**lidheni**) etj. Nga shembujt e dhënë mund të shihet se zanorja **-e** është rrëgjuar plotësisht. Rënia e zanores **-e** hetohet edhe te disa folje të mënyrës dëftore, koha e pakryer, trajta pësore, veta e parë e njëjësit, p.sh.: **lahesha**, **knaqesha**, **mësohesha**, të cilat në Istog bëjnë: **u lajsha**, **u knaqsha**, **u msojsha** etj.

Ekziston mundësia që gjatë zhvillimit historik, zanorja **-e** fillimisht ka kaluar në **-ë** dhe së fundmi ka rënë nga përdorimi, p.sh.: **lahesha- u lahësja-u lajsha** etj. Procesi i tillë fonetik, pra i sinkopës vihet re edhe në disa të folme të toskërishtes (Thomai 1961:184).

§ 74. Dallime të kushtëzuara lidhur me zanoren e.- Me sa kemi vënë re, zanorja - **e** ka pasuar këto ndryshime:

e>ê: *pêm (pemë)*

e>i: *shiçer (sheqer), minil (mendil)*. Kalimi **e>i**, në gjuhë njihet si *metafoni*.

Përkitazi me dallimet e kushtëzuara të zanores **-e**, duhet thënë se ajo theksohet me një timbër më të hapur nga **e**-ja e shqipes standarde, pra te fjalë kur zanorja **-e** ndiqet nga dy e më tepër bashkëtingëllore, p.sh.: ***vétlla (vetulla), pétlla (petulla), hékri (hekuri), lépri (lepuri)*** etj.

Nga ana tjetër, po që se shohim evoluimin e trajtave të fjalëve, mund të ndeshim në shembuj kur zanorja **-e** e pa theksuar ka rënë, e vetme ose komplet rrokja, p.sh.: trajta foljore: ***pasmǐ***, kundrejt formës letrare: ***paskemi*** etj. Zhdukja e zanores **-e** vihet re edhe te ato fjalë kur ajo është në pozicion të hapur, p.sh.: te foljet e tipit: ***me shku:, me knu:, me punu:,*** për format gjegjëse ***me shkue, me knue, me punue*** etj.

§ 75. Zanorja *ë*.- Kjo zanore përbën një nga tiparet dalluese midis dy kryedialekteve të shqipes dhe krahasuar me zanoret e tjera, situata paraqitet paksa më e ndërlikuar. Sot, kjo zanore theksohet e plotë në rastet kur gjendet para tingullit **r**. p.sh.: ***kërkoj, fërkoj, tërfo:j***⁴. Si zanore e plotë theksohet edhe në rastet kur gjendet në rrokjen fundore, pra kur nuk del në rrokje të hapur dhe ndiqet nga ndonjëra prej bashkëtingëlloreve **r, rr, l, ll, m, n**, si p.sh.: ***motër, zemër, themër, thekën, dimën, gogël, i vogël, dasëm, lakën*** etj.

Zanorja **ë** në pozicion fundor ka pësuar rrëgjim të plotë dhe nuk dëgjohet fare, p.sh.: ***mo:ll, to:k, sho:k, zo:rr*** etj, por si kompensim për të është bërë zgjatja e zanores në rrokjen e mbyllur. Rënia e volakit **ë** vihet re edhe në rrokje të mbyllur nistore, p.sh.: ***kta (këta), kto (këto), ksaj (kësaj), ktu (këtu), knej-knena (kënde), kshtu (kështu)*** etj. Po kështu, rënia e saj është realizuar edhe në rrokje të mbyllur fundore, p.sh.: ***lo:pt (lopët), flokt/flok:t (flokët), kraht (krahët)*** etj, kurse te një dorë fjalësh bashkë

⁴ Tërfili.

me zanorën –*ë* ka rënë e gjithë rrokja e fjalës, p.sh.: *thmi:(fëmijë), dý mi: (dy mijë), fî (finjë)* etj.

Zanorja- *ë* nuk dëgjohet as te shumësi i emrave të tipit: *ushta:r, hoxhalla:r, samâ^o:r* etj. Ajo ka rënë edhe te disa parafjalë si dhe te nyja e përparme *të* p.sh.: *n’ pazar, n’ shpî, n’ kojshi:, n’ mu:llî, t’ u:rt, t’ mi:r, t’ pasûn* etj. Spikasin edhe raste të tjera të rënies së kësaj zanorjeje, p.sh.: disa folje të mënyrës dëftore, koha e tashme, veta e parë dhe e dytë e shumësit , p.sh.: *puno:jm, shko:jm, livro:jm, kno:jm, kallzo:jm* etj.

§ 76. Dallime të kushtëzuara me zanoren *ë*.- Kjo fonemë zanore e shqipes, në të folmen në trajtim pëson këto alternime:

ë>i: difte:s (dëftesë)

ë> â^o: kâ^om (këmbë), â^osht (është)

ë>ô: ôsht (është).

§ 77. Zanorja *i*.- Del gati njëlloj sikurse bashkëtingëllorja *j*, pra si një *i* gjysmë e theksuar *j*. Kjo vihet re te disa trajta të sistemit foljor të kësaj ane, p.sh.: koha e kryer e thjeshtë e mënyrës dëftore, veta e tretë e numrit njëjës, forma veprorë: *punoj-(punoj), lexoj (lexoj), knoj (këndoj)* etj, ndërkaq te një vistër fjalësh tjera, zanorja *i* e patheksuar nuk dëgjohet fare p.sh.: *ëpnu (epuni) bûk thmive, rrefenû (rrefehuni) para priftit* etj. Rënia e zanores *i* vihet re edhe te mbaresa vetore e disa foljeve (mënyra dëftore, koha e tashme, forma joveprorë, veta e parë shumës), p.sh.:

shíhem (shihemi), níhem (njihemi), njóftohem (njoftohemi), shoçnóhem (shoqërohemi) etj.

Për sa i përket gjatësisë së theksit, zanorja *i* del tri llojesh:

a) zanore e shkurtër (*î*): *lîs, plîs, godîs, prashîs* etj.;

b) zanore e mesme (*i*) : *lîsi, plîsi, godîti, prashîti* etj.;

c) zanore e gjatë (*i:*) : *rîni:, hajni:, borçli:, nafakli:, msitni:* etj.

§ 78. Dallime të kushtëzuara me zanoren i. Një grup fjalësh, që në shqipen standarde dalin me *-i*, në Istog e rrethinë, marrin *y*, pra kemi kalimin *i>y* p.sh.: *kryp (kripë), bylbyl (bilbil), çylym (qilim)* etj. Dukuria e tillë ndeshet edhe në të folmet e tjera të Kosovës veriore (Mulaku 2005:41). Nga shembujt e dhënë dhe të tjerë të kësaj natyre, mund të kuptohet se labializimi i zanores *i>y* ka ngjarë pikërisht nga ndikimi që ka pësuar nga bashkëtingëlloret e tipit *p, b, m*.

§ 79. Zanorja o. Ruhet mirë dhe mund të thuhet se përkon me të folmet tjera fqinjësore mirëpo, kemi vënë re edhe disa fjalë kur ajo ndryshon, veçmas tek ato fjalë të gurrës orientale dhe asaj sllave, me ç'rast zanorja *o* kalon në *a (o>a)* p.sh.: *nashta (ndoshta), apet (opet), kallaj (kollaj)*. Nga ana tjetër spikasin edhe disa orientalizma ku zanorja *o* nuk ka kaluar në *a* p.sh.: *çóban, ortak kónop, óborr* etj, porse të njëjtat fjalë, në të folmen e Malishevës, të Skënderajt e ndonjë tjetër dalin me zanorën *a (çaban, artak, kanop, aborr* etj.).

§ 80. Dallime të kushtëzuara me zanoren o. Për sa i përket kësaj zanorejeve, duhet thënë se kemi vënë re fare pak raste të alternimit të saj, e për t'u përmendur është kalimi *o>a*, i cili vihet re te disa toponime të burimt sllav, që përfundojnë më sufiksin *ovo (ova)* p.sh.: *Lubova (Lubovo), Dubova (Dubovo), Kosova (Kosovo)* etj.

§ 81. Zanorja u. Kjo fonemë përgjithësisht ruhet mirë, sidomos në pozicion të theksuar, megjithëkëtë bine në sy edhe raste të alternimit të saj, veçmas kur është e patheksuar me ç'rast kalon në zanoren *-ë*, p.sh.: *flútër (flutur), hëkër (hekur), lepër (lepur)* etj. Nga ana tjetër spikasin edhe disa raste të rënies së kësaj zanoreje, posaqërisht kur gjendet afër bashkëtingëlloreve sonante *ll* dhe *r*, p.sh.: *pétllat (petullat), vétllat (vetullat), hékrat (hekurat)* etj. Rënia e zanores *-u* vihet re edhe në këto raste: *mlōj (mbuloj), mlo:j (mbulojë)* etj., ndërkaq te një dorë fjalësh zanorja *u* ka kaluar në *i* dhe *o* p.sh.: *líftōj-(luftoj), dóket (duket)*, p.sh.: *S'pō dóket kurgjâ° pej mjégllë!*

Zanorja e përmendur del në pozicione të ndryshme të fjalës:

a) në fillim: **ushtar, urim, urdhën, ushti:m** etj.;

b) në mes: **bújari, ókupīm, zbukurīm** etj.;

c) në fund të fjalës: **zógu, brégu, shóku** etj.

E shohim të një interesi të veçantë dialektologjik ta potencojmë faktin se, për sa i përket fushës së fitonimisë, një numër fare i vogël emrash nisin me zanoren **-u**, p.sh.: **úfull**- barishtja *Rumex acetosa*- është shumë e rëndësishme dhe njerëzit e përdorin dendur si ushqim, bëjnë "*laknor me ufla*". Kjo bimë për shkak të shijes së thartë quhet **úfull**, përkatësisht **-ufëll**, sipas uthullës (**Sejdiu 1979:269**). Përveç kësaj, kemi regjistruar edhe fitonimin me emrin: **úrov** (bima *Vicia Ervilia*)- në mbarë shqipen quhet *urov*. (**Sejdiu 1979:270**), si dhe **úlz (ulëz)**, **lloj** druri me emrin *Acer tataricum* (**Sejdiu 1979:270**) pra, i ngjashëm me ahun.

§ 82. Dallime të kushtëzuara me zanoren u:- Kjo zanore nuk theksohet te një numër fjalësh (vlen për ato fjalë, rrokjet fundore të të cilave mbyllen nga bashkëtingëlloret **ll** ose **r**) dhe në vend të saj del t zanorja **ë**. p.sh.: **flutër (flutur), hekër (hekur)** etj.

§ 83. Zanorja y:- Kjo fonemë zanore krahas veçorive tjera, përbën një nga tiparet dalluese midis dialekteve dhe nëndialekteve të gjuhës shqipe. Siç dihet, në disa të folme të shqipes, është alternuar në tingullin **i**. Dukuria e tillë, pra kalimi **y>i** së shpeshti ndeshet në të folmet jugore të Shqipërisë, p.sh.: në Gjirokastrë dhe në disa pjesë të tjera jugore të Shqipërisë, për të vijuar me Arbëreshët e Italisë, me Arvanitasit e Greqisë si dhe me Arnautët e Ukrainës, (**Voronina .. 1996:28**). Po ashtu, alternimin **y>i** vihet re edhe te një e trevave shqiptare në Maqedoni si dhe në Luginën e Preshevës, p.sh.: **syni-sini, dryni-drini, ndryshimi-ndrishimi** etj. Kalimi **y>i** fare rrallë ndodh edhe në Istog, p.sh.: **hina (hyra), tim (tym)** etj. Kjo zanore, te një dorë fjalësh të të folmes së Istogut, ka rënë që në rrokjen e parë, p.sh: **fty:r (fytirë)**. Nga ana tjetër, një vistër emrash të gurrës orientale, që në gjuhën burimore dalin me **u**, të njëjtit, në të folmen në shyrtim dalin me

-y, p.sh.: **Avdyl (Avdul), Mevlyde (Mevlude)** etj. Për sa i përket zanores së përmendur, përgjithësisht mund të thuhet se e ruan fizionominë e saj, si të fjalët e gurrës së shqipes ashtu edhe të huazimet (p.sh.: **gjýsa, gjytyrym, kry:**) etj.

§ 84. Dallime të kushtëzuara me zanoren y.- Te një dorë fjalësh ndodh delabializimi i zanores i>y, p.sh.: **Imer (Ymer), çístek (çystek), tǐm (tym), hǐ (hy)** , kurse te disa tjera, zanorja y kalon në u (y>u) p.sh.: **rushfet (ryshfet), burek (byrek)**. Siç shihet nga shembujt, kalimi i zanores y në i , por edhe në u ka ndodhur si rezultat i ndikimit të bashkëtingëlloreve të tipit **b, m, r**.

§ 85. Diftongjet dhe togjet zanore.- Prej dukurive gjuhësore që e karakterizojnë të folmen e Istogut me rrethinë është edhe formimi i togjeve të zanoreve dhe i diftongjeve, por për sa u përket këtyre të fundit, kemi vënë re se në të shumtën e herëve ato monoftongohen, pra diftongjet përgjithësisht nuk janë ruajtur. Fjala vjen, diftongu **-ue** ka përfunduar në zanore të thjeshtë, të tipit të gjatë. Kjo për faktin se, sipas gjasash zanorja e patheksuar, dikur pjesë përbërëse e diftongut, është reduktuar deri në shkallën zero. Ja disa shembuj të reduktimit të diftongut, në rrojke të hapur: **me msu:, me knu:, me punu:, kam lexu:** etj., nga ana tjetër, diftongu i dikurshëm **-ue**, ka përfunduar në vetëm zanore të thjeshtë, kurse te një dorë fjalësh ai del si grup vokalik. Ndodh kështu, kur pas grupit **-ue** nuk pason ndonjë fjalë tjetër, p.sh.: **ka msue, ka kallzue, ka urdhnue** etj. Duhet thënë se shembujt e tillë i kemi regjistruar vetëm te brezi i vjetër, e fare pak tek të rinjtë.

§ 86. Togu ie (je/je).- Togu ngjitës **ie** në idiomën gjuhësore të Istogut në të shumtën e herëve dëgjohet si **-je** e nganjëherë si **-je** : **pjek, mjekërr, vjedh, pje:rdh**, ndërkaq, te disa fjalë, për shkaqe të njohura fonetike, togu i përmendur monoftongohet në zanoren **-i** të gjatë (**i:**), p.sh.: **kam zi: (kam zie), kam ni: (kam nie), di:ll (diell), mi:ll (miell)**. Nga shembujt e dhënë, dëshmohet se togu zanor **-ie** është rrudhur zanorën **-i** , për arsye të përqendrimit të theksit pikërisht mbi këtë zanore.

§ 87. Grupi ye.- Në disa pjesë të gegërishtes verilindore ky grup zanor, përgjithësisht ruhet mirë, por në të folmen në shqyrtim, me sa kemi vërejtur ne, në të shumtën është rrudhur në zanoren -y, p.sh.: *e shkelçýshme (e shkëlqyeshme), e krýme (e kryer) e çkýme(e shkyer), ka msy: (ka mësyer)* etj. Nga ana tjetër, te brezi i moçëm i disa fshatrave, siç janë: Uça, Zhakova, Shushica, Padalishta, Rakoshi, Mojstiri, Sineja, kemi vënë re se ruhet grupi zanor -ye, p.sh.: *kryet, fyell, ka msye, ka krye, ka frye* etj.

§ 88.Togu ae.- Vështruar historikisht, ky grup ka gjetur përdorim të plotë gjithandej trevave shqipfolëse. Në të mirë të kësaj që u tha, dëshmojnë edhe shkrimet e vjetra të shqipes të shekullit XVI-XVII. Në kapërcyell të viteve, ky tog zanor ka pësuar kontraksion, kurse në të folmen tonë, del me një -e të tipit të hapur, me nuancë të hundorësisë, p.sh.: *dhê-* historikisht nga një *dhae; thê* nga *thae* etj. Pra, për sa i përket togut -ae duhet thënë se gjatë punës sonë nuk kemi hetuar asnjë rast të ruajtjes të tij.

§ 89.Togu oe.- Ky grup i vjetër zanor i shqipes, në rrymë të moteve është paraqitur përmes disa trajtash fonetike si: *e, oe* dhe *õ*. Në arealin gjuhësor të Istogut, në të shumtën ka pësuar kontraksion të plotë, përveç atyre fjalëve që dalin me -o të gjatë (*o:*). Në vazhdë të kësaj, duhet thënë se nuk kemi hetuar asnjë rast kur ruhet i plotë togu -oe, apo ndonjë prej formave të tij fonetike, të karakterit historik. Alternime (ndërrime) të togut -oe, p.sh.: *vo: (voe), dro: (droe)* etj.

§ 90. Togu ue.- Është përfutur si rezultat i zhvillimit historik të grupit -oe, që dikur shtrihej gjithandej të folmeve të shqipes. Si rezultat i zhvillimit historik të togut -oe, sot kemi -ue në gegërishte dhe *ua+r* në toskërishte. Për sa i përket të folmes së Istogut, togu -ue në të shumtën haset i monoftonguar në zanoren -u , ndërkaq, ruhet i plotë vetë te një numër i kufizuar fjalësh (*ue*-kryesisht te të moshuarit). Kontraksioni i

togut **-ue**, sjell zgjatjen e zanores **-u**, p.sh.: **gru: (grue), thu: (thue), prru: (prue), me sakatu:(me sakatue)** etj.

§ 91. Sistemi bashkëtingëllor.- Historikisht i është nënshtruar ndryshimeve më të mëdha se sistemi zanor. Shtrirja e këtyre ndryshimeve përgjithësisht përkon me lëvizjet (valencat), që shfaqen përgjatë pjesëve të ndryshme të gegërishtes verilindore, prandaj mund të thuhet se sistemi konsonantik i të folmes së Istogut nuk dallon shumë nga ai nga ai i të folmeve fqinjësore. Rrethi gjuhësor në shqyrtim përmban këtë inventar bashkëtingëlloresh:

-17 bashkëtingëllore të zëshme : *b, d, dh, g, j, l, ll, m, n, nj, r, rr, v, x, xh, z, zh;*

-10 bashkëtingëllore të pa zëshme (të shurdhëta) *c, ç, f, h, k, p, s, sh, t, th*, kurse qiftet e bashkëtingëlloreve janë : *p-b, t-d, f-v, k-g, ç-xh, s-z, c-x, th-dh, sh-zh.*

Të zhurmëta	Buzore	Dhëmbore	Alveolare	Qie. alv.	Qie. Palat.	Grykore
Të shurdhëta	p	t	c	ç	-	k
Mbyll. të zësh.	b	d	x	xh	-	g
Të shurdhëta	f	th	s	sh	-	h
Shteg. të zësh.	v	dh	z	zh	-	-
Hundore	m	n	p	-	nj	-
Sonante	-	ll	l	-	-	-
Anësore	-	-	-	-	-	-
Mesore	-	-	-	-	j	-
Dridhëse	-	-	r, rr	-		

Tabela 1. Klasifimi i bashkëtingëlloreve në arealin gjuhësor të Istogut.

Është me interes të vihet në dukje fakti se, bashkëtingëlloret palatale **q, gj** këtu nuk paraqesin tipare dalluese fonetike, pavarësisht pozicionit të tyre në fjalë, ngase ka kohë që janë afrikatizuar në bashkëtingëlloret **ç, xh**.

§ 92. Bashkëtingëllorja *h*. Përbën një nga tiparet dalluese midis të folmeve shqipe. p.sh.: në gegërishten jugore, bashkëtingëllorja *-h* ka kaluar në buzore-dhëmboren - *f*. p.sh.: *shof (shoh), rraf (rrah), njoft (njoh)* etj.

Për sa i përket arealit gjuhësor në shqyrtim, fonema *-h* ruhet deri në njëfarë mase, pra del në fillim të fjalës (*hap, ha, hapsi:n*); në mes (*ahi:sht, marrhaba*), por dëgjohet fare në pozicion fundor të fjalëve p.sh.: (*te^h, she^h, ple^h*, etj).

Fonema *h* me vlerë epentetike del në diatezat (format) pësore dhe vetvetore të foljeve vokalike, p.sh.: *lyhet, fryhet, çkyhet, thehet* etj. Kjo bashkëtingëllore ruhet mirë te disa ndajfolje që shoqërohen me parafjalën e rasës rrjedhore *prej/pej+* mbaresa e rasës rrjedhore *-it* p.sh.: *pej aty+h+it, pej atje+h+it, pej anej+h+it* etj. Te rastet ti këto, *h*-ja del e ngjashme me *-h* epentetike të foljeve vokalike, p.sh.: *bléhet, kréhet, krúhet* etj. Nga ana tjetër, për sa u përket huazimeve, p.sh.: te orientalizmat dhe sllavizmat bashkëtingëllorja *h* ruhet e plotë: në turqizma: *hájr, hámam, hesáp, háta, ho:xh* etj; në sllavizma: *stréh, gërrha:t* etj.

Është me interes të përmendet fakti, se në disa të folme të Kosovës, fonema *-h* ruhet te sllavizma, përderisa në gjuhën burimore (sllave) nuk përdoret, p.sh.: topiku Suhareka (serb.*Suvareka*).Kështu ngjet edhe me fjalët: *streha (serb.strea), Suhogërlla (serb.Suvagrla)* etj.

Në të folmen tonë, por edhe në disa të folme fqinjësore, bie fjala në atë të Shalës së Bajgorës, për dallim nga shqipja standarde, me *-h* dalin fjalët: *harrën, harrnoj, harrnim, harrne:s*, si dhe te turqizmat: *halet, hazdi:s* etj.

Shembuj të përdorimit të bashkëtingëllores *-h* në pozicione të ndryshme të fjalës:

-në ballë të fjalës: *hesáp, hap, herët, hâ^ona, hástret, hapsín* etj.

-në trup të fjalës: *at'he:r, pahíri, Tahir* etj.

Vihet re se, te disa shembuj bashkëtingëllorja *h* në trup të fjalës del me theks fare të zbehtë, p.sh.: *a^hi:sht, kra^hi:n. i lé^ht, i nxé^ht, i zbé^h:t* etj. Bashkëtingëllorja e përmendur, dëgjohet shumë pak edhe kur është me pozitë të rrokjes fundore, pra kur

bën mbylljen e rrokjen, p.sh.: *shô^h (shoh), xhyna^h (gjynah), le: ^h (leh), sàba^h (sabah)* etj.

§ 93. Kalimi i bashkëtingëllores *h* në *f*.- Te disa fjalë, kur grykorja *-h* është ndjekur nga bashkëtingëllorja *-t*, është bërë ndërrimi cilësor i këtyre tingujve, p.sh.: *i ftoft (i ftohtë), t' ftoftit (të ftohtit), njëfta (njoha), ftófa (ftoha)* etj.

Te fjalët e tipit si: *ftófa, njëfta* etj., kalimi *h>f* ka ardhur nga ndikimi i fonemës *-f*, pra kemi kalimin *ht > ft*. Mendojmë se kjo ka ndodhur për lehtësi shqiptimi, sepse siç dihet, shtegorja *h* + bashkëtingëllorja gjuhore-dhëmbore - *t*, formojnë *-ht*, me ç'rast ka pengesa në shqiptim. Ndodh kështu, sepse vendi i nyjtimit të fonemës *-h* dhe i asaj *-t* janë larg njëra-tjetrës, prandaj shtegorja *-h* ka kaluar në *f + t*, si tinguj të afërt për nga ana nyjtëtimore.

§ 94. Bashkëtingëlloret *k, g*.- Këto fonema, përgjithësisht ruhen mirë, pra në të gjitha pozicionet (në ballë, në trup dhe në fund të fjalës), por kemi vënë re edhe raste të palatalizimit (respektivisht afrikatizimit) të tyre, sidomos kur janë në pozicion fundor të fjalëve, përkatësisht kur kryejnë funksionin e mbaresës së shumësit, p.sh.: *mik- miç, lak- lëç(e), peshk-peshç (i), plak- pleç, breg-bríxh (e), lug-lúxh(e), burg-búrxh(e)* etj.

Në opozicion me tinguj e tjerë, bashkëtingëllorja *k* vërehet në këto raste.

<i>k/g:</i>	<i>kāt/gāt</i>
<i>k/t:</i>	<i>ku:rr/ tu:rr.</i>
<i>k/th:</i>	<i>thíka/thítha</i>
<i>k/s:</i>	<i>ku:p/su:p</i>
<i>k/z:</i>	<i>ko:rr/zo:rr etj.</i>

Okluzivja e shurdhët *-k* shqiptohet në të gjitha pozicionet (në ballë, në trup dhe në fund të fjalëve), p.sh.:

a) në ballë të fjalës: *kíme, ke:p, kúnâ^ota, ka:, káshta, kê^onga, krísma* etj;

b) në trup të fjalës: *bŭkurí, lakŏj, bekŏj, shtektŏj, Bekim* etj.;

c) në fund të fjalës: **brisk, rrisk, pick, armik, ballnik, pishpirik** etj.

Edhe bashkëtingëllorja **-g** ruhet mirë në të gjitha pozicionet e fjalës.

a) në ballë të fjalës: **gërdhâ^gj, gërshâ^gn, gisht, gusht, Gashi, grry:j** etj.;

b) në trup të fjalës: **pagu:j, largoj, përgoj, përgadíti** etj.;

c) në fund të fjalës: **zog, breg, lug, lu:g, breg** etj.

Në opozicion me tingujt e tjerë, bashkëtingëllorja **-g** vërehet në këto raste :

<i>g/m:</i>	<i>gu:sh/mu:sh; gaz/maz</i>
<i>g/v:</i>	<i>ga:l/ va:l; gra:/vra:</i>
<i>g/n:</i>	<i>ga:l/na:l</i>
<i>g/dh:</i>	<i>gu:n/dhu:n</i> etj.

§ 95. Bashkëtingëlloret *q, gj/ ç, xh*. -Klasifikimi dhe sistemi i bashkëtingëlloreve palatale ***q, gj*** dhe i atyre afrikate, ***ç*** dhe ***xh*** vazhdon të mbetet një ndër problemet më të mprehta në dialektologjinë shqiptare. Sipas pohimeve të Idriz Ajetit, rrafshimi i plotë i okluziveve dhe i afrikateve palatale në Kosovë ka përfunduar nga fundi i shekullit të kaluar (Ajeti 1960:227). Nga ana tjetër, siç dihet konsonantet ***q, gj/ç, xh*** në të folmet shqipe, gjithandej marrin trajta jo të njëjlojshme, ndërkaq në të folmen në shqyrtim fonemat e përmendura janë afrikatizuar në ***-ç*** dhe ***-xh***. Këtë e vërteton edhe fakti se nuk kemi hasur as edhe në një rast të vetëm të ruajtjes së palataleve të dikurshme ***q*** dhe ***gj***. Pra, sot e gjithë ditën, enklavës gjuhësore në shqyrtim i mungojnë palatalet e tipit ***q, gj*** dhe në vend të tyre kemi afrikatet ***ç, xh*** , p.sh.: ***çýçe (qyqe), e kéçe (e keqe), e kúçe(e kuqe), çjell (qiell), xhithmo:n (gjithmonë), xhýkata (gjykata)*** etj. Për sa i përket aspektit kohor të kalimit të palataleve ***q, gj*** në afrikatet ***ç, xh*** në të folmen e Istogut, në ndihmë na del fjalësi i Gurrrakocit (Gjurakovcit) i vitit 1830 i mbledhur nga Vuk Karaxhiçi.

Ky material gjuhësori dëshmon se aso kohe, mjaft qartë bëhej dallimi midis palataleve ***q, gj*** dhe afrikateve ***ç, xh*** pra, “në shkrimin e bashkëtingëlloreve palatale ***q, gj***

dhe afrikateve **ç, xh** në këngët popullore shqiptare të Gjurakovcit dhe me shpjegimin e mënyrës së shqiptimit të tyre, Vuku ka konstatuar mjaft mirë ekzistimin e këtyre dy palë bashkëtingëlloreve në kohën e tij në të folmen e Kosovës veriore” (Mulaku 2005:58).

Nga ana tjetër bashkëtingëlloren **ç** e gjejmë të prejardhur a të përftuar nga një **t-sh=ç**, si te shembujt: **i moçëm, i lezeçëm** etj., pra ngjashëm me të folmet e tjera të grupit të toskërishtes, por edhe të disa pjesëve të gegërishtes verilindore (Murati 1989: 19).

Bashkëtingëllorja **ç** në opozicion me tingujt e tjerë, dallohet në këto raste :

ç/l:	çáj/láj; çífti/lífti; përçáj/përláj
ç/p:	çe:t/pe:t; çe:l/pe:l
ç/th:	çark/thark
ç/xhe:	çépi/xhépi etj.

Nga ana tjetër, bashkëtingëllorja guturale **xh**, siç thamë edhe më lartë, rrjedh nga alternimi i bashkëtingëllores palatale **gj** dhe si e tillë, ruhet mirë në të gjitha pozicionet e fjalës.

-në ballë të fjalës: **xhăk (gjak), xhíthsja (gjithësia), xhýsa (gjysma)** etj.

-në trup të fjalës: **përxhíthsōj(përgjithësoj), përgjy:st (përgjysmë)**etj.

-në fund të fjalës: **kĩnxh (çengj), jăpâ^onxh** etj.

Bashkëtingëllorja **-xh** në opozicion me tingujt e tjerë :

xh/l:	xhâ ^o ma/lâ ^o ma
xh/t:	xhýbe/týbe etj.

§ 96. Bashkëtingëllorja j. -Përgjithësisht ruhet mirë, ndërkaq vetëm te një numër i kufizuar fjalësh pëson pak ndryshime. Kështu, p.sh.: folja **jep** nganjëherë shqiptohet me **j** e në disa raste jo, p.sh.: **jepŭ dhíve u:j**, por edhe: **epu dhíve u:j!**

Sonantja *j* del e plotë te përemrat pronorë p.sh.: ***e jême, e jóna, e júve***, etj. Ajo ruhet edhe te koha e pakryer e foljes, mënyra dëftore, veta e tretë e njëjësit, p.sh.: ***kallxojke, púnojke, ládrojke, vëzhgojke***, etj. si dhe në disa toponime, mikrotoponime dhe patronime të këtyre anëve.

a) në toponime: ***Mojsti:r, Drej, Bellopo:j***;

b) në mikrotoponime: ***Llójzat*** (vreshta në fshatin Sinajë), ***Lúgu i Çelíjave*** (Sine), ***Hajratet*** (Saradran), ***Lúgu i Ímerajve*** (Trubuhoc) etj;

c) në patronime: ***Blákaj, Méhaj, Muzlíaj, Dréshaj, Mírâ⁹naj, Zógaj, Arífaj, Bálaj, Métaj, Shábâ⁹naj, Jánuzaj*** etj. Nuk mungojnë edhe rastet kur bashkëtingëllorja *-j*, del jo në vendin e duhur, p.sh.: te disa emra që sosin me zanore të gjatë si dhe te disa folje të mënyrës dëftore, koha e pakryer, veta e tretë e njëjësit: ***shpíja (shtëpia), liríja (liria), barazíja (barazia), pleçníja (pleqëria)*** etj.

Te një numër fjalësh, ku theksi ka lëvizur në pjesët e përparme, konsonantja *-j* kalon në gjysmëzanoren *j* p.sh.: ***me zgje:dh(me zgjedhë), zgjedha e kíve (zgjedha e çeve), sjellet (sillet)*** etj. Po ashtu edhe fjalët ***ŭk*** dhe ***uki***: shqiptohen pa sonanten *j*, pra për mashkullin ***ŭk-u*** dhe për femrën ***ukí-a***. Për këtë emërtim kemi edhe trajtat ***uke:sh*** dhe ***ujke:sh***, pra te kjo e fundit del sonantja *j*.

Fonema *j* mund të hetohet në këto opozicione fonematike:

<i>j/k:</i>	<i>jôm/kôm</i>
<i>j/t:</i>	<i>ja:v/ta:v</i>
<i>j/d:</i>	<i>jes/des; je:t/de:t</i> etj.

§ 97. Bashkëtingëllorja *nj*.- Kjo bashkëtingëllore qiellzore, nuk është shumë stabile, sidomos kur gjendet në pozitë fundore. Në funksionin e mbaresës së shumës, ajo tkurret (alternohet) në zanoren *j*. p.sh.: ***ftoj, hûj, drûj, pátkoj , rrâ⁹j, zoj, pêj, shêj, skêj, ullij, t' mdhej, e êjte*** etj. Nga ana tjetër ruhet, kur është në ballë apo në trup të disa fjalëve, p.sh.:

a) emrat: ***njérka, njerzit*** etj;

- b) përemrat e pacaktuar: *njâ^oni, njâ^ona, nejnjâ^oni, nejnjâ^ona*;
 c) foljet: *njoh, njeh, njóftoj*;
 d) mbiemra: *i njo:m, i njëjt, i njofshëm* etj.

Bashkëtingëllorja qiellzore **-nj** dallohet në këto opozicione fonematike:

<i>nj/z:</i>	<i>njâ^oni/zâ^oni</i>
<i>nj/b:</i>	<i>njâ^ona/bâ^ona</i>
<i>nj/ç:</i>	<i>njërka/çërka</i>
<i>nj/s:</i>	<i>njëri/sëri</i> etj.

§ 98. Bashkëtingëlloret I, II. - Këto bashkëtingëllore ruhen mirë, me përjashtim të pak rasteve, kur bashkëtingëllorja **I** kalon në **-II** si p.sh.: te disa përemra pyetës, lidhorë dhe te një grup përemrash të pacaktuar: *cilla, cilli, cillt, cillat, i cilli, e cilla, t' cillat, secilli, kurcilli, kurcilla*. Kalimi **I > II** vihet re edhe te emri **tunell (tunel)** etj.

Është me interes të vihet në dukje fakti se bashkëtingëlloret **I, II** nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim cilësor as te disa sllavizma e turqizma, p.sh.: në toponiminë dhe mikrotoponiminë e këtyre anëve, si: **Lubo:v, Lubo:zhd, Kaliçan, Stërglla:v** (mikrotoponim në fshatin Kaliçan), **Suhogë:rrll, Zabllaç, Zallç, Llu:g, Llukac i Begut, Llukavc i Tha:t** etj.

Fonema **I** ruhet në këto pozicione:

- a) në krye të fjalës: *ledi:n, lômsh, lakën, līs* etj;
 b) në trup të fjalës: *ble:t, fle:t, flútur, aeróplan* etj;
 c) në fund të fjalës: *tâ^omël, demel, cúrrrel, ba:gël* etj.

Bashkëtingëllorja **-I** hetohet përmes këtyre opozicioneve fonematike:

<i>l/p:</i>	<i>lash/pash; lája/pája; lūs/pūs</i>
<i>l/rr:</i>	<i>lúj/rrúj, lýp/rrýp</i>
<i>l/k:</i>	<i>lâ^oma/kâ^oma</i> etj.

Edhe konsonantja **ll** përgjithësisht ruhet mirë, pavarësisht pozicionit në fjalë, p.sh.:

- a) në ballë të fjalës: **llókum, llastik, llôm** etj;
- b) në trup të fjalës: **baklla:v, hállve, fllâenz** etj;
- c) në fund të fjalës: **prra:ll, bakall, hamall, za:ll** etj.

§ 99. Kalimi (jotizimi) i bashkëtingëllores *l* në *j*.- Ky ndërrim fonetik në shqipe ka ndodhur gjatë fazës së saj të vjetër, duke prekur shtresën e leksikut me gurrë nga latinishtja. Tingulli ndërzanor ***l*** te disa fjalë është jotizuar në bashkëtingëlloren ***j* (*bi:j*)** nga ***bilë*** e shqipes së vjetër; ***pa:j*** nga ***-palë*** e shqipes së vjetër e kjo nga latinishtja ***paleum, thmijë- fëmilë; -go:j*** nga ***golë*** etj.

Bashkëtingëllorja e zënë në gojë, në trevën gjuhësore të Istogut, kryesisht ka dhënë dy tinguj:

a) ***j***- në huazimet sllave të mesjetës. ***L***, përkatësisht ***lj*** është jotizuar në ***-j*** në fjalët e tipit: ***nevo:j, rásoj, gërbu:j*** (edhe ***grabu:j*** e ***grebu:j***). Jotizimi vihet re edhe në topikun ***Bellopo:j (Bellopolje)*** e në ndonjë tjetër të këtij lloji, kurse te huazimet sllave të mëvonshme (kryesisht gjatë periudhës osmane) kemi të bëjmë me ruajtjen e bashkëtingëllores ***l***, p.sh.: ***Corropola⁵(Corropolje), Kralíca(Kraljica)⁶***, përderisa në huazimet me gurrë orientale, nuk ndodh jotizimi ***l > j***, p.sh.: ***lezet, belësh*** etj.

§ 100. Bashkëtingëlloret *r, rr*.- Këto fonema bashkëtingëllore sonante të shqipes, përgjithësisht ruhen, p.sh.: ***rúj, i rí, râna, i râen, rjépa, dikúr, rrânxax⁷, rrünxak, rrümúllak, rrótull, rrafshi:n*** etj., mirëpo te disa fjalë vihen re pak ndryshime cilësore të bashkëtingëllores ***r***, pra kemi kalimin ***r>rr***, p.sh.: ***dóktor*** (doktor), ***harrnoj***(arnoj) etj. Ngjashëm ngjet edhe te disa huazime nga sllavishtja, p.sh.: ***njèrrha:t (gërhat), Torrováca⁸*** etj. Në vend të fonemës ***r***, me bashkëtingëlloren ***rr*** dalin edhe disa orintalizma të cilat, në gjuhën burimore nisin me ***r***, p.sh.: ***Rrahim (Rahim), Rrustem (Rustem), Rrahman (Rahman)*** etj.

⁵ Mikrotoponim në fshatin Saradran.

⁶ Mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Lubozhdë.

⁷ Fshatrat që shtrihen buzë bjeshkëve.

⁸ Mikrotoponim në fshatin Prigodë.

Dridhësja **r** del e paprekur në këto pozicione:

- a) në ballë të fjalës: **rúj, respektoj, rje:p, rani:s** etj;
- b) në trup të fjalës: **bre:shk, bri:m, bry:m, brísk** etj;
- c) në fund të fjalës: **traktor, vizito:r, malso:r** etj.

Konsonantja **rr** ruhet në këto pozicione:

- a) në ballë të fjalës: **rrukulli:s, rrégull, rrafshi:n, rrâº:nx, rróploj** etj;
- b) në trup të fjalës: **përreth, grry:s, prru:,** etj;
- c) në fund të fjalës: **doktorr, dhâºnërr, âºnërr, fu:rr, tu:rr** .

Bashkëtingëlloret **r, rr** hetohen në këto opozicione fonematike:

<i>r/p:</i>	<i>ra:sh/pa:sh; râºna/ bâºna</i>
<i>r/rr:</i>	<i>ma:r/marr; ba:r/ba:rr</i>
<i>r/t:</i>	<i>râºn/tâºn</i>
<i>rr/sh:</i>	<i>rróta/shóta</i>
<i>rr/g:</i>	<i>rrêmi/gêmi</i>
<i>rr/p:</i>	<i>rri:/pi:etj.</i>

§ 101. Bashkëtingëlloret s, z.- Këto bashkëtingëllore përgjithësisht ruhen, por kemi vënë re edhe raste kur ato ndryshojnë pamje. Ja disa shembuj kur fonemat **s, z** ruhen të plota:

- a) në ballë të fjalës: **so:rr, síni:, zemër, zbu:t** etj;]
- b) në trup të fjalës: **masnésrĭ, másmrâºmti, házer, lazëm** (nevojë) etj;
- c) në fund të fjalës: **shkums, thĭjas, thúras, bi:z, shti:z** etj.

Në të folmen në shqyrtim kemi vënë re raste të kalimit të bashkëtingëllores **s** në **c** (**s>c**) p.sh.: te disa emra mashkullorë që dalin me **-ës** si: **rjepc (rjepës), pshtjellc (pshtjellës)** etj. Pra, siç mund të hetohet, këtu kemi të bëjmë me kalimin e grupit **ps** në **pc**. Ky ndryshim mendojmë se ka ndodhur për lehtësi theksimi, sepse **c**-ja dhëmbore kundruall tingullit **t** në aspektin e artikulimit qëndron më afër sesa konsonantja **s**. Edhe

në të kaluarën, pra në shkrimet e vjetra të shqipes, fjalët e këtilla dilnin me prapashtesën **ës**, p.sh.: **rrënës, lypës** etj. Bashkëtingëllorja **s** në pozitë nistore te disa fjalëve kalon në **c** p.sh.: **ci:c (sisë)**. Poashtu kemi vënë re një rast kur **s** e pozitës fundore ka kaluar në **z** p.sh.: **taz (tas)**. Te disa raste, kur bashkëtingëllorja **s** gjendet para buzoreve **b,v** dhe para bashkëtingëllores **d**, nën ndikimin e disimilit, sonorizohet në **z**. Kjo ndodh kur **s**-ja kryen funksionin e pjesës mohuese (Ibrahimi 2005:93) p.sh.: **z'bashkóhet (s'bashkohet), z'vjen (s' vjen), z'duhet (s'duhet), z'díhet (s'dihet), z'dal (s'dal)** etj.

Bashkëtingëlloret **s, z** mund të hetohen në këto opozicione fonematike:

s/z:	sot/Zot
s/k:	su:p/ku:p
s/v:	sje:ll/ vje:ll
s/m:	sot/ mot
s/t:	su:t/tu:t
s/ll:	kos/koll
z/t:	zo:j/ to:j
z/m:	Zot/mot
z/h:	zíle/híle
z/r:	zâ ^o na/râ ^o na etj.

§ 102. Bashkëtingëlloret sh, zh.- Përgjithësisht ruhen mirë, mirëpo vihen re edhe raste kur ato ndryshojnë pamje p.sh.: kur gjenden në funksione parashtesore, sidomos para ndonjëres nga konsonantet (**f, v, p, l, k, m, nj**) shkojnë e kalojnë në **—ç** dhe **xh**. p.sh.: **çfaro:s (shfarosë), çbloj (shploj), çpra:z (shpraz), xhleftsøj (zhvlerësoj), xhve:sh (zhvesh)** etj.

Bashkëtingëlloret e përmenduara ruhen në të gjitha pozicionet:

- a) në ballë të fjalës: **shes, shty:, zha:b, zhâ^oñël, zhgúni** etj;
- b) në trup të fjalës: **mishterí, ka:sht, mósha, përzhíta, manzhéta** etj;

c) në fund të fjalës: **balōsh, kuçlōsh, kúdōsh, masa:zh, drenâ⁹:zh** etj.

Konsonantet **sh, zh** mund të identifikohen në këto opozicione fonematike:

<i>Sh/zh:</i>	<i>shu:j/Zhu:j</i>
<i>sh/k:</i>	<i>sha:l/ka:l</i>
<i>sh/t:</i>	<i>sho:t/bo:t</i>
<i>sh/v:</i>	<i>sh:j/va:j</i>
<i>sh/th:</i>	<i>shesh/ves</i>
<i>zh/h:</i>	<i>zhúrma/húrma</i>
<i>zh/b:</i>	<i>zhába/bába</i>
<i>zh/ç:</i>	<i>zhapíni/çapíni etj.</i>

§ 103. Bashkëtingëlloret c, x.- Këto bashkëtingëllore ruhen mirë në

çdo pozicion të tyre p.sh.:

a) në ballë të fjalës: **Cërrca⁹, cikrri:m, cofti:n, cu:c, Ce:n¹⁰, xíxa, xixellónja** etj;

b) në trup të fjalës: **kêrrca¹¹, vêrrca, fllâ¹²nxa, â¹³nxa** etj;

c) në fund të fjalës: **thñc¹², pñc¹³, klínc, xi:x, â¹³nx** etj.

Konsonantet **c, x** dallohen në këto opozicione fonematike:

<i>c/x:</i>	<i>cíca/xíxa</i>
<i>c/l:</i>	<i>cópa/lópa</i>
<i>x/p:</i>	<i>xíxa/píca</i>
<i>x/t:</i>	<i>Xu:f/tu:f etj.</i>

§ 104. Bashkëtingëlloret t,d,n.- Bashkëtingëllorja **t** te një vistër fjalësh, në pozitë fundore, bie nga përdorimi, p.sh.: te disa folje të mënyrës dëshirore, koha e pakryer: **u gzófshi, u trashígófshi, u rritshi** etj. Poashtu, fonema **t** bjen nga përdorimi edhe te ato raste kur është në funksion të mbaresës vetore, fjala vjen, te foljet e mënyrës dëftore,

⁹ Fshat rreth 3 km në perëndim të Istogut.

¹⁰ Antoroponim.

¹¹ Pjesa e fortë e ngjitur midis eshtrave dhe muskujve në trupin e shtazëve.

¹² Thinci i gjarpërit, thinci i grerëzit (mjet thumbimi) etj.

¹³ I thuhet një njeriu dinak.

koha e pakryer, veta e dytë, numri shumës. p.sh.: *lájshi (lajshit), knøjshi (knojshit), lexøjshi (lexojshit), hájshi (hajshit)* etj.

Në dallim nga disa të folme tjera ku konsonantja **t** del në funksion të mbaresës rasore (gjinore, dhanore, rrjedhore) p.sh.: emrat e tipit: *shokëvet, lopvet* etj., këtu **-t** fundore nuk gjen përdorim, p.sh.: *shókve, lõpve* etj. Me fundoren **-t** formohen disa mbiemra të tipit: *i dũkt, i mũsht, i pjèkt, i djègt* etj.

Gjatë mbledhjes së lëndës gjuhësore, kemi vënë re se te një numër i caktuar fjalësh, bashkëtingëllorja e shurdhët **-t** alternohet në të zëshmen **d**, p.sh.: *sod (sot), i sódit(i sotëm), me sóden*, por edhe *me sódin (me të sotmen) , mas sódit (pas të sotmes)* etj., pra ngjashëm si në “shkrimet e vjetra të shqipes: (Buzuku: *ënbas sodi*), (F. Bardhi-*sod*), V. Karaxhiçi: *sod* etj. (Mulaku 2005:65) kurse te disa emra njerëzish, kryesisht të gurrës orientale, kemi hetuar të kundërtën e asaj që u tha, pra kalimin **d > t**. p.sh.: *Halit (Halid), Ahmet (Ahmed)*. Poashtu, spikasin edhe disa raste të rënies së plotë të bashkëtingëllores së zëshme **d** p.sh: *vên (vend), sên(send), shkûn (shkund), fûn (fund)* etj., ndërkaq, për sa i përket bashkëtingëllores nazale **n** mund të thuhet se ajo ruhet në të gjitha pozicionet e fjalës.

Bashkëtingëlloret **t,d,n** mund të dallohen nëpërmjet këtyre opozicioneve fonematike.

<i>t/d:</i>	<i>téhu/déhu</i>
<i>t/f:</i>	<i>kutí/kufí</i>
<i>t/m:</i>	<i>týta/mýta</i>
<i>t/b:</i>	<i>treg/breg</i>
<i>d/b:</i>	<i>dóra/bóra;</i>
<i>n/ll:</i>	<i>nòm/llòm</i>

§ 105. Bashkëtingëlloret *th*, *dh*.- Bashkëtingëllorja ***th*** ruhet mirë në të gjitha pozicionet e fjalës p.sh.:

- a) në ballë të fjalës: ***thmja*, *thúpra* *thâ^ona*** etj;
- b) në trup të fjalës: ***kthína*, *kthej*, *kthésa*** etj.;
- c) në fund të fjalëve: ***rreth*, *ku:rth*, *nárth*** etj, por kemi vënë re edhe një ndryshim cilësor, me ç' rast ***th*** kalon në ***f*** (***th* > *f***). p.sh.: ***fell* (*thellë*), *fellsí* (*thellësi*), *i kjjellt* (*i kthjellët*).**

Edhe bashkëtingëllorja ***dh*** është ruajtur mirë, pra folësit e këtyre anëve asnjëherë nuk i përziejnë tingujt ***dhe*, *th***, por fare mirë e bëjnë dallimin midis këtyre dy fonemave.

Konsonantja ***dh*** te disa fjalë ka pësuar ndryshim cilësor, pra ka kaluar në ***-v*** (***dh* > *v***), ndonëse këtë e kemi vënë re te vetëm një rast, p.sh.: ***vjâ^omi*** (dhjami) .

Bashkëtingëlloret ***th*** , ***dh*** dallohen në këto opozicione fonematike:

<i>th/s:</i>	<i>thâ^on/sâ^on</i>
<i>th/v:</i>	<i>thúj/vúj</i>
<i>th/m</i>	<i>thí/ mí</i>
<i>dh/d</i>	<i>dhâ^omi/dâ^omi</i>
<i>dh/j:</i>	<i>dhe:t/je:t</i>
<i>dh/p</i>	<i>dhênel/pênel</i> etj.

§ 106. Bashkëtingëlloret *f*,*v*.¹⁴- Këto dy konsonante labiodentale të shqipes, nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim specifik, pra janë të njëjta me shumicën e të folmeve shqipe dhe ruhen në të gjitha pozicionet e fjalës:

¹⁴ Shënim: Në arealin gjuhësor në vështrim, për emrin fëmijë përdoren dy trajta: ***fmija***, por edhe ***thmija***. Nga ky rast mund të vërehet procesi fonetik i disimilitimit, me ç'rast është bërë kalimi nga ***-fm*** në ***-thm***, përkatësisht kalimi i bashkëtingëllores ***-f*** në ***-th***.

a) në ballë: *fácja, flládi, fúrra, vétlla, vetmja, vllaznja* etj.;

b) në trup: *défi, mshéfi, pacóvi*¹⁵, *krevéti* etj.;

c) në fund: *def, shef, mshe:f, Lubo:v*¹⁶, *Dubo:v*¹⁷, *oshöv*¹⁸ etj.

Kur jemi te bashkëtingëlloret *f,v* kemi vënë re këmbimin (dukurinë e substitucionit) e bashkëtingëllores *f* me *th* edhe të *th*-së me *f*, p.sh.:

-kalimi *f>th*: *thérra (ferra), fèll (thell), thmí (fëmijë)* etj.;

-kalimi *th>f*: *fllâ^onza (thëllëza), úfúll (uthull)* etj.

Për sa i përket kalimit (*th>f*) mund të pohohet se kjo dukuri fonetike (e disimilitetit) deri më tani nuk ka gjetur hapësirën e as trajtimin e duhur në korpusin e studimeve për të folmet shqipe.

E shohim të arsyeshme të vëmë në dukje këtu faktin se në të folmen në studim, ashtu sikurse edhe në ndonjë të folme tjetër shqipe, bie fjala në Rrethin e Prilepit dhe të Krushevës, “bashkëtingëllorja –*v* përdoret si tingull epentetik , si dukuri e rregullt kundër hiatusit. Një –*v* epentetike e ndeshim edhe në aoristin e mënyrës dëftore të disa foljeve të zgjedhimit të parë. p.sh.: *shkova-shkove, pava-pave, punova-punove, rava-rave*”(Ibrahimi 2005:95). Edhe për të folmen tonë vlen pohimi i studiuesit Ibrahimi i cili, thekson se: “kur fonema –*v* është në fund të fjalës shpeshherë kalon në *f*, p.sh.: *kadaif (kadaiv), pozif (poziv)* ¹⁹ etj. “(Ibrahimi 2005:95).

¹⁵ Mi i madh.

¹⁶ Emër fshati në Istog.

¹⁷ Emër fshati në Istog.

¹⁸ Vegël pune për shkriftimin e tokës.

¹⁹ Letërthirrje.

Bashkëtingëlloret **f, v** mund të hetohen në këto opozicione fonematike:

<i>f/th:</i>	<i>fmí/thmí:; fí:k/thi:k</i>
<i>f/s:</i>	<i>faj/saj</i>
<i>f/t:</i>	<i>fúti/kúti</i>
<i>v/dh</i>	<i>ve:t/dhe:t</i>
<i>v/th:</i>	<i>ves/thes</i>
<i>v/t:</i>	<i>ve:sh/te:sh; vrap/trap etj.</i>

§ 107. Bashkëtingëlloret *p, b, m*.- Sa u përket këtyre konsonanteve dybuzore, mund të thuhet se treva gjuhësore e Istogut përgjithësisht përputhet me të folmet e tjera të arealit të gegërishtes, pra tingujt e përmendur dalin të plotë, te fjalët e tipit si: ***púla, pishman, prâ^omja, nëpër kátun, búza, bléva, bishtája, bába, mótra, martésa, msu:si, mrâ^omja***. Nga ana tjetër, kemi vënë re disa shembuj kur bashkëtingëlloret e sipërtheksuara ndyshojnë pamje, p.sh.: disa emra me gurrë orientale (***Ragib, Jakub, xhevab, çitab*** etj.) dalin me – ***p*** (***Ragip, Jakup, xheváp, çitáp*** etj.). Ndryshime e tilla janë të pranishme edhe në të folmen e Shalës së Bajgorës (Mulaku 2005:68), në të folmen shqipe të Rrethit të Prilepit dhe të Krushevës (Ibrahimimi 2005:96) e në ndonjë të folme tjetër.

Bashkëtingëlloret ***p, b, m*** mund te hetohen nëpërmjet këtyre opozicioneve fonematike:

<i>p/sh:</i>	<i>páva/sháva</i>
<i>p/n:</i>	<i>píva/níva</i>
<i>b/f:</i>	<i>bléta/fléta; brýma/frýma</i>
<i>b/m:</i>	<i>bíku/míku</i>
<i>b/d:</i>	<i>básma/dásma</i>
<i>m/v:</i>	<i>mótra/ vótra</i>
<i>m/l:</i>	<i>móti/lóti etj.</i>

§ 108. Grupet e bashkëtingëlloreve.- Në këtë pjesë të punimit do t'i shqyrtojmë këto grupe bashkëtingëlloresh: **kl, gl, lk, lg, mb, ng, ngj (nxh), fsh, nx, pl, ts, mj**, sepse siç dihet grupet e përmendura, por edhe të tjera të ngjashme, përbëjnë disa nga veçoritë dalluese midis të folmeve shqipe.

§ 109. Grupet kl, gl.- Këto grupe të vjetra të shqipes janë ruajtuar fare pak, sepse në të shumtën janë reduktuar në bashkëtingëlloret e thjeshta **k, g** p.sh.: **ko:ft (kloftë), kisha (klisha), gu:ha (gluha), gúnj (gluni), nígj (ndigloj)**, por spikasin edhe pak raste të ruajtjes së tyre p.sh.: **áshkla búkla ,çákla²⁰, xiglíti²¹**. Për sa i përket grupit **-kl**, nga fusha e toponimisë kemi vënë re disa raste të ruajtjes, p.sh.: **Grázhdi i Ha (kl)aj²², Kërrshí i Číklénit²³** etj.

Për sa i përket aspektit kohor të shndërrimit të grupeve **kl** e **gl** në bashkëtingëlloret **k, g**, janë ngritur diskutime dhe janë shprehur mendime të ndryshme. Kështu, në këtë plan, studiuesi Latif Mulaku thekson se " *për sa i përket kalimit të grupeve kl, gl, në k,g në të folmet e Kosovës, mendojmë se ky ndërrim ka ndodhur kryesisht gjatë shekullit XVIII. Ky konstatim mund të jepet në bazë të gjuhës së Pjetër Bogdanit (1685) e të Gjon Nikollë Kazazit (1743), te të cilët ndeshim grupet kj, g-j (tue kjanë, g'juha =g-juha, kjoftë kjenë); të gjuhës së Tahir Boshnjakut (1835) dhe të këngëve popullore të Gjurakovcit te Peja, viti 1830, ku ndeshën velaret k, g në vend të grupeve të ndërmjetme kj, g-j: me kâ²⁰n, káj, guha, i gát" (Mulaku 2005:70) . Pra, siç mund të vërehet grupet **kl, gl** për të kaluar në bashkëtingëlloret e thjeshta **-k, g**, kanë shkruar përmes një rruge të ndërmjetme, p.sh.: **kl- kj- k** dhe **gl- g'j- g**.*

Për sa i përket aspektit dialektor, grupet konsonantike **kl, gl** në të folmet veriperëndimore kanë kaluar në **kj** dhe **g-j**, ndërkaq në arealet toskërishte kanë kaluar në palatalet **q, gj**.

²⁰ Lodër e fëmijëve.

²¹ Ngacim që bën dikë për të qeshur.

²² Mikrotoponim në fshatin Lluga.

²³ Mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Vrellë.

§ 110. Grupet *lk, lg*.- Grupi *-kl* ka kaluar në bashkëtingëlloren e thjeshtë *-k*, p.sh.: *ūk (ulk), py:k (pylkë)* etj., mirëpo vihen re edhe raste kur ai është jotizuar në grupin *-jk*, p.sh.: *bŭjk (bulk), a:jk (alkë)* etj.

Folja **heç** (e cila në disa të folme arkaike, p.sh.: te arvanitasit e Greqisë, te arbëreshët e Italisë, te shqiptarët e Ukrainës si dhe në shkrimet e vjetra të shqipes përgjithësisht del me *lk* ose *lg*, si: *helk, helg*) në të folmen në hetim , rregullisht dëgjohet me trajtën : *hjek/ hjek*. E tillë del edhe në të folmen shqipe të Shalës së Bajgorës, pra edhe këtu kemi të bëjmë me dukurinë e jotizimit të grupit *lk* dhe *jk*.

Për sa i përket grupit *lk*, mendojmë se ai ruhet te shembulli *pëlkej*,²⁴ mirëpo nuk hetohen raste të tjera të këtij lloji, sepse, siç dihet grupi në fjalë i është nënstruar procesit të metatezës, si p.sh.: *bagël (balgë)* etj.

§ 111. Grupi *mb*.- Është rrudhur në vetëm bashkëtingëlloren *m*, porse në këtë rast është bërë zgjatja e zanores në trup të fjalës, p.sh.: *mre:ti (mbreti), mle:dh (mbledh), mu:sh (mbush), mi: (mbi), prâº:mja (mbrëmja)* etj.

Reduktimi i grupit *mb* në bashkëtingëlloren *m* vërehet, pavarësisht pozicionit të tij në fjalë, p.sh.:

a) në ballë të fjalës: *mre:ti (mbreti), mle:dh (mbledh), mu:sh (mbushë), ma:th (mbathë), mräpsht (mbrapsht)*;

b) në trup të fjalës: *kúmla (kumbulla), i âºmël (i ëmbël), kâºma (këmba)*;

c) në fund të fjalës: *hu:p (humb), shkrŭm (shkrumb), pllŭm (pëllumb)* etj.

Për sa i përket aspektit kohor të reduktimit të grupit *mb* në bashkëtingëlloren *m*, studiuesi Latif Mulaku, thekson se “*kjo dokumentohet relativisht vonë, kryesisht në gjysmën e shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX .. në këngët popullore të Gjurakovcit (1830) dhe në Vehbijen e Tahir Boshnjakut (1835) .. mirëpo këtu hasen edhe disa fjalë që e ruajnë të plotë grupin mb, p.sh.: plumba, mbush, mbet, përmbi, kumbona*”(Mulaku 2005:72).

²⁴ Nxjerrja nga vendi e nyjës së këmbës apo të dorës.

§ 112. Grupi ng.- Ndryshimet e këtij grupi janë të ngjashme me ato të grupeve **mb** , **-nd**, por këtu dallim përbën fakti se, **ng** ka pësuar kontraksion të plotë, pra ka kaluar në tingullin **ñ**, *ndonëse* ky kalim nuk përbën ndonjë risi, sepse kështu ka ngjarë edhe në shumë pjesë të gegërishtes.

Kalimi **ng> ñ** vihet re në të gjitha pozicionet e fjalës si:

a) në ballë të fjalës: ***i ñsht (i ngushtë), ñutëm(ngutëm), ñátrrøj(ngatërroj), ñríhet(ngrihet), ñúl (ngul), ñániher (nganjëherë) etj.***;

b) në trup të fjalës: ***ópâñga(opinga), kúñüll (kungull), áñări: (angari);***

c) në fund të fjalës: ***bñ (bung), cñ(cung), lõñ (lëng) etj.***

§ 113. Grupi ngj./nxh.- Te ky grup, bashkëtingëllorja **gj** është afrikuar në **xh**. Në Istog, grupi i përmendur ruhet mirë, me disa përjashtime të rralla, p.sh.: ***nxhýra, nxhála, përxhíxhna, axhalla:r, kinxh*** etj. Nuk mungojnë edhe rastet kur grupi **nxh** kalon në **nj**, pra njëlloj si në shqipen standarde dhe disa pjesë të gegërishtes verilindore, p.sh.: ***njoh (nxhoh), i njofshëm (i nxhofshëm), nihemi (nxhihemi) etj.***

§ 114. Grupi fsh.- Ruhët i plotë në të gjitha pozicionet e fjalës, pra ashtu siç ngjët në shqipen standarde. Ja disa raste të përdorimit të grupit- **fsh** sipas pozicionit në fjalë:

a) grupi **fsh** del në ballë të fjalës te shembujt : ***fshâñj, fshi:,rrafshi:n*** etj;

b) në trup të fjalës: ***jetófshít, kófshit, rrnofshit etj;***

c) në fund të fjalës: ***kófsh, jetófsh, kalófsh,mlófsh*** etj.

§ 115. Grupi nx.-.Ruhët i plotë në të gjitha rastet e përdorimit, p.sh.: ***nxâñ (zë), nxâñsi (nxënësi), nxórra (nxora), nxe:t (nxehtë) etj.***

§ 116. Grupi pl.- Përdoret te një numër tejet i kufizuar fjalësh. Nuk kemi vënë re asnjë rast , kur ky grup del në pozitë fundore, por vetëm në ballë dhe në trup të fjalës, p.sh:

a) në ballë të fjalës: *plás, plís,plăsarít, plâºni, plánifíkoj, pléhi, pu:l, píxhâºme* etj;

b) në trup të fjalës: *shupla:k, rrúpuplík²⁵, púpla, përpla:s* etj.

§ 117. Grupi *ts*.- Te disa fjalë është alternuar në fonemën— *x* e në disa raste shkon e kalon në *-c*. Pra, përgjithësisht mund të thuhet se togu *ts* ka ndrruar pamje, p.sh.: *tűx (tuts-), mócanĩk (motsanik)*.

§ 118. Grupi *mj*.- Ky grup konsonantik ruhet i paprekur, ndonëse edhe si i tillë nuk ka përdorim shumë të dendur, kurse në ato raste kur përdoret, del në të gjitha pozitat e fjalës.

a) në ballë të fjalës: *mjâºlta, mjéku, mjështri, mjéglla*;

b) në trup të fjalës: *něrmjétza, přermjéti²⁶,*

c) në fund të fjalës: *skâºmja, mrâºmja, e pámjja, e vrámja* etj.

²⁵ Këmbadoras.

²⁶ Shpina e njeriut.

KREU III

DUKURITË FONETIKE

Ndërrimet (ndërkëmbimet) e tingujve

Pjesa më e madhe e dukurive fonetike që ndeshen në të folmen në studim, janë të mbarë shqipes. Në këtë pjesë të punimit po paraqesim disa prej dukurive fonetike që përdorim më të dendur në trevën gjuhësore në shqyrtim.

§ 119. Metafonia (umlauti).- Është ndër dukuritë fonetike më të vjetra në mbarë shqipen dhe njihet si zhvillim i brendshëm i saj, që në thelb përbën alternimin e zanores **a** në **e**. Ky ndërrim tingujsh është aktiv si në sistemin emëror (p.sh.: formimi i shumësit të emrave të tipit **plak- pleç, kúlaç-kuleç, dësh-desh, nâ^{at}-net, kûnat- kúnet, trómak-trómeç, lăk-leçe**) ashtu edhe në sistemin foljor, pra disa folje të mënyrës dëftore, koha e tashme, numri njëjës, zgjedhimi vepror, përmes metafonisë ju mundësohet kalimi nga veta e parë e njëjësit në vetën e dytë dhe të tretën p.sh: **vrăs-vret, trókas-troket, marr-merr, dâl-dil-dîl**ni etj.

§ 120. Apofonia.- Kjo dukuri fonetike realizohet ashtu si në pjesën më të madhe të gegërishtes verilindore, ndonëse në disa vende mungon krejtësisht, p.sh: në arealin gjuhësor të Kaçanikut (Raka 2004: 76-77). Në të folmen në hetim kjo dukuri është e pranishme pasi që te shumë fjalë është ende aktiv alternimi i zanores **-e** në **-o**, p.sh. **drédh-dródha, bredh-bródha, vjél-vóla, mjél-móla, vjéll-vólla, djég-dóxha, pjék-póça** etj. Nga shembuj e dhënë vihet re se, dukuria e përmendur është në funksion të dallimit të kategorive gramatikore të kohës së foljes.

§ 121. Kontraksioni.- Procesi i tillë fonetik ka të bëjë me shkrirjen e dy tingujve në një të vetëm, brenda një fjale. Si rezultat i veprimit të kësaj dukurie, te një fjalë e caktuar mund të dalë një tingull i njëjtë me elementet e para, por mund të dalë edhe i ndryshëm, pra që ndryshon prej të dyve (**Dodi:1996:89**). Në arealin në studim, gjallojnë këto mënyra të kontraksionit:

a) kontraksioni me zanore të njëjta: ***e+e: me e la: (me la:); me e pru: (me pru:), me e çu: (me çu:), me e punu: (me punu:)*** etj.

b) kontraksioni me zanore jo të njëjta: ***a+e: (dha:), tha ; o+e- o:(vo:), dro;; ë+e (t'a)*** etj.

Format e tilla të kontraksionit vihen re edhe në të folmen e Hasit (**Badallaj 2001:102**), në të folmen e Opojës (**Pajaziti 2005: 97**), në të folmen shqipe të Rrethit të Prilepit dhe Krushevës (**Ibrahimi 2005:103**) e ndonjë të folme tjetër.

§ 122.Shurdhimi.- Pjesa më e madhe e bashkëtingëlloreve të zëshme kanë çiftet e tyre të shurdhëta. Një bashkëtingëllore e zëshme kthehet në shurdhët në ato raste kur gjendet para atyre të pazëshmeve, pra ato shurdhohen nën ndikimin e të zëshmeve.p.sh.: bashkëtingëllorja e zëshme ***b***, kur gjendet në trup të fjalës, shurdhohet në konsonanten ***-p***, p.sh.: ***i kälpt (i kalbt), i thärpt (i tharbt), hu:p (humb), pshte:t (mbështetë)*** etj. Po ashtu, këtu spikasin edhe disa raste kur bashkëtingëllorja e zëshme ***-g*** shurdhohet në ***-k*** (kur gjendet para ndonjëres prej bashkëtingëlloreve të tipit: ***t, sh,ç, s***), p.sh.: ***i dükt (i dugt), vèksh (vegsh), rröktár(rrogtar)***.

§ 123. Sonorizimi.- Paraqet të kundërtën e shurdhimit, pra me anë të këtij procesi fonetik bashkëtingëlloret e shurdhëta kthehen në të zëshme. Rëndom, sonorizohen bashkëtingëlloret ***-s*** dhe ***-t***. Konsonantja ***-s*** sonorizohet (kur kryen funksionin e pjesës së mohimit, p.sh.: ***z' bön (s'bën), z' duhet (s'duhet), z'däl (s'dal), z'bësöj (s'besoj)***, kurse konsonantja ***-t*** sonorizohet kur është në funksion të nyjës së përparme si dhe kur gjendet në pozitë fundore të fjalës p.sh.: ***d' búta (të buta), söd (***

sot), *d'bíme (të mbira)* etj. te pak shembuj vihet re edhe sonorizimi i bashtingëllores – *sh*, pra kalimi i saj në –*zh*, sidomos te disa numërorë, p.sh. *xhāzhde:t, xhāzhdhèt e trè, xhāzhdhèt e shta:t* etj.

§ 124. Asimilimi.- Ky ndërrim fonetik paraqet procesin kur dy tinguj në pozita të afërta me njëri-tjetrin ndërndikohen midis vetës, duke u asimiluar në mënyrë të pjesshme apo të plotë, pra duke u kthyer në tinguj të njëjtë ose pjesërisht të njëjtë. Thënë shkurt, asimilimi ka të bëjë me ndikimin e një tingulli mbi një tingull (fonemë) tjetër.

Në rastet kur fonema e parë asimilon të dytën, kemi të bëjmë me asimilim progresiv, ndërsaq asnasjelltas, kemi të bëjmë me asimilim regresiv. Arsye kryesore e ekzistimit të asimilimit është vetë natyra e tingujve, e fjalëve dhe e gjuhës, përgjithësisht. Pra, një folës i caktuar, gjatë aktit të të folurit nuk i thekson të gjithë tingujt njësoj, prandaj disa prej tyre i asimilon. Kjo më shumë vihet re te fjalësi i gurrës së huaj. Siç kemi vënë re, dukuria e asimilimit ka prekur si radhën e zanoreve, ashtu edhe atë të bashkëtingëllorëve, përfshirë këtu edhe togjet *mb, nd, ng*.

Disa shembuj të asimilimit: *bŭŋ (bung), cŭŋ (cung), i ŋŭsht(i ngusht), ŋŭsht(ngusht), ŋŭshtŏj (ngushtoj), mâ^aŋa (mënga), katŭn (katund), knèj (këndej), kuvên (kuvend), ma:th (mbathë), mäs (mbas), mlídhēt ((mblidhet), mlo:j (mbulojë), mret (mbret), nêja (ndeja), ní^hmŏj (ndihmoj), nrŷshe (ndryshe), zŭnxhin (zenxhin) , cíkrrŏj (cakërroj), çílíbar (çelebar), márak (merak)* etj.

§ 125. Disimilimi.- Nën ndikimin e këtij procesi, dy tinguj të njëjtë apo të ngjashëm shndërrohen në tinguj (fonema) të ndryshëm. Si proces, nuk ndeshet shpesh, prandaj një pjesë fare e vogël e fjalësit autokton të shqipes i është nënshtruar dukurisë së tillë. Ka ndodhur kështu, sepse disimilimi është më aktiv te fjalësi i gurrës së huaj.

Disimilimi mund të jetë dy llojesh : a) disimilimi në zanore: *matŏrr (motor), biríçet (bereqet), shíçer (sheqer)* etj. Raste të ngjashme të disimilimit vihen re edhe në të folmen shqipe të Rrethit të Prilepit dhe të Krushevës (**Ibrahimi 2005:106**).

-disimilimi në bashkëtingëllore: **bīrbīl (bilbil)** etj. Disimilimi mund të ndeshet në të tri pozicionet e fjalëve:

a) shtimi i tingullit në fillim të fjalës (**proteza**), p.sh.: **çatje (atje), çanej (andej), çatýne (atyre), çeknej (këndej), çáta (ata), çásajde (asajde)** etj.

b) shtimi i tingullit në mes të fjalës (**epenteza**), p.sh.: **dhíja (dhia), Sadríja (Sadria), Poloníja (Polonia), dashuríja (dashuria), frýje (fry)** etj.

c) shtimi i tingullit në fund të fjalës (**epiteza**), p.sh.: **mshélĭ (mshel), thérĭ (ther), nxérrĭ (nxjerr), atína (atij), asájna (asaj), dikújna (dikujt), knéjna (këndej), anéjna (andej)** etj.

§ 126. Rënia e tingujve.- Është formë e reduktimit, pra në rrethana dhe kushte të veçanta fonetike ndodh rënia e një tingull apo e një rrokjeje. Rëndom, rënia e tingujve ndodh në këto pozita:

a) në ballë të fjalës (**afereza**).- Siç kemi vënë re, në Istog një numër i konsiderueshëm fjalësh i janë nënshtruar aferezës p.sh: **fshâ²ⁿ (ofshan), mu:sh (mbush), Bráhim (Ibrahim), Smajl (Ismajl), nry:she (ndryshe), nāl (ndal), nryshk (ndryshk), nŭtem (ngutem), nřéhĭ (ngrehi)** etj.

b) në trup të fjalës (**sinkopa**).- Dukurisë së tillë i janë nënshtruar fjalët e tipit: **lóve (lopve), kuále/kuaje (kuajve), shpí (shtëpi), vétlla (vetulla), pétlla (petulla), asimtári (arsimtari), kpút (këputë), kněj (këndoj), kcěj (kërcej)** etj.

c) në fund të fjalës (**apokopa**)- I ka prekur zakonisht zanoret e një rrokjeje të patheksuar në pozicion fundor. Së shpeshti, apokopës i është nënshtruar zanorja e pa theksuar- **ë** në pozitë fundore si dhe disa fjalë me gurrë orientale p.sh.: **Nu:r (Nuridin), Ha:t (Hatmane), Llŭk (Llukman), Ru:k (Rukmane), Re:xh (Rexhep) ble:t (bletë), mên (mend) vên (vend), krym (krimb),** etj.

§ 127. Metateza. -Paraqet këmbimin e tingujve brenda fjalës. Në të folmen në shqyrtim, procesi i metatezës ka prekur vetëm një numër të kufizuar fjalësh, p.sh.: **pshtŭ (shpëtu), hamak (ahmak), trŭbull (turbull), i trŭbullt (i turbullt), hulát (luhat),**

Mejrem (Merjem) pshtëj (shpëtoj). Metateza ka prekur si fjalët e gurrës autoktone, ashtu edhe ato huazimet. Sejdaaa

§ 128. Elizioni (elidimi).- Ka të bëjë me rënien e një zanoreje të patheksuar në pozicion fundor të fjalës, që gjendet para një zanoreje- pjesë e fjalës që pason. Në rrethiin gjuhësor në shqyrtim, dukuria e tillë është mjaft e shpeshtë. Ja disa raste të elizionit:

a) **e-** paraqitet e eliduar te nyja e rasës gjinore të emrave, që mbarojnë me zanoren **-a**. p.sh. **púna dréçit (puna e dreqit), púna mrapsht (puna e mbrapshtë), drita hân's (drita e hanës)** etj.;

b) te nyja e mbiemrave (nyje e gjinisë femërore) në të shquarën e numrit njëjës, p.sh.: **púna ma:r (puna e mbarë), dóra tha:t (dora e thatë), mólla kuçe(molla e kuqe)** etj.;

c) **ë-** paraqitet e eliduar te rastet: **káli mi:r (kalë i mirë), n'mal (në mal), n' fu:sh (në fushë)** etj.;

d) **i-** elidohet kur ndodhet në afërsi të nyjës së rasës gjinore: **úji bjeshk's (uji i bjeshkës), drûnĩ mâ⁹lit (druri i malit), Zabélĩ Feks²⁷ (Zabeli i Fekës)** etj.;

e) **o-** elidohet kur është në pozitë fundore të fjalës dhe kur pas saj në radhë është zanorja **i** e nyjës shquese: **i, e** dhe **u**. p.sh.: **p' e shet (po e shet), p' e merr (po e merr), p'u flet (po u flet), p'u vjen (po u vjen), p'u thõt (po u thotë)** etj.;

ë) **ë-** këtu del e eliduar ashtu si edhe në të folmen shqipe të Rrethit të Prilepit dhe Krushevës (Ibrahimi 2005: 111), pra në rastet kur është në pozitë fundore të fjalës dhe gjendet para një zanoreje apo para trajtave të shkurtra të përemrave vetorë: **t' erdh keç (të erdhi keq), t'kallxoj (të tregoi)** etj.

§ 129. Aglutinacioni (përngjitja).- Është dukuri fonetike, kur dy a tri fjalë që gjenden në pozicione të afërta, janë përngjitur dhe kanë formuar një fjalë të vetme. Nuk është i madh numri i fjalëve dhe fjalëformave, që janë formuar me anë të aglutinacionit,

²⁷ Mikrotoponim në fshatin Prigodë.

p.sh.: *msysh* (*më+sy+sh*), *farefis* (*far+e+fis*), *çatje* (*ç+atje*), *tâ^omël* (*t+ ëmbël*), *môzomôkeç* (*mo+ zot+ma+keq*), *çashtû* (*q+ashtu*), *krymadh* (*krye+madh*) etj. Kur kemi të bëjmë me aglutinacionin, është me interes të vihet në pah fakti se format aglutinative të foljeve ndihmëse **kena** (kemi) dhe **jena** (jemi) në rrethin gjuhësor në shqyrtim, kanë përdorim fare të kufizuar, për dallim nga pjesët e tjera të Kosovës ku ato dalin mjaft dendur.

Për sa u përket trajtave foljore- aglutinative (**kena/jena**) të foljeve ndihmëse (**kemi/jemi**), kemi vënë re se ato më shumë gjejnë përdorim te banorët e fshatrave Rakosh, Uçë, Shushicë, Padalishtë, Suhogerllë e ndonjë tjetër, pra fshatra këto në kufi me krahinën etno-gjeografike të Drenicës, përkatësisht me komunën e Skënderajt.

§ 130. Palatalizimi.- Ndryshe njihet si alternimi (shkrirja) i tingujve. Si i tillë nuk është një proces i ri dhe i panjohur në rrethin gjuhësor në hetim. Këtij ndryshimi fonetik i janë nënshtruar bashkëtingëlloret e tipit **k, g, ll, n, r**.

Siç e kemi thënë edhe më lart në këtë punim, tingujt palatalë **q** dhe **gj** janë afrikuar në **ç, xh**, ndërkaq bashkëtingëllorja **-k** alternohet në **-ç**, p.sh.: **lak- léçe, plak- pleç, ũk-ũç** (por edhe **ujç**). Nga ana tjetër, konsonantja **-ll** është palatalizuar (jotizuar në **j**), p.sh.: shumësi i emrave të tipit: **bũll-bũj**, etj., kurse sonantja **-r** është jotizuar në **j**. p.sh.: **bĩr- bĩj**.

§ 131. Reduktimi.- Ka të bëjë me regjimin (rënien) e tingujve, veçmas të grupeve të bashkëtingëlloreve, kurse formë e veçantë e reduktimit të tingujve të dyfishtë është geminacioni (*geminata- tingujt e dyfishtë*). Kemi vënë re se gjatë procesit të të folurit, më së shpeshti dyfishohen tinguj e tipit **t, sh, n, k, v**. Kështu, në këtë plan, dyfishimi i tingujve ndodh në ato raste kur kemi të bëjmë me rënien e zanores **-ë**, kur ajo është në pozicion midis dy bashkëtingëlloreve të njëjta . p.sh.: **ble:tt (bletët), i ja:vve (i javëve), i kravve (i krihëve), patt (patët), di:tt (ditët), pe:tt (petët), lott (lotët), u rri:tt** etj.

§ 132. Kontraksioni i zanoreve.- Është lloj i veçantë i reduktimit të tingujve, pra

reduktohen tinguj zanorë të njëjtë dhe që renditën afër njëri-tjetrit. Nuk mungojnë rastet kur kontraksioni ndeshet edhe te zanoret e ndryshme. Në disa raste kontraksionit i janë nënshtruar edhe gupet vokalike *-oe, -ae*. p.sh.: **dro:(droe), vo:(voe) pa: (pae), tha: (thae)** etj. **E porosíta me: thi:rr n' dasêm!**, pra kemi **me: = me+e** etj.

§ 133. Kontraksioni i bashkëtingëlloreve.- Përbën një formë të reduktimit të tingujve bashkëtingëllorë, por ndodh edhe te zanoret.

Shembuj të kontraksionit të bashkëtingëlloreve:

ts > c: mócanĭk (motsanik)

ts> x: tŭx (tuts)

tsh>ç : i gaçêm (i gatshëm), përpeç (përpetësh) etj.

§ 134. Analogjia.- Kjo dukuri fonetike ka prekur një numër të konsiderueshëm fjalësh dhe fjalëformash, si në rrafshin fonetik ashtu edhe në atë morfologjik. Nga ndikimi i analogjisë dy tinguj të ndryshëm, shndërrohen në të njëjtë, duke mos mos prishur strukturën dhe domethënien e fjalëve. Sikundër dihet, në pjesën më të madhe të të folmeve shqipe, emrat farefisnorë (familjarë) dalin me një të përparme (p.sh.: **i biri, e bija, e shoqja, e reja** etj.), ndërkaq në të folmen tonë, por edhe në të folme të tjera të arealit të gegërishtes verilindore, nën ndikimin e dukurisë së analogjisë, emrat e përmendur dalin pa një të përparme (p.sh.: **bíri, bíja, shócja, réja** etj).

Analogjia ka vepruar edhe te disa folje (në vetën e dytë dhe të tretë të njëjësit, në të tashmen e dëftores) pra në drejtim të njëjtësimi të tyre. p.sh **ti hân (ti ha), ajo dĭn (ajo di), aj rrĭn (ai rri)** etj.

KREU IV

MORFOLOGJIA

Tiparet morfologjike

Në arealin gjuhësor të Istogut me rrethinë, ndryshimet morfologjike janë më të pakta se ato fonetike, ndërkaq edhe ato, që ekzistojnë janë të ngjashme me të folmet e grupit të gegërishtes verilindore. Megjithëkëtë, kemi vënë re se e folmja në shqyrtim është e prirur t'i thjeshtësojë dhe t'i njëjtësojë disa trajta të pjesëve të ndryshme të ligjëratës. Në këtë plan, bien në sy, përveç formave dialektore edhe trajta arkaike të shqipes që, janë ruajtur në rrymë të moteve.

Në këtë pjesë të punimit, pjesët e ligjëratës i kemi marrë në vështrim sipas kategorive gramatikore të tyre. Ato të ndryshueshme i kemi trajtuar më përimshtet (për shkak të kategorive të shumta gramatikore që kanë) kurse pjesët e pandryshueshme i kemi paraqitur në vija më të përgjithshme.

Sistemi morfologjik i të folmes së Istogut përmban njësi të caktuara të karakterit leksiko-gramatikor siç janë: emri, mbiemri, numërori, përemri dhe folja, njësi këto që formojnë kategorinë e pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës, kurse në grupin e pjesëve të pandryshueshme bëjnë pjesë: ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza, pasthirrma, të cilat asnjëherë nuk ndryshojnë trajtë.

Parë nga aspekti morfologjik, e folmja në kundërim përbën interes të veçantë për dialektologjinë shqiptare, sepse ruan trajta dhe forma fjalësh të vjetra dhe të rralla të shqipes siç janë: ruajtja e disa emrave asnjëanës, rasat gjinore-dhanore në shumës pa –v epentetike si dhe disa trajta të caktuara foljore.

§ 135. Emri dhe format e tij.- Sipas Gramatikës së Akademisë “emër quhet ajo pjesë e ligjëratës që emërton qenie të gjalla dhe sende dhe ka kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit, të rasës dhe të shquarsisë e të pashquarsisë. Nga pikëpamja kuptimore në klasën leksiko-gramatikore të emrave përfshihen fjalë të ndryshme që mund të emërtojnë veta e frymorë të tjerë (*njeri, burrë, grua, ka, dele, flutur*), sende konkrete (*gur, dru, shtëpi, qytet, mal*), dukuri të realitetit (*dimër, furtunë, tërmet, shi, borë*), cilësi (*bukuri, dashuri, mirësi, shkathtësi*), veprime ose gjendje (*ecje, drejtim, përkrahje, lodhje, tmerr*), nocione abstrakte si: *e mira, e vërteta* etj. (Gramatika I 2002:81).

Përkufizimi i tillë është i vlefshëm edhe për idiomën gjuhësore të Istogut. Sistemi emëror i kësaj treve gjuhësore nuk ndryshon shumë nga gjuha letrare, por as nga të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, mirëpo, krahasuar me shkrimet e vjetra të shqipes, dallimet janë të theksuara, p.sh: numri më i vogël i rasave krahasuar me të kaluarën, ndryshimet në pamjen e emrave të gjinisë asnjëanëse, ndryshimet në formimin e shumësit të emrave mashkullorë si dhe disa lëkundje të mbaresat rasore. Të gjitha këto lëvizje janë bërë si rezultat i zhvillimit të brendshëm të shqipes, por pavarësisht këtyreqë u thanë, inventari gjuhësor i Istogut ka trashëguar mjaft tipare të shqipes së moçme.

Kështu, pra kur kemi të bëjmë me sistemin emëror, kemi vënë re se në disa raste ruhet paranyjëzimi i emrave, që tregojnë prejardhjen e origjinën e një njeriu, përkatësisht të një banori, p.sh.: *i vrëllsi* (banori i Vrellës), *i prīgódsi* (banori i Prigodës), *i lŭbóvsi* (banori i Lubovës) e kështu me radhë.

Ngjashëm si në Istog, kemi hetuar se paranyjëzimi ruhet edhe në të folmen e Plavës dhe Gucisë (Ahmetaj 2002:118) e në ndonjë të folme tjetër.

§ 136. Kategoria e gjinisë.- Kjo kategori gramatikore qysh herët ka shërbyer si një prej mjeteve gjuhësore për dallimin e gjuhëve indoevropiane nga ato jo indoevropiane (Demiraj 1988:177) prandaj, gjinia e emrave është bërë objekt trajtimesh nga shumë gjuhëtarë, që janë marrë me studime edhe në fushë të shqipes.

Për sa i përket truallit gjuhësor të Istogut, të gjithë emrat i takojnë njëres prej gjinive gramatikore (femërore, mashkullore, asnjëse).

Shumica e gramatikave të shqipes, ndër to edhe ajo e Akademisë (Gramatika I 2002: 88) gjininë e cilësojnë si një prej katagorive gramatikore me karakteristike për emrat në gjuhën shqipe, që dallohet nga kategoritë e tjera gramatikore të emrit siç janë: numri, rasa, kategoria e shquarsisë dhe pashquarsisë, sepse kundërvënja mashkullore-femërore-asnjëse ka të bëjë me gjithë klasën e emrave përgjithësisht dhe shfaqet në shpërndarjen e tyre në gjini të ndryshme dhe, jo me forma të ndryshme të të njëjtës fjalë. Kur jemi te gjinia e emrave, është me interes të vihet në dukje fakti se shqipja e sotme është e prirur që të kalojë nga sistemi tri gjinish në atë dygjinish, siç po ngjet me disa gjuhë indoevropiane dhe me rumanishten, si një prej gjuhëve ballkanike.

§ 137. Gjinia mashkullore.- Një dorë emrash, që në disa të folme dalin në gjininë femërore, në të folmen e Istogut me rrethinë, i takojnë gjinisë mashkullore, p.sh.: ***harrën-harrni, dūd-dūdi*** etj. Poashtu, gjinisë mashkullore i takojnë edhe ata emra, që në trajtën e pashquar përfundojnë me bashkëtingëllore, kurse në të shquarën marrin mbaresën ***i*** ose ***u***, p.sh.: ***mal-mali, bu:rr-burri, shok-shoku, mik-miku*** etj.

Grupin e emrave mashkullorë e ndërtojnë edhe të atillë emra që në trajtën e pashquar mbarojnë me ndonjëren nga bashkëtingëlloret ***k, g, h***, p.sh.: ***shtek, mik, brisk, oxhak, sokak, trumcak, breg, Beleg*** (oronim në bjeshkët e fshatit Kaliçan) , ***berllog, strufulllog, Sofrabeg*** (mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Cërkolez), ***krah, shah*** (shahu) etj., ndonëse konsonantja ***h***- fundore tek emrat e përmendur është zbehur dhe shqiptohet jo e plotë, pra si gjysmë ***-h (ʰ)***. Në lidhje me këtë kemi folur te pjesa për fonetikën.

Të gjinisë mashkullore janë edhe disa emra tema e të cilëve del me zanore të gjatë si: ***thi:, mi:, shi:*** etj. si dhe disa emra të përveçëm njerëzish që përfundojnë me ***-i*** të shkurtër dhe lakohen sipas paradigmës së lakimit të tretë si, p.sh.: ***Sadri, Fazli, Imri, Kadri, Sejdi, Nuri, Nuh*** etj.

Janë të gjinisë mashkullore të gjithë ata emra që në të pashquarën mbarojnë me **-i** të theksuar dhe shënojnë ndonjë profesion, p.sh.: **sharaxhí-sharraxhija, opâ^oñaxhí-opâña^oxhija, samârxhí- samârxhija, teneçexhí- teneçexhja, burekxhí-burekxhja**. Në gjininë mashkullore bëjnë pjesë edhe emrat e tipit: **dash, bu:rr, dja:l, mik, armik, msu:s, bark, zog, breg, mal**, etj. të cilët, janë mashkullorë si nga pikëpamja natyrore ashtu edhe nga gjinia gramatikore. Në kategorinë e mashkullorëve bëjnë pjesë edhe ata emra që përfundojnë me zanore hundore të tipit **î,û**, p.sh.: **hî, mullî, hû** etj. si dhe emrat e tipit **thu, prru, kru, ftu**. Këta të fundit, në trajtën e pashquar dalin me **u**, kurse në të shquarën mbarojnë me **oni**, p.sh.: **thu:-thóni, kru:-króni, ftu:-ftóni, lañu:-lañóni**.

Një kategori të veçantë emrash mashkullorë e përbëjnë edhe ata që në shqipen letrare dalin me zanoren **-ë** fundore p.sh.: **djalë, burrë, kalë,gurë** të cilët, dalin pa zanore fundore (për shkak të rënies së saj), prandaj këtu është bërë zgjatja e zanores në trup të fjalës p.sh.: **dja:l, bu:rr, ka:l, gu:r** etj.

§ 138. Gjinia femërore.- Në rrethin gjuhësor në shqyrtim gjallon një dorë emrash që përdoren vetëm në gjininë femërore dhe lakohen sipas paradigmës së lakimit të tretë, p.sh.: **pjepën-pjépna, kryelâ^on-kryelâ^ona, ne:r-néra** etj., kurse po këta emra, në pjesë të tjera të të folmeve shqipe përdoren në gjininë mashkullore, ose herë si mashkullorë e herë si femërorë.

Në gjininë femërore natyrore të emrave bëjnë pjesë edhe disa tipa emrash vetjakë (kryesisht të gurrës orientale) që në të shquarën e emërores përfundojnë me zanoren **-i**, p.sh.: **Rukmâ^oni, Ajmâ^oni, Kyméti, Xhylsháhi, Fitanéti** etj. Nga ana tjetër, disa femërorë dallohen nga mashkullorët, pikërisht për shkak të gjatësisë së tingujve në trup të tyre (gjatësia fonologjike), p.sh.: **plak (mashkull)- pla:k (femër), mushk (mashkull)-mu:shk(femër), krushk(mashkull)- kru:shk(femër), kunat (mashkull)-kunâ:t (femër)**.

Gjinisë femërore i takojnë edhe emrat e atillë që, në të pashquarën dalin me zanoren **e** ose **i**, p.sh.: **lúle, núse, téze, shpí, taxhí** etj.

Kur kemi të bëjmë me gjininë femërore te emrave, karakteristikë është edhe ndërrimi i gjinisë së tyre. Kështu, p.sh.: disa emra mashkulloresh njëjës, në shumës kalojnë në gjininë femërore, p.sh.: **ky mal- kto malíje, ky breg- kto bríxhe, ky shtek- kto shtíxhe, ky vën- kto vëne** etj. Gjinisë femërore i takojnë edhe një tufë emrash që përdoren vetëm në shumës, p.sh.: **kto malíje, kto flók, kto e:n, kto vetúlla (vetlla), kto kunra (kpu:c)** etj. Gjinisë femërore i takojnë edhe disa emra që, në trajtën e pashquar mbarojnë me bashkëtingëllore (për shkak të rënies së zanores fundore **ë**, p.sh.: **bu:k, mo:ll, pu:n, xhe:ll, su:p, fu:sh, gro:p** etj.

§ 139. Gjinia asnjëanëse.- Gjinia asnjëanëse e emrave dita-ditë k ardhur duke u rudhur, megjithatë ende gjallon një numër i kufizuar asnjëanësish, sidomos ata që shoqërohen me përcaktorë. Asnjëanës të mirëfillë janë: **uj-t** dhe **kry:t**, pra këtu asnjëanësi i emrave del ngjashëm si në të folmen e Deçanit (Mehmetaj 2006:38). Emri asnjëanës (**kry:t/kryet**) kalon në gjininë femërore gjatë lakimit në tri rasa, p.sh.: gjinore (**i,e kre:s**), dhanore (**kre:s**), rrjedhore (**prej kre:s**), kurse në emërore dhe kallëzore nuk ndërron gjini.

Gjinisë asnjëanëse i takojnë edhe ata emra që janë krijuar si rezultat i substantivimit të mbiemrave foljorë p.sh.: **t' kuçt, t'bardh, t' zi:t** si dhe emrat e formuar nga substantivimi i pjesores së foljes p.sh.: **t' rritunit, t' msúmit, t' árdhnit, t' pámit, t'shkúmit** etj.

§ 140. Emrat ambigjenë.- Siç e kemi thënë edhe në një rast tjetër gjatë këtij punimi, parimisht të gjithë emrat bëjnë pjesë në njëren prej tri gjinive gramatikore, mirëpo këtu ekziston edhe tipi i emrave të quajtur ambigjenë (të dygjinishëm), të cilët ndërrojnë gjini gjatë kalimit nga njëjësi në shumës dhe anasjelltas, p.sh.: **mal- mâ⁹le, breg-bríxhe, shtek-shtíxhe**. Përmes kësaj rruge ndryshojnë edhe ata emra që shumësin e formojnë me anë të prapashtesës **-na**, p.sh. **bo:j-bójna, u:j-újna, dry:-dryna, brî-brina** etj. Parë historikisht, dukuria e ndërrimit të gjinisë së emrave është e vjetër, kurse “ në

gjuhën letrare ajo është e përgjithësuar dhe është bërë e detyrueshme edhe nga norma” (Gramatika I 2002:92).

§ 141. Kategoria e shquarsisë dhe e pashquarsisë.- Mjaft mirë dallohet kategoria e shquarsisë nga ajo e pashquarsisë, si për nga mjetet gjuhësore (mbaresat) e ndryshme, ashtu edhe për nga funksionet sintaksore të tyre.

Emrat e gjinisë mashkullore që, në të pashquarën dalin me ndonjërin nga bashkëtingëlloret okluzive **k, g** në të shquarën dalin me zanoren **-u** p.sh.: **físhek-físheku, ũk-úku, mĩk-míku, plāk-pláku, lāk-láku, brĕg-brĕgu, būrg-búrgu, mŭrg-múrgu, pllŭg-pllúgu**, ndërkaq një kategori tjetër mashkullorësh që, në të pashquarën dalin me glotalen **-h** , trajtën e shquar e bëjnë me mbaresën **-i**, p.sh. **krāh-kráhi, tĕh-téhi, shĕh-shéhi, plĕh-pléhi** etj.

Në disa të folme të gegërishtes verilindore, emrat mashkullorë njërrrokësh të tipit: **káli, magári, déti, drúni, gúri** etj. dalin vetëm në trajtën e shquar, kurse në Istog, të njëjtit përdoren në të dy trajtat, pra varësisht nga konteksti i fjalisë, p.sh.: **//Ismeti e kĭsh ble: nĩ ka:l** (trajta e pashquar); **Káli i Ismetit e kĭsh kimĕn e ze:z!** (trajta e shquar) etj. Këta shembuj dhe të tjerë të këtij lloji, argumentojnë se nuk është me vend mendimi i Idriz Ajetit, kur thekson se *“këta emra në tërë Kosovën shqiptohen vetëm në trajtën e shquar”* (Ajeti 1998:19).

Përveç shëmbujve të lartshënuar, ekzistojnë edhe një varg emrash të gjinisë mashkullore, që në trajtën e pashquar dalin me zanoret **a** dhe **i**, kurse në të shquarën mbarojnë me **-u**. p.sh. **ká-káu, vllá-vlláu, shí-shíu, thí-thíu** etj.

§ 142. Kategoria e numrit.- Kjo kategori gramatikore e emrit është mjaft karakteristike. Pjesa më e madhe e emrave emërtojnë sende që mund të numërohen, *“prandaj gjuha shqipe njeh dy numra: njëjësin dhe shumësin, të cilët i kundërvihen njëri-tjetrit si me anën e formave të vetë fjalës: mal-male, ashtu edhe me anën e fjalëve që përshtatën me emrin në numër: shtëpi e re- shtëpi të reja; kjo shtëpi-këto shtëpi”* (Gramatika I 2002:94). Pra, shqipja letrare ka mbaresa të veçanta për trajtat rasore të

shumësit, të dallueshme prej atyre të njëjësit. Si të tilla, ato shërbejnë edhe për shprehjen formale të shumësit, mirëpo gjendja nuk paraqitet gjithëherë kështu, sepse shumica e emrave, që përdoren në të dy numrat, në shumës dalin me një temë të veçantë, të ndryshme nga ajo e njëjësit. Siç u sipërtheksua, shqipja e sotme njih vetëm dy numra (njëjësin dhe shumësin), por historianët e gjuhës kanë dëshmuar se në familjen e gjuhëve indoevropiane, në të kaluarën ka ekzistuar duali i numrave (**Badallaj 2001:126**). Për sa i përket kategorisë së numrit është më interes të vihet në pah fakti se, trualli gjuhësor i Istogut nuk përbën ndonjë dallim në krahasim me pjesët e tjera të gegërishtes verilindore .

§ 143. Shumësi i emrave mashkullorë.- Në gjeografinë gjuhësore të Istogut, formimi i shumësit të emrave është mjaft i larmishëm, kurse shumësi i emrave femërorë është më i kufizuar. Në këtë pjesë të punimit do të vëmë në dukje disa lloje të shumësit të mashkullorëve.

§ 144. Shumësi me *a*.- Një mënyrë e formimit të shumësit të mashkullorëve është kur temës së fjalës në njëjës ia prapavendosim mbaresën e shumësit *a*. Përhapja e kësaj mbarese te emrat e përmendur është mjaft e dendur. Emrat që, në gjuhën letrare, në shumësin e pashquar mbarojnë me zanoren –*ë*, kur në Istog dalin me anë të mbaresës -*a*, p.sh.: ***doktorë (doktorra), profesorë (profesora), inxhinierë (inxhinjera), shoferë (shoferi), autobusë (autobusa), fashistë (fashista)*** etj.

Më zanoren *a* e formojnë shumësin edhe ata emra që, në shqipen letrare janë krijuar me anë prapashtesash të tipit si: *s (ës), ër* . p.sh.: ***njëksa, hjéksa, msu:sa, nípa, shtýpca, lýpca*** etj. Me mbaresën *a* e bëjnë shumësin edhe disa emra mashkullorë që emërtojnë lëndë a materiale të ndryshme, bimë, kafshë si dhe pjesë apo gjymtyrë trupi p.sh: ***cúña, iríça, búña, bostâªna, shotâªna, brrýla, krýma, vídha, çárra, krékca*** etj. Shumësi me *a* del edhe tek ata emra që, në njëjës dalin me *an* dhe kanë kuptim përçmues a përbuzës p.sh.: ***búçkâªna, mrrólâªna, balushâªna, drédhâªna, hajvâªna, rraspillâªna, çyrrâªna, fëncâªna*** etj. Në disa të folme gegërishte, një tip tjetër emrash

mashkullorë shumësin e formojnë me anë të mbaresës së shumësit **e**, p.sh.: **púse**, e ndonjë tjetër, ndërkaq në Istog shumësi i tillë del me **a**: **púsa** etj.

§ 145. Shumësi me e.- Emrat mashkullorë që shumësin e formojnë me mbaresën **e** janë të tipit si: **gzīm-gzíme, idhnīm- idhníme, takīm-takíme, harxhīm-harxhíme, fitīm-fitíme, shpërblīm- shpërblíme, mallkīm- mallkíme, urīm- uríme** etj. Kur kemi të bëjmë me këtë lloj shumësi, është me interes të vihet në dukje edhe tipi i shumësit të emrave mashkullorë me **ije** që, në Istog ndeshet mjaft dendur, p.sh.: **mal-malíje, shpat-shpatíje, gru:n- gruníje, shtrat-shtratíje, stôm-stômíje, grāzhd- grazhdíje, raft- raftíje, jāz- jazíje** etj.

§ 146. Shumësi me mbaresë zero.- Në gjeografinë gjuhësore të Istogut gjallojnë disa emra mashkullorësh që, shumësin e ndërtojnë duke mos ndryshuar pamje nga numri njëjës. Që në krye të herës, këta emra shumësin e kanë ndërtuar me **ë** fundore, por siç dihet, në këtë të folme ky tip zanoreje në pozitë fundore ka rënë nga përdorimi.

Pavarësisht kësaj që u tha, kur kemi të bëjmë me emrat mashkullorë që, shumësin e bëjnë me mbaresë zero, bien në sy disa tipa emrash si: a) emrat që kanë bërë rrafshimin e njëjësit me shumësin, duke mos e ndryshuar as theksin p.sh.: **malsór-malsór, mertek-mertek, puntór-puntór, arsimtar-arsimtar, dru-dru, fërkëm- fërkëm, dáj-dáj, hamar-hamar** etj; b) disa emra gjatë kalimit nga njëjësi në shumës kanë mbaresë zero, por e zgjatin zanoren në trup të fjalës. Këtu, kryesisht bëjnë pjesë emrat mashkullorë që, formohen me prapashtesën **ak, ek** dhe në trajtën e pashquar mbarojnë me **k**, pra kur konsonantja **k** nuk palatalizohet në palatalen **q**, përkthësisht në afrikatën **ç**, p.sh.: **dyrek-dýrek, pishak-píshak** etj. Siç kemi vënë re, format e tilla të shumësit mashkullorë gjenden edhe në të folmen e Deçanit (Mehmetaj 2006:46) e në ndonjë të folme tjetër. Në Istog gjallon një tip emrash të gurrës orientale që, gjatë kalimit nga njëjësi në shumës , nuk ndryshojnë pamje, p.sh.: **dervish-dervish, subash-subash, kadí-kadí, haxhí-haxhí** etj. Edhe emrat e tipit **prizrenalí, kojshí, mitrovícalí, prishtínalí** e ndonjë tjetër kanë pamje të njëjtë për të dy numrat.

§ 147. Shumësi me palatalizim.- Një numër i konsiderueshëm emrash mashkullorë që, në njëjës mbarojnë me ndonjërin nga bashkëtingëlloret e tipit **-k, -g, -ll, -n** shumësin e bëjnë me anë të palatalizimit (përkatësisht të afrikatizimit) të bashkëtingëlloreve fundore, p.sh.: **mik-miç, zog- zoxh** (por edhe **zøj**), kurse në disa raste vihet re edhe formimi i shumësit me anë të jotizimit, p.sh.: **duk-du:j, bull-bu:j**.

Përmes jotizimit formohet edhe shumësi i emrave mashkullorë që, në njëjës mbarojnë me zanore hundore si: **gû- guj, hûj-huj, pê-pêj** etj. Nga ana tjetër kemi vënë re edhe

tipin e emrave që në njëjës dalin me **n/η** ndërkaq, shumësin e formojnë me anë të zanores **a**, p.sh.: **cûη-cúηa, bûη-búηa, zeshkan- zeshkâ^ona, galan-galâ^ona, mrrôlan-mrrólâ^ona** etj. Është me interes të vihet në dukje edhe tipit i emrave mashkullorë që, shumësin e bëjnë me anë të palatalizimit, duke ia shtuar edhe nyjën shquese-**i**, p.sh.: **krushk- krushç (i), peshk-peshç (i), brisk-brisç (i)** etj.

Përveç shembujve të përmendur, kemi vënë re edhe mënyrat e formimit të shumësit me anë të parapashtesave **ën** dhe **-na**, p.sh.: **dreç-dreçën, vlla- vllazën, shat-shytën, bri-brina, mäll-mállna, ba:r-bárna, drith-dríthna** etj.

Kur kemi të bëjnë me mënyra dhe rrugë për formimin e shumësit të mashkullorëve, duhet thënë se në arealin gjuhësor të Istogut, ashtu si edhe në të folme të tjera të gegërishtes verilindore, vihet re edhe tipi i emrave mashkullorë që, shumësin e formojnë me anë të dukurisë fonetike të metafonisë, p.sh.: **kulaç-kuleç, tarak-tareç, dash-desh, mzat-mzet** etj.

§ 148. Shumësi i emrave femërorë.- Kur kemi të bëjmë rrugët dhe mjetet për formimin e shumësit të emrave femërorë, qysh në fillim duhet thënë se, në krahasim me gjininë mashkullore, këtu rrugët dhe mundësitë janë më të kufizuara. Për sa i përket të folmes në shqyrtim, pjesa më e madhe e emrave femërorë që, në njëjës dalin me ndonjë prej bashkëtingëlloreve, shumësin e formojnë me anë të mbaresës **a** dhe për dallim nga shqipja standarde, nuk vihet re shumësi me anë të mbaresës **-ë** , p.sh.: **një mollë- disa**

mollë, por thuhet: *nǐ mo:ll-dǎ mólla*. Ja edhe disa emra femërorë që shumësin e ndërtojnë me mbaresën *-a*: *da:rdh-dárdha, çì:k-çíka, nâºn-nâºna, motër-mótra, a:r-ára, ga:r-gára, aru:sh-arúsha, the:rr-thérra, kunâº:t-kunâºta* etj. Me mbaresën *-a* e formojnë shumësin edhe disa emra femërorë që dalin me *ër, ërr, ën, ël, ull*, p.sh.: *letër-létra, motër-mótra, lpetër-lpétrra, kókërr-kókrre, mjékërr-mjékrre, gógël-gógla, cúkël-cúkla, hátull-hátlla, vétull-vétlla, pétull-pétlla, nêrse:tull-nêrsétlla* etj.

Siç mund të vihet re, emrat femërorë gjatë kalimit nga njëjësi në shumës e humbasin zanoren në trup të tyre (*petull-petlla, flutur-flutra* etj). Një tip tjetër emrash femërorë që, në njëjës mbrojnë me zanoren e theksuar *-i*, në shumës marrin mbaresat *a* ose *ja*, p.sh. *lejthí - lejthía, shpí - shpíja, thmí - thmíja, tepsí - tepsía, burgí- burgíja, kojshí- kojshía, mantí- mantíja, flí- flíja, alltí-alltíja* etj.

Me mbaresën *a* shumësin e formojnë edhe disa emra femërorë që, janë krijuar me anë prapashtesash të ndryshme, p.sh.: *mlo:js-mlójsa, çiro:js-çirójsa, kullo:js-kullójsa, grry:s-grrýsa, fshi:s-fshísa, natrre:s-natrrésa* etj.

Një dorë e kufizuar emrash femërorë, shumësin e bëjnë me anë të mbaresës *-na*, p.sh.: *u:j-újna, ko:h-kóhna, e:r-érna, lo:j-lójna, shi:-shína* etj., kurse disa të tjerë, gjatë kalimit nga njëjësi në shumës, nuk ndryshojnë pamje, ashtu siç ngjet edhe me disa mashkullorë, për të cilët diskutuam pak më parë. p.sh.: *dít- dít, ja:v, ja:v, kafsha:t-kafsha:t, de:k-de:k* (vdekja), *ñujóre- ñujóre, maxhetóre-maxhetóre, akullóre-akullóre, katunóre-katunóre, nxheshatóre-nxheshatóre* etj. Në këtë kategori bëjnë pjesë edhe emrat abstraktë që, janë formuar nga pjesorja, me anë të prapashtesës *--me*, p.sh. *d bléme, t ráme, t páme, t kçýrne, t'pjékne* etj., ndërkaq emrat femërorë të tipit *de:r, do:r, gru:* etj., shumësin e formojnë me anë të kontraksioni të zanoreve, p.sh.: *de:r-dy:r* (*e>y*); *do:r – du:r* (*o>u*), *gru:-gra* (*u>a*).

§ 149. Shumësi i emrave asnjës.- Emrat asnjës prejfoljorë, të tipit: *t bërtítnit, t íknit, t nxhéshnit, t écnit, t hâºñrit, t pímit* etj., por edhe ata prejmbiemërorë të tipit si: *t zít, t kèçt* etj., nuk kanë numër shumës, sepse kur përdoren në plural, atëherë kalojnë në gjininë femërore, megjithëkëtë, këtu vihen re edhe përdorimet

paralele të gjinisë femërore, si: **dý t bërtítne, dý t íkne, dý t nxhëshme, dý t écne, dý t hâºngre, dý t píme** etj.

Kur kemi të bëjmë me emrin përgjithësisht, e konkretisht me numrin e tij, hetohen edhe dy të tyre; të atillët që përdoren vetëm në njëjës (*singularia tantum*) që përfshin:

a) disa emra që tregojnë lëndë të panumërueshme, p.sh: **sheçèri, úfla, tâºmli, kósi** etj.;

b) emrat e ashtuquajtur përmbledhës , p.sh.: **rini-a, granim-i, robnim-i** etj.

c) emrat që shënojnë nocione kohore, si ditët e javës dhe stinët e vitit, p.sh.: e **hâºne, e ëjte, e dílle, pranvèra, vjështa, dímní**; d) emra sëmundjesh dhe virusësh të ndryshëm:

carilláku, kancèri, píka n’trû, tifúzi, malárja etj.; e) emrat që tregojnë dukuri atmosferike të natyrës, p.sh. **zhègu, flládi, lagshtëja, thatsíja** etj.

Përveç singularit, vihet re edhe tipi i emrave që, dalin vetëm në shumës (*pluralia tantum*). Emrat e kësaj kategorie, më tepër tregojnë shumësi dhe rëndom nuk shprehin ndonjë shumicë të thjeshtë të numërueshme (Agalliu 1972:90). Emrat e tillë, varësisht prej asaj se çka shënojnë, mund të jenë:

a) emra që tregojnë gjymtyrët e trupit, veshëmbathjet apo mjetet e punës, p.sh.: **böth, flökt, mustéçe, pantólla, tírçi, sýza, gërshâºn, dâº na** etj.

b) disa emra abstraktë që tregojnë kohën e kryerjes së një pune apo veprimi, p.sh.: **t’ zhdjérgat, t mjéllat, t kórrat, t shtátat** etj.

Një fushë tjetër, që është mjaft e pasur me emra të tipit *pluralia tantum* është edhe toponimia, përkatësisht mikrotoponimia, p.sh.: **Gúrrat e Bárdha** (kroje në bjeshkët e fshatit Cerrcë), **Ramadâºnet** (fusha dhe kullosa në fshatin Prigodë), **Veshtëjet** (mikrotoponim në fshatin Lubovë dhe Orroberdë), **Rrásat**(mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Suhogerllë) etj.

§ 150. Rasat.- Kur kemi të bëjmë me rasën e emrit në gjuhën shqipe, në gramatikën e Akademisë thuhet se “emri në fjali përdoret në funksione të ndryshme

sintaksore, në rolin e gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë. Në varësi të kësaj ndryshon edhe forma e tij. Këto forma të emrit, me anën e të cilave shprehen lidhjet e tij me fjalët e tjera në fjali, quhen rasa” (Gramatika I 2002:105).

Hapësira gjuhësore në trajtim, ashtu si të folmet tjera të gegërishtes verilindore dhe më gjerë, ka pesë rasa (*emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore*), por mjaft shpesh del edhe rasa *thirrore*. Kur kemi të bëjmë me arsyet e reduktimeve që ka pësuar sistemi rasor i shqipes, studiuesit Shaban Demiraj dhe Hilmi Agani, pohojnë se “*kjo ka ardhur si rezultat i paaftësisë së trajtave të rasave për të shprehur gjithë lidhjet sintaksore të emrit në procesin e komunikimit, e për pasojë, shfaqjen e parafjalëve si mjet precizimi të lidhjeve e raporteve të caktuara në njësitë e komunikimit; së dyti, te evolucioni i tingujve fundor, dhe në fund, te veprimi rrafshues i analogjisë” (Demiraj & Agani 1978: 254).*

§ 151. Rasat gjinore e dhanore.- Emrat mashkullorë në rasat e përmendura, në trajtën e pashquar dalin me mbaresat *i* dhe *u*, p.sh. *i në djáli, i në zógu, i në míku, në míku (i,e) , ni brégu (i,e)*, ndërsa femëroret në trajtën e pashquar dalin me mbaresat *s* dhe *i*, p.sh *i në çíks* (por edhe *i në çíke*), *në çíke (i,e), në grúje (i,e)* etj. Nga ana tjetër, në këto rasa, shumësi i pashquar del dy farësh: me mbaresën *e* dhe me *v* epentetike, p.sh.: *i lísav* (por edhe: *i lísave*), *i,e krójeve, núsev (e)* etj., ndërkaq pa *-v* epentetike del një numër i kufizuar emrash të tipit si: *tâ^omli dhêne, hîñllîma kuale, atyne xhíne, pu:n çubâ^one, para dō vjéte*. Nga ana tjetër,kemi vënë re se disa prej këtyre emrave dalin edhe me *-v* epentetike, p.sh.: *//çitu kuálve taxhí se kémi me shkú n’mal!// Xhinve duhet me ju kallxú çì néstra po e bâ^ojm djálin synet!//* etj.

§ 152. Rasa kallëzore.- Formohet në atë mënyrë kur emrave mashkullorë që, në trajtën e pashquar dalin me bashkëtingëllore, kurse në të shquarën e emërores u shtohet mbaresa *n*, p.sh. *obórri (n), çóshi (n), drúni(n), xhárpni(n)* etj.

Në rasën kallëzore bëjnë pjesë edhe disa emra mashkullorë të cilët, në të pashquarën e emërores dalin me ndonjërin nga zanoret e theksuara të tipit **a, e, i**, por që u shtohet edhe mbaresa rasore **n**, p.sh. *vlláun, shíun, dhéun* etj.

Janë të rasës kallëzore edhe disa emra kafshësh, që në numrin njëjës dalin me temë në **j** dhe marrin mbaresën **n**, p.sh. *larójin, kuçójin, murrójin, sharójin* etj.

Kallëzores i takojnë edhe një dorë emrash vetjakë të gjinisë mashkullore, të cilët në trajtën e pashquar dalin me temë në zanore të gjatë (të theksuar), ndërsa këtu marrin mbaresën **n**, p.sh.: *Sejdi:n, Sadri:n, Gani:n, Sabri:n, Elmín, Shefki:n* etj, kurse emrat e gjinisë femërore, të shquarën e kallëzores e formojnë, njësoj si mashkullorët, pra duke marrë mbaresën **n**, p.sh.: *shpi:n, thúprën, mótrën, kúnatën, shóqën, nâ^onën* etj.

§ 153. Rasa rrjedhore.- Kur kemi të bëjmë me rrjedhoren është me interes të thuhet se ajo delpërmes formash të larmishme gjithandej të folmeve shqipe. E tillë është edhe në të folmen në shqyrtim. Emrat njëjës të gjinisë femërore, në rasën rrjedhore kanë pamje të njëjtë me kallëzoren dhe gjinoren. Emrat femërorë në rrjedhore dalin me mbaresat **e** dhe **s**, p.sh.: *pej bjéshks, dárdhs, pej mótrës, pej tézes, pej mënjes* etj. Në vazhde të kësaj, është me interes të theksohet fakti se kur emrat e rrjedhores nuk shoqërohen me nyjën e përparme **pej**, atëherë ata dalin me **e** fundore, p.sh.: *vó púle, tâ^omël lópe, co:p tóke, bu:k thékne* etj.

Sa u përket konstrukteve të rrjedhores me **et** që, hasen dendur në të folmet veriore, të tilla trajta nuk vihen re në Istog. Një tufë emrash në rasën rrjedhore dalin përmes dy formash: a) ata që dalin me mbaresën **ve** dhe janë më të shumtë në numër si dhe;

b) emrat që dalin me mbaresën **-sh**, p.sh.: *ky u:j buron pej lísave// t mirën mos e prit pej armiçve// rakí dárdhash// e kápi për krahsh// e zhagíti për flóksh//* etj.

Në disa raste, rasa rrjedhore përdoret në funksion të emërores dhe kallëzores, p.sh.: *shkoj pej Péje (shkoi në Pejë)// u nis çanej pej shpíje (shkoi në shtëpi)//* etj.

§ 154. Rasa thirrore.- Siç e thamë edhe në një rast tjetër, thirrorja është prej rasave që, në shqipen e sotme nuk gjen përdorim formal dhe nuk shpreh kuptim të pavarur, por vetëm në kuadër të kontekstit, mirëpo kjo nuk mund të thuhet edhe për arealin gjuhësor të Istogut, sepse aty kemi vënë re se kjo rasë gjallon ende, pra në ato raste kur dikush e thërret dikë apo i drejtohet ndonjërit për ndonjë kërkesë a nevojë që ka. Kjo rasë ka pamjen e emërores së pashquar, vetëm se këtu, shoqërohet me pasthirrmat përkatëse për të dy gjinitë; për mashkullore: **o, ore, more**, ndërkaq, për femëroren gjejnë përdorim pasthirrmat **oj,moj, mori**, p.sh. **//O Hysen-o/ñutu more/ se na nxuni nâ^ota// Oj Hatíxhe/ moj po a po nî:n mori/ bîna dō u:j t ftōft oj//** etj.

Kur jemi të rasa thirrore e emrave vihen re edhe ndërtime e trajta të tjera të saj si: pashtirmë+ përemër vetor, apo mbiemër+ e pashquara e emërores: **//ore ti dja:l/ kçyre punën tâ^one// O ju thmija mos na bōni zhu:rm//** etj. Përveç trajtave të përmendura për ndërtimin e thirrores, hetohen edhe disa raste kur format e thirrores dalin pa pasthirrma e pa pjesëza përkatëse, p.sh.: **Isuf!// Adem!// Hatíxhe!// Míxha Avdyl/ mûle se po t thrásin!//** etj.

§ 155. Lakimi.- Shumica e gramatikave të shqipes njohin katër lakime, kurse klasifikimi i tyre është bërë në bazë të parimeve të ndryshme, sidoqoftë edhe në idiomën gjuhësore në shqyrtim, ndryshimet apo format që marrin emrat gjatë lakimit nuk dallojnë shumë prej të folmeve fqinjësore dhe më gjerë. Në këtë plan, duke u mbështetur në mbaresat rasore, emrat të klasifikohen në katër lakime: a) në lakimin e parë që, është më i pasuri, bëjnë pjesë emrat mashkullorë që, në të shquarën e emërores marrin nyjën shquese-**i**, kurse në rasën gjinore, dhanore dhe rrjedhore marrin mbaresën **-it**. (p.sh. **lis-i, plis-i, ah-i, dja:l-i, bu:rr-i, gru:n-i, zhgÿn-i** etj.).

Këtij lakimi i takojnë edhe disa emra të gjinisë femërore, që në trajtën e shquar dalin me nyjën shquese **i**, p.sh.: **Hatmon-i, Rukmon-i** e ndonjë tjetër. Po ashtu, në lakimin e parë bëjnë pjesë edhe një kategori emrash, dikur të gjinisë asnjëanëse, si : **míshi, véshi, tâ^omli** etj. Me qëllim, që të kemi një pasqyrë më të plotë në lidhje me

lakimin e parë, më poshtë po paraqesim disa emra të këtij lakimi, në të dy trajtat dhe në të dy numrat (gjatë lakimit, trajta e shquar e emrit do të vihet në kllapa).

Paradigma e lakimit të emrit **djalë (dja:l)**, në trajtën e shquar dhe në të pashquaren e numrit njëjës dhe shumës.²⁸

Numri njëjës		Numri shumës
Em.	<i>nǎ dja:l (djáli)</i>	<i>dǎ djel (djelt)</i>
Gj.	<i>nǎ djáli (djálit)</i>	<i>dǎ djelve (djelve)</i>
Dh.	<i>nǎ djáli (djálit)</i>	<i>dǎ djelve (djelve)</i>
Kall.	<i>nǎ dja:l (djálin)</i>	<i>dǎ djel (djelt)</i>
Rrjedh.	<i>pej nǎ djáli (djálit)</i>	<i>dǎ djelve</i>

Paradigma e lakimit të emrit **lis** në trajtën e shquar dhe në të pashquaren e numrit njëjës dhe shumës.

Numri njëjës		Numri shumës
Em.	<i>nǎ lis (lisi)</i>	<i>dǎ lisa (lisat)</i>
Gj.	<i>nǎ lísi (lísit)</i>	<i>dǎ lisav/lisave (lisav/lisave)</i>
Dh.	<i>nǎ lísi (lísit)</i>	<i>dǎ lisav/lisave (lisav/lisave)</i>
Kall.	<i>nǎ lis (lísin)</i>	<i>dǎ lisa (lisat)</i>
Rrjedh.	<i>nǎ lísi (lísit)</i>	<i>dǎ lisave (lisave)</i>

²⁸ Shënim: Me qëllim që të mos ngarkohet paradigma, aty nuk i kemi shënuar trajtat e shkurtra e as rasën thirrë, që gjen përdorim në të folmen që po e trajtojmë.

Më poshtë po paraqesim paradigmën e lakimit të emrave të paranyjësuar: *i shoj/i shoçi* dhe *i vllaj*.²⁹

Numri njëjës		njëjësi	shumësi
Em.	<i>i shoj (i shóçi)</i>	<i>i vllaj</i>	-----
Gj.	<i>t'shojt (t' shóçit)</i>	<i>d vllaut</i>	<i>d vllázniv (e)</i>
Dh.	<i>t'shojt (t' shóçit)</i>	<i>d vllaut</i>	<i>d vllázniv (e)</i>
Kall.	<i>t'shojn (t' shóçin)</i>	<i>d vllaun</i>	<i>vlláznit</i>
Rrjedh.	<i>t' shojt (t' shóçit)</i>	<i>pej d vllait</i>	<i>pej d vllaznive</i>

Në lakimin e dytë bëjnë pjesë disa emra mashkullorësh, që në trajtën e pashquar të rasës emërore dalin me zanore të theksuar, kurse kur shquhen mbarojnë me zanoren *u*. Emrat e tillë tutje, në rasat gjinore, dhanore dhe rrjedhore të numrit njëjës, dalin me *ut*, p.sh.: *kà, shí, thí, dhé, vllà*. Në këtë lakim bëjnë pjesë edhe disa emra mashkullorësh që, në trajtën e pa shquar dalin me bashkëtingëlloret: *g, k*, p.sh.: *breg, shtek* (në shqipen standarde: *shteg*).

Paradigma e lakimit të emrit *thí* në trajtën e shquar dhe në të pashquarën e numrit njëjës dhe shumë.

Numri njëjës		Numri shumë
Em.	<i>nĩ thí (thíu)</i>	<i>dõ thí (thi:t)</i>
Gj.	<i>nĩ thíu (thíut)</i>	<i>dõ thíve (thíve)</i>
Dh.	<i>nĩ thíu (thíut)</i>	<i>dõ thíve (thíve)</i>
Kall.	<i>nĩ thí (thíun)</i>	<i>dõ thí (thi:t)</i>
Rrjedh.	<i>nĩ thí (thíut)</i>	<i>dõ thíve (thíve)</i>

²⁹ Në rrethin gjuhësor të Istogut, emrat e paranyjësuar janë shumë të rrallë.

Paradigma e lakimit të emrit **breg** në trajtën e shquar dhe në të pashquarën e njëjësit dhe shumës.

Numri njëjës		Numri shumës
Em.	<i>nǐ breg (bregu)</i>	<i>dǒ bríxhe (bríxhet)</i>
Gj.	<i>nǐ bregu (bregut)</i>	<i>dǒ bríxheve (bríxheve)</i>
Dh.	<i>nǐ bregu (bregut)</i>	<i>dǒ bríxheve (bríxheve)</i>
Kall.	<i>nǐ breg (bregun)</i>	<i>dǒ bríxhe (bríxhet)</i>
Rrjedh.	<i>nǐ bregu (bregut)</i>	<i>dǒ bríxheve (bríxheve)</i>

Në lakimin e tretë bëjnë pjesë disa emra të gjinisë femërore, dhe disa mashkullorë që në numrin njëjës të rasës emërore, trajta e shquar, marrin nyjën shquese **a / ja**, kurse në rasat e tjera, përkatësisht në gjinore, dhanore dhe rrjedhore dalin me bashkëtingëlloren **s**, p.sh.: **nâ^ona, mótra, díta, nâ^ota, , Râ^oma, Fazlíja, dája, lúlja** etj. Emrat e këtij tipi, në rasat e zhdrejta të trajtës së pashquar dalin me mbaresëne, p.sh.: **i, e nǐ díte, pej nǐ díte** etj.

Paradigma e lakimit të emrit **dité (di:t)** në trajtën e shquar dhe në të pashquarën e njëjësit dhe shumës.

Numri njëjës		Numri shumës
Em.	<i>nǐ dít (díta)</i>	<i>dǒ dít (dǐtt)</i>
Gj.	<i>nǐ díte (dít's)</i>	<i>dǒ dǐtve (dǐtve)</i>
Dh.	<i>nǐ díte (dít's)</i>	<i>dǒ dǐtve (dǐtve)</i>
Kall.	<i>nǐ dít (dítën)</i>	<i>dǒ dít (dǐtt)</i>
Rrjedh.	<i>nǐ díte (dít's)</i>	<i>dǒ dǐtve (dǐtve)</i>

Paradigma e lakimit të emrit **dajë (da:j)** në trajtën e shquar dhe në të pashquarën e njëjësit dhe shumës.

Numri njëjës		Numri shumës
Em.	<i>nĩ da:j (dáj)a</i>	<i>dõ dáj (dáj)t</i>
Gj.	<i>nĩ dájje (dáj's)</i>	<i>dõ dájve(dájve)</i>
Dh.	<i>nĩ dájje (dáj's)</i>	<i>dõ dájve (dájve)</i>
Kall.	<i>nĩ da:j (dájën)</i>	<i>dõ dáj (dáj)t</i>
Rrjedh.	<i>nĩ dájje (dáj's)</i>	<i>dõ dájve (dájve)</i>

Në lakimin e katërt bëjnë pjesë emrat e gjinisë asnjëanëse, pra ashtu si në të folmet e tjera shqipe. Emrat e dikurshëm në asnjëanës, tani shumica e tyre janë mashkullorë, e shumë pak femërorë. Asnjëanësit, sot dalin shumë të kufizuar dhe në të shumtën e rasteve shoqërohen me përcaktorët e asnjëanësisë, p.sh.: **//kta tâ°mël/ kta mish/ kta kryp/ kta t' nxe:t/ kta kry:/ kta t' ftoft//** etj.

Paradigma e lakimit të emrave asnjëanës **kta u:j** dhe **kta tâ°mël**.

kta u:j		kta tâ°mël
Em.	<i>kta u:j</i>	<i>kta tâ°mël</i>
Gj.	<i>ktí úji</i>	<i>ktí tâ°mli</i>
Dh.	<i>Ktí úji</i>	<i>ktí tâ°mli</i>
Kall.	<i>kta u:j</i>	<i>kta tâ°mël</i>
Rrjedh.	<i>ktí úji</i>	<i>ktí tâ°mli</i>

Paradigma e lakimit të emrit asnjans **hta t ftöft**, në trajtën e pashquar dhe në atë të shquar.

Trajta e pashquar		Trajta e shquar
Em.	<i>hta (dö) t ftöft</i>	<i>t ftöftit</i>
Gj.	<i>kti (dö) t ftöfti</i>	<i>t ftöftit</i>
Dh.	<i>kti (dö) t ftöfti</i>	<i>t ftöftit</i>
Kall.	<i>hta (dö) t ftöft</i>	<i>t ftöftin</i>
Rrjedh.	<i>kti (dö) t ftöfti</i>	<i>t ftöftit</i>

§ 156. Nyjet.- Gramatikat e shqipes tashmë kanë krijuar një traditë për sa i përket trajtimit të nyjeve të cilat, siç dihet janë dy farësh, pra si nyje të përparme dhe nyje të prapme. Nyjet e përparme **i,e,t (të)** janë të njëjta apo të ngjashme me të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, dhe përdoren tek emrat, mbiemrat dhe përemrat.

Kur kemi të bëjmë me nyjën e përparme **t (të)**, vihet re rënia e zanores **ë**. Për këtë kemi folur te pjesa e fonetikës, kurse kur kemi të bëjmë me përdorimin e nyjave të përparme, vihen re shumë lëkundje, në kuptimin që këto nyje herë përdoren tek emrat e rasës gjinore e herë te mbiemrat e nyjshëm, p.sh.: **Zabéli i Féks** (mikrotoponim), **Lúgu i Madh** (mikrotoponim), **Livádhi i Ilirve** (mikrotoponim), **Árat e Muj’s** (mikrotoponim), **Shkálla e Kaliçânit** (mikrotoponim).

Në rastet kur emri gjendet para nyjës së rasës gjinore apo para mbiemrit që mbaron me zanoren **u**, atëherë përdorimi i nyjës së përparme është i domosdoshëm, p.sh.: **Brégu i Hîñit, Búnâri i Kaúrrit** (mikrotoponime në fshatin Kaliçan). etj. Nga ana tjetër vihen re disa raste, kur nyja është në kontakt të drejtëpërdrejtë, të pashkëputshëm me ndonjë mbaresë, veçmas mbaresa **i** me nyjën **i**, atëherë nyja e përparme **i** nuk shqiptohet fare, pra ajo elidohet, p.sh.: **Lísi Zójs** (lis i njohur në fshatin Lubovë), **Króni Smétit** (krua në bjeshkët e fshatit Cerrcë) , **Króni Va:s’s** (krua në fshatin Prigodë) etj. Nyja nuk elidohet në rastet kur elementi i parë del me nyjën e prapme **u**

ose, kur emri është në numrin shumës, p.sh. //Vlláu i Ismetit/Káu i Zymérit/ Vlláznit e Sókólit //etj.

Në të folmen e Istogut me rrethinë, të paranyjzuar dalin disa emra që shënojnë prejardhje a përkatësi lokaliteti, p.sh. i **Vréllsi**, i **Lubóvsi**, i **Prigódsi** etj. Poashtu, të paranyjzuar dalin edhe disa emra farefisnorë si dhe ditët e javës, p.sh. **e â^oma**, i **shóçi**, **e shóçja**, i **bíri**, **e bíja**, i **bíri míxhs**, **e hâ^one**, **e shtúne** etj.

§ 157. Mbiemri.- Në trevën e Istogut, mbiemrat nuk dallojnë shumë nga të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, prandaj këtu do t'i trajtojmë vetëm disa nga çështjet më kryesore që lidhen me ta. Në gjuhën shqipe, mbiemrat janë dy faresh: të nyjshëm dhe të panyjshëm. Ata emërtojnë një tipar të një sendi dhe me të përshtatet në gjini, në numër dhe në rasë, prandaj mund të thuhet se mbiemri ka kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit, të shkallës, të rasës dhe të shquarësisë.

Kur jemi te mbiemrat, vihet re se disa prej tyre janë formuar me anë të prapashtesës së vjetër të shqipes **ŭn.**, p.sh. i **árdhŭn**, i **mshélŭn**, i **ftófŭn**, i **rrítŭn**, i **trédhŭn**, ndërkaq kur kalojnë në trajtën e shquar, atëherë bie nga përdorimi zanorja **u**, p.sh.: i **árdhni**, i **mshélni**, i **ftófni**, i **rrítni**, i **trédhni** etj. Janë mjaft të shpeshtë mbiemrat prejfoljorë, pra ata që janë formuar nga pjesorja e foljes, p.sh. i **çkým**, i **vrám**, i **mlúm**, i **vlúm** etj. Mbiemrat e tillë e formojnë gjininë femërore, duke e ndërruar nyjën e përparme nga **i** në **e** si dhe, duke marrë mbaresën e gjinisë femërore **e**, p.sh.: **e çkýme**, **e vráme**, **e mlúme**, **e vlúme** etj.

Një dorë mbiemrash krijohen nga pjesoret e foljes apo nga ndajfoljet e tipit si: **(i,e) ftoft**, **(i,e) nxe:t**, **(i,e) mërdhit**, **(i,e) rra:ll** etj. Mbiemrat e tillë janë të njëjtë për të dy gjinitë, por dallon vetëm nyja e përparme, **i** për mashkullore dhe **e** për gjininë femërore. Është më interes të vihet në spikamë fakti se këta mbiemra mjaft shpesh janë të prirë të substativohen dhe dalin si emra të gjinisë asnjëanëse, p.sh. **t' mërdhitit**, **t' ftoftit**, **t'rrállt** etj.

Në Istog vihen re edhe mbiemrat e llojit të prejardhur, që zakonisht krijohen përmes një emri+mbiemri, p.sh.: **lëshkuç, syve:rdh, hunga:t, veshllapësh, brîthy:m, hunshtrëmt, zemërprisht** etj.

Përveç mbiemrave të përmendur, vihen re edhe të atillë që dalin si plotës kallëzuesorë, e në disa raste edhe si kallëzues emërorë, si: **zi, bardh, kuç, verdh, ftoft, kfejllt**, për të saktësuar sa më shumë veçantinë e tiparit që emërtojnë, p.sh.: **zi si fúta, kuç si xháku, verdh si çapíni, bardh si bóra, ftoft si akúlli, kfejllt si lóti** etj. Mbiemrat e tillë, kur shoqërohen me njëën e përparme kanë përdorim mjaft të dendur. p.sh.: **i zí si fúta, i kuç si xháku, i ftoft si ákulli** etj.

Lakimi i mbiemrit prejpjesor **i ardhûn** në njëjës dhe shumës, në trajtën e pashquar dhe në atë të shquar.

Njëjës		Shumës
Em.	<i>nĩ i árdhûn (i árdhni)</i>	<i>dõ t' árdhûn (t' árdhûnit/ t' árdhnit)</i>
Gj.	<i>nĩ t' árdhni (t' árdhnit)</i>	<i>dõ t' árdhûnve (t' árdhûnve)</i>
Dhan.	<i>nĩ t' árdhni (t' árdhnit)</i>	<i>dõ t' árdhûnve (t' árdhûnve)</i>
Kall.	<i>nĩ t' árdhûn (t' árdhnin)</i>	<i>dõ t' árdhûn (t' árdhûnit/ t' árdhnit)</i>
Rrjedh.	<i>nĩ t' árdhni (t' árdhnit)</i>	<i>dõ t' árdhûnve (t' árdhûnve)</i>

Paradigma e lakimit të mbiemrit të prejardhur **lëshkuç**, në numrin njëjës dhe shumës, në trajtën e pashquar dhe në të shquarën.

Njëjës		Shumës
Em.	<i>nĩ lëshkũç (lëshkũçi)</i>	<i>dõ lëshkũça (lëshkũçat)</i>
Gj.	<i>nĩ lëshkũçi (lëshkũçit)</i>	<i>dõ lëshkũçav (lëshkũçav)</i>
Dhan.	<i>nĩ lëshkũçi (lëshkũçit)</i>	<i>dõ lëshkũçav (lëshkũçav)</i>
Kall.	<i>nĩ lëshkuç (lëshkũçin)</i>	<i>dõ lëshkũça (lëshkũçat)</i>
Rrjedh.	<i>nĩ lëshkũçi (lëshkũçit)</i>	<i>dõ lëshkũçav (lëshkũçav)</i>

§ 158. Shkallët e mbiemrit.- Kategoria gramatikore e shkallës së mbiemrit tregon masën (sasinë) në të cilën gjendet një cilësi e caktuar të sendi i dhënë. “*Këtë kategori gramatikore e kanë vetëm mbiemrat cilësorë, semantika e të cilëve lejon që tipari i emërtuar prej tyre të shprehet në masë të ndryshme*” (Gramatika I 2002: 172).

Shkallëzimi i mbiemrave realizohet ngjashëm si në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, me pjezësat : **ma, shum, tepër, fort** të cilat, çdo herë janë të natyrës ekspresive (pra theksohen më shumë), p.sh.: **i mi:r** (pohore), **ma i mi:r** (krahasore), **fort i mi:r** (sipërore).

Sikurse edhe në të folmet e tjera të arealit të gegërishtes verilindore, ashtu edhe në të folmen tonë, vihet re shkallëzimi i disa mbiemrave të përgjithshëm, p.sh.: **//Ma i poshtër se aj nuk ka// Edhe ai â^osht buda:ll/ ama Fazlia â^osht ma buda:ll//** etj.

Kur kemi të bëjmë me shkallën sipërore, është me interes të pohohet fakti se këtu format e mbiemrit janë analitike, pra formohen me anë të mjeteve leksikore, me ç’rast, prej tyre, më shpesh përdoren ndajfoljet e tipit: **shum, tepër, xhith**, p.sh. **//Kâ^omën e kish shumë t’ madhe// Tepër ahmak koka ky djali i Rexhëpit//** etj.

Kur kemi të bëjmë me shkallët e mbiemrit, përveç sipërores, mjaft dendur gjejnë përdorim edhe disa fjalë (zakonisht emra) që nuk emërtojnë ndonjë send, por shërbejnë për të vënë në pah karakteristikat e atyre sendeve, p.sh. **I rí ganz, e re fla:k, e ftöft ákull, e nxe:t va:l** etj.

§ 159. Numërori.- Numërori është ajo pjesë e ligjëratës që tregon numra abstraktë ose sasi të caktuar sendesh a qeniesh të një fare. “*Numërorët në përgjithësi nuk janë fjalë emërtuese. Ato japin nocione të veçanta që nuk janë të lidhura me sende reale, por me numrat matematikë. Kjo fjalë ka vetëm një tipar qenësor: dallojnë një numër nga numrat e tjerë*” (Gramatika I 2000:203). Për sa i përket numërorit si pjesë e ligjëratës, e folmja e Istogut nuk përbën ndonjë dallim nga të folmet e tjera të gegërishtes verilindore. Edhe këtu ekzistojnë numërorët themelorë dhe ata rreshtorë. Numërori themelor **një**, varësisht nga mosha e folësve del në trajtat : **një, një, një**. Numërori themelor **një** del gjithmonë vetëm në funksion të numërorit dhe përdoret i pashoqëruar

nga emri, p.sh. *//A kí náj mik çĩ munet me na krý pu:n?//Po, e kam njô po nuk di sa munet me na nĩmu!//*. Ky numëror, kur përdoret para emrave, del në formën *-nĩ*, p.sh.: *//E pava nĩ shok t' fmini:s!//E preva nĩ lĩs t' madh me bâº dru: për dĩmẽn!//*. Kur jemi te numërorët themelorë, duhet thënë se ata nuk kanë gjini, me përjashtim të numërorit *dy* dhe *tre*. Numërori *dy*, dallon në gjini me anë të gjatësisë së zanores *y*, p.sh: *dy* (për gjininë mashkullore) dhe *dý* (për gjininë femërore), ndërkaq numërori *tre* dallon në gjini, thuhet *tre* (për gjininë mashkullore) dhe *trĩ* (për femëroren).

Në disa raste numëroret emërzohen (substativohen) dhe dalin si emra me kuptime të caktuara. Kështu ndodh edhe në disa pjesë të tjera të gegërishtes verilindore, p.sh.: në të folmen e Deçanit (**Mehmetaj 2006:69**) e në ndonjë tjetër. Në këtë plan, është më interes të përmendet edhe numërori themelor *katër*, i cili në bashkëvjajtje me emrin nuk bënë diferencimin gjinor, por kur përdoret i vetëm, forma që merr në gjini dallon mjaft qartë, sepse del me mbaresën *a*, p.sh. *//Sa núse erdhẽn n'dasẽn?//Erdhẽn kátra.//*

Gjatë vjeljes së lëndës gjuhësore, kemi vënë re edhe përdorimin e numërorëve që tregojnë sasinë e sendeve apo gjërave në formë të përmbledhur, duke mos përcaktuar qartë masën e tyre. Numërorët e tillë gjithmonë marrin nyjën *-t* dhe, po ashtu diferencohen edhe në aspektin gjinor, p.sh. *//A erdhen da:jt? //Po, erdhẽn t' trèt!// A i páve hállat?// Po i páva t' trĩjat!//*. Numëroret rreshtorë nuk do t'i trajtojmë në këtë pjesë të punimit, sepse i kemi përmendur te mbiemrat.

Përveç numërorëve të përmendur, në gjeografinë gjuhësore të Istogut, gjejnë përdorim edhe disa numërorë thyesorë (thyesa), si: *xhýsa, çeréku, dý t'trétat* etj.

Poashtu, përdoren edhe disa numërorë që shprehin barazim, radhitjeje, p.sh.: *dýzash, kátrash, dy ka dy, tre ka tre* etj. Këta lloj numërorësh vihen re edhe në të folmen fqinjësore të Deçanit (**Mehmetaj 2006:70**) e gjetiu.

§ 160. Përemri. -Përemër quhet ajo pjesë e ligjëratës që tregon në mënyrë të përgjithshme, pa i emërtuar frymorë, sende, tipare ose sasi të caktuara. Kuptimin konkret përemri e merr në kontekst, në kushtet e ligjëritimit të lidhur (**Gramatika I 2002:2015**).

Për sa i përket të folmes së Istogut, mund të thuhet se përemrat përgjithësisht janë të ngjashëm me pjesët e tjera të gegërishtes verilindore.

§ 161. Përemri vetor.- Trajtat e përemrit vetor të vetës së parë, numri njëjës në rasën emërore janë **une** dhe **Ûn**, mirëpo te folësit e brezit të vjetër kemi vënë re se përdoret edhe përemri vetor **û**, ndonëse më rrallë. Përemri i tillë, në rasat kallëzore dhe dhanore përdoret në formën **mu:**, por edhe **-mue**, shoqëruar me trajtën e shkurtër **m** (por edhe **um**), p.sh.: **mu (mue) m'kallzoj** etj. Në këtë plan, kemi vënë re se te fjalitë mohore, në vend pjesëz **m**, përdoret **um**, p.sh.: **Nuk um kallzove çj po vjen sontë për da:rk // Nuk um tha me shku: n'Pe:j se isha shku:!!** etj.

Përemri vetor **Ûn** në vetën e parë të shumësit, në rasën emërore del në trajtën **na**, p.sh.: **na po shko:jm e ju hajdeni mas nësh!** etj.

Paradigma e lakimit të përemrave vetorë **Ûn** dhe **na**.

Numri njëjës		Numri shumës
Em.	<i>Ûn</i>	<i>na</i>
Gjin.	<i>i jêmi/ e jêmja</i>	<i>i,e jóni/ jóna</i>
Dhan.	<i>mu: (mue) m</i>	<i>nëve (ne)</i>
Kall.	<i>mu: (mue) m</i>	<i>nëve (ne)</i>
Rrjedh.	<i>méje</i>	<i>nëve (nesh)</i>

Përemri vetor i vetës së dytë njëjës del **tí**, kurse në shumës **ju**, pra të njëjtë si në shqipen standarde, ndërsa në rasën kallëzore dhe dhanore del në formën **ty+** trajta e shkurtër **t**, p.sh.: **//Edhe ty t pa:sh/ ishe kâºn me çikën e Halilit// Ty t thash mos shko n' mal se tash âºsht ko:h dimni/ po ti nuk móre vesh//**. Përemri i përmendur, në rasën rrjedhore del **téje**, p.sh.: **//Pej téje e páta ní kÿt lajm//** etj.

Paradigma e lakimit të përemrave vetorë **tí** dhe **ju**.

Numri njëjës		Numri shumës
Em.	<i>ti/ju</i>	<i>Ju</i>
Gjin.	<i>ýti/jótja</i>	<i>júvi/júvja</i>
Dhan.	<i>tý t'</i>	<i>júve (ju) ju</i>
Kall.	<i>tý t'</i>	<i>júve(ju) ju</i>
Rrjedh.	<i>téje</i>	<i>júve (jush)</i>

Përemrat vetorë në vetën e tretë njëjës kanë këtë pamje: **aj, ajo**, kurse për vetorët e vetës së tretë shumës kemi trajtat: **ata, ato**.

Trajtat e përemrit vetor **aj, ajo** dhe **ata, ato** përdoren për t'i plotësuar detyrat gramatikore të vetorit për ata persona apo përgjithësisht për frymorë a gjëra që gjenden larg folësit. Kur jemi te këta përemra, duhet hedhur në dritë faktin se ata bëjnë edhe diferencimin gjinor, pra kanë kategorinë gramatikore të gjinisë.

Paradigma e lakimit të përemrave vetorë **-aj,ajo** dhe **-ata,ato**

Numri njëjës		Numri shumës
Em.	<i>aí/ajo</i>	<i>ata/ato</i>
Gjin.	<i>atij (tij) /asaj (saj)</i>	<i>atýne (tyne)</i>
Dhan.	<i>atí i / asaj i</i>	<i>atýne</i>
Kall.	<i>atâ° e/ atâ° e</i>	<i>ata/ató</i>
Rrjedh.	<i>atíj /asaj</i>	<i>atýne (týne)/</i>

§ 162. Përemri vetvetor.- Ky tip përemrash del njëllor si në pjesët e tjera të gegërishtes verilindore. Të tillë përemra në të folmen tonë janë: **vet, veti** p.sh.:// **Hajde vet/ mos i prit shókt!// A je n' véti se çka po flet?//**.Ndërkaq, në trajtën e shquar dalin edhe format **vétja, vetvétja** p.sh.: // **Çka po t' doket vétja / a je bâ° fort i meçëm, a çka?!// Çka ta bôn vetvétja nuk ta bôn kërkúshi!//** etj.

Përemri vetvetor **vet** në disa raste shërbën si mjet për përforsimin e funksionit të kryefjalës, sidomos kur është në vetën e parë të njëjësit, p.sh.:// **Ûn vet jôm aj çí t nimóva me a:rdh n çit di:t ku je tash!//**, ndërkaq edhe vetvetori **véti** shërben për

përforcimin e kuptimit apo përcaktimin e gjymtyrëve të fjalisë, p.sh.// **A e ki fjalën për véti a për tjetër kôn?//**

Përemri vetvetor **vet** përdoret edhe si përemër pronor-vetvetor, p.sh.: **i véti, e véta, d'vet, d' vétat**:, p.sh.:// **Káli âsht i véti/ n dáçt e shet/ n dáçt e fa:l// I ka t xhákut d vet/ nuk ká ku i çon!// Páret çí i ka fitu:/ i ka d vétat/ se i ka tubu: me nje:rs d bállit//** etj.

Paradigma e lakimit të përmave vetvetorë -**vetja** dhe **vetvetja**

Em.	<i>vétja</i>	<i>vetvétja</i>
Gjin.	<i>i,e vétes</i>	<i>i,e vetvétes</i>
Dhan.	<i>vétes ,i</i>	<i>vetvétes, i</i>
Kall.	<i>véten, e</i>	<i>vetvétén, e</i>
Rrjedh.	<i>pej (pĩ) vétes</i>	<i>pej (pĩ) vetvétes</i>

§ 163. Përemri dëftor.- Në rrethin gjuhësor të Istogut dalin këta përemra dëftorë: **-ky, kjo, kta, któ** (për gjera që ndodhen afër folësit) dhe **aj, ajo, ata, ató** (për gjëra që ndodhen larg folësit). Kur jemi te përemri **aj, kta, któ** kanë ngjarë disa ndryshime fonetike, p.sh.: te përemri **aj** theksi ka lëvizur nga zanorja **a** në **i**, përkatësisht në gjysmë zanoren **j**, kurse te përemrat **kta, któ** ka ndodhur rënia e zanorës **ë** në trup të fjalës, të cilat procese i kemi përmendur te pjesa për fonetikën.

Është me interes të vihet në dukje fakti se në arealin gjuhësor të Istogut, përemrat dëftorë mjaft shpesh dalin përmes trajtash dialektore: **çeky, çekjo, çetó, çaj, çajo, çata, çató**, pra përemrat e tillë janë formuar me anë të aglutinimit (përngjitjes) së pjesës dëftuese **çe+** përemrat dëftorë, p.sh.: **çe+ky= çeky, çe+kjo= çekjo**, etj.. Përveç trajtave të përmendura, kemi vënë re edhe të tilla trajta të dëftorëve si: **çikjo, çitó, çita, çaj**.

Në vazhdë të kësaj që u tha, spikasin edhe tipat e dëftorëve që, përdorën për gjininë asnjane, p.sh.: **//Çèta u:j kôka t'vôkt// Çata shèçer kôka shôm t'tra:sh//** etj.

Kur jemi të përemrat dëftorë dhe përdorimi i tyre, kemi vënë re se disa prej tyre përdoren edhe në funksion të mbiemrave dëftorë, kur janë në shoqërim të emrave në trajtën e shquar, p.sh.: *//Aḡ pláku kōka lo:dh e kōka a:rdh n'prag déke// Ajo hálla ish shurdhu: n'dy vèsht!//* , por ndeshen edhe raste kur shoqërohen edhe me emra të pashquar. Kjo dukuri vërehet edhe në pjesë të tjera të gegërishtes verilindore e më gjerë, p.sh.: *// Nuk dí çka po ly:p ma shum ajo çì:k// Ky bu:rr kŭrr nuk e ka dī:t se çka po dōn!//*.

Përemrat dëftorë *ky, ai, kjo, ajo* gjatë lakimit në rasën kallëzore të numrit njëjës , kur janë të shoqëruar me emra, përdoren njëllor për të dy gjinitë, pra në trajtat: *kēt, at/çat* p.sh.: *// Kēt dja:l po e njoh pi fmini:s// Kēt çì:k e kōm pa:s n' shko:ll//* etj.

Te folësit e brezit të vjetër kemi vënë re se, disa dëftorë, qofshin në funksion të përemrit apo në atë të mbiemrit, dalin sipas këtij tipi: *así, asó, asísh, ksísh* p.sh.: *//Nuk ka así búrrí//Nuk ká asó gru:je//*.

Trajtat *asísh, ksísh* përdoren me kuptim negativ (pezhorativ), p.sh.: *//Çíka e lsmetit kish ní:s mu asísh* (euf. d.m.th. të bëjë marrëdhënie seksuale)// etj.

Në dallim nga e folmja fqinjësore e Shalës së Bajgorës (Mulaku 2005:106) e ndonjë tjetër, në Istog nuk kemi vënë re të përdoren përemrat e tipit: *ksōsh, asōsh* qoftë kur janë në funksion të mirëfilltë të përemrit, por as kur janë në rolin e mbiemrave.

Paradigma e lakimit të përemrave **çeky, çata, çaj** në bashkëvjajtje me emra.

Em.	<i>çeky bu:rr</i>	<i>çata búrra</i>	<i>çaj mik</i>
Gjin.	<i>çetj búrrri</i>	<i>çatyne búrrave</i>	<i>çatj miku</i>
Dhan.	<i>çetj búrrri</i>	<i>çatyne búrrave</i>	<i>çatj miku</i>
Kall.	<i>çet bu:rr</i>	<i>çata búrra</i>	<i>çat mk</i>
Rrjedh.	<i>çetj búrrri</i>	<i>çatyne búrrave</i>	<i>çatj miku</i>

§ 164. Përemri pyetës.- Është përemri me të cilin pyetet për frymorë a sende ose për sasinë, rreshtin, përkatësinë a tiparet e tyre (Gramatika I 2002: 243).

Përemrat pyetës në të folmen e Istogut janë: **kush, cilli, cilla, cillt, cillat, çka, ça, sa, kur, ku** etj., pra janë të njëjtë apo të ngjashëm me të folmet e tjera të gegërishtes verilindore.

Përemri pyetës **kush** përdoret për të pyetur për njerëz (për të dy gjinitë) dhe asnjëherë nuk del në bashkëvjajtje me emrin, p.sh.://**Kush t' kallzoj ç po martóhet Xhavíti?// Kush po shkon n' paza:r/ ti a vlláu yt?//.**

Nga ana tjetër, përemrat pyetës **cilli, cilla, cillt, cillat** përdoren për të pyetur për njerëz, për kafshë dhe për gjëra të tjera, p.sh.: //**Cilli pej sho:kve âºsht ma i dáshtuni?// Cilla pej çikave u nis me shku: n' shko:ll?// Cilla lo:p e ka rënin me pje:ll?// Cilli mal âºsht ma i rritun?//.** Nga shembuj e dhënë mund të vihet re se përemrat e lartëshënuar dalin në bashkëvjajtje me emrat dhe, në të tilla raste, kryejnë funksionin e mbiemrave përcaktorë-pyetës.

Nga ana tjetër, përemrat pyetës të tipit **çka, ça** dalin në formë të ngurosur, pra nuk kanë kategori gramatikore dhe përdoren për të pyetur për ndonjë tipar a veti të frymorëve, p.sh.: //**Çfar' kímje kish káli ç e bléve?// Çka /ça lýpi Rexhépi ç i t' thírri te déra?//**

Përemri pyetës **sa** shërben për të pyetur për ndonjë sasi të njerëzve, kafshëve a gjësendeve, p.sh.: //**Sa ve:t i ke thi:rr n'dasêm?// Sa mótra ini?// Sa kília kryp i bléve?//.**

Paradigma e lakimit të përemrave pyetës **kush, cilli, cilla, cillt, cillat**

Em.	<i>kush</i>	<i>cilli</i>	<i>cilla</i>	<i>cillt</i>	<i>cillat</i>
Gjin.	<i>kúj (t)</i>	<i>cillit</i>	<i>cillês</i>	<i>cillve</i>	<i>cillave</i>
Dhan.	<i>kúj</i>	<i>cillit</i>	<i>cillês</i>	<i>cillve</i>	<i>cillave</i>
Kall.	<i>kôn</i>	<i>cillin</i>	<i>cillên</i>	<i>cillt</i>	<i>cillat</i>
Rrjedh.	<i>kúj (t)</i>	<i>cillit</i>	<i>cillês</i>	<i>cillve</i>	<i>cillave</i>

§ 165. Përemri i pacaktuar.- Tregon frymorë a sende në mënyrë të pacaktuar ose sasi të pacaktuar të tyre (Gramatika I 2002:249), p.sh.: **nejkush, asnjô, kurrnjô, asnjâⁿⁱ, kurrnjâⁿⁱ, dikush, secilli, secilla, secillt, secillat**, ndërkaq përemrat e tipit si: **shëm, pak, dō, t'tâⁿ, pakkush, shëmkuh**, shërbejnë për të treguar sasi të pacaktuar frymorësh a sendesh. Për sa i përket aspektit të formimit të përemrave të pacaktuar si njësi gjuhësore, kemi vënë se shumica e tyre janë të formuar me anë të përngjitjes , p.sh.: nga përngjitja e përemrit pyetës **kush+** pjesëzat si: **di +kush = dikush; nej+kush = nejkush; kër+kush=kërkush; pak+kush=pakkush; shum+kush=shumkush; xhith+kush=xhithkush; tjetër+kush=tjetërkush; di+kush= dikush** etj.

Në disa raste, përemrat e pacaktuar përdoren në formë të përsëritur,veçmas kur tregojnë veprime që ndodhin më rrallë, p.sh.:// **Dikush-dikush dru:t e dimnit i len përjáshta n' shí e n' bo:r!// Dikôn- dikôn nuk â^sht mi:r me çit n'dri:t!//**. Mjaft dendur përdoren edhe përemrat e pacaktuar, të formuar me anë të përngjitjes së përemrit **xhith+** përemrat e tipit: **secilli, secillt, secilla, secillat, ajo kjo, kta, kto**, p.sh.: **xhithsecilli, xhithsecilla, xhithktó** etj. Përemrat e formuar nga **xhi:th+secilli, xhi:th+secilla** etj. zakonisht përdoren në krye të fjalisë, p.sh.:// **xhithsecilla pej júve duhet me kçýr punën e vet//**. Përemrat e pacaktuar të tipit **njâⁿⁱ, njâ^{na}, nejnâⁿⁱ, nejnâ^{na}, kurrnjâⁿⁱ** nuk shkojnë në bashkëvajtje me emrat, por lakohen njëlloj si ata.

Paradigma e lakimit të përemrave të pacaktuar: *njâ°ni*, : *njâ°na*, *nejnjâ°ni*, *nejnjâ°na*.

Em.	<i>njâ°ni</i>	<i>njâ°na</i>	<i>nejnjâ°ni</i>	<i>nejnjâ°na</i>
Gjin.	<i>njâ°nit</i>	<i>njâ°nës</i>	<i>nejnjâ°ni</i>	<i>nejnjâ°nës</i>
Dhan.	<i>njâ°nit</i>	<i>njâ°nës</i>	<i>nejnjâ°nit</i>	<i>nejnjâ°nës</i>
Kall.	<i>njâ°nin</i>	<i>njâ°nën</i>	<i>nejnjâ°nin</i>	<i>nejnjâ°nën</i>
Rrjedh.	<i>njâ°nit</i>	<i>njâ°nës</i>	<i>nejnjâ°ni</i>	<i>nejnjâ°nës</i>

§ 166. Përemri pronor.- Përemrat e tillë kanë përdorim të dendur dhe dalin me një shumësi trajtash. Në të shpeshtën janë të ngjashëm me pjesët e tjera të gegërishtes verilindore, por ka edhe të atillë që, janë karakteristik në këto anë.

Pronorët e vetës së parë njëjës, në rasën emërore, dalin në trajtën *jêm-* për gjininë mashkullore, p.sh.: *Djali jêm*, dhe *jême-* për gjininë femërore, p.sh.: *Çika jême*. Përemrat e tillë gjithmonë gjenden pranë emrave dhe në rastet, kur janë në bashkëvajtje me emrat, çdo herë janë të panyjshëm, kurse kur nuk janë në bashkëvajtje me emrat marrin nyje të përparme, p.sh.: *i jêmi*, *e jêmja* etj. Përfundim nga kjo që u tha përbën përemri pronor i tipit aglutinativ: *satâ°ma* (*mëmës/nënës tënde*), p.sh.: *Ta kájsha satâ°mën!*

Për dallim nga disa të folme veriore, në Istog, pronoret e vetës së parë njëjës, kur prona dhe pronari janë në njëjës, dalin me *j* (me funksion hiati). Ky tip përemrash u prapangjitet emrave, p.sh.: *shpja jême*, *nâ°na jême*, *vllau jêm* etj.

Paradigma e lakimit të përemrave pronorë të vetës së parë:

1. Pronari njëjës (gjinia mashkullore)		
	Prona njëjës	Prona shumës
Em.	<i>shóku jëm</i>	<i>shókt e mị</i>
Gjin.	<i>shókut têm</i>	<i>shókve t mị</i>
Dhan.	<i>shókut têm</i>	<i>shókve t mị</i>
Kall.	<i>shókun têm</i>	<i>shókt e mị</i>
Rrjedh.	<i>shókut têm</i>	<i>shókve t mị</i>

Gjinia femërore				
	Prona njëjës		Prona shumës	
Em.	<i>nusja jême</i>	<i>e jêmja</i>	<i>motrat e mija</i>	<i>t mijat</i>
Gjin.	<i>nuses têm</i>	<i>têmes</i>	<i>motrave t mija</i>	<i>t mi:jav(e)</i>
Dhan.	<i>nuses têm</i>	<i>têmes</i>	<i>motrave t mija</i>	<i>t mijat</i>
Kall.	<i>nusen têm</i>	<i>têmen</i>	<i>motrat e mija</i>	<i>t mi:jav(e)</i>
Rrjedh.	<i>nuses têm</i>	<i>têmes</i>	<i>motrave t mija</i>	<i>t mi:jav(e)</i>

2. Pronari shumës				
Gjinia mashkullore				
Em.	<i>vlláu jo:n</i>	<i>i jóni</i>	<i>vlláznit to:n</i>	<i>tónt</i>
Gjin.	<i>vlláut to:n</i>	<i>tónit</i>	<i>vllazníve to:n</i>	<i>tónve</i>
Dhan.	<i>vlláut to:n</i>	<i>tónit</i>	<i>vllazníve to:n</i>	<i>tónve</i>
Kall.	<i>vlláun to:n</i>	<i>tónin</i>	<i>vlláznit to:n</i>	<i>tónt</i>
Rrjedh.	<i>vlláut to:n</i>	<i>tónit</i>	<i>vllazníve to:n</i>	<i>tónve</i>

Gjinia femërore				
Em.	<i>grúja jo:n</i>	<i>e jona</i>	<i>gra:t tóna</i>	<i>tónat</i>
Gjin.	<i>grús to:n</i>	<i>tónes</i>	<i>gráve tóna</i>	<i>tónav(e)</i>
Dhan.	<i>grús to:n</i>	<i>tónes</i>	<i>gráve tóna</i>	<i>tónave</i>
Kall.	<i>grún to:n</i>	<i>tónen</i>	<i>gra:t tóna</i>	<i>tónat</i>
Rrjedh.	<i>grús to:n</i>	<i>tónes</i>	<i>gráve tóna</i>	<i>tónave</i>

Kur prona dhe pronari janë në njëjësin e gjinisë mashkullore, pronori i vetës së dytë del në trajtën **yt** për rasën emërore, dhe **to:n** për gjinore, dhanore dhe kallëzore, ndërkaj pronomi femëror në rasën emërore del në trajtën **jóte**, kurse në katër raset e tjera del me trajtën **tâºne**.

Pronori i vetës së dytë, kur prona është shumës dhe pronari njëjës i gjinisë mashkullore, del me trajtën: **e tu** (për rasën emërore), kurse **tu** për raset e tjera.

Në disa raste, pronori **júve** përdoret në vend të përemrit **juaj** (i shqipes standarde). Trajta e tillë përdoret edhe në disa pjesë të tjera të gegërishtes verilindore, p.sh. në të folmen fqinjësore të Shalës së Bajgorës (Mulaku 2005:108) e ndonjë tjetër.

Veta e dytë				
1. Pronari njëjës (gjinia mashkullore)				
	Prona njëjës		Prona shumës	
Em.	<i>shóku yt</i>	<i>i yti</i>	<i>shókt tu:</i>	<i>tu:t</i>
Gjin.	<i>shókut tâºn</i>	<i>tâºnit</i>	<i>shókve tu:</i>	<i>túve</i>
Dhan.	<i>shókut tâºn</i>	<i>tâºnit</i>	<i>shókve tu:</i>	<i>túve</i>
Kall.	<i>shókun tâºn</i>	<i>tâºnit</i>	<i>shókt tu:</i>	<i>tu:t</i>
Rrjedh.	<i>shókut tâºn</i>	<i>tâºnit</i>	<i>shókve tu:</i>	<i>túve</i>

Gjinia femërore				
	Prona njëjës		Prona shumës	
Em.	<i>shóçja jóte</i>	<i>e jótja</i>	<i>shóçet tua</i>	<i>túat</i>
Gjin.	<i>shóçes tâºne</i>	<i>e tâºnes</i>	<i>shóçeve tua</i>	<i>túave</i>
Dhan.	<i>shóçes tâºne</i>	<i>tâºnes</i>	<i>shóçeve tua</i>	<i>túave</i>
Kall.	<i>shóçen tâºne</i>	<i>tâºnen</i>	<i>shóçet tua</i>	<i>túat</i>
Rrjedh.	<i>shóçes tâºne</i>	<i>tâºnes</i>	<i>shóçeve tua</i>	<i>túave</i>

2. Pronari shumës (gjinia mashkullore)				
Em.	<i>shóku i jǔv</i>	<i>i júvi</i>	<i>shókt e jǔv</i>	<i>t jǔvt</i>
Gjin.	<i>shókut t jǔv</i>	<i>t júvit</i>	<i>shókve t jǔv</i>	<i>t jǔvve</i>
Dhan.	<i>shókut t jǔv</i>	<i>t júvit</i>	<i>shókve t jǔv</i>	<i>t jǔvve</i>
Kall.	<i>shókun e jǔv</i>	<i>t júvin</i>	<i>shókt e jǔv</i>	<i>t jǔvt</i>
Rrjedh.	<i>shókut t jǔv</i>	<i>t júvit</i>	<i>shókve t jǔv</i>	<i>t jǔvve</i>

Gjinia femërore				
Em.	<i>shóçja ju:ve</i>	<i>e júvja</i>	<i>shóçet e júve</i>	<i>t júve</i>
Gjin.	<i>shóçes ju:ve</i>	<i>t júves</i>	<i>shóçeve t júve</i>	<i>t júvve</i>
Dhan.	<i>shóçes ju:ve</i>	<i>t júves</i>	<i>shóçeve t júve</i>	<i>t júvve</i>
Kall.	<i>shóçene ju:ve</i>	<i>t júven</i>	<i>shóçet e júve</i>	<i>t júvet</i>
Rrjedh.	<i>shóçes ju:ve</i>	<i>t júves</i>	<i>shóçeve t júve</i>	<i>t júvve</i>

Janë me interes dialektor edhe përemrat e ashtuquajtur pronorë-vetvetorë : **vet**, **i véti**, **e vet**, **e vétja (e véta)**, **d vett**, **d vétat**. Përemrat e tillë përdoren në vend të përemrave pronorë e mbiemrave të vetës së tretë: **i, e sáj; i, e tij; i, e týne**, p.sh.:// **Shkoj n katun t vet// Nuk âsht mi:r me harru: njeri t vétin// Âsht mi:r çj secilli mǐ kçy:r punt e véta// Krejt Krasniçen i ka t vett//**. Këtu spikasin edhe trajtat e pronorëve të tipit si: **i tǐj, i sáj, i týne** të cilët, në vetën e tretë të njëjësit e zgjerojnë formën me **na**, p.sh.: **i, e atína; i, e asájna(sájna)**, p.sh.:// **I kallxóva Ismetit çj kjo to:k âsht e atína t prigódsit//**. **Djálit tēm, ja bâªna me díje se ky livadh âsht i asájna/ çj e patēm pa: nǐ her n' pazár!//** etj.

§ 167. Folja.- Folje quhet ajo pjesë e ligjëratës që "emërton një veprim si proces dhe që ka kategoritë gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës, diatezës. Ajo përbën bërthamën kryesore të fjalisë" (Gramatika I 2002:259).

Sistemi foljor i arealit gjuhësor të Istogut përmban shumësi trajtash dhe formash foljore që kanë ruajtur elemente të etapave të moçme të shqipes, por edhe të indoevropianishtes, përgjithësisht. Në rrjedhë të moteve, trajtat dhe format foljore kanë ardhur duke u zgjeruar dhe duke u pasuruar vazhdimisht, gjë kjo, jo aq e shprehur te

gjuhët e tjera, fqinjësore apo më të largëta, p.sh.: mënyra habitore dhe kohët e saj, disa nga format e paskajores të tipit ***pa lexue, pa u msu:(e)***.

Si rezultat i zhvillimeve të vazhdueshme, sistemi foljor i shqipes sot ka dy paradigma paralele të zgjedhimit, për formën veprorë dhe për atë jo veprorë.

E folmja në trajtim, në krahasim me shqipen standarde, por edhe me pjesët e tjera të gegërishtes verilindore, paraqet disa ndryshime në sistemin foljor. Gjatë mbledhjes së lëndës gjuhësore kemi vënë re një varg ndryshimesh (këmbimesh) të mbaresast vetore. Poashtu, kemi vënë re edhe përdorimin e një kohe foljore në vend të një tjetrës si dhe disa lëkundje në kategorinë e zgjedhimeve.

Pra, përgjithësisht mund të thuhet se sistemi foljor i këtyre anëve skajore të shqipes është mjaft i pasur, sepse foljet si njësi të caktuara lekiskore, përveç kuptimeve të para leksiko-semantike, mjaft shpesh janë bartëse të kuptimeve të dyta (modale).

Që të kemi një pasqyrë sa më të saktë të të gjitha trajtave të sistemit foljor të arealit gjuhësor në hetim, mendojmë se është me interes dialektor që në pjesën e mëposhtme t'i trajtojmë të gjithë mënyrat, format (diatezat), kohët, vetat dhe numrin e foljes, pra me një fjalë të gjitha kategoritë gramatikore të saj.

§ 168. Mënyra dëftore.- Nëpërmjet kategorisë gramatikore të mënyrës shprehet lidhja midis veprimit të emërtuar nga folja dhe realitetit objektiv. Pra, "me anë të kategorisë gramatikore të mënyrës folësi shpreh qëndrimin e tij ndaj veprimit të emërtuar nga folja, duke e paraqitur atë si të vërtetë, të mundshëm, të dëshirueshëm etj.... Sipas kuptimeve modale dhe formave gramatikore përkatëse, në gjuhën shqipe dallohen gjashtë mënyra të foljes: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore".(Gramatika I 2002: 272), ndërkaq përmes mënyrës dëftore, folësi shpreh modalitetin e vërtetësisë.

§ 169. Koha e tashme.- Foljet e zgjedhimit të parë, në formën (diatezën) veprorë, të kohës së tashme dalin me mbaresat: ***-j,-n,-n*** (në njëjës) dhe ***-jm, -ni*** dhe ***-jn*** (për shumës), p.sh.:

<i>lexoj</i>	<i>sha:j</i>	<i>blu:j</i>	<i>rru:j</i>	<i>pi:</i>	<i>çky:</i>	<i>vras</i>
<i>lexon</i>	<i>shan</i>	<i>blu:n</i>	<i>rru:n</i>	<i>pin</i>	<i>çky:n</i>	<i>vret</i>
<i>lexon</i>	<i>shan</i>	<i>blu:n</i>	<i>rru:n</i>	<i>pin</i>	<i>çky:n</i>	<i>vret</i>
<i>lexo:jm</i>	<i>sha:jm</i>	<i>blu:jm</i>	<i>rru:jm</i>	<i>pi:m</i>	<i>çky:jm</i>	<i>vrásim</i>
<i>lexoni</i>	<i>sháni</i>	<i>blúni</i>	<i>rrúni</i>	<i>pini</i>	<i>Çkýni</i>	<i>vráni</i>
<i>lexo:jn</i>	<i>sha:jn</i>	<i>blu:jn</i>	<i>rru:jn</i>	<i>pi:n</i>	<i>çky:jn</i>	<i>vra:jn</i>

Siç mund të shihet nga paradigma e zgjedhimit të foljeve në kohën e tashme, morfema trajtëformuese **–j** del te foljet e zgjedhimit të parë dhe, vështuar që në lashtësi, ajo rrjedh nga një **–nj** e shqipes së vjetër, që dikur paraqiste tingullin fundor të temës. Kjo mbaresë del në shumicën e të folmeve shqipe, përfshirë edhe standardin e saj.

Nga ana, tjetër foljet e llojit: **ha, pi, rri, di, zi** etj. në vetën e parë të njëjësit dalin pa mbaresa, por kështu nuk ndodh në vetën e dytë e në të tretën, sepse i marrin ato, kurse për sa i përket numrit shumës, foljet e tilla dalin pa bashkëtingëlloren – **j** si mbaresë vetore, p.sh. : (**un**) **pí**, (**ti**) **pin**, (**aj/ajo**) **pin**, (**na**) **pi:m**, (**ju**) **pini**, (**ata pi:n**) etj. Foljet e tipit **nxâº, përzâº** etj., në të tashmën e dëftores dalin kështu: (un) **nxâº**, (ti) **nxan**, (ai/ajo) **nxan**, (na) **nxâº:m**, (ju) **nxani**, (ata/ato) **nxâº:n**(por edhe **nxâº:jn**).

Foljet e zgjedhimit të dytë dalin me temë në bashkëtingëllore. Gjatë kalimit nga veta e parë në vetën e dytë të njëjësit, e metafonizojnë zanoren **–a** në **e (a>e)**, në trup të temës p.sh.: **dal- del, marr-merr** etj. Pjesa më e madhe e foljeve që dalin me temë në bashkëtingëllore, vetën e parë të numrit njëjës e zgjerojnë me anë të mbaresës **–i**, e cila mendohet të jetë mbetje e mbaresës **–enj (-inj)** e shqipes së vjetër, p.sh.: **hýpi, zhdrypi, plási, mërtýpi, nxhéshi, pshéshi, kréhi, mshéli, drédhi** etj.

Me mbaresën **–i** në vetën e parë të njëjësit del edhe një numër foljesh, tema e të cilave mbaron me bashkëtingëlloren **–t**, p.sh.: **prashíti, vadíti, kosíti, mërtýpi, vllaçíti, kullóti** etj. Këto folje dalin me mbaresë vetëm në vetën e parë të njëjësit, ndërkaq në vetën e tjera dalin pa mbaresa.

Foljet e zgjedhimit të tretë që, në shqipen standarde dalin me zanore, dhe gjatë zgjedhimit në të tri vetat e njëjësit kanë zero mbaresë, në të folmen e Istogut marrin mbaresa vetore, p.sh.:

unë	<i>ha:</i>	<i>pi:</i>	<i>di:</i>
ti	<i>ha°n</i>	<i>pīn</i>	<i>dīn</i>
ai/ajo	<i>ha°n</i>	<i>pīn</i>	<i>dīn</i>
na	<i>ha:m</i>	<i>pi:m</i>	<i>di:m</i>
ju	<i>hani</i>	<i>pīñĩ</i>	<i>dīñĩ</i>
ata/ato	<i>ha:n</i>	<i>pi:n</i>	<i>di:n</i>

§ 170. Foljet e mi- konjugacionit (*jôm, kôm, thôm*). -Këto folje, zgjedhohen kështu:

<i>jôm</i>	<i>kôm</i>	<i>thôm</i>
<i>je</i>	<i>kí</i>	<i>thu: (thue)</i>
<i>ô</i> (edhe <i>ôsht/ â°sht</i>)	<i>ká</i>	<i>tho:t</i>
<i>jém/jémi</i> (rrallë edhe <i>jéna</i>)	<i>kém/kemi</i> (shumë rrallë: <i>kéna</i>)	<i>tho:m (tho:jm)</i>
<i>īni (jini)</i>	<i>kīñĩ</i>	<i>thúni</i>
<i>jôn</i>	<i>kân</i>	<i>tho:n (tho:jn)</i>

Foljet me temë në bashtingëllore, në vetën e parë të shumësit dalin me mbaresën **-im**, p.sh.: ***kórrim, flásim, ujítim, kosítim, prashítim, vadísim/vadítim*** etj; vetën e dytë të shumësit e ndërtojnë me anë të mbaresës ***ni***, p.sh.: ***korrni, folni, ujitni, kositni, prashitni, vaditini***, ndërkaq veta e tretë e shumësit merr mbaresën **-in**, p.sh. ***kórrin, fólín, ujítin, kosítin, prashítin, vadítin*** etj.

§ 171. Koha e tashme e formës (diatezës) pësore. -Kjo kohë e foljes ndërtohet me anë të mbaresave: **na (hna), esh (hesh), et (het)** për numrin njëjës dhe, **em(hem), i(ni),en (hen)** për numrin shumës, p.sh.:

<i>lódhna</i>	<i>gzóna</i>	<i>msóna</i>
<i>lódhesh</i>	<i>gzóhesh</i>	<i>msóhesh</i>
<i>lódhet</i>	<i>gzóhet</i>	<i>msóhet</i>
<i>lódhem</i>	<i>gzóhem</i>	<i>msóhem</i>
<i>lódhni</i>	<i>gzóhesh</i>	<i>msóhesh</i>
<i>lódhen</i>	<i>gzóhet</i>	<i>msóhet</i>

Nga shembujt e dhënë mund të vihet re se në vend të mbaresës **-hem** të shqipes standarde, del mbaresa **na (hna)**, p.sh.: **rrítna, ftófna, nxé' na, véshna, krú' na** etj.

§ 172. Koha e pakryer.- Nga të gjitha kohët e foljes, e pakryera (imperfekti) e dëftores ka më së shumti trajta, ndonëse shumica e tyre kanë një temë të përbashkët me atë të kohës së tashme të dëftores. Kjo kohë foljore është mjaft komplekse dhe ndërtohet mbi bazën e kohës së tashme, apo mbi pjesoren, duke ua prapashtuar mbaresat e tipit: **sha, she, ke, shim, shit, shin** te foljet që dalin me temë në bashkëtingëllore, kurse **jsha, jshe, jke, jshim, jshi, jshin** te foljet me temë në zanore, p.sh.: **hajsha, hajshe, hajke, hajshim, hajshi, hajshin; rrisha, rrishe, rrike, rrishim, rrishi, rrishin** etj. Te kjo trajtë e foljes nuk hasen fare mbaresat e tipit: **-shna, nja, nje, njim, njit, njin** që, dalin në disa të folme shqipe.

Kur jemi te koha e pakryer, është me interes të vihet në pah fakti se disa folje të kësaj kohe, kanë dy trajtash, p.sh.:**vjelsha-vilsha, mjelsha-milsha, vjerrsha-virrsha, tjerrsha-tirrsha, nxjerrsha-nxirrsha, pjeksha-piçsha, heksha-hiçsha** etj. Format e tilla vihen re edhe në të folmen fqinjësore të Deçanit (Mehmetaj 2006:90) e në ndonjë tjetër. Nga ana tjetër, një numër foljesh të parregullta të tipit si: **ardhur, rënë, shtënë** etj. kohën e pakryer e formojnë kështu: **vike, bike, shtike**. Trajta të tilla foljore vihen re edhe

në të folmen e Hasit (Badallaj 20001:175), ndërkaq e pakryera e foljeve ndihmëse **kôm/ jôm**, përgjithësisht del si në shqipen standarde, me një ndryshim të vogël te veta e tretë e njëjësit, p.sh.: **isha, ishe, ish, i shim, i shit, i shin; kisha, kishë, kish, kishim, kishit (kishi), kishin.**

§ 173. Koha e kryer e thjeshtë.- Nuk dallon nga pjesët e tjera të gegërishtes verilindore. Foljet me bashkëtingëllore në këtë kohë marrin mbaresat:**a, e, i; em,t, en**, p.sh.: **mâ^ata, mâ^ate, mâ^ati, matem, matt, maten; nxéva (ngroha), nxéve, nxéhi, nxe:m, nxe:t, nxe:n** etj. Nga ana tjetër foljet me temë në zanore, në vetën e parë dhe të dytë të numrit njëjës marrin një – **v** antihiatizuese, p.sh.: **shkrúva-shkróve, shkóva- shkóve, çóva- çóve, níva-níve** etj. Veta e tretë njëjës del me mbaresën **u** apo **i**, përkatësisht gjysmëzanoren -**j** p.sh.: **thau, leu, çkeu, maroj, lexoj, shkoj** etj, ndërkaq në shumës merr mbaresat **um, ut, un**, p.sh.: **shkru:m, shkru:t, shkru:n; punu:m, punut, punu:n** etj.

Shumës i së kryerës së thjeshtë të dëftores, te disa folje formohet me anë të mbaresave të tipit: **m (em), t, n (en)**, p.sh.: **mushëm, musht, mushën; erdhëm, erdhht, erdhën; dúlëm (por edhe dolem), dúlt, dúlën** etj.

Disa folje të kësaj kohe, ashtu si në kohën e pakryer dalin me dysi trajtash, p.sh.: te brezi i moçëm, koha e kryer e thjeshtë del me diftong të reduktuar në zanoren **o**, kurse brezi i mesëm dhe të rinjtë, më dendur i përdorin trajtat e pandryshuara:

p.sh. **njeka-nóça, deka-díça, pjeka-póça, djéga-dóxha, vjédha-vódha, vjélla-vólla, drédha-dródha, pshtjélla- pshtólla** etj. Këto trajta foljore apofonike në vetën e tretë të njëjësit dalin me mbaresë zero dhe te disa prej tyre vihen re alternime vokalike, p.sh.: **nxóra-nxúr, nóça-nõç, pjélla-pöll** etj.

Foljet ndihmëse **kôm, jôm** kohën e kryer të thjeshtë e formojnë kështu: **páta, páte, páti, patëm, patt, patën; kesh, ké, kè, kèm, kèt, kèn**, ndërkaq një numër i kufizuar foljesh të parregullta, në vetën e parë të numrit njëjës dalin në aorist sigmatik të tipit si: **pa:sh, ra:sh, thash, dhash, lash** etj, kurse në vetat e tjera, aoristi nuk është i llojit sigmatik, p.sh.: në vetën e dytë njëjës, foljet e këtij tipi e reduktojnë grupin **ae**, në vetëm

zanoren hundore *ê*, p.sh.: *//Ti m' lê tu prit xhith dítën// Pse nuk m' thê çj po vjen edhe ti?//* etj.

Trajtat e formës (diatezës) pësore-vetvetore të së kryerës së thjeshtë ndërtohen kur trajtave të së kryerës së thjeshtë u paravihet pjesëza *u* p.sh.: *u msóva, u msóve, u msu:, u msúm, u msút, u msún; u msóva, u msóve, u msu:, u msúm, u msút, u msún* etj. Në këtë formë (diatezë) disa folje kanë dyshi trajtash, p.sh. *u pína-u píva, u ñrína- u ñríva, u shtrína- u shtrëva* etj.

§ 174. Koha e kryer.- Kjo kohë sajohet kur trajtave gramatikore të kohës së tashme të foljes që zgjedhohet i paravihen foljet ndihmëse, *kôm (kam)* për diatezën veprorë dhe *jôm (jam)* për diatezën pësore -vetvetore, p.sh.:*kôm msu:, kí (ke) msu:, ka msu:, kémi (kem) msu:, kini msu:, kãn msu://; kôm púnu, kí (ke) púnu, ka púnu, kémi púnu, kini púnu, kãn púnu*, kurse forma pësore vetvetore ka këtë pamje:*jôm msu:, je msu:, âsht (ôsht) msu:, jemi msu:, jini msu:, jôn msu:* etj.

Për sa i përket kohës së kryer, por edhe kohëve të tjera të përbëra, me mjaft interes dialektor është edhe ndërrimi i vendit të foljes ndihmëse, pra në vend të foljes *jôm*, del ndihmësja e tipit *kôm* dhe anasjelltas. Mendojmë se ky ndërrim, me shumë ka të bëjë me aspektin psikologjik të folësve të caktuar, sesa që është një proces thjesht gjuhësor, p.sh.:*// N' kófsha xha:ll/ ká me mâ^{rr} vesh krejt katuní se djáli i kúj jôm un// A je kâⁿ kótó kóht e funít n' shéher a jo?//* etj.

Në të folmen në shqyrtim, ashtu si në disa pjesë të tjera të gegërishtes verilindore, foljet që shprehin drejtimin a kahjen e lëvizjes, kohën e kryer e formojnë me anë të ndihmësës *jôm (jam)*, p.sh. *//Jôm a:rdh pĩ mâ^{lit}// Jôm msu: pej shókve// Jôm da:l n' bje:shk //*etj.

Një grup foljesh jo kalimtare që tregojnë drejtim a lëvizje, kohën e kryer të dëftores e ndërtojnë me anë të foljes ndihmëse *jôm*, por disa të tjera edhe me foljen *kôm*, p.sh.:*// Gra:t jôn shku: n'xhíni:/Kémi a:rdh me nëjt sâⁿte te ju//*etj.

Trajtat e formës (diatezës) pësore-vetvetore të së kryerës së dëftores ndërtohen me anë të foljes ndihmëse -*jôm* duke ia paravënë pjesores së foljeve, p.sh.: *// jôm msu:,*

je msu:, jôm msu:, âsht (ôsht) msu:, jemi (jem) msu:, jïni (ïni) msu:, jôn msu:/ etj.
Spikat këtu edhe diateza pësore-vetvetore e kohës së kryer, e tipit: *//Mu ka çu: nǐ dhímt midis dy krahve// M’u kǎn çorrú sy:t me t pá // T’u ka pri:sh gója, për çata nuk po e hǎn bukën//* etj.

§ 175. E kryera e plotë (më së e kryera).- Kjo kohë foljore ndërtohet duke ia paravendosur pjesores së foljes që zgjedhohet trajtat e të pakryerës së foljes ndihmëse *kôm*, për formën veprorë, dhe *-jôm* për formën pësore-vetvetore, p.sh.: *kǐsha msu:, kǐshe msu:, kǐsh msu:, kǐshim msu:, kǐshit msu:, kǐshin msu:* (forma veprorë), kurse për pësore -vetvetore kemi: *ǐsha msu:, ǐshe msu:, ǐsh msu:, ǐshim msu:, ǐshit msu:, ǐshin msu:; ǐsha me:t, ǐshe me:t, ǐsh me:t, ǐshim me:t, ǐshit me:t, ǐshin me:t* etj.

§ 176. Koha e kryer e tejshkuar.- Formohet kur pjesores së foljes që zgjedhohet i paravendoset aoristi i njërës prej foljeve ndihmëse, *kôm*- për formën veprorë, dhe - *jôm* për formën joveprorë (pësore-vetvetore). Këto trajta foljore, në arealin gjuhësor në trajtim kanë përdorim mjaft të dendur, p.sh.: vargjet e këngës popullore:*// Skënderbeu kur pat lǐftu:// Krejt Turçi:n n’ kâôm e pat çu://Pat çu: fja:l te sulltan e mrèt// Tókat shiptáre mos mi pre:k//*.

Paradigma e zgjedhimit të foljes *-mësoj* në kohën e kryer të tejshkuar të mënyrës dëftore, diateza veprorë dhe ajo pësore –vetvetore.

<i>pǎta msu:</i>	<i>kěsh msu:</i>
<i>páte msu:</i>	<i>kémsu:</i>
<i>pǎt (pa:ti) msu:</i>	<i>kě msu:</i>
<i>pǎtēm msu:</i>	<i>kēm msu:</i>
<i>pǎtt msu:</i>	<i>kět msu:</i>
<i>pǎtën msu:</i>	<i>kěn msu:</i>

Kohët foljore që i trajtuam deri më tani (me përjashtim të kohës së tashme) i takojnë të shkuarës, si njëra prej tri kohëve themelore të foljes. Sikundër dihet, kohët e shkuara për nga ana ndërtimore (strukturore) grupohen në:

a) *kohë të shkuara të thjeshta (e pa kryera) dhe*

b) *kohë të shkuara të përbëra (e kryera, e kryera e plotë ose më së e kryera dhe koha e kryer e tejshkuar).*

§ 177. Koha e ardhme.- Koha e ardhme (futuri) e foljes del me dysi trajtash; futuri që formohet me anë të foljes ndihmëse *kôm +* paskajorja e foljes p.sh. *kôm me msu:* p.sh.: // *Po shkoj te shpja se kôm me msu://* etj. Kjo njihet si e ardhme e domosdoshmërisë dhe i ruan ngjyrimet kuptimore të detyrimit, ndërkaq trajta perifrastike e futurit, ndërtohet me anë të foljes gjysmëndihmëse *dú (dǎ)+* e tashmja e lidhore (*dú me msu:*),p.sh.// *Dú me msu: e me kâ^on ma i míri nxôns n kla:s//*, ndryshe njihet si e ardhmja e dëshirës. Kjo trajtë e së ardhmes i ruan (paraqet) ngjyrimet kuptimore të vullnetit a dëshirës. Për sa i përket dendurisë së përdorimit të këtyre dy trajtave të futurit, kemi vënë se më tepër përdoret ajo e para.

§ 178. Mënyra lidhore.- Nuk përdoret aq të dendur, sepse funksionet sintaksore të saj shprehen me anë të paskajores, mirëpo kjo trajtë foljore janë të pranishme në ligjërimin shqip të këtyre anëve, sidomos te brezi i ri të cilët, dita-ditës janë gjithnjë e më të arsimuar. Kështu, pra përdorimi i mënyrës lidhore më së shumti vihet re te fjalitë kushtore dhe ato lidhore, pastaj te fjalitë me ngjyime kohore, por edhe në togjet foljore, p.sh.:// *I kéçi t' merr n' ça:f// Kur t'folsh, ose máje fjálën, o mos fol hiç// Jepu thmíve t' ha:n e t' pí:n nëj sën!*

Mënyra lidhore, siç e thamë edhe më lart, mjaft shpesh del edhe te togjet e qëndrueshme foljore, pra ashtu si në të folmen fqinjësore të Deçanit (Mehmetaj 2006:99), p.sh.:// *thírri me a:rdh n' pu:n/ thúju d ví:n n pu:n// britju t' shko:jn n' pu:n d véta//* etj.

Në vazhdë të kësaj që u tha, kemi vënë re edhe disa raste të përdorimit të lidhore së ndërtuar nga pjesëza **t' (-të)** dhe koha e pakryer e dëftores, por edhe nga aoristi. Përdorimi i kësaj trajte foljore është e lidhur me situata hipotetike (kushtore) për kryerjen e një veprimi, p.sh.: *//Mos t' erdh mjéku dǔgri kè tu de:k çíka e Fazli:s// N ti folke cǔll edhe j her , ke tu my:t me tǔ// Mos t ishim ve:sh trash, kem tu u mǔrdhí s ftofti//* etj. Në arealin gjuhësor në shqyrtim, mënyra lidhore ka tri kohë:

a) *koha e tashme*- e cila në diatezën veprorë del e njëjtë sikurse dëftorja, porse këtu folja gjithnjë paraprihet nga pjesëza **t' (të)**. Dallimi tjetër qëndron në faktin se në lidhore , veta e dytë e numrit njëjës merr mbaresën **-sh/-jsh**.

b) *Koha e pa kryer*- del me trajta të njëjta sikurse dëftorja, vetëm se këtu foljes i paravendoset pjesëza **-t (të)**.

c) *Koha e kryer e plotë (më së e kryer)*- mund të thuhet se nuk ka përdorim aq të dendur dhe në disa raste e kryen funksionin e mënyrës kushtore, p.sh. *//Ta kishe çe:l kanâ⁹llin, kishe me pás u:j // T na kishin thâ⁹n me çu: te mjéku, e kishim çu: çysh mǔti//* etj.

Zgjedhimi i foljes **-punoj** në mënyrën lidhore.

<i>E tashme</i>	<i>E pa kryer</i>	<i>E kryer e plotë (ms. e kryer)</i>
<i>t punǔj</i>	<i>t punǔjsha</i>	<i>t kǔsha pǔnu</i>
<i>t punǔjsh</i>	<i>t punǔjshe</i>	<i>t kǔshe pǔnu</i>
<i>t punǔn</i>	<i>t punǔjke</i>	<i>t kǔsh pǔnu</i>
<i>t puno:jm</i>	<i>t punǔjshim</i>	<i>t kǔshǔm pǔnu</i>
<i>t punǔnǔ</i>	<i>t punǔjshi (-it)</i>	<i>t kǔshǔt (kishi) pǔnu</i>
<i>t puno:jn</i>	<i>t punǔjshin</i>	<i>t kǔshǔn pǔnu</i>

§ 179. Mënyra kushtore.- Folja në mënyrën kushtore tregon rrjedhimin e një kushti të shprehur nga një pjesë e nënrenditur kushtore, kallëzuesi i së cilës është një folje në kohën e pa kryer ose në të kryerën e plotë të mënyrës lidhore. Mënyra kushtore

në gjuhën shqipe "përdoret edhe nëpër ligjëratë të zhdrejta për të zëvendësuar kohën e ardhme ose të ardhmen e përparme të ligjëratës së drejtë, në rast se veprimi i shprehur nga folja nuk i përket më së ardhmes në çastin kur e kthejmë ligjëratën e drejtë në të zhdrejtë" (Gramatika I 1975:237).

Kjo mënyrë ndërtohet me anë të së pa kryerës së foljes ndihmëse **kôm** për diatezën veprorë dhe, **-jôm** për diatezën pësorë-vetvetore si dhe duke ia shtuar pjesoren e foljes që zgjedhohet, p.sh.: // **Un kisha me shku: n' fakulltet mi pa:s kushtet e mîra//Kisha me shku sod te daj:t/ po nuk po kôm ko:ⁿ**// etj. Kjo trajtë e kushtores nuk del aq dendur, prandaj në vend të saj më tepër përdoret koha e kryer e tejshkuar e dëftores, e tipit si:// **Pâta me shku: n fakulltet/ po nuk i kôm kúshtet// Pâta me shku: te da:jt/ po nuk po kôm ko:ⁿ** // etj.

Gjatë mbledhjes së lëndës gjuhësore, kemi vënë re se më së shpeshti përdoret trajta e kushtores që , ndërtohet nga e kryera e foljes ndihmëse **kôm** në dëftore+ paskajorja e foljes që zgjedhohet, p.sh.:// **Kôm pa:s me msu: //Ke pa:s mi thi:rr miçt n' dasëm**// etj.

Mënyra kushtore këtu nuk ka përdorim aq të dendur, sepse funksionet e saj në të shumtën shprehen përmes ndonjëres nga kohët e mënyrës dëftore, rëndom me anë të kohës së pa kryer, të së kryerës së plotë e në disa raste edhe me anë të së kryerës së plotë (më së të kryerës) të mënyrës lidhore.

§ 180.Mënyra habitore.- Gjuha shqipe gjatë zhvillimit të saj historik ka krijuar formë foljore me anën e të cilave shprehet kryesisht habia e folësit për një veprim a gjendje të papritur që, është kryer në të shkuarën, ose që është në të kryer e sipër në çastin e ligjëritimit, pra është fjala për format e habitores, që për nga modaliteti është e afërt me mënyrën dëftore, sepse ashtu si kjo, edhe habitorja karakterizohet nga modaliteti i vërtetësisë, shoqëruar njëherazi edhe nga shprehja e habisë së folësit. Për nga "tipi strukturor, habitorja e shqipes nuk ka shoqe në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane" (Demiraj1980: 324). Përdorimi i shpeshtë i habitores përbën një nga veçoritë e të folmes së Istogut. Përdorim të shpeshtë kanë kryesisht koha e tashme dhe

e kryera e habitores, por edhe e kryera e dytë, ndërkaq më së denduri vihet re përdorimi i kohës së tashme.

Foljet e kohës së tashme që dalin temë në bashkëtingëllore, përgjithësisht dalin me temë të pjesores dhe marrin këto mbaresa: **kna, ke, ka, kem, ki (-t), kan**, p.sh.: **lajkna, lajke, lajka, lajkem, lajki (t), lajkan**.

Në raste e rrethana të veçanta ligjërimore, banorët e kësaj ane, format foljore të së tashmes së habitores i përdorin duke ua paravënë foljeve pjesëzën **po**, p.sh.: **po lajkna, po lajke, po lajka, po lajkem, po lajkī (t), po lajkān; po msōjknā, po msōjke, po msōjka, po msōjkem, po msōjki (t), po msōjkan** etj.

Trajtat e diatezës pësore-vetvetore të kohës së tashme të habitores ndërtohen kur formave foljore të diatezës veprore u paravihet pjesëza trajtëformuese **u**, p.sh.: **u lajkna, u lajke, u lajka, u lajkēm, u lajki (t), u lajkan** etj., ndërkaq koha e kryer e e kësaj mënyre formohet me anë të foljeve ndihmëse **kōm** (për diatezën veprore) dhe, **jōm** (për diatezën pësore-vetvetore) në kohën e tashme të habitores+ pjesorja e foljes që zgjedhohet, p.sh.: **pāsnā la:, pāske la:, pāska la:, pāskem la:, pāski (-t) la:, pāskan la:** (diateza veprore); **kōkna la:, kōke la:, kōka la:, kōkem la:, kōkit (kōket) la:, kōkan la:**, për diatezën pësore-vetvetore . Siç mund të vihet re, trajtat e tilla foljore shprehin një ndodhi a veprim të papritur që ka ndodhur në të kaluarën, por që rrjedhojat e tyre vërehen më vonë, pra në çastin e ligjërimimit (në kohën e tashme).

§ 181. Mënyra dëshirore.- Në sistemin foljor të shqipes ekzistojnë forma të posaçme për të shprehur modalitetin e dëshirës, p.sh.: format e tipit **punofsha, lexofsha** etj., të cilat për nga struktura nuk kanë shoqe në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane. Siç dihet, *”në gjuhët e indoevropiane mënyra dëshirore e dikurshme është zëvendësuar nga mënyra lidhore ose është përzier me këtë të fundit”* (Demiraj 1980: 313).

Mënyra dëshirore e foljes në arealin gjuhësor në trajtim, ashtu si edhe në shqipen standarde, ka dy kohë: të tashmen, që ka përdorim më të dendur si dhe kohën e kryer, që përdoret më rrallë.

Trajtat e diatezës veprorë të kohës së tashme të dëshirores ndërtohen nga tema e aoristit ose nga tema e pjesores së foljes duke ia shtuar mbaresat vetore të tipit: **-fsha, fsh, ft, fshim, fshi (-t), fshin** (kjo vlen për ato folje që dalin me temë në zanore), p.sh.: **msófsha, msofsh, mso:ft, msófshim, msófshi (t), msófshin; punófsha, punöfsh, puno:ft, punófshim, punófshi (t), punófshin** etj., ndërkaq foljet me temë në bashkëtingëllore, gjatë zgjedhimit në kohën e tashme, marrin mbaresat e tipit: **sha, sh, t, shim, shi (-t), shin**, p.sh. **vráfsha, vräfsh, vra:ft, vráfshim, vráfshi (-t), vráfshin; kórrsha, körrsh, ko:rrt, kórrshim, kórrshi (-t), kórrshinetj.**

Format e diatezës pësore-vetvetore të së tashmes së dëshirores formohen kur trajtës veprorë të dëshirores u paravijet pjesëza fjalëformuese **u**, p.sh. **u msófsha, u msofsh, u mso:ft, u msófshim, u msófshi (t), u msófshin; u rrítsha, u rritsh, u rrítt, u rrítshim, u rrítshi (t), u rrítshin** etj.

Koha e kryer e mënyrës dëshirore formohet mbi bazën e kohës së tashme të dëshirores së foljeve ndihmëse **kôm** dhe **jôm+** pjesorja e foljes në zgjedhim, p.sh.: **páça msu:, páç (e) msu:, pa:st msu:, páçim msu:, páçi (t) msu:, páçin msu:; páça ko:rr, páç (e) ko:rr, pa:st ko:rr, páçim ko:rr, páçi (it) ko:rr, páçin ko:rr** (për diatezën veprorë, kurse për diatezën (formën) pësore-vetvetore kemi format: **kófsha msu:, kófsh msu:, ko:ft msu:, kófshim msu:, kófshi (it) msu:, kófshin msu:** etj.

§ 182. Mënyra urdhërore.- Mendohet se është trashëguar nga një fazë e hershme e indoevropianishtes dhe në rrymë të shekujve i është nënshtruar ndryshimeve të vazhdueshme.

Urdhërorja e foljes në gjuhën shqipe, ashtu si në gjuhët e tjera indoevropiane, "përdoret zakonisht për të shprehur një kërkesë të folësit në formë urdhri, nxitjeje, lutjeje etj." (Demiraj 1980:294). Mënyra urdhërore në rrethin gjuhësor në shqyrtim, në thelb, nuk dallon nga të folmet e tjera të gegërishtes verilindore. Kjo mënyrë ka vetëm kohën e tashme (prezentin), pra ngjyrimi urdhëror mund të shprehet vetëm përmes vetës së dytë të njëjësit dhe të shumësit. p.sh.: **//Föl me zâº ma t nâºlt se nuk po níhesh!// Fölni me zâº ma t nâºlt se nuk po níh (e)ní!//** etj. Trajatat e foljeve të tipit: **le t mso:j, le t (net)**

vjen etj., edhe pse në thelb shprehin ngjyrimin e kuptimit urdhëror, ato janë forma tipike të mënyrës lidhore që, u paravihen formantet e ngurosura si: **let (net)**. Trajtat e tilla foljore me kuptim urdhëror vihen re edhe në të folmen e Hasit (**Badallaj 2001:188**), në të folmen e Deçanit (**Mehmetaj 2006:105**) e në ndonjë të folme tjetër.

Siç u sipërtheksua edhe më lart, mënyra urdhërore mund të shprehet në formë:

-urdhëri:// **Mos fōl// Përgaditne drékën // Mos shko n' xhāmí//** etj.

-nxitje:// **Bōnu nxōns i mi:r/ përga:j bab's tōn// Merre vet cillën po t pëlçen//**.

-këshille:// **Du:je atdhéun si shçipónja fole:n// Respektó sa t' âsht xha:ll se kur t dës tani âsht vo:n//**

-lutjeje:// **A s na recitoni nëj vje:rsh// A s' po e thirr mjekun a/ se s' po mÿj mi dúru dhi:mt//** etj.

Te disa folje në mënyrën urdhërore, ndodh përngjitja e trajtave të shkurtra të përemrave, **e** dhe **i** me foljet, p.sh.: **kape, mshele, hape, nxirre, pshtille** etj.

§ 183. Format e pashtjelluara të foljes.- Në sistemin foljor të së folmes së Istogut, përveç trajtave (formave) të shtjelluara të tipit sintetik dhe të atij analitik, janë përfutur edhe trajtat e pashtjelluara të foljes, nga të cilat vetëm njëra është sintetike (pjesorja), kurse të tjerat janë të llojit analitik (përcjellorja, paskajorja dhe mohorja). Quhen trajta të pashtjelluara të foljeve, sepse "*janë forma jopredikative ose jovetore dhe asnjëra prej tyre nuk mund të ketë kryefjalë me të cilën do të përshtatën në numër dhe vetë*"(Çeliku 2000:28).

§ 184. Pjesorja (participi).- Është një prej trajtave të pashtjelluara të foljes që del me laryshi trajstash. Më tepër përdoret si pjesë përbërëse e kohëve analitike, ndonëse vihen re edhe raste kur del me përdorim të pavarur, p.sh.: **//Lá e çpêrlá po/ po éra e llóçit nuk ju kish he:k// Le: e rri:t n' katun e nuk e din çka âsht sháti//** etj. Kjo trajtë foljore, ndryshimet më të mëdha i pëson në rastet kur është pjesë përbërëse e kohëve analitike, sepse në disa raste formohet me zanore të gjatë, p.sh.: **livru:, sakatu:, çillu:** etj., kurse në një numër shembujsh, pjesorja del me togun zanor **ue**, p.sh.: **livrue, punue,**

sakatue, çillue etj. Ndryshimi i pamjes së pjesores është mundësuar prej disa faktorësh siç janë: mosha e folësve (brezi i vjetër), vendi apo origjina e folësit (fshatrat periferike të Istogut ,në kufi me Skënderajn, siç janë: Padalishta, Rakoshi, Uça etj., dhe gjinia (vihet re se togjet e zanoreve më mirë ruhen te femrat sesa te meshkujt).

Foljet me temë në bashkëtingëllore, pjesoren e formojnë pa mbaresa, p.sh.: **vje:ll, vje:dh, vje:l, çke:p, dre:dh** etj., e nga ana tjetër, disa folje me temë në zanore të gjatë, p.sh.: **ble:, thy:, blu:** etj., në pjesore nuk marrin mbaresa. Disa folje, në pjesore marrin mbaresën e tipit **në**, përkatësisht **n**, p.sh.: **thâⁿ, nxâⁿ, lâⁿ**, ndërsa disa të tjera, pjesoren e formojnë me atë të mbaresës **t**, p.sh.: **xhu:jt ru:jt, xhe:t, di:t, rri:t, prashi:t, kosi:t** etj.

§ 185. Paskajorja (infinitivi) - Trajtat e kësaj mënyre të pashtjelluar të foljes dalin në dy-tri forma që janë përfutur nga ndryshimet e bëra në rrymë të moteve.

Kjo mënyrë është e vjetër, sepse qëmoti del pareshtur në shkrimet e vjetra të shqipes. Format e paskajores paraqesin një ndër dallimet kryesore dialektore të shqipes, sepse sikundër dihet, në dialektin e gegërishtes prej shekujsh përdoret trajta e gegërishtes që formohet me anë të pjesëzës **me** dhe pjesorja e foljes, p.sh.: (**me punu:, me msu:** etj.) ndërkah në toskërishte kemi paskajoren e formuar nga parafjala **–për** + pjesëza **–të+** pjesorja e foljes, p.sh.: (**për të punuar, për të mësuar** etj).

Paskajorja në të folmen tonë ka përdorim të dendur dhe më së shpeshti del ajo e tipit perifrastik, e formuar nga pjesorja e foljes, duke i paravënë pjesëzën **me**, p.sh.: **me pa:, me a:rdh, me shku:, me livru:, me përzi:** etj. Këtu vihet re edhe tipi i paskajores së ashtuquajtur paskajorja e mungesës që, formohet nga pjesorja e foljes duke ia paravënë pjesëzën mohuese **pa**, p.sh.: **pa pa:, pa a:rdh, pa shku:, pa livru:, pa përzi:** etj. Krahastrajtave të përmendura të paskajores, kemi vënë re edhe trajta të atilla që, formohen me anë të dy pjesëzave: **për me** dhe **për pa**, p.sh.: **//Për me pa:s/ duhet me punu: shum// Për pa de:k djem e çika/ jo nuk lshóhet Mitrovica//** etj.

Foljet e kësaj mënyrë, diatezën pësore-vetvetore e formojnë duke u paravënë pjesëza **u** para pjesores së foljes, p.sh.: **mu msu: (për mu msu:) m'u gzu: (për mu gzu:), mu livdu: (për mu livdu: etj).**

Disa trajta të paskajores shprehin edhe modalitetin e kohës së kryer. Këto tipe paskajoresh formohen me anë të pjesëzës **me+** folja ndihmëse **kôm (pas)+** pjesorja e foljes, p.sh.: **//Me kê^on me pas shku: me vakt/ nuk ju kish i:k autobúsi// Mee pa mje:ll grunñ çysh duhet/ nuk ish me:t pa bí// etj.**

§ 186. Përcjellorja (gjerundi).- Formohet në atë mënyrë, kur pjesores së foljes i paravihet pjesëza **tu (tuj = duke)**, p.sh.: **tu punu:, tu lexu:, tu livru:** Pjesëza **tu (tuj)** në të folmen në shqyrtim pëson ndryshime mjaft të shpeshta, sepse te i njëjti folës, herë përdoret pjesëza **tu**, e herë ajo **tuj**. Për sa i përket përcjellores së foljes, në disa raste kemi dëgjuar edhe trajtat si: **//Jôm tût thâ^on le: mos shko n' pazár// Pse po i lakmoni tókat e húja tuj pa:s t'júvet// Kah i nxhíti xhâ^o:n n' bje:shk ja nísi me frý e:r e me rá shí //etj.**

§ 187. Fjalët e pandryshueshme.- Në të folmen e Istogut, shumica e fjalëve të pandryshueshme dalin me po ato trajta (forma) si në pjesët e tjera të gegërishtes verilindore dhe më gjerë, megjithëkëtë, gjallojnë edhe forma të veçanta fjalësh dialektore, p.sh.: disa ndajfolje, lidhëza, parafjalë. Prej pjesëve të pa ndryshueshme të ligjëratës veçohen: *parafjalët, ndajfoljet, lidhëzat, pjesëzat, pashtirrmat dhe onomatopetë.*

§ 188. Ndajfolja.- Përdoret mjaft të dendur dhe është e ngjashme me pjesët e tjera të gegërishtes verilindore, ndonëse në ditët e sotme, parë nga rrafshi (struktura) morfologjik ato pasurohen vazhdimisht nga pjesët e tjera të ligjëratës (Hysa 1972:288). Duke qenë kështu, ndajfoljet janë disa llojesh. Më poshtë po paraqesim disa prej tyre.

§ 189. Ndajfolja e vendit.- Nga të gjitha llojet e ndajfoljeve të vendit që ka gjuha shqipe, me interes dialektor na duken këto: *k^hâ^o* (edhe *çek^hâ^o*), *āsajde (časajde)*, *ksājde*, *çeknej(çeknéna)*, *çăněj (çănénaj)*, *nat*, *lārg*, *kūn*, *xhithkun*, *dikūn*, *nèjkūn*, *kūrrkun*, *atje (çătje)*, *ktū (çetū)*, *xhithka^h*, *kërka^h*, *përmî*, *përfunî* etj.

Ndajfolja e vendit *k^hâ^o* me trajtën e vet *çek^hâ^o*, shpreh nocionin e vendit, por të papërcaktuar saktësisht, p.sh.: //Hajde çek^hâ^o/mos rri te déra// A po vjen k^hâ^o / apo vi un atje?// etj.

Ndajfolja *asajde*, me variantet e saj *časajde*, *ksajde*, *çeknej (çeknéna)* dhe *çăněj (çănénaj, ənénaj)* shërben për të treguar drejtimin (kahjen) e lëvizjes, pra trajektoren apo vijën nëpër të cilën lëvizet a kalohet, p.sh.:// Çasajde i ra:m/ po nuk pa:m as mīlic e as ushta:r// Mos hīn çăněj se īsh llōç i madh e bâ^ohesh çýçe//Çanénaj nuk e paska ka:p úji/ kōka me:t pa vadi:t// etj.

Ndajfolja *kūn*, me trajtat e veta (*dikūn*, *nèjkūn*, *xhithkūn*, *tjetèrkūn*) kanë përdorim mjaft të dendur, p.sh.: // Mos shkō kūn/ rrī te shpja// Dikūn kīsh rá shí e dikūn bo:r// Mos kī shku: nèjkūn pa e ve:t babën?// Xhithkūn sot jōn a:rdh ko:h t' rā^ona// Shkova te Alija/ ja lýpa dō páre/ po tjetèrkūn nuk shkáva// etj.

Për sa i përket ndajfoljes së vendit *dikūn*, kemi vërë re se, kjo trajtë mjaft shpesh përdoret edhe në formë të dyfishuar, p.sh.://Livádhin dikūn- dikūn e kīsh dje:g dīlli/ e dikūn jo// Dikūn- dikūn thmja po jōn për mashalla^h e dikūn jó // etj.

§ 190. Ndajfolja e kohës.- Ndajfoljet e kohës "emërtojnë një rrethanë kohore, d.m.th kohën kur kryhet veprimi ose gjendja e shprehur nga një folje, nga një emër prejfoljor i nyjësuar" (Gramatika I 2002: 362). Në idiomën gjuhësore të Istogut, dalin këto trajta dialektore të ndajfoljeve të kohës: *tash*, *dje*, *prâ^om*, *pārprâ^omi*, *pärtjetèrprâ^omi(pärtitiprâ^omi)*, *pārdjehí (pardje)*, *néstra*, *masnéstri,māsnéstriprâ^oma*, *pārvjet (pārvjéti)*, *përnihère*, *tānaherèt*, *nīsesos*, *fūnekrý* etj.

Të po kësaj natyre janë edhe ndajfoljet: *kādit* (moti, prej kohësh), *dōgrī* (menjëherë, mu tani, në çast) dhe ndajfolja *nâ^otje* (në mëngjes).

Përdorim kanë edhe ndajfoljet e tipit ***néstra, masnéstri***, që gjallojnë edhe në trajtat: ***n'néstrit, n' masnéstrit*** që, për nga ana semantike janë të barasvlefshme me trajtat ***të nesërmen, të pasnesërmen***. Këto tipe ndajfoljesh vihen re edhe në të folmen fqinjësore të Deçanit (Mehmetaj 2005:112), por edhe në pjesët e tjera të gegërishtes verilindore, ndërkaq në vend të ndajfoljes ***përsëri***, del trajta e gurrës sllave ***apèt*** (sllav. ***ópet***).

Përveç trajtave të përmendura, vihen re edhe ndajfoljet e tipit: ***kajher, najher, meniher, përnat, nâºtpërnâºt, përpára, moti*** etj., p.sh.: // ***Kajher xhýshja po harron mii pi: bárnat// Dëknu najher se bëll rra:ll po delni// Menjher po e thras doktórrin// Përnat po i ngoj lájmet// Nâºtpërnâºt po shkôj te vlláu// Përpara jôn kêºn tjera kôhna// Môti nuk e kôm pa: shókun e ushtri:s*** // etj.

§ 191. Ndajfolja e mënyrës.- Prej ndajfoljeve të mënyrës që kanë përdorim më të dendur në ligjërimin e folësve të idiomës gjuhësore të Istogut janë: ***mi:r, keç, ligisht, fýtaz, kêºmaz, dréçaz, thîjas, rrúmas, çênçe, gabélçe, maxhúpçe, shkînisht, kûrçýshe, dîçýshe, nrýshe, tërmekt, mazûn, dallash, lîñ, bëthas, gûjas, hãmadréças, çóbâºnçe, órtaz*** (mesatarisht), ***kôkrrosh*** (lirshëm), ***cúc*** (i grrysur), ***fílikall*** (vetëm), ***tamarûk*** (mbërthyer), ***përñút, përkry:t, çpejt, kadále*** etj.

Në të folmen në shqyrtim gjallojnë edhe disa tipa ndajfoljesh, përkatësisht lokucionesh ndajfoljore si: ***fije-fije; gríma-gríma; cópa-cípa; vázhga-vázhga; hãºn-hãºn; pi:k e pês; rrýpa-rrýpa*** etj., p.sh.: // ***Ësh thý xhãºmi Ësh bâº cópa-cópa// Djáli i Idrízit Ësh bâº krejt hãºn- hãºn// Ëshîn da: Alíbekt e Ëshîn bâº pi:k e pês// Kjo dynjë krejt rrýpa-rrýpa***// etj.

§ 192. Ndajfolja e sasisë.- Disa prej ndajfoljeve të sasisë, që paraqesin interes dialektor janë: ***çekaç/ çíkaç*** (kaq), ***çăç*** (aq), ***bëll, bëll shûm, bëll fôrt, bëll pak, sa xérrja, sa gríma, krejt pak***, etj., p.sh.:// ***Çekaç shí nuk kôm pri:t çí bjen!// Çaç keç ish bâº udha a?// Kîni punu: bëll!// Bëll shûm Ësh mërzi:t për dja:l çí i shkoj n' Xhermôni// Bëll fôrt i***

kîsh me:t mărak me shku: te dája// Bôll pak îsh bâº pásúli sivjet// Kînxhi çî leu îsh sa xérria// Zógu i mâºlit îsh sa gríma// Krejt pak kîsh mû:jt me msu: msímin// etj.

Kur jemi te ndajfoljet, vihet re edhe një tipi i ndajfoljeve të pohimit, mohimit e dyshimit që, parë nga rrafshi dialektologjik janë me mjaft interes, p.sh.: *āni, āni pra, po pra, çysh jo, sahí, cōk, cōk po, cōk híle, beli po, kŭrr jo, kŭrr e përje:t, bëli jo, pēde, dýzash, kŭshedī, z di çysh bâºhet* etj. Trajtat e tilla ndajfoljore, përveç idiomës në shqyrtim, dalin edhe në të folmen fqinjësore të Deçanit (Mehmetaj 2005:113) e në ndonjë të folme tjetër.

§ 193. Parafjalët.- Shumica e parafjalëve në të folmen e Istogut janë të njëjta a të ngjashme me pjesët tjera të gegërishtes, veçmas me atë verilindore, p.sh.: (*te, tu, me, për, mî,pa,pî/ pej* etj.) mirëpo, ekziston edhe një vistër parafjalësh të cilat, si për nga ana ndërtimore, ashtu edhe për nga aspekti semantik, janë me interes dialektor.

Me rasën emërore del parafjala *te*, ndërkaq te disa folës dëgjohet trajta *tu* (kryesisht te brezi i moçëm). Vështruar semantikisht, parafjalët e tipit *te, tu* tregojnë vendin, ambientin (hapësirën fizike) ku ndodhemi, kryejmë ndonjë lëvizje a veprim, p.sh.: *//Hajde se po vi:m te ti// Shkóva te Ara e Madhe// Çēnin e kôm li:dh tu (te) dera// E pa:sh úkŭn îsh afrú te dbâºni //*etj.

Parafjala *ka^h* tregon orientimin prej nga drejtohet një frymor, një send a një dukuri, p.sh. *//Mos shko ka^h Çarrishta e Jañuzaj/ po bîri pak ma po:sht// I ra:sh ka^h Tomóci e jo ka^h Llúgat//* etj.

Për rasën kallëzore përdoren parafjalët e tipit: *n', mî, pērmî, nēr, për, nëpër*. Dy parafjalët e para, pra *n* dhe *m* shprehin vendin, por edhe kohën se ku ngjan ndonjë ndodhi a zhvillim, p.sh. *//Ja thăsh n' go:j ndáč ti pëlçen/ ndáč jo!// Tŭ shku: u:dhs e pa:sh nŭ aru:sh/ îsh kâºn stru:k n'shpe:ll e aty e kîsh pa bâº nŭfar grópe// Djáli i Rexhépít edhe pak dŭt kîsh me shku: n Xhermôni* etj. *//*.

Parafjalët e tipit *mî, pērmî* shërbejnë për të treguar vendin se ku kryet një veprim, p.sh. *//E lash bukēn pērmî tavo:lin// Plot sórra ishin hy:p mî kŭlm t' shpi:s//*, ndërkaq parafjala *nēr* shërben për të treguar vendin nën të cilin ndodhet diçka , p.sh.:*//*

E kışh shtí kry:t nër tavo:lin e nuk mujsha mee pá// E kışh mâºrr nř bu:k nër sétull // etj.

Parafjala **nëpër** tregon vendin (lokacionin) në të cilin kryhet një veprim a një ndodhi, p.sh.: *// Kishin hî: kualt nëpër lákna// I ra:m nëpër Kameni:c e dulèm n Orrobêrd //* etj.

Në rasën rrjedhore, së shpeshti përdoren parafjalët e tipit: **pi (pej), për, përjáshta** etj., ndërkaq përdorim më të dendur ka parafjala **př (pej)** që, shpreh marrëdhënie shkakore apo vendore p.sh.: *//Érdha př (pej) mâºlit// Lájmin e kuptóva př (pej) djálit// E kish mâºrr smújën př (pej) s ftófti //*. Kjo parafjalë përdoret dendur edhe në të folmen e Anadrinit (Pajaziti 2008:222), në të folmen e Deçanit (Mehmetaj 2006:115), në të folmen e Shalës së Bajgorës (Mulaku 2005:134), në të folmen e Hasit (Badallaj 2001:200) e në ndonjë të folme tjetër.

Në idiomën e Istogut vihen re edhe parafjalët e tipit: **përkry (-e), përmâºje, bashk me, n vën, dej tú (deri te)** etj., p.sh.: *//E móra djáthin përkrye tinâºrit // E kosítke sâºnën/ i shkójkve veç përmâºje// Băshk me Agimin erdhëm n çytet// E kışh ka:p plúmř ee kışh lâºn n' vën// Livádhi i Sokólit âºsht dēj tú Grópa e Mâºdhe//* etj.

§ 194. Lidhëza.- Është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që lidh dy gjymtyrë fjalie ose dy fjali dhe shpreh marrëdhënie të ndryshme sintaksore ndërmjet tyre (Gramatika I 2002:397). Për sa i përket lidhëzave, mund të thuhet se areali gjuhësor i Istogut nuk përbën ndonjë dallim, kundruall pjesëve të tjera të gegërishtes verilindore.

Përdorim të dendur kanë lidhëzat bashkërenditëse-shtuese të tipit si: **edhe, e,** kurse lidhëza **dhe**, përdoret fare rrallë, p.sh.: *// Edhe lyps edhe krenâºr/ któ dýja nuk shko:jn// Edhe shpiün edhe patriöt/ ku ke pá ti kshtu?!// N dasëm po shko:jm veç ũn e ti// Erdh pej Xhermanie/ nëjti veç pak e shkoj n déti //* etj.

Lidhëza **as**, zakonisht përdoret në formë të përsëritur, dhe si e tillë haset mjaft shpesh, p.sh.: *// As nuk ka hâºnjër as nuk ka pí// Nuk e dí as i káhit âºsht e as i kújt âºsht//*.

Në grupin e lidhëzave bashkërenditëse shtuese bën pjesë edhe lidhëza - *ham...ham* e cila, siç mund të vërehet, është dygjymtyrëshe. p.sh.:// *ham mĩ ni^hmu: ham me t' da:l idhnĩm me pãrẽt túa// Ham me da:l n' pazár ham me shkú n shko:ll nuk bôn kshtu o lũm mĩxha* etj.//. Kështu, në këtë kuadër vihen edhe lidhëzat bashkërenditëse veçuese të tipit si: *ńaç-ńaç, ja-ja, ńo-ńo, ńose-ńose*, p.sh.:// *Merre ńaç t' bãrdhen/ ńaç t' zẽzẽn// ńaç shko ńaç rri// Ja vraje/ ja fale// ńo shkõ n' shko:ll/ ńo merri lshõj xhãⁿ// ńose kallzója realitetin/ ńose lé krejt ket pu:n //*.

Funksionin e lidhëzave bashkërenditëse kundërthuese të tipit :*por, porse, mirẽpo, ndẽrsa* etj., e kryejnë trajtat : *veç, po, e*, p.sh.:// *Po pranõj me t kallxú/ po mos e merr ńat zemre// Éra u nãl/ veç dãⁿmet jôn t mdha:// Msu:si sa mũjke fõlke e nxõnsit sa mũjshin kçyrshin //*.

Përveç lidhëzave bashkërenditëse që i përmendëm më lart, kemi vënë re se mjaft shpesh përdoren edhe lidhëzat nënrenditëse të tipit si: *mãsi, kur, n' ko:ft çĩ (-se), edhe se, edhe çĩ, kúdo çĩ, sadõ, si n'* etj. p.sh. // *I kallzóva fũn e krý/ masi ish kãⁿ púna çãshtu// Ja kish nĩs óra e msĩmit/ kur mrrĩva n shko:ll// N ko:ft çĩ vjen Shprẽsa edhe ũn po shkoj me nẽjt te dãja// Kúdo çĩ shkelke/ tóka u bõjke shkrũm* etj.

§ 195. Pjesëzat.- Prej pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në arealin gjuhësor të Istogut janë edhe pjesëzat. Ato "shprehin nuanca kuptimore plotësuese të një fjalë atë një fjalie ose përdoren për të ndërtuar disa forma gramatikore" (Gramatika I 1975:290). Sipas strukturës trajtëformuese, pjesëzat klasifikohen në:

a) të thjeshta: *bãsh, cõk, bile, çẽ, jo, po, nuk, as, njõ*, p.sh.:// *Bãsh çysh m ka thãⁿ dãja /çãshtu m du:l// lshin kãⁿ njõ katër- pẽ:s ushta:r//* etj.

b) të përngjitura- janë këto pjesëza: *kushedi, gãti, bukur mi:r, bukur shum*, p.sh. // *Kushedi sa lítra u:j i nxãn ky bunã^r//Gati u myt n prrú t mos çellõjsha çaty ńat e me pshtu://* etj.

c) pjesëza lokucione: *as çĩ, jo se jo, po se po* etj., p.sh.:// *As çĩ m ka shku: mẽnja çĩ munẽt me rá çikãç bo:r//*etj.

Sipas aspektit semantik veçohen këto lloj pjesëzash: Pjesëzat e pohimit: *cők hîle, beli po, ani, ani de, po, po pra, po hîjdi, po more, çysh jo* etj., p.sh.: *//Cők hîle/ çika e Halilit ish kê^n çajo ç shkoj núse// Ani de/ un po shkoj n Pe:j e ti shko n Istog // Shko te dâjt/ çysh jo!// Po hîjdi ish vra: Xhavíti edhe kóxha fôrt bile//* etj.

Te disa raste, me anë të pjesëzave të pohimit shprehen nuanca dyshimi, mosbesimi, ironie apo përbuzjeje, p.sh.: *// Po hîjdi e paske nre:ç e paske knâç krejt!//Po/ po mi:r po e di çysh e päske livru: arën//* etj.

Për dallim nga shqipja standarde, ku përpara foljeve të mënyrës lidhore përdoret pjesëza *le*, në të folmen e Istogut del trajta *ne*, p.sh.: *//Nè t shkôn/ nè t vjën// nè t msôn//* etj.

Një tip tjetër pjesëzash janë edhe ato të tipit përcaktues si: *tamôn, bâsh*.

Pjesëzat *tamôn (tamam)* dhe *bâsh* janë të gurrës turke. Ato përdoren para ndajfoljes apo rrethanorit të vendit, pra në ato raste kur saktësohet një vend apo hapësirë se ku ndodhet një gjë apo ku kryhet një veprim, p.sh. *// Ish praptu: kërri bâsh n' Kthe:s t' Madhe nat shpi:ss Isúfit// E kishin pa vra: bâsh midis áre// Ish vésh n' fistôn t' ba:rdh tamôn si núse//* etj.

Pjesëza *njô* del para një numërori themelor dhe semantikisht nuk shpreh diçka të saktë, por diçka të përafërt, p.sh.: *// Ishin kê^n njô katër- pês ushta:r//*. Para numërorëve themelorë, poashtu përdoren edhe pjesëzat e tipit: *rrafsh, rrûm* dhe *rrumullak*, por për dallim nga pjesëza *-njô*, ato shprehin përmasa të sakta, p.sh.:

// UÇK-ja i ka pa:s rrafsh 20 mi:j ushta:r// etj.

Edhe pjesëza përcaktuese e tipit *përnjô* përdoret bashkë me lidhëzën *si* apo *ç* dhe semantikisht shpreh aspekt kohor në lidhje me kryerjen e ndonjë veprimi, p.sh.: *//Përnjô ç jôn a:rdh miçasía/ veç kur t jôn a:rdh edhe plot musa:fir tje:r// Përnjô ç ka vetu: móti/ veç kur kan kërsi:t xhâ⁹mat//* etj.

Pranë foljeve që shprehin lëvizje, në të shumtën përdoren pjesëzat *thîk, thîkdôn* dhe *ñûl*. Pra, përmes këtyre pjesëzave nënkuptohet që lëvizja a veprimi është kryer në mënyrë lineare (pa asnjë devijim anësor), p.sh. *// U nxhît kodrës thîk përpje:t// U*

zhdjërg teportzes thĩkdôn tepo:sht// Me shku: te Gúrrat e Bárdha údha âºsht nũl përpje:t// etj.

Me funksionin e pjesëzës caktuese-kufizuese të shqipes standarde (*vetëm*), në trevën gjuhësore në shqyrtim del pjesëza e tipit *cõll*, p.sh.:// *A po i merr sho:kt a po vjen cõll ti?// Cõll t ish shku: plũmi pak ma âºnash kĩsh me ka:p úkun e me lâºn cõft e n to:k//* etj.

Krahas pjesëzave që i përmendëm, këtu spikasin edhe pjesëzat e mohimit të tipit: *nuk, s' (z'), mos, jo, as, cõk jo, jo çebësa* etj., p.sh. // *Zbôn mu kori:t me mĩç e sho:k!// Mos shkõ n pazár pa m kallxu: edhe mu:!/ Jo çebësa nuk i lsho:jm tókat tóna! //* etj.

§ 196. Pashirrmat.- Si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës gjallojnë mjaft dendur në gojën e folësve të këtyre anëve, sepse përmes tyre shprehen ndijimet, ndjenjat, vullneti, por pa i emërtuar ato. Pra, pashirrmat, krahas pjesëve të tjera të ligjëratës, zënë një vend të rëndësishëm në ligjërimin e gjallë të banorëve të kësaj treve, për faktin se ato janë bartëse të funksioneve të rëndësishme leksikore dhe gramatikore.

Në të idiomën në shqyrtim, pashirrmat dallohen qartë nga pjesët e tjera të ligjëratës, sepse folësit ato i shqiptojnë me një ngjyrim dhe intonacion të ndryshëm nga fjalët e tjera, shpeshherë duke i shoqëruar me lëvizje, gjeeste dhe mimika të ndryshme.

Midis pashirrmash, mjaft dendur përdoren edhe ato të tipit emocional që shprehin gëzim ose adhurim, p.sh. *o^h- o^h! ; iha!; hallall t' ko:ft; i lumi un; e lumja un; u rritsh; shyqyr; t' lu:mt; bravo; mashalla^h; shyçyr; Allahu t'dha:sht* etj., kurse lloji i pashirrmave që shprehin frikë, hidhërim, keqardhje, përbuzje etj., janë: *o^h; i^h; çýcja une; kúku; haj medet; mozomokeç; hajde de; haj bre; hajt bre; pu:n e mâºdhe* etj.

Në mënyrë që të tërhiqet vëmendja e të tjerëve, folësi përdor pashirrmat që shpehin urdhër, thirrje apo nxitje: *plaç, shúj more, pssst, shshsht, hajde, mule, bini, hej more* etj. Në këtë grup pashtirrmash klasifikohen edhe ato që shprehin falenderim, urim, mirënjohje etj, p.sh.: *nâºtën e mi:r, timi:rmetç (mirëmbetsh), udha már, tu rri:t nera, me ne:r kofsh, shnët paç, t' lu:mt gója, t' lumt kráhi, t' lũmshin kâºmt* etj.

Kur kemi të bëjmë me pasthirrmat urdhërore, me anë të të cilave folësi synon që të tërheq vëmendjen e të tjerëve, janë me interes të përmenden disa fjalë që, kryesisht përdoren në sferën e blegtorisë e, me anë të të cilave, blegtori mëton të ndjellë, ndërsejë apo të trembë (largojë) kafshët. Këtu, secila pasthirrmë është përkatëse për llojin e kafshës, p.sh.: **çās-** përdoret për ta qetësuar (urtësuar) lopën gjatë mjeljes; **çūk- çūk-** përdoret për të nxjellur mazin apo pelën (kalin) kur dëshirojmë që ta kemi afër; **çyp- çyp-** kur trembet qeni; **cyrrik-** (nga gjerm.) përdoret për t'i detyruar kuajt që të shtyhen pak më para kur janë të ngjitur në qerre; **hi:-** përdoret për ta detyruar (nxitur) lopën që të ecë përpara; **hīshsh-hīshsh-** përdoret për t'i trembur pulat dhe shpezët e tjera; **kīc-** përdoret për t'i detyruar dhitë që të ecin apo të ndërrojnë drejtim; **kūcī- kūcī-** shërben për ta ndjellur qenin; **lōk-lōk-lōk-** përdoret për ta ndjellur viçin; **lýks-** përmes kësaj pasthirme ndjellen delet kur lëshohen në fushë apo kur bëjnë rrugë pak më të gjatë; **māc-māc-** përdoret për ta ndjellur macën; **óça-** përdoret për ta qetësuar lopën kur i jepet ndonjë ilaç apo diç tjetër ; **ōkshsh-** përdoret për t'i ndalur qetë, **pèrr tiki-tīk-** përdoret për t'i ndjellur pulat; **tājt-** përdoret për t'i frikësuar (larguar) bishat nga vathat apo stallat e bagëtive; **ūjst-** kur e trembim (largojmë) kaun.

§ 197. Onomatopetë.- Edhe onomatopetë (tingullimitimet) kanë përdorim mjaft të dendur në të folmen e këtij krahu të shqipes.

Ato "shërbejnë për të riprodhuar tinguj, zëra, zhurma, britma, klithma etj., të sendeve e të dukurive të ndryshme të realitetit objektiv ose thirrma që shoqërojnë herë-herë ndonjë veprim a akt fiziologjik" (Gramatika I 2002:437).

Onomatopetë, për dallim nga gjymtyrët e tjera të fjalisë, shqiptohen me një ngjyrim dhe intonacion më të veçantë, p.sh.: **// Īsh rri:t Drini e ushtëjke auuu// Frýke meçáva e u níke tu bâº fjuuu-fjuuu//**etj.

Mbi bazën e disa imitimeve onomatoepike janë ndërtuar një numër foljesh që, shënjojnë të bërtiturit e kafshëve, shpezëve a dukurive të ndryshme të natyrës, p.sh.: **ham-ham- ham** (lehja e qenit), **by-by-by** (byrykatet kau), **kí-kí-kí** (këndon xheli), **ku:-ku:, ku:-ku:** (kukatë qyqja), **mjau-mjau** (mjauillin maca), **fjú-fjú, fjú-fjú** (fryen era), **brrr-brrr**

(krisma e automatikut), **tkrrr-tkrrr** (zhurma e çukapikut), **hĩ-hĩ-hĩ** (hingëllima e kalit), **bê-bê** (blegërima e delës) etj.

KREU V

FJALËFORMIMI

Tiparet fjalëformuese

Në studimet dialektologjike shqiptare të derisotme, fjalëformimi si një fushë e veçantë dhe shumë e rëndësishme e gjuhës, me anë të të cilit bëhet pasurimi i vazhdueshëm i saj, mund të thuhet se nuk është trajtuar mjaftueshëm ashtu sikundër janë trajtuar, p.sh.: fonetika, morfologjia etj.

Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë, në sferën e fjalëformimit, por edhe në fushat e tjera të gjuhësisë paraqet interes dialektor, sepse përmes shqyrtimit dhe analizimit të mënyrave dhe mjeteve fjalëformuese mund të hetohen më detajisht shumë aspekte dhe veçori dialektore të kësaj të folmeje.

Nga lënda gjuhësore e vjelë në terren, vihet re se leksiku (fjalësi) dialektor i Istogut është mjaft i pasur, si për nga ana sasiore, ashtu edhe për nga mënyrat dhe mjetet fjalëformuese. Krijimi i njërive leksikore në këtë të folme, përgjithësisht ka ndjekur rrugët e ngjashme me të folmet e tjera shqipe, veçmas me ato të grupit të gegërishtes verilindore, mirëpo në këtë drejtim vihen re edhe veçanti, p.sh.: mënyra e përdorimit të disa parashtesave dhe prapashtesave si dhe mënyrat dhe format e përngjitjes së disa fjalëve.

Te pjesa e fjalëformimit, do ta vështrojmë edhe fushën e toponomastikës, sepse mendojmë se ajo është me mjaft interes dialektor.

§ 198. Fjalët e parme.- Një numër i konsiderueshëm leksemash dialektore të Istogut bën pjesë në grupin e fjalëve të parme. Ato shtrihen gati në të gjitha fushat e

përdorimit dhe shumica prej tyre shërbejnë si tema motivuese për formimin e fjalëve të reja (në të gjithë tipat e fjalëformimit). Pjesa më e madhe e fjalëve të parme në të folmen në shqyrtim dalin edhe në pjesët e tjera të shqipes, por ka edhe të atilla që janë tipike dialektore për këto anë, p.sh.: *kâ^om*, *shpí*, *gru:n*, *râ^on*, *nâ^on*, *krý (krye)*, etj. Këto fjalë, përkatësisht temat e tyre, ndihmojnë në formimin e njësive të reja leksikore (fjalëve të reja), p.sh.: *kâ^omsōrí*, *shpíjaník*, *grúnâ^oj*, *nâ^onlóke*, *krý (e)madh* etj.

§ 199. Fjalë jo të parme.- Mbështetur në analizën fjalëformuese, vihet re se në këtë të folme, pjesa më e madhe e fjalëve janë jo të parme, që formohen nga tema fjalëformuese dhe formanti fjalëformues. Në këtë kategori fjalësh hyjnë:

-fjalët e prejardhura të formuara me anë të parashtesave dhe ato me prapashtesa;

-fjalët e formuara me parashtesa dhe prapashtesa njëkohësisht

-fjalët e formuara pa ndajshtesa;

-fjalët e formuara me anë të paranyjëzimit;

-fjalët kompozita (të përbëra);

-fjalët e tipit të përngjitur (aglutinative);

-fjalët e formuara me anë të konversionit;

-fjalët e formuara përmes mënyrash të përziera.

Për sa u përket mënyrave të fjalëformimit, duhet thënë se pjesa e madhe e fjalëve formohen me anë të prapashtesimit, ndërsa modelet e tjera fjalëformuese janë më pak prodhimtare.

§ 200. Parashtesimi.- Paraqet një nëntip të veçantë të fjalëformimit që, krahasuar me prapashtesimin, del të jetë më pak prodhimtar, pra afërsisht sa një e treta e prapashtesave, megjithëkëtë parashtesimi është një nga mënyrat më të rëndësishme dhe më të gjalla të fjalëformimit. “Parashtesa nuk ia ndërron kategorinë leksiko-

gramatikore fjalës me të cilën bashkohet, por i jep asaj vetëm një kuptim të ri plotësues (Gramatika I 2002: 61).

Parashtesat më të shpeshta në të folmen e Istogut janë: **ç, kăca (kaça), kăla, kăra, m, mí, n, nër, pa, păra (păr), pěr (për), s, çpër, k (ka), z.**

Kur kemi të bëjmë me parashtesat, duhet thënë se jo të gjitha janë njëlloj prodhimtare. Kështu, në këtë kuadër, disa prej tyre janë shumë aktive, duke ndihmuar në formimin e shumë fjalëve, ndërkaq disa të tjera kanë dalë nga përdorimi dhe tani konsiderohen arkaike.

Shumica e fjalëve që formohen me anë të parashtesave kanë shtrirje në pjesën më të madhe të të folmeve shqipe, prandaj këtu do t'i trajtojmë vetëm ato që mendojmë se janë më karakteristike për rrethin gjuhësor në vështtrim.

§ 201. Parashtesa ç.- U ngjitet foljeve duke u dhënë kuptim antonimik, mirëpo gjen përdorim edhe te disa mbiemra e ndajfolje. Kështu ndodh edhe në pjesët e tjera të gegërishtes verilindore dhe më gjerë, p.sh.: **çprish** (shprish), **çkatrrōj** (shkatërroj), **çthúr** (shthur), **çkáp, çkré^h** (shkreh), **çkōklōj** (shkokloj), **çpík** (shpikë), **çpíhet** (shpihet). Poashtu, parashtesa **ç** ndihmon në formimin e disa mbiemrave të nyjshëm, p.sh.: **i çkătrrúm** (i shkatërruar), **i çthúrūn** (i shturur), **i çkápūn, i çkōklúm** (i shkokluar), **i çkōçt** (i shkoqur), **i çkrèt** (i shkrihet). Parashtesa e përmendur vihet re edhe te disa ndajfolje të tipit si: **çkōçt** (shkoqur), **çthúrūn** (shthurur), **çărmatósūn, çărřătísūn** (verbërisht), **çlírúshēm** etj.

§ 202. Parashtesa kaca/kaça.- Me anë të kësaj parashtese formohen disa emra, mbiemra e folje të cilat shpesh dalin në dy variante, pra me **-kaça** dhe **-kaca**. Numri i fjalëve të formuara me këtë parashtesë është i kufizuar, p.sh.: **i kacavjerrūn** (i varur), **kacaváret** (ngjitet), **kacafýtet** (përleshët), **kaçarrēm** (gëmb), **kaçak** (ai që është i përndjekur politikisht dhe jeton i fshehur në male), **kaçapordhíca** (fjalë të kota), **kaçamín** (i dobët nga shëndeti). etj. (Berisha 2017:148).

§ 203. Parashtesa *kala*.- Kjo parashtesë ka përdorim të dendur. Me anë të saj janë formuar emrat e tipit: *kalavësh*, *kalabësh/ kaladësh* (boqëzat e pishës), *kaladredhën* (kala+ dredh +än) ; foljet e tipit: *kalavéshet* (sëmuret) , *kalafënët* (përgjumet), *kaladrédhet* (dredhohet), *kalamënët* (i mirren mendtë); ndajfoljet e llojit: *kalabësh* (bashkë, ngjitas), *kalakrýças* (të qëndruarit ulur e me këmbë të mbledhura).

§ 204. Parashtesa *kara*.- Është e gurrës së turqishtes dhe tregon ngjyrën e zezë. Në gjuhën dhënëse (turqishte) me anë të kësaj parashtese janë formuar mjaft fjalë, të cilat në rrymë të moteve kanë depërtuar edhe në shqipen, me të njëjtin kuptim apo me kuptim keqësues. Ndërkohë, parashtesa e përmendur është bërë produktive duke iu ngjitur me analogji disa fjalëve jo të gurrës së turqishtes. Parashtesa e përmendur nuk është shumë produktive dhe haset te një numër i kufizuar fjalësh, p.sh.: *karaborç* (borxh i kahmotshëm), *karakopıl* (fëmijë i llasuar), *karathı* (që është shumë kokëfortë), *karabudáll* (budalla, injorant), *karáxh* (ai që e ka lekurën e zezë).

Paralelisht me këtë parashtesë, në Istog përdoret edhe parashtesa *karra* që është e barasvlefshme (ekuivalente) me të parën, p.sh.: *karrabışt* (lloj insekti), *karrabın* (lloj pushke) etj.

§ 205. Parashtesa *m*.- Haset te emrat e tipit: *mshtjérr* (shtjerr), *msýsh* (best. syri i keq); te foljet: *msýj* (sulmë), *mërdhézet*(skuqet), *mré^h* (mpreh), *mshél* (mbyll), *mshâ⁹j* (bie, godas); ndajfoljet: *mrîjâz* (me shumë mundim, me peripeci), *mómäs* (përgjysmë), *mshéftäs* (fshehurazi) si dhe te mbiemri: *e mrû:me* (bukë e ardhur).

§ 206. Parashtesa *mı*.- Është e njëjtë me parashtesën e shqipes standarde –*mbi*. Me anë të saj janë formuar fjalët: *mívádat* (toka që nuk ujiten, që nuk i kap uji), *mi:udhat* (mikrotoponim në fshatin Kaliçan); *míkçyrs* (mbikqyrës, epror).

§ 207. Parashtesa *n*.- Kjo parashtesë u ngjitet emrave të tipit: *ñëja* “ngeja”(koha), *nóre* “ ndore-ndorja” (n+dorë), *nëja* (n+deja), *níshku* “ në ije” (n+ishk);

mbiemrave të tipit: **i nyllävt** (n+dyll+av+t); foljeve: **nréç** (n+drejt)- rregulloj, **nrýshk** (ndryshkë), **nxxháll** (n+ gjallë), ndajfoljeve: **ñúsh** (ngusht), **ñîshëm** (ngopur), **ñûtshëm** (me guti), **no:r** (n+dorë, d.m.th. menjëherë, aty për aty).

§ 208. Parashtesa nër.- Del te disa emra që tregojnë vegla pune, mjete të ndryshme, por edhe te një numër fjalësh që shënojnë vend, p.sh.: **nërliçt** (pjesë e vekut, avlemendit), **nërvádat** (tokat që ujiten, që i kap uji). Kjo parashtesë u ngjitet edhe disa fjalëve të tjera si: **Nërfúsha** (mikrotoponim në fshatin Lubozhdë), **Nërkísha** (mikrtotoponim në fshatin Studenicë), **nërmjétza** (rrip toke midis të mbjellash), **nërkéhet** (sëmundje e trurit te kafshët), **nërshtëj** (barra që ngarkohet në samarin e kalit a gomarit), **nërbárkza** (rrip që i vihet nën bark kalit a gomarit), **nërvéti** (tatëpjetë), **nërgöj** (i jep gji foshnjes).

§ 209. Parashtesa pã.- Me anë të kësaj parashtese formohen disa emra, mbiemra e ndajfolje. U jep fjalëve kuptim tjetër (të ri) mohues a antonimik. Po ashtu, kjo parashtesë ndihmon në formimin e emrave prejfoljor të tipit: **t pãpámt** (të pa parët), **pãvádat** (toka që nuk ujiten), **t pãdálnit** (të pa dalurit), **t pãdáshtnit** (të pa dashurit); disa emra abstraktë: **pãbúrni**, **pãmundsí**, **pãdrejtsí**. Me parashtesën e përmendur dalin edhe disa mbiemra që tregojnë mungesën e një tipari a të një cilësie p.sh.: **t pãkôjshëm** (pa shije), **t pãmarrúshëm** (të pa turp), **t pãrrítun** (të pa rritur a zhvilluar sa duhet), **i pãshné** (i pa shëndet), **i pãfty:r** (i pa fytyrë), **i pãu:dh** (i humbur). Po ashtu, përmes rrugës së njëjtë formohen edhe disa mbiemra të nyjshëm, me ç’rast dalin me kuptim antonimik, p.sh.: **i pãzím**, **i pãmsúm**, **i pãfé**, **i pãpjékun** etj.

§ 210. Parashtesa pãra, pãr.- Na krijon përshtypjen e një lidhjeje me një send a një veprim që kryhet para një tjetri. Me anë të saj krijohen disa fjalë, kryesisht ndajfolje kohe, p.sh. **pãradréke**, **pvraprâmjës**, **pãrasabáhít**, **pãraakshâmit**, **pãradíte**, **pãrprâmi**, **pãrdje**, **pãrtjetërdje**. E kundërt me parashtesën, **-para** del ajo **-mas** (pas), p.sh.: **masdíte**, **masakshâmi**, **masdárke**, **masmrâmtí** (krejt në fund).

§ 211. Parashtesa për.- Kjo parashtesë e gurrës së shqipes ka origjinë parafjalore dhe si e tillë haset mjaft dendur . Ajo u ngjitet disa emrave, mbiemrave, foljeve e ndajfoljeve, duke u dhënë kuptime të ndryshme. Emrat që formohen me anë të kësaj parashtese mund të jenë emra konkretë e abstraktë, frymorë e jo frymorë, pra emra të gjërave të ndryshme (sendeve), por edhe emra vendesh (topikë). Konsiderohet si parashtesa me prodhimtare e mbarë shqipes.

Disa emra që krijohen me parashtesën **–për** janë: **përkrysa** (pjesa e sipërme e opingës, këpucës), **përdreç** (ai që është i llastuar), **përcjells** (shoqërues). Me anë të parashtesës së përmendur formohen edhe mbiemrat prejemërorë e prejpjesorë, bashkë me nyjën e përparme-**i**, p.sh. **i përvújtn** (i hequr keq), **i përmallúshëm** (i përmalluar), **i përllóçun** (i përlyer), **i përxxhúshëm**, **i përfúlit** (i përpëlitur) , **i përbétúm** (i përбетuar) etj. Nga ana tjetër, po më këtë parashtesë, formohen edhe disa tipa foljesh, p.sh.: **përvløj**, **përmýs** (përmbysë), **përkun** (përkund), **përxhák**, **përtháj**, **përlótet** etj. Parafjala **–për** del edhe te ndajfoljet e tipit: **përstrúp**, **përkréje**, **përskej**, **përshtatshëm**, **përmallshëm**, **përmýs**, **përrânes**, **përpára**, **përmídis** (edhe : **përmídisdísit**), **përfúni**, **përrnat**, **përvjet** etj.

§ 212. Parashtesa stër (stër).- Kjo parashtesë nuk ka përdorim aq të dendur. E hasim tek ato fjalë që shënojnë diçka të zmadhuar apo të ndryshuar nga realja. U ngjitet emrave të tipit: **stërnip**, **stërkopíl**, **stërthâ`n**, **stërme:s**, **stërvín** ( ngordhësirë), **stërpläk**, **stërpla:k**; te foljet e tipit: **stërpík**, **stërpílág**, **stërholló`et**, **stërkéçet** (dergjet). Parashtesa **stër** te disa fjalë del bashkë me temën fjalëformuese, p.sh.: **nípa e stërnípa**, **mésa e stërmésa**, **ñarkú e stërrarkú** (Mehmetaj 2006:137).

Përveç parashtesave të përmendura, në Istog përdoren edhe këto parashtesa:

s- u jep fjalëve kuptim mohor a antonimik, p.sh. **skâ`mje**, **s`munët**, **s` msön** etj.

çpër - u mundëson fjalëve formimin e kuptimit antonimik, p.sh. **çpërthekøj**, - **çpërdredh**, **çpërlán**, **çpërvjél**, **çpërthen** etj.

k/ka - me anë të kësaj parashtese formohen fjalët e tipit: **kçýr** (çyr), **kaçep** (çep), **kaçúb** (çubë), **kaçel** (çel), **kadále** (dale).

z - **zgurøj**, **zgúr**, (zbrazur), **zbárdh** (bardh), **zdri:t**, **zgídh** (zgjidh) etj.(Berisha 2017:156).

§ 213. Prapashtesimi.- Formimi i fjalëve me anë prapashtesash është mënyra më e shpeshtë dhe më prodhimtarja nga të gjitha, prandaj edhe më kryesorja,. pra, e tillë del edhe në të folmen në shqyrtim.

Prapashtesat e idiomës gjuhësore të Istogut dalim me kuptime dhe me aftësi të shumta fjalëformuese, prandaj përveç disa pjesëve të ligjëratës siç janë: emri, mbiemri, folja e ndajfolja, prapashtesat përdoren mjaft dendur edhe në fushën e toponomastikës. Në këtë kuadër, shumë topoleksema janë formuar me anë prapashtesash, e, prej tyre më *“kryesoret që kanë hyrë në formimin e një numri jo të vogël mikrotoponimesh në Istog janë: -isht,- ín, el, -íc,-aj,-ník,-ak etj.”* (Bicaj 1996:23).

§ 214. Prapashtesa a:t (-atë).- Me këtë prapashtesë janë formuar disa emra, nga temat foljore, p.sh.: **lija:t** (sëmundje), **kafsha:t**, **ura:t** (urim). Prapashtesa epërmendur ndihmon edhe në formimin e disa foljeve si: **çuka:t** (çuka:t pula), **coka:t**, **gërrzha:t** (ngacmon), **vazhga:t** (zvarrit), **vërrtaka:t** (flet pa ndalur), **fuza:t** (rrëshqet), **lula:t** (stërmbush), **theka:t/piza:t** (ngacmon) etj.

§ 215. Prapashtesa a:v (-avë) ävt.- Studiuesi E. Çabej, këtë prapashtesë e nxjerr me gurrë sllave (Çabej 1976:214). Me anë të saj është formuar pjesorja e disa foljeve, p.sh.: **mörre:v**, **këça:v**, **pshÿrra:v**, **tërpÿja:v**, **gÿsha:v**, **pÿja:v**, **budallaka:v**, **rraspÿlla:v**, **nylla:v** etj. Po ashtu, me ndihmën e kësaj prapashtese janë formuar disa mbiemra të nyjshëm, shumica me kuptim keqësues (pezhorativ), p.sh.: **i ligävt**, **i pshÿrrävt**, **i tërpÿjävt**, **i gÿshävt**, **i búdallakävt**, **i krrútävt**, **i dérXHävt** etj.

§ 216. Prapashtesa *áč* (a:ç).- Me anë të kësaj prapashtese formohen disa emra e mbiemra, me tema emërore dhe foljore, që shprehin kuptime pezhorative a përçmuese; ose fjalë që emërtojnë vegla të ndryshme pune, cilësi a veti të ndryshme, p.sh.: *fítíláč* (fitil), *căkraç* (lodër fëmijësh), *tekërrláč* (çukapik), *neláč* (ngelës), *pördháč* (pordhç), *thmījáč* (mendjelehtë), *rrůgaç* (bredhës rrugësh), *kösáč* (kostarë), *prăsháč* (prashitës), *tăniráč* (makineri për imtësimin e tokës-dheut), *zhbřıráč* (hulumtues).

§ 217. Prapashtesa *acăk*.- Paraqet shkrirjen e prapashtesave *–ac* e *–ak* dhe u ngjitet emrave e mbiemrave prejemërorë, duke u dhënë kuptim keqësues a pezhorativ. Vihet re tek emrat dhe mbiemrat e tipit: *búrracăk* (burrë jo i besës, i pa besë), *gúracăk* (lojë fëmijësh), *mórracăk* (ai që ka morra), *ărdhacăk* (të ardhur, jo vendës). Prapashtesa e përmendur vihet re edhe te mikrotoponimet e tipit: *Gúracăkt* (mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Shushicë), *Thérrăk* (Istog), *Batállăk* (Orroberdë) etj. (Bicaj 1996 :25).

§ 218. Prapashtesa *ăj* (a:j). -Me anë të kësaj prapashtese, rëndom dalin patronimet e llagapet, p.sh.: *Bálaj, Bícaj, Blákaj, Dákaj, Dréshaj, Elézaj, Hazíraj, Ibrahímaj, Iméraj , Janúzaj, Mâºraj, Maxhárraj, Méhaj, Métaj, Mirâºnaj, Múlaj, Múzliaj, Pépaj, Séjdaj, Sýlaj, Shabâºnaj, Vúthaj, Zékaj, Zógaj* etj. Me prapashtesën *aj* (a:j) formohen edhe disa emra përmbledhës (kolektiv) që emërtojnë cilësi a tipar të ndonjë vendi, p.sh. *dűshkáj, gŕáj, plűhnâºj, rrŭnjáj* (Mehmetaj 2006:142), si dhe mikrotoponimi, *Guráj*(Istog).

§ 219. Prapashtesa *ăk*.- Është mjaft prodhimtare dhe me anë të saj formohen emra, mbiemra (nga tema emërore, mbiemërore e foljore) duke u dhënë kuptime të ndryshme. U ngjitet emrave mashkullorë të tipit: *čúfřřăk* (lloj shkurreje) *túlăk* (i butë, i dhjamosur), *rrúnxăk* (qingj i moshës 2-vjeçare), *thúprăk* (vend me shumë thupra), *pshtjěllăk* (mbështjellës te kostumet e grave), *lulăk* (lloj shoke), *batallăk* (tokë e pa punuar), *sŭtak* (pjesa e sipërme e kokës), *mzorăk* (qe të moshës rreth 2-vjeçare), *tínzăk* (dinak), *dĭmnăk* (dimëror), *búcăk* (enë për ujë) etj. Me prapashtesën e

përmendur janë formuar emra abstraktë të tipit: **búdallāk** (budallēk), **bóllāk** (mjaftueshëm) etj. Po ashtu vihet re edhe te disa emra që tregojnë banorin e një krahine a të një fisi, p.sh.: **drenícāk** (banor i Drenicës), **dúrřsāk** (banor i Durrësit), **úlçināk** (banori i Ulqinit), etj. Prapashtesa **-āk**, në disa të folme, p.sh.: në Deçan (Mehmetaj 2006:143), por edhe në disa pjesë të tjera të Dukagjinit, ndihmon në formimin e emrave që tregojnë përkatësi fisi, p.sh.: **Berishāk** etj., por, kështu nuk ndodh edhe në të folmen tonë, sepse këtu emrat farefisnor dalin të paranyjzuar, p.sh.: **i Beríshsi, i Gashnjâni, i Mavríçsi, i Krasníçsi** etj. Prapashtesa **-āk** u është ngjitur edhe disa mbiemrave, që dalin me kuptim përçmues (pezhorativ), p.sh.: **túlāk** (tepër i shëndoshë), **spírrāk** (tepër i dobët), **píçrrāk** (tepër i vogël, por edhe: laraman). Prapashtesa e përmendur u ngjitet edhe disa ndajfoljeve, p.sh.: **vízāk** (mënyrë ecjeje), **fúzāk** (me detyrim) , **lúlāk** (lidhur), p.sh.: **E lidhën milicíja ee bân lúlāk!** etj. Me **-āk** dalin edhe disa mikrotoponime si: **Báltáku** (toka në Carallukë, Istog i Poshtëm dhe Llukavc i Begut), **Bătalláku-** (toka djerrina në Gurrakoc dhe Bellopjë), **Bírat e Vídullákut** (mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Kaliçan), **Çepurāk** (mikrotoponim në fshatin Prekallë), **Grópat e Kaçākve** (mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Cerrcë), **Malenjāk** (mal në bjeshkët e fshatit Cerrcë), **Oshlāk** (mal në bjeshkët e fshatit Cerrcë) , **Thérrāk** (mikrotoponim në Orroberdë).

§ 220. Prapashtesa ān/ a:jk.- Del te një numër i kufizuar emrash e mbiemrash, duke u dhënë kuptim negativ (pezhorativ). Prapashtesat e lartcekura përdoren në mënyrë paralele, pra e para për gjininë mashkullore, kurse e dyta për gjininë femërore, p.sh.: **filān** (**filān-físteku**), **rrēncān** (gënjeshhtar), **rrēncájk** (gënjeshtare), **fencān** (ai që liron shumë gazra), **fěncájk**, **túxān** (frikacak), **tuxájk** (frikacake), **zhúgān** (i papastër), **zhugájk** (e papastër), **trúllān** (kokëtrashë), **trullájk** (kokëtrashë), **mrrólān** (i vërenjtur), **mrrolájk**, **shakllamān** (i çrregulluar)- **shakllamájk**, **arúshān** (shëndetmirë), **lóçkān** (i dashur) etj. Me çiftin e prapashtesave **ān/ a:jk** dalin edhe fjalët e tipit: **gúshān-gusha:jk**, **llafazān-llafaza:jk**, **breshkān-breshka:jk**, **gěrrbān-gěrrba:jk**, **balúshān-**

balusha:jk, krrútän-krrüta:jk, mrapshtän-mrapshta:jk, fütän-füta:jk, laríckän-laríčka:jk etj.

§ 221. Prapashtesa *â^or/a:r/are*.- Kjo prapashtesë është e pranishme edhe te gjuhët e tjera ballkanike. Me anë të saj formohen disa emra enësh, veglash pune, apo emërtime për banorin e një vendi a krahine të caktuar. Ajo u ngjitet emrave si: *kúlmâ^or* (trari kryesor në një pullaz), *llapár* (pjesë e plugut-parmendës), *bunâ^or*, *tetovár (e)*, *xhakovár (e)*, *preshevár (e)*, *kërçovár (e)* etj. Me anë të prapashtesës *ár/ â^or* formohen edhe disa fjalë me gurrë sllave: *kuhár* (gjellbërës), *shumâ^or* (pylltar), *pushkár* (mjeshtër pushkësh) etj. (Mehmetaj 2006:145). Prapashtesa e përmendur del edhe tek emërtimi *Kunullár* (mikrotoponim në fshatin Vrellë dhe në Sine).

§ 222. Prapashtesa *âž*.- Rrjedh nga prapashtesa *as* dhe u ngjitet temave emërore të thjeshta dhe atyre të prejardhura, përkatësisht temave mbiemërore dhe atyre ndajfoljore me ç’rast formohen ndajfolje mënyre, p.sh.: *fýtâž, gújâž, bárkâž, nâtâž, vétmâž, hapakâ^omâž*. Me anë të prapashtesës *–âž* formohen edhe disa ndajfolje, që tregojnë llojin e lojës etj., p.sh.: *kapúçâž, gúxhâž, nílâž, klîncâž* etj.

§ 223. Prapashtesa *c*.- Ndiemon në formimin e disa fjalëve që emërtojnë sende a vegla të ndryshme, p.sh.: *lídhc* (mbulesë koke, pjesë e kostumit të grave), *shtrydhc* (koprrac), *klînc* (tinëzar), *thînc* (thumbi i gjarprit). Me anë të prapashtesës së përmendur formohen edhe d emra me kuptim negativ a përçmues, p.sh.: *rrënc* (gënjeshtar), *fënc* (ai që liron shumë gazra), *plönc* (barkmadh), *fjälç* (grindavec), *ñèlc* (përsëritës) etj.

Përveç prapashtesës *c* te disa fjalë shtohet edhe prapashtesa tjetër (e dytë) *–ân*, p.sh.: *rrëncän, fëncän, fjalcän* etj. Me prapashtesën *–c* formohen edhe fjalët e tipit: *pshtjellc* (pjesa e poshtme e kostumit të femrave), *xhvjellc* (bosht rreth të cilit mbështillen penjtë), *hjekc* (mjet metali për tërheqjen e sanës, barit).

§ 224. Prapashtesa *e:sh* (*eshë*).- Del në shumicën e të folmeve të Kosovës dhe më gjerë dhe me anë të saj janë formuar një vistër emrash, që shprehin a tregojnë një profesion të caktuar. Prapashtesa **–e:sh**, te disa fjalë zgjerohet në bashkëtingëlloren **–n** (**n+e:sh**) si p.sh.: **trīmne:sh** (trimëreshë), **thine:sh** (shpirtëzezë), **būrrne:sh** (burrërore), **çōbane:sh** (baresë), **hājne:sh** (vjedhëse), **rrōktare:sh** (shërbëtore) etj.

§ 225. Prapashtesa *èc* .- Fjalët e formuara me anë të kësaj prapashtese shprehin kuptimin e zvogëlimit të një gjëje, p.sh.: **būbrrèc**, **búrrèc**, **kōdrèc** (kodër e vogël), **gúrèc** (gur i vogël). Prapashtesa **–c** në disa raste u jep fjalëve kuptim negativ (pezhorativ), p.sh.: **larèc** (lajkatar), **búrrèc** (burrë me karakter të ulët, i pa burrë), **túrrèc** (ai që flet vend e pa vend) etj. Gjinia femërore e emrave të sipërshtuar formohet duke ua shtuar mbaresën **–e**, p.sh. **laréce**, **túrréce** etj.

§ 226. Prapashtesa *hâºne* .- U ngjitet disa turqizmave, që shënojnë vende apo objekte të caktuara, pra me anë të kësaj prapashtese formohen fjalë të reja si, p.sh.: **akçihâºne** (gjelltoire), **berberhâºne** (rrojtoire), **ýzerhâºne** (toaleti, wc), **nallbahâºne** (vendi ku mbathen kuajt, qetë etj.), **fllìçníhâºne** (vend i papastër), **māskrallakhâºne** (turp i madh), **drèçníhâºne** (best. vend ku qëndron djali/ dreqi), **kūrvahâºne** (vend ku bëhet prostitucion), **mūtçihâºne** (punë të pista, vepra të liga).

§ 227. Prapashtesa *i:c* (*icë*).- Me këtë prapashtesë formohen emra, prej emrash, foljesh e ndajfoljesh, që tregojnë më të shumtën zvogëlimin e një gjëje, një gjë konkrete dhe femrën e mashkullit, p.sh.:

a) disa emra që tregojnë një gjë me përmasa të vogla, p.sh.: **lāti:c** (copëz e vogël toke), **rrūgi:c** (rrugë e ngushtë, njëkahore) etj.

b) emra prejfoljor që tregojnë një gjë konkrete, p.sh.: **ñālli:c** (lulja e qepës).

c) me funksion femorizues del te disa emra, p.sh.: **māgari:c** (gomareshë), **kōpili:c**, **būdālli:c**, **sūgari:c**, **kāpri:c**, **hōxheni:c**, **gābèli:c**, **tāpalli:c** (e qalë), **mūrri:c** (e murrme), **shūmi:c** (shumë), **tēpri:c** (tepër), **gāli:c** (e zezë) etj. Mjaft shpesh del edhe në

fushën e toponimisë si: *Kameni:c*, *Kashi:c*, *Studen:c*, *Beli:c*, *Shushi:c*, (fshatra të Istogut), *Kralíca* (mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Lubozhdë dhe Cerrcë), *Boavíca* (mal në bjeshkët e fshatit Shushicë), *Bogàshíca* (mikrotoponim në fshatin Osojan), *Kàni:c* (mikrotoponim në fshatin Lubozhdë), *Bàri:c* (mikrotoponim në fshatin Llugë), *Dàkovi:c* (mikrotoponim në Istog). Prapashtesa me gurrë sllave *i:c* (*icë*), nëpërmjet disa fjalëve sllavishte, ka depërtuar edhe në shqipen, p.sh.: *poli:c* (raft), *bòròni:c* (luleshtrydhe), *úli:c* (shesh), *kràli:c* (mbretëreshë) etj. (Mehmetaj 2006: 151).

§ 228. Prapashtesa *i:n* (*inë*).- Kjo prapashtesë mundëson krijimin e disa emrave femërorë, të formuar prej temash emërore a mbiemërore me kuptime të ndryshme, p.sh.: *guri:n* (tokë e fortë), *kërrshi:n* (sipërfaqe shkëmbore), *lūgi:n*, *bàtáll:i:n* (djerrinë), *shkreti:n*, *cofti:n* (i.e ngordhur), *tūrbulli:n* (i turbullt). Prapashtesa e përmendur ndihmon në formimin e disa mikrotoponimeve, p.sh.: *Llàzi:n* -nga serb. “*rrah*” (toka në fshatin Staradran), *Livádhet e Zhègín’s-* (livadhe në bjeshkët e Istogut), *Shóvarínat* (rrip tokash në fshatin Prigodë), *Bàtáll:i:n* (toka në fshatin Staradran dhe Zallç), *Tulína* (toka bujqësore në fshatin Vrellë), *Guri:n* (mikrotoponim, rrip tokash në fshatrat Vrellë, Lubozhdë, Istog, Sine dhe Prigodë), *Balti:n* (mikrotoponim në Vrellë), *Tūli:n* (Vrellë), *Plëhni:n* (mikrotoponim në fshatin Lubozhdë) etj. (Bicaj 1996: 24).

§ 229. Prapashtesa *i:sht/isht*.- Ndhmon në formimin e disa emrave dhe të disa ndajfoljeve, p.sh.: *çarri:sht* (pyll me dru çarri), *Çarríshta e Januzaj* (mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Lubozhdë), *ahi:sht* (pyll me dru ahu), *buji:sht* (pyll me dru bungu), *shkózi:sht* (pyll me dru shkoze), *mlaki:sht* (pyll me dru mllaku). Kjo prapashtesë ndihmon edhe në formimin e disa emrave që shënojnë përbërjen dhe pozitën gjeografike të një vendi a hapësire të caktuar, p.sh. *mèlli:sht*, *ràni:sht*, *gúri:sht*. Po ashtu, prapashtesa e përmendur ndihmon në formimin e disa ndajfoljeve, p.sh.: *kàtunisht* (i gjithë fshati), *burrnisht*, *trimnisht*, *maxhūpisht* (moskujdesshëm, shkel e shko), *tinzisht* (dinakërisht), *vllàznisht* (vëllazërisht), *ràzish* (në harmoni) etj.

Prapashtesa **i:sht** ndihmon në formimin e disa mikrotoponimeve, p.sh.: **Varri:sht** (mikrotoponim në Istog, Llugë, Vrellë), **Ahi:sht** (mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Vrellë), **Gruni:sht** (mikrotoponim në fshatin Llugë), **Lini:sht** mikrotoponim në Istog), **Guri:sht** (mikrotoponim në fshatin Kaliçan), **Çarri:sht** (mikrotoponim në fshatin Vrellë, Lubozhdë) etj. (Bicaj 1996: 23).

§ 230. Prapashtesa **i:t**.- Kjo prapashtesë u ngjitet disa temave emërore e ndajfoljore, duke formuar kështu një grup foljesh që shprehin kuptime të ndryshme, p.sh.: **vădi:t** (ujit), **kōsi:t**, **jăvăshi:t** (qetëson, ndalon, pushon), **kūsuri:t** (llogaritë), **lări:t**, **pări:t** (mjekohet me avull), **vllăçi:t**, **zhăgi:t** (zvarrit), **səri:t** (mahnit, befason), **dăllashi:t** (gabon, huq) .

§ 231. Prapashtesa **īm/i:m**.- Është një ndër prapashtesat më të shpeshta të shqipes. Me ndihmën e saj, në të folmen e Istogut, nga temat foljore, janë krijuar emrat: **punīm**, **durīm**, **fitīm**, **trullīm**, **pezmatīm**, **munīm**, **pshtīm**, **besīm** etj., të cilët rrjedhin nga foljet : **punoj**, **duroj**, **fitoj**, **trullohem**, **pezmatohem**, **mundohem**, **besoj**. Nga ana tjetër, nga temat e prejardhura emërore janë krijuar emrat kolektiv të tipit si: **búrnrīm** (burrat), **granīm** (gratë), **voxhlīm** (fëmijët), **parsīm** (të parët), **shtèrpnīm** (kafshët shterpa) etj . (Mehmetaj 2006: 151-152).

Krahas prapashtesës **īm**, përdoret edhe variantja e saj **i:m** që del edhe në shqipen standarde, **imë**. Ajo përdoret te disa emra femërorë abstraktë , shumica prej të cilëve tregojnë fenomene atmosferike dhe kanë nuanca onomatopeike, p.sh.: **tiŋlli:m** (tingëllij), **veti:m** (vetëton), **bubulli:n** (bubullon), **hiŋlli:m** (hingëllon), **uluri:m** (ulërin), **ushti:m** (ushton), **murmuri:m** (murmuron), **bërti:m** (bërtet), **vizlli:m** (vezullim) etj.

§ 232. Prapashtesa **lí**.- Është e gurrës së turqishtes dhe përdoret mjaft të dendur në të folmen në vështrim. Me anë të saj janë formuar emra e mbiemra , që tregojnë cilësi a prejardhje, p.sh.: **sabërli** (i durueshëm), **kymëtlí** (kursimtar), **năműzlí** (ai që lutet,

falet), **kryçali** (i krishter), **bërçetli** (fatsjellës), **venali** (vendas), **prishtinali** (prishtinas), **vushtrrali** (i Vushtrrisë) etj.

§ 233. Prapashtesa llak.- Kjo prapashtesë ka depërtuar në gjuhën shqipe përmes disa turqizmave dhe, sot është mjaft prodhimtare. Me anë të saj formohen emra konkretë e abstraktë si dhe mbiemra, p.sh.: **baballak** (babai i nusës), **qushllak** (vështirësi), **bashkallak** (bashkësi e gjerë familjare), **paçllak** (pastërti), **dyjëllak** (bota), **pshtjellak** (mbështjellës, pjesë e kosmumit të femrave), **budallak** (pa maturi) **hajvanllak** (bota shtazore), **fukrallak** (varfëri). Prapashtesa **llak** vihet re edhe te disa mikrotoponime, p.sh.: **Bashkallaku** (toka bujqësore në fshatin Lluga), **Bírat e Víduallakut** (mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Kaliçan), **Lúgu i Mllaki:s** (luginë në bjeshkët e fshatit Orrobërdë).

§ 234. Prapashtesa m.- Ndhmon në formimin e një numri emrash emra e mbiemrash, prej temash emërore, mbiemërore e foljore, p.sh.: **bî:m** (nga bij), **ushti:m** (nga ushtë), **kërsî:m** (nga kërcas), **grî:m** (nga grij), **bërtî:m** (nga bërtas), **i vra:m** (nga vras), **i thy:m** (nga thyej), **i çky:m** (nga shkyej). Me prapashtesën e përmendur formohen edhe emra abstraktë ë tipit si: **kûkâ^om**, **pîskâ^om**, **vîkâ^om**, **hûrrpâ^om** etj. Nga shëmbujt e dhënë mund të vihet re se emrat e lartshënuar janë formuar nga temat e foljeve me natyrë onomatopeike si: **kûka:t**, **pîska:t**, **vîka:t**, **hûrrpa:t**.

§ 235. Prapashtesa í.- Mundëson formimin emrave femërorë (abstraktë-kolektivë) të tipit si: **bûrrn í**, **çikn í**, **vllâzn í** **djëlmnî**, **nûsnî**, **kûrvnî**, **trîmnî**, **plëçnî**, **cûbnî**, **shtätzânî**, **fllîçnî** etj.

§ 236. Prapashtesat ôk, -óle, -ôj.- Me anë të këtyre prapashtesave, prej temash emërore e mbiemërore, janë formuar pak emra, mbiemra e folje, p.sh.: **bàblôk**, **míxhök**, **bardhök**, **malök**, **maçök**, **kapóle** (kapele), **kaçóle** (grumbuj të tallës së misrit), **balôj** (ka me larë në ballë), **múrrôj** (ka i murrmë), **shalôj**, **gozhdôj**, **majôj**, **bekôj**, **lakôj**, **dredhôj**,

tradhtōj, plē nōj, livrōj, krahōj, mlōj, shtrōj, rrxōj, marōj, dimnōj, vjeshtōj, pranverōj, verōj, lumnōj.

§ 237. Prapashtesa tār.- Me anë të kësaj prapashtese formohen një kategori emrash e mbiemrash që, tregojnë profesion a përkatësi të caktuar, p.sh.: ***bjeshkatār*** (ai që veron në bjeshkë) ***ūdhtār, kōñātār*** (këngëtar), ***msītār*** (shkuesi), ***kursimtār, nīsmtār*** (nismëtar), ***bajrāktār*** (ai që mban flamurin), ***rrōktār*** (shërbëtor), ***lavērtār*** (ai që lavron tokën), ***çēhtār*** (ai që qeth delet) etj.

§ 238. Prapashtesa tóre.- Ndiemon që, nga temat emërore të formohen emra femërorë të cilët, shënojnë profesione të ndryshme (kryesisht nga fusha e amvisërisë), p.sh.: ***māxhetóre*** (ajo që përgatit ushqimet), ***ēnatóre*** (ajo që kujdeset për enët), ***mlōjatóre*** (që kujdeset për shtrojë e mbulojë), ***nxxhëshātóre*** (mjek popullor-fiziatër) ***rrēthātóre*** (rrip, brez fishekësh), ***falltóre*** (parashikuese e fatit), ***rāñjatóre*** (ajo që kryen punët e përditshme të shtëpisë), ***amēltóre*** (pasticeri), ***puntóre*** (e vyer), ***mjëlatóre*** (ajo që mjel lopët, delet, dhitë).

§ 239. Prapashtesa u:k (ukë).- Prej temash emërore, mundëson formimin e disa emrave dhe mbiemrave, p.sh.: ***lāru:k*** (lopë me lara), ***bīшту:k*** (lopë me bisht të gjatë), ***trashu:k*** (e trashë, e majmë), ***sharu:k*** (me lara). Prapashtesa e përmendur del edhe te topiku ***Carallu:k*** (fshat i Istogut).

§ 240. Prapashtesa û:η (ungë).- Me këtë prapashtesë janë formuar emra (me tepër femërorë) me kuptime të ndryshme (Xhuvani & Çabej 1987: 291), p.sh.: ***māllû:η*** (e enjtur në trupin e njeriut), ***maçāllû:η*** (copëz druri me majë disi të kthyer, të fryer), ***shtllû:η*** (shtëllung leshi), ***lû:η*** (një lloj i thati), ***maçāllû:ηa - maçāllû:ηa*** (të enjtura të njëpasnjëshme), ***shtllû:ηa- shtllû:ηa*** (1. flokë të mëdhenj bore, 2. grumbuj mjegulle etj.), ***shtrû:ηa*** (vatha e deleve).

§ 241. Prapashtesa *űsh/u:sh*.- Me anë të kësaj prapashtese, prej emrash janë formuar emra mashkullorë e femërorë me kuptim zvogëlimi, dhe mbiemra prej mbiemrash, p.sh. ***babűsh*** (babë), ***dajűsh*** (dajë), ***drenu:sh*** (femra e drerit), ***aru:sh*** (femra e ariut), ***xharpnu:sh*** (femra e gjarprit), ***műnu:sh*** (femra e miut), ***űikűsh*** (i thuhet vajzës, me kuptim përkëdhelës), ***zembrűsh-zemru:she*** (i, e dashur) etj. Me prapashtesën e përmendur formohen edhe mbiemrat e tipit: ***larűsh/laru:sh*** (me lara), ***barkűsh*** (barkmadh), ***bukurűsh*** (i bukur). Poashtu, me prapashtesën ***űsh. /u:sh*** janë formuar edhe antronimet si: ***Agűsh, Alűsh, Malűsh, Kadrűsh, Metűsh, Lűsh, Raműsh*** si dhe topikët e tipit: ***Dobru:sh*** (fshat i Istogut), ***Radu:sh*** (kompleks malesh në bjeshkët e Istogut), ***Balűshat*** (mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Sine).

§ 242. Prapashtesa *nűk*.- Kjo prapashtesë me gurrë sllave hetohet në formimin e disa emrave e mbiemrave prej temash emërore, mbiemërore e foljore, p.sh.: ***hűthenűk*** (byrek me hitha), ***leűenűk*** (byrek me lakër), ***besnűk, hisenűk, shpijanűk, mónafűk*** (spijun), ***xhallnűk*** (punëtor i madh), ***ballnűk*** (pjesa ballore e një gjëje), ***mócanűk*** (moshatar), ***pasanűk*** (i pasur), ***bukanűk*** (bukëdhënës), ***mexhanűk*** (ai që është në kufi).

Prapashtesa e përmendur vihet re edhe te formimi i disa emër-vendeve si: ***Korenűk*** (majë mali në bjeshkët e fshatit Kaliçan), ***Homnűk*** (mikrotoponim në fshatin Baicë), ***Mâ⁹ja e Shtrashnűkut*** (majë mali në bjeshkët e fshatit Tomoc), ***Rasadnűk*** (mikrotoponim në fshatin Orrobërdë), ***Rubnűk*** (mal në bjeshkët e fshatit Cërrkolez), ***Zműjanűk*** (mikrotoponim në fshatin Rakosh).

§ 243. Prapashtesat *t*.- Me anë të kësaj prapashtese dhe me paranyjëzim janë formuar mbiemra, prej temash emërore, mbiemërore dhe ndajfoljore.

Prej temash emërore + me paranyjëzim janë formuar mbiemrat lëndorëtë tipit si: ***i paműkt, i lesht, i ftoft, i nxe:t, i ńri:t, i pi:t, i bűjt, i tha:t, i rjèpt, i űkèpt*** etj.

Prapashtesa **t** del edhe te patronimet, pra kur dëshirojmë të shënojmë përkatësinë e pjesëtarit të një fisi, p.sh.: **Gāsht** (Gashi), **Drëshajt** (Dre:shaj), **Kābasht** (Kabashi), **Méhajt** (Mehaj), **Mâ^orajt** (Mâ^oraj), **Lājçt** (Lajçi), **Rugōvt** (Rugova), **Maxhárrajt** (Maxharraj) etj.

§ 244. Prapashtesa z.- U ngjitet temave emërore, duke formuar emra femërorë, më të shumtën prej emrash veglash a mjetesh pune me kuptim zvogëlimi a përkëdhelie, p.sh. **kâ^o:mz** (këmbëz, këmbëzat e qerres), **do:rz** (dorëza e derës), **shti:z** (mjet për tjerren e leshit), **mû:llz** (semundje lukthi te bagëtitë), **kî:z** (mjet për të prerë), **çe:llz** (çellza e gojës), **u:lz** (lloj druri, i ngjashëm me ahun), **flî^onz** (thëllëz), **ka:bz** (kapëse për rroba etj.), **kābz** (problem në kryrjen e nevojës fiziologjike). Prapashtesa **z**, përdoret në formimin e disa emërvendeve, p.sh.: **Krōjzit** (Vrellë), **Te Gurzīt** (mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Suhogerllë).

Nga sa u theksua në lidhje me parashtesat dhe prapashtesat, mund të pohojmë se këto mjete fjalëformuese nuk dallojnë shumë nga të folmet e tjera të gegërishtes verilindore dhe më gjerë.

§ 245. Formimi parashtesor-prapashtesor i fjalëve.- Në të folmen e Istogut nuk është shumë prodhimtar, megjithëkëtë kemi vënë se me anë të kësaj rruge janë formuar foljet e tipit si: **përmallōj**, **përçáfī**, **përtrīj**, **zbūkurōj**, **zbardhōj** etj., si dhe emrat e llojit: **nērgo:jc** (pjesë e frerit të kalit), **nērskā^omz** (pjesë e vekut), **pērkry:s** (pjesa e sipërme e opingës), **zbārdhīm** (zbardhje), **pērmallīm** (mallëngjim), **pērshtātje** etj. (Mehmetaj 2006: 165).

§ 246. Paranyjëzimi.- Me anë të kësaj rruge janë formuar mbiemra të nyjshëm prejfoljorë (pra që rrjedhin nga pjesorja e foljes), p.sh.: **i msúm**, **i árdhūn**, **i mshélūn**, **i djégūn**, **i dáshtūn**, **i korítūn**, **i vra:m**, **i mrríshēm**, **t' dālūn** etj.

Përveç parashtesave, prapashtesave, para-prapashtesave njëkohësisht, dhe paranyjëzimit, si mjete të veçanta fjalëformuese, në idiomën gjuhësore të Istogut vihen

re edhe disa mënyra (rrugë) të tjera fjalëformuese, por që në krahasim me të parat, e, veçmas me prapashtesat, janë më pak prodhimtare.

§ 247. Kompozimi (përbërja). -Është formë e veçantë dhe mjaft prodhimtare “me anë të së cilës krijohen fjalë të reja që kanë në përbërjen e tyre dy a më shumë tema motivuese; njëra nga këto (tema mbështetëse, që është zakonisht e dyta) e formëson gramatikusht gjithë kompozitën , ndërsa tema tjetër është asnjënjësuar nga pikëpamja e kuptimeve të saj gramatikore” (Gramatika I 2002:70). Pra, në të folmen në shqyrtim vihet re një numër relativisht i madh kompozitash, që janë me interes si nga aspekti fjalëformues, ashtu edhe për nga ana aspekti semantik. Temat motivuese mund të jenë emërore, mbiemërore, foljore e ndajfoljore:

p.sh.: *shpërli:g, sýkeç, zemërmi:r, çãfga:t, fjãltha:t, trÿpshkÿrt, sýkÿç, lëshkÿç, façèkÿç, vëshllavësh, hÿnshtremt, xhákdérdhje, mÿkprítje, púndóre, bábxhysh, nãnlóke* etj.

Gjatë shqyrtimit të kompozitave, jemi mbështetur në Gramatikën e gjuhës shqipe I, me ç’rast aty jepen dy lloj: kompozitash; ato këpujore dhe kompozitat përcaktore (Gramatika I 2002 : 71-72).\

§ 248. Kompozitat këpujore.- Paraqesin ato fjalë që përbëhen nga dy e më shumë gjymtyrë me lidhje bashkërenditjeje ndërmjet vetës. Kompozitat këpujore në idiomën gjuhësore të Istogut, janë më të pakta se ato përcaktore, p.sh.: *kuçezi, mÿsheshpi:rt, vëshmáthje, jÿglíndje, pshëshetâºmël, mÿshelákna, tâºmëlebo:r* etj.

§ 249. Kompozitat përcaktore.- Formohen vetëm prej dy gjymtyrësh nga të cilat, njëra përcakton tjetrën. Vështruar nga aspekti i temave motivuese, kompozitat përcaktore mund të jenë:

-emër+emër, si: *kryçýtet* (kryeqytet), *krý(e)mali, leshmâºce, sórrshki:n, káldéti* etj.

-kompozita të tipit emër+emër që kanë dhënë mbiemër, p.sh.: **barkpe:t** (bark+petë), **gójsho:sh** (gojë-shoshë), **búzçerep** (buzë+çerep), **syhüt** (sy+hut) etj.

-kompozitat e formuara nga emër+mbiemër , p.sh: **syhăpt** (sy+ të hapur), **krý(e)madh** (krye+ i madh), **leshküç** (*lesh i kuq*), **trűpga:t** (trup+i gjatë) etj.

-kompozitat emër + pjesore e foljes në disa raste formojnë:

mbiemra të tipit: **leshdrédhűn** (lesh-dredhur), **bışhtkpútűn** (bisht+këputur), **kryeshtru:m** (krye+shtruar), **bukpěrmýsűn** (bukë+përmbysur) etj. Nga ana tjetër, po ky tip kompozitash (emër+pjesore e foljes) ka formuar ndajfoljet e llojit: **syhápűn**, **gójmshélűn** etj.

Në të folmen e Istogut është mjaft i madh numri i kompozitave si: **bărkçélűn** (bark+çelun), **bűthpăla:m** (bűth+ pa la:m), **bűthshje:rr** (bűth+ shtjerrë- i varfër, me gjendje të dobët ekonomike), **kapűçga:t** (kapuç+ i gjatë- mendjemadh), **dhômçátall** (dhëmb+çatall- me dhëmbë të deformuar), **műkpřits** (mik+ pritës) etj.

§ 250. Pěrngjitja (aglutinimi).- Ndiemon që të “*krijohen fjalë të reja nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi, i një togu parafjalor ose i një grupi në pėrgjithësi*” (Gramatika I 2002:75).

Fjalët e formuara me pėrngjitje i ruajnë lidhjet sintaksore ndėrmjet gjymtyrëve pėrbėrėse. Nė arealin gjuhėsor nē shqyrtim, nuk ėshtė i madh numri i fjalëve tē krijuara me anē tē pėrngjitjes, p.sh.: **mozomokeç** (mos+o+Zot+ma+keq), **herdőkúrdő** (herë+do+kur+do), **tă^onahérět** (tē+ gjitha + herët), **hămadreç** (ha+ more+ dreq), **tekdernĩ** (tek+deri+ nē), **pěrvjet** (për+vjet), **fărefıs** (far+e+fis), **thashethă^one** (thash+e+theme), **paradíte** (para+dit+e), **masdíte** (pas+dit+e) etj.

§ 251. Konversioni.- Formimi i fjalëve mē anē tē konversionit (ndėrrimi i kategorisē leksiko-gramatikore) pėrfshin një numėr tē kufizuar njėsisish leksikore. Kėshtu p.sh. nga foljet e llojit: **hap**, **çull**, **krip**, **ndryshk**, **pshesh** etj., janē formuar emrat e tipit: **hápı**, **çűlli**, **krýpa**, **’nrýshku**, **pshėshi** etj. Kėshtu, nga emrat (**víti**, **móti**, **rră^onxa**, **brėgu**, **midísi**) janē formuar ndajfoljet e llojit: **vjet**, **mot**, **rrőnx**, **breg**, **rreth**, **midis**, si dhe

ndajfoljet: ***m'u lësh*** (nga emri lesh), ***me pshësh*** (nga emri përslesh), ***mu vësh*** (nga emri veshë) etj. Përmes rrugës së njëjtë janë formuar edhe disa emra prej foljesh: ***mêrzí*** (nga folja mërzít), ***çúdí*** (nga folja çúdít), ***pōrosí*** (nga folja porosít), ***hăbí*** (nga folja habít) etj. (Mehmetaj 2006: 175).

KREU VI

SINTAKSA

Tiparet sintaksore

Sintaksa e fjalisë së kësaj të folmeje është e njëjtë me të folmet e tjera të gegërishtes (sidomos me ato të gegërishtes verilindore) prandaj është e vështirë të dallohen tipare vetjake të saj, megjithëkëtë, në këtë pjesë të punimit do të përpiqem t'i marrim në shqyrtim disa prej tipareve sintaksore më karakteristike për këtë të folme dhe që janë me interes për dialektologjinë shqiptare.

Për të hetuar sadopak strukturën sintaktore të kësaj të folmeje kemi ndjekur bashkëbisedime të pjesëtarëve të brezit të moçëm, të atij të mesëm, por edhe të brezit të ri, të dy gjinive, kryesisht biseda në ambientet familjare, por edhe biseda të realizuara sipas orientimit tonë paraprak. Në këtë kuadër i kemi analizuar edhe disa tekste të ndryshme nga kjo e folme, gjithëmonë, duke synuar që në mënyrë sa më të plotë dhe sa më përmbajtësore t'i hetojmë tiparet dhe veçoritë e kësaj të folmeje në fushë të sintaksës.

Siç dihet ndryshimet dialektore në fushë të sintaksës, gjithandej shqipes janë më të rralla, kundrejt fushave të tjera gjuhësore.

§ 252. Paskajorja në vend të lidhores.- Një prej veçorive sintaksore e arealit gjuhësor të Istogut është përdorimi i paskajores së foljes në vend të lidhores, pra shumë funksione sintaksore, që i kryen lidhorma në mbarë toskërishten (më pak në gegërishten jugore) në të folmen tonë dhe në mbarë gegërishten veriore dhe verilindore, kryehen me përmes trajtave të paskajores. Kështu, pra, në të folmen në hetim, por edhe në pjesët e tjera të gegërishtes verilindore mjaft dendur përdoret paskajorja e tipit: **me**

punu:, me msu: etj. Në këtë kuadër, së shpeshti paskajorja del me pocicion pas foljes gjysmëndihmëse **duhet**, p.sh.:// **Duhet me msu: për me përparu:// Fjala ç'i jepet duhet mu ma:jt// Miçsi:n duhet me ru:jt për ko:h t ga:t! // Nâ^ona e bába duhet mu désht si sy:t e bállit! //** etj.

Kur temi të bëjmë me përdorimin e paskajores, është me rëndësi të thuhet se mënyra paskajore përdoret mjaft dendur për të ndërtuar fjali, që shprehin marrëdhënie kushtore, p.sh.: // **Me pushkatu:/ nuk munësh me friksu:// Mè ç'i:t n gry:k t tópit/ sýni nuk i trêmet// Me fo:l xhith ditën me tô/ kry:t vesh nuk po i mèrrke// Me pa:s páre/ i kish ble: drû:t e dímnit //** etj.

Nga ana tjetër nuk mungojnë rastet, kur paskajorja dhe lidhorja përdoren përkrah njëra-tjetrës, p.sh.: **Jêpu (epű) dhêne u:j me pí/ se jôn eçtu:// Jêpu (êpu) dhêne t pi:n u:j/ se jôn eçtu:// Thërri thmi:n me hâ^ongër bu:k/ se jôn ũntu:/ Thërri thmi:n t ha:n bu:k/ se jôn ũntu: //** etj.

Paskajorja në funksion të kallëzuesit, rëndom përdoret edhe te fjalitë e varura kryefjalore, p.sh.:// **Nuk â^osht keç me shku: edhe ti me ta// Â^osht mi:r me ju kallxu: edhe shókve//**. Poashtu, paskajorja del në funksion të kallzuesit edhe te fjalitë e varura kohore, p.sh.:// **Para se me shku: n mal jepu kuále u:j me pi:// Para se me mje:ll grûnin lïvro: arën mi:r // Para se mï thi:rr miçt /siguro: bukën për tã//**.

Trajtat e paskajores në funksion të kallëzuesit vihen re edhe te fjalitë e varura qëllimore, si p.sh.:// **Shkoj n mal mï mâ^orr dō dru:// U nãl te króni me pi: u:j//Dul: n pazár mi ble: nï pên kije//**.

Mënyra paskajore e luan rolin e kallëzuesit edhe te fjalitë e varuara kushtore, p.sh.: // **Me da:l dilli/ çkrihet bóra// Me kê^on ma i rí/ Idrízi e:c shpejt//Me a:rdh edhe ti/ kishim shku: te da:jt//**.

Me anë të paskajores ndërtohen edhe disa tipe fjalish ftilluese, p.sh.:// **Si nisên me da:l lúlat/ nuk u nãlën dej n fűn vére// Me bâ^o me t nxâ^on ushtrija tũ e kalu: kúfinin/ t shtín n búrg//Me msu: xhithçýshe/ se duhet me përseri:t klásên//**.

Kemi regjistruar edhe disa tipe fjalish kundrinore, që ndërtohen me anë të mënyrës paskajore, p.sh.:// **Me ma rre :^h djálin/ kÿrr s tã fáli// Me kallxu: çysh â^osht púna/ u kâ^on shÿm ma mi:r//**.

Kur jemi te përdorimi i paskajores, kemi vënë re se në vend të saj përdoren disa lidhëza, lokucione lidhëzore si dhe folje të ngurosura të cilat, dalin rregullisht në trajtë të lidhores, p.sh.: **kur, masi, dej, çj, ndáçt** (por edhe **nàç**):// **Kur t hãjsh buk/ hãjde t mlédhim pasÿl// Masi t vÿsh pÿ shkólle/ merri e bôni detýrat// Dej çj t vjen pranvéra/ po rri:m çÿtu// Ndáçt t msôn ndáçt jo/ n shko:ll nuk ká çáre pã shku: //** etj. Konstrukte të tilla fjalish vihen re edhe në të folmen e Plavës dhe të Gucisë (Ahmetaj 2002: 186).

Interes dialektor në fushë të sintaksës paraqesin disa emra të gjinisë mashkullore, kur kryejnë funksionin e llagapeve të gjinisë femërore të cilët, në të shpeshtë dalin me prapashtesën **ja** (për t'u dalluar nga mashkullorët) p.sh.: // **Miru:sh Hetémja/ Ry:v Tahírja/ Shku:rt Sokólja//** etj.

§ 253. Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën.- Në të folmen në shqyrtim, kur kryefjala shprehet me një emër kolektiv, atëherë edhe kallëzuesi del në numrin shumës, p.sh.: // **Njerzja shóhin se çka po ndo:dh n kët vên// Udh'heçsja hajshin e pÿshin e na veç kçyrshim// Hállku shóhin púnt e véta// Burrnîmi shko:jn n dásêm e thmíja rri:n te shpíja** etj. Edhe në rastet, kur kryefjala shprehet me dy gjymtyrë (emër+përemër ose përemër +emër), ajo del në numrin shumës, ndonëse nuk mungojnë rastet kur ajo del në numrin njëjës, p.sh.:/ **Mótra e vlláu i sáj i thãn/ ja shko n shko:ll/ ja nãlÿ e pÿno te shpíja// Llúka e Põzhári kishin mâ^orr vesh çj u martu çíka e Can Rugóvs// N shpi:n t nã^ons/ pshtoi edhe çíka e djáli//** etj.

Në truallin gjuhësor të Istogut, ashtu sikurse edhe në të folmen e Hasit (Badallaj 2001:225), kur kryefjala është një emër fshati ose krahine, kallëzuesit nuk është i qëndrueshëm (stabil) pra herë del në numrin njëjës e herë në shumës, p.sh.: /**U mlòdh Vrëlla// U mlodhën Vrëlla// Flèt Prigóda për búrrat e Isníçit//Flásin Prigóda për búrrat e Isníçi// Riníja e Istógut punon shÿm// Riníja e Istógut puno:jn shÿm //** etj.Kur kemi

të bëjmë me përshtatjen e gjymtyrëve në fjali, duhet thënë se mbiemrat dhe fjalët e tjera përcaktuese janë të gjinisë së njëjtë me emrat,

p.sh.: // *Livádhët e gáta jôn n kry: t katunit //Búrrat e fo:rt kallzóhen n ko:h t vshtíra// Któ gra: jôn pej Kovráge// Ata búrra jôn pej malsíje// Fúshat tóna jôn shùm pjellóre//* etj.

Në të folmen tonë, ashtu si edhe në të folmen e Opojës (Pajaziti 2005:209) e ndonjë të pjesë tjetër të gegërishtes verilindore, për të shprehur zgjatjen a përsëritjen e një veprimi, nganjëherë përsëritet kallëzuesi, p.sh.:// *Hônêr sa hônêr e dikúr u nî// Fóli sa fóli e tha/ búrra çònu t ja nísim pun's// Príti sa príti/ po n fund ju desht mu ni:s vet //* etj.

§ 254. Rreth përdorimit të disa parafjalëve.- Në sistemin gjuhësor të Istogut më së shpeshti përdoren parafjalët e tipit: *nëpër, pa, për, ka^h, me, pë*.

§ 255. Parafjala *nëpër* në të folmen në trajtim ashtu si edhe në pjesët e tjera të gegërishtes verilindore del me funksion vendor, pra shpreh aspektin vendor se ku kryhet një veprim a zhvillohet një ngjarje, p.sh.: // *Íshin çke:p lépujt nëpër fúsha// Nëpër fla:k e plúma kish shku: me pshtu: shókun e vet// Po lűfto:jn n fúsha e n mâ^{le}/ zot atdhéut për mi da:l.. e* (këngë popullore)// etj.

§ 256. Parafjala *pa* dendur vihet re në ligjërimin e këtyre anëve dhe, në të shumtën shpreh mungesën apo mos plotësimin e një kushti a mjeti për kryerjen e një veprimi, p.sh.://*Pa púnu nuk ka t árdhme// Pa páre nuk maróhet shpíja// Pa msu: nuk krýhet shkólla// Pa mjéte nuk punóhet tóka//* etj.

§ 257. Parafjala *për* si në pjesën më të madhe të folmeve gegërishte, ashtu edhe te ne, mjaft dendur përdoret në rasën kallëzore dhe rrjedhore (në trajtën e pa shquar), p.sh.:// *Ja dhâ dokuméntet për ftýre// Ja nxu:r hákun për hû:nsh// Ish lo:dh ish pshte:t për gárdhi//* etj.

§ 258. Parafjala **ka** në të shumtën përdoret në vend të parafjalës së shqipes standarde **nga** dhe si e tillë, shpreh aspektin vendor të kryerjes së një veprimi, p.sh.: *//Po shkëlqejte ka Gúrrat e Bárdha // Ka jé ni :s kshtu çj kôke mu :sh fry :m?// Ka erdhëm pï bjëshke i ra:m ka Shkállla e Kaliçâ⁹nit //* etj.

§ 259. Parafjala **me** në të folmen tonë ashtu si edhe në pjesët e tjera të gegërishtes verilindore, p.sh. të folmen e Hasit (Badallaj 2001:226) ka përdorim të dendur dhe si e tillë tregon shoqërim, bashkim, mjet dhe rrethanë kohe, p.sh.: *//Dý çershía li:dh me nï rrfâ⁹në/ rri:n dý çika me nï nâ⁹:n* (sipas Ndre Mjedës)*// Bába me dy t bëjt e tij u nïs me shku: n Xhermăní// Délmja me dy kínxhat e saj e kîsh kalu: gárdhin e îsh da:l mîdis údhe//* etj.

§ 260. Parafjala **pï (prej)** gjithashtu tregon shkakun e kryerjes ose moskryerjes së një veprimi, por shpreh edhe raporte vendi, p.sh.: *//Diç pï zemre//Ju çórrun sy:t pï sheçërit// Pï tu:ts aru:shs nuk kish gúxu mï çit: xhâ⁹n mï kullo:t // Erdh pï Péje e po shkon n Istog// Pï asáj famílje xhithmo:n jôn da:l búrra t zôt//* etj.

Kur jemi te parafjalët, duhet thënë se në rrethin gjuhësor në trajtim, emri kur kryen funksionin e plotësit të shkakut dhe të vendit në rasën rrjedhore, në të shumtën nuk merr parafjalë, p.sh.: *//Du:l fáre// U çárt sy:sh// Lújti mênsh* (por edhe *lújti mê:ç*) *// I du:l dóre* etj., mirëpo kemi vënë edhe raste të caktuara, kur emrave u paravendosen parafjalët përkatëse, p.sh.: *// U mêrdhi s ftôfti// U prish pï ftýre// M du:l pï dóre//* etj.

§ 261. **Funksioni sintaksor i lidhëzave.**- Kur jemi të fjalitë e përbëra me nënrenditje, duhet thënë se përdorim mjaft të dendur kanë edhe lidhëzat, me anë të të cilave krijohen trajta sintaksore mjaft interesante, disa prej të cilave janë: *//Pleçt to:n kân jetu: me ne:r n lu:ft e n paçe e nuk jôn kori:t asnihër// Ata lúftôjshin edhe me shkíje edhe me cörrogor// Po nuk erdhën/ dert i madh!//* etj.

§ 262. Lidhëza **nō** (*ose*) përdoret mjaft dendur, p.sh.:// *Nō hñ mrêna / nō dñl jāsht// Nō ulu ha būk/ nō mos e nxăn vênin e hu:j// Nō kallxoj çysh âsht púna/ nō çkrêhe krejt kñt pu:n//* etj.

§ 263. Lidhëza nënrenditëse **po** (*pra*) është mjaft e pranishme në ligjërimin shqip të këtyre anëve e cila, përveç funksionit kohor shpreh edhe nuanca kushti, p.sh.:// *Ta mår míkun n pu:n/ po igbáll i Zótit// E ble:va çit lo:p/ po ta shō a po vy:n xhâ a jó!//* etj.

§ 264. Lidhëza **kā** (*nga*) ka përdorim mjaft të dendur dhe në të shumtën shërben ër të ndërtuar fjali që, shprehin raporte vendore, p.sh.://*Shkō kā ja kñ msy: //Kā jé a:rdh/ thé çafên e kñrr mos u kthè!// Kā shëlke/ u thájke bárñ //* etj.

§ 265. Lidhëza **sa** përdoret për të lidhur fjali që, janë në raporte rrjedhimore, p.sh.://*Kur i shkoj djáli ushtár u mърzit shumë /sa i shkōjshin lott nëpër fáçe//Djáli i Isúfit e pranoj fájin /sa mos me ja pá shërrin kōjshia e tij // Erdh nñ cóp her/ sá mos me thâñn çñ s èrdh hñç//* etj.

§ 266. Lidhëza **kur** përdoret mjaft dendur në të folmen në shqyrtim dhe si e tillë, shërben për të ndërtuar fjali nënrenditëse kohore, p.sh.://*Kur èrdh Xhavíti/ u:ku ish fu:t n tu:b t dhêne // Kur u çu :m n sabañ /bóra e kñsh zba:rdh tokën//Kur híni būgári (bullgari)/n Koso:v trí vjet májtñ thátsí e mâñdhe//* etj.

SKRÏPCAN,-I m.sh.-A(T). mb. Fëmijë shëndetlig. *Djáli i Shçipes Ësh skrÏpcan!* Për femrën thuhet: *skripcu:l, por edhe: skripca:jk.!*

SKYPE, pasth. Pasthirrmë për ta ndërsyer qenin. *Skype Zhuko skype!*

SMET,-I m.sh.- JE(T). Grumbull i madh bore nga ndërhyrja e njeriut, prej nga e siguron ujin e pijes. *Nestra kem me shku: mi ni:°mu Hasâ°nit me bâ° smet n' bje:shk.*

SMO:LL,-A f.sh.-A(T). Masë rrëshinore e pishës. Ka aromë të mirë dhe përdoret për shërimin e plagëve dhe infeksioneve të ndryshme. *Smólla â°sht e mi:r me çit:t n' va:rr!*

SMONI:C,-A f.sh.-A(T) mb. Lloj toke me shumë lagështi, e vështirë për t'u punuar. *To:k smoni:c!*

SÛRRAN,-I m.sh.-A(T). mb. Ai që ka pika të vogla në fytyrë. *Koka bu:rr sÛrran.*

SPARI:S kal. ITA,-I:T. Zverdhët, dergjet, vyshket. *Ësh spari:t krejt barÏ, po dojke mu: tha:!*

SPARÏM-I etnog. Vizita fillestare e familjes së nusës. *Po i vÏshin për sparÏm nusês s' Jetónit!*

SPI:C, ndajf. Plot e përplot. *E kish mu:sh traktórin spi:c me dru:!*

SPICÁT kal.-A,A:T. Mbush, stërmbush. *E kish spicát bárkun me búk!*

SPÏKT, ndajf. Kur diçka vihet në vend të pa përshtatshëm, gati për të rënë. *E lách kofen me u:j n' spÏkt t'ballkonit, kollaj múnët muu de:rdh.* 2. Kur lihet kohë shumë e shkurtër për të kryer një punë apo veprim. *E kôm aeroplanin n' spÏkt, ishalla po mÏj me mrri: me ko:h!*

SPIRÛC,-I m.sh.-A(T). mb. Fëmijë ngucakeq, që nuk rri rehat. *RrÏ aty more spirÛc e mos mÏ ñuç thmi:n!*

STÊRLÉÇE f.v.sh. Gënjeshtër. *Valla na mÏti tu na thy: stêrléçe!*

STÊRVÁJ ndajf. Shkapërderdhur, shkepur, shpërndarë. *Daútit ja nxûni shíu sâºnên stêrváj!*

STOG,-U m.sh.-**STOXHE (T)** Mjeti druri që përdoret në mullirin me ujë, për të bluar trashë apo imët . *Mullinxhja ísh kâºn tu e maru: nǐ stog pêr mulli:!*

STRI:NC,-A mb. fig.1. E shkathët. 2. Foshnjë e imët, e pazhvilluar mjaftueshëm. *Ajo çí:k ísh stri:nc!*

STRÛFULLÛG,-Um.sh.-**XHE(T)**.Qerdhe zogjsh. *StrufÛllógu i dallêndýshes!*

STRUHE:R,-A f.sh.-**A(T)**. Vend ku nuk e kap era. *Hîna n'struhe:r se gáti m'mýti éra e fuçishme.*

SU:T,-A f.zool. Lopa që i ka brirët shumë të shkurtër. *Shabâºni po dojke me pre: lopên su:t!*

SÚMÛLL,-A f. zool. Lopë që e ka trupin disi të rrumbullakët.

SURDA:R,-I mb. Njeri i pa edukatë, i pa sjellshëm, pa kulturë. *Kojshia i Beçirit âºsht nifãr surdári, kurxhâº nuk âºsht púna e tǐ!*

SURÛJ,-I mb. Ka që i ka qimet ngjyrë hiri. *E kǐsh ble: Izlâºmi nǐ ka: surõj.*

SÛT, ndajf. 1. Qethje e tërësishme e deleve. *I ka çe:th dhêt i ka bâºsút!* **SY:K,-A** f.sh.-**A (T)** mb. Delja me shumë pikla në fytyrë.

SÝMÎ/SÝMÎNI, mb. Ai që ka sytë e imët, si të miut. *Ík more sýmí!*

SYGÊMT,-I m.sh.-**A (T)** mb. Ai që i ka sytë e shtrëmbëruar, syvëngër.

SYKAPSÛLL,-I m.sh.-**A (T)**. mb. Ai që ka sytë e hapët, të zgurdulluar.

SYLA^h, -I m.sh.-**E(T)**. Pushim gjatë shërbimit ushtarak. *Djáli i Rexhepit ísh a:rdh te shpija pêr syla^h!*

SHAKLLÄMA:JK,-A f.sh.-**A(T)**. mb.Ajo që flet shumë, pa ndalur. Llafazane. *Po shaklläma:jka çí ísh çíka e Sherifit! Pêr mashkullin thuhet: shakllämãn!*

SHALAKÁTET, vetv. Ec ngadalë duke u lëkundur, duke u luhatur. *Ec ma çpejt, mos u shalakat!*

SHÁRA- SHÁRA, ndajf. Me pulla a lara të zeza. *Çêni i Fazli:s ísh krejt shára- shára!*

SHASHTRÍSNA vetv. Frikësohem së tepërmi. *Ademi shashtríset me da:l natên vetun pêrjáshta!*

SHAZOTEN, *palak*. Shkurtesë për " pasha Zotin". *Shazoten kÿrr nuk e kam di:t se nuk e kisha lâ^{on} pa a:rdh me t pa:.*

SHEGA:VNA *vetv.* Bëj shaka, humor. *Nuk ka xhâ° t' kéçe kur shegávet shóku me shókun!*

SHEGÁREM (por edhe: **SHEGÁRNA**) *vetv.* Tallem, mahitem, shegatem. *Po shegárna pak me Enverin!*

SHEGÏJ, - *m.zool.* 1. Ka, dem. 2. *fig.* Ai që është kokëtrashë. *Po shegÏji çj je bâ° kry:t vesh nuk po t merr!*

SHÊJ, - **A f.sh.** - **A (T)**. *mb.* Dhuratë e falur. *Dája çj erdh pj XhermÏni:s krejtve na prúni ka nj shêj!*

SHËJOHET, *jokal.* Piqen pemët a perimet. Ka ni:s mu shëju rrúshi.

SHFÊNSHÊM, *ndajf.* Lëshueshëm nga gjymtyrët. *Çka po rrÿn ashtu shfênshtëm?*

SHIBLOJ, *kal.* - **VA**, - **U**:. I vë dikujt shibla, e njollos dikënd. *Ferídja nuk la: kôn pa e shiblu:!*

SHKALAFÊNC, - **I m.sh.** - **A(T)**. *mb.* Ai që është i ngathët. *Po shkalafênci çj ish aj dja:!!*

SHKAMCOJ, *kal.* - **ÓVA**, - **U**:. Zbërthej, demoloj, prish diçka. *E shkamcÓva kulmin e shpi:s vjetêr!*

SHKAPÛRDHT (i, e) *mb.* I shkathët, i shpërdhit. *Çika e Besnikut ish shumë e shkapÛrdht!*

SHKEPÏJ *jokal.* - **VA**, - **U**: Çaloj, ecë me vështirësi. *Nuk muj me e:c, po shkepÏj se po m dhêm kê^ama.*

SHKEPTÁZ, *ndajf.* Ndaras. *A lu:jm shkeptáz çitash se bÏll nëjtêm o búrra?!*

SHKÊRDHY:M/E (i,e) *mb.* I zoti(e zonja), i,e aftë. *Ma t' shkêrdhy:m se Hajdini nuk munësh mee xhe:t, veç lódhesh!*

SHKLLÛM, *pasth.* **Tregon** zhytjen në ujë. *Çysh kem tu nëjt me Ahmetin, veç kur ra: shkllÛm e n'Ûj!*

SHKO:FTLÁRG, - **U m.** Eufemizëm për djallin. *T' rro:ft shko:ftlÁrgu!*

SHKRE:BZ, - **A f.sh.** - **A(T)**. Sëmundje që godet këmbët e deleve, dhive etj. *I kÿsh ka:p shkrélbza dhêt e Sokolit!*

SHKRE:P, - **A f.sh.** - **A (T)**. *mb. fig.* Femër e dobët, shëndetligë.

SHKU:LL, - **A f.sh.** - **A (T)**. Mashë zjarri. *E bleva nj shku:ll pêr zjêrm!*

SHKY:S,-I m.sh.-A (T). Ai që gjendet mirë në situata të vështira, depërtues. *Shkýsĭ ĉĭ â°sht djáli i Malúshit!*

SHLLÄP-SHLLÄP, ndajf. Ecje e pa kujdesshme. *Fazlia ecke shlläp-shlläp!*

SHLLAPUTAN,-I m.sh.-A (T). mb. Ai që ecë në formë të çrregullt, që i ngre këmbët disi zvarrë.

SHLLU:N-A f.sh.- A(T). Grumbull leshi që vihet në furkë për ta tjerre. *I bléva n' pazár tri shllúnga lesh.*

SHMARK,-U m.sh.-ÇE(T). nga (*Shën Marku*).*etnogr.* Festë e përvitshme që kremtohet më 8 maj në vendin e quajtur “Kodra e Ilixhës (Banjës së Pejës) . Aty mbledhen njerëz nga të gjitha fshatrat e Podgurit dhe më gjerë, të të gjitha kombësive. Po ashtu, marrin pjesë instrumentistë e grupe të ndryshme orkestrash. Me dominimin e fizharmonisë e të muzikave luhen valle të ndryshme, këngë e lojëra. Ka shumë vite që ky manifestim ka marrë karakter panairi, në të cilin tregtarët endacakë ofrojnë prodhime të ndryshme për shitje, kryesisht industriale. Vlen të theksohet këtu se popullsia shqiptare, përkundër pranisë së përhershme në këtë festë, e konsiderojnë atë si festë të popullsisë rome, ndërkaq, nuk e fshehin pohimin e tyre se ata (romët), mbajnë festën më të mirë të vitit, festën kur dilet nga dimri, pra festë kjo, që ka të bëjë me rite që lidhen me ringjalljen e natyrës, me kultin e bimësisë, i cili në këtë kremte simbolikisht shpreh plleshmërinë.

SHMÍTÊR,-I m.sh.-A (T). *entongra.*Festë pagane që kremtohet me 8 nëntor. *Dimni te na â°sht pej Shmítiri e dej n'Shinxherxh!*

SHNÛKS,-I m.sh.-A(T). mb. Ai që përpiqet vetëm të përfitojë, egoist, lakmitar. *Po shnÛksi ĉĭ â°sht Emini!*

SHO:KZ,-A f.sh.-A (T). Shokëz, brez, për ta lidhur foshnjë në djep. *Hasîmja ja kĭsh maru: djálit nĭ sho:kz djépi!*

SHOFAÇOK, ndajf. Lojë fëmijësh, symbyllazi. *Agron apo vjen me lu:jt shofaçok?*

SHÓRTE,-JA f.sh.-E(T). Fidane pemësh të ndryshme. *I bléva dŏ shóрте t' mo:ll's e dështa mii mje:ll!*

SHPÄNKŦJ, kal.-ÓVA,- NKU: Rrah dikë shumë. *E rréha djálin e kojshi:s e shpänkóva!*

SHPĀNKU:M/E (i,e) mb. I, e lodhur, i,e dërrmuar, i,e rraskapitur. *Çika e Xhafërit ish e shpānkúme!*

SHPATULLĀK,-Um.sh.-A (T). mb. Gur me formë disi të shtypur, shpatuk. *Duhet mee xhe:t nĩ gur shpatullāk çì me nêjt ma mi:r!*

SHPATULLĀN,-I m.sh.-A (T). mb. I fuqishëm, i fortë, muskuloz. *Hajt shpātullâ°ni i Ba:b's bĩna dō u:j! Për femrën thuhet: shpatulla:jk!*

SHPĒNKĒÇE, -JA f.sh.- E(T). Lloj zogu, i cili gjatë natës nxjerr zë të trishtueshëm(të qirrur). Sipas besimit popullor, këndimi i këtij zogu afër ndonjë shtëpie sjell diçka të keqe për atë familje. *Knojke shpēnkeçēja n' buna t' Fazli:s!*

SHPĒRLAME,-T (t') f.v.sh. Mbetjet (mbeturinat) e ushqimeve që u ngjiten enëve (tlâ°na).

SHPĒRTHĒKOJ kal.,-VA,-U: Hap këmishën, ia zgjidh mbërthyeset (pullat). *Djāli i ba:b's, nuk duhet mee shpērthëku: kmishén se tash â°sht móti i ftōft!*

SHPĒRTHĒKU:M, ndajf. Zhveshur, çkopsitur. *Ashtu çysh po don ti, shpĒrthëku:m, nuk shkohet n'mal o djāli i mi:r!*

SHPĒRTHĒKU:M/E (i,e) mb. I veshur holl, a me këmishë të hapur. *N' kit t' ftoft ish da:l i shpērthëku:m!*

SHPESHTI:N,-A f.sh.-A(T). Mal i shpeshtë, i dendur. *Dikur mâ°let e bjëshkve tóna ma shum jôn' kâ°n shpeshtína, e jo ashtu çysh jôn sod, nĩ lis çetu e njō çatje, sa çe edhe minĩn e sheh tũ ec: n' mal !*

SHPIJANĪK,-U m.sh.-A (T) mb. Përparimtar, punëtor i madh, që është në hap me kohën. *Shpijanik â°sht Selimi, di:t e na:t punon pa da:.*

SHPJE:RDH, folj. -DHA,-E:RDH. Mund thellë, fitoj meritueshëm. *I kôm mu:jt thmi:n e kojshíve, i kôm shpje:rdh krejt!*

SHPJERDHT, ndajf. Kokulur. *Djali i kojshi:s shpjerdht shkoj te shpíja e vet!*

SHPO:RDH, kal.-A,O:RDH. Heq dorë nga ndonjë plan, dëshirë a qëllim, ndërron mendje. *Salihi e kish shpo:rdh at' pu:n, nuk po shkojke n' Xhermōni!*

SHPŌJC,-I m.sh.-A (T). Shpues metali për t'i shpuar rripat e opingave. *Ama nĩ shpōjc ta çpōj pak çet rryp!*

SHPÖRDHT (i,e). *mb. fig.* Dyshues, skeptik. *Diçysh i shpördht u doke n'at pu:n!*

SHPÖRDHT, *ndajf.* Me dyshim, me skepticizëm. *Böll, shpördht ish tũ e kry: at' shko:ll.*

SHPU:LL,- A f.sh.-A (T). 1. Shuplaka e dorës. 2. *fig.* Kur dikush pëson keq, dështon. *E mu:r shpu:ll ftyr's.*

SHTALB, *fig.* Ai që është i papjekur mendërisht, që nuk e ka formimin duhur. *Shtalb ish pej kréje, i kışh mêt̃t e thmi:s.*

SHTAVI:T kal.-A,-I:T. Zbus, bëj me elastik. *E kôm çi:t dõ duhõn mu shtavi:t!*

SHTERPNI:M,-I m.v.sh. Bagëtitë që kanë shteruar, që nuk milen. *A tu ka rri:t a tu ka zvo:glu shterpni:mi sivjet ?*

SHTËRRBA:JK,-A f.sh.-A (T). Ajo që nuk ka dhëmbë. *Ëk anej more shtërrba:jka e kéçe!* Për mashkullin thuhet: *shtërrban!*

SHTËRRMÂ:Z,-A f.sh.-A (T). *zool.* Lopë që nuk pjell dy vjet radhazi, por që vazhdon të milet ngapak. *Po i ma:j dy lo:p shtërrmâ:za!*

SHTI:Z,- A f.sh.-A (T). Mjet i mbrehtë druri për pshtjelljen e penjve të leshtë. *Bába ma kışh maru: nř shti:z me tje:rr lesh!*

SHTIHÓNA *vetv.* Shtirem, inskenoj. *Ajo gru: â°sht tuu shtihu: se hiç nuk â°sht smu:t!*

SHTIHU:M/E (i,e) *mb.* I shtirur. *Ajo gru: ashtu po bâ°het si e shtihúme se hiç nuk â°sht smu:t!*

SHTÍZASH, *ndajf.* Lojë barinjsh me shkopinj. Është emërtuar kështu ngase shkopinjtë hedhen në fomë shtizash. *Ishin da:l n'livádhe me lu:jt shtízash!*

SHTRËZ,-I m. 1. Fije të imëta bore që gjatë mëngjeseve dimërore ngjiten nëpër degët e pemëve. *Sod koka díta e vrõnt e paska shũm strëz.* 2. akull mbi lumë, që nuk është i ngjitur.

SHTRÛMT, (t'). *asnj.* Shtroja për kafshët. *Pêr t' shtrũm t' xhâ°:s, çka po boni sivjet?*

SHTRUJ,-A f.sh.-A (T). Vend në derën e vathës ku mjelen delet, dhitë, etj. *I çova dhêt n' shtruj mii mje:l .*

SHÚJÂN,- m.sh.-A,-AT. Ai që nuk di të flasë. Nuk e kam di:t çĩ *djáli i Isufit ish shújân!*

SHURRXHÁKE,-JA f.sh.-E (T). *mb.* Sëmundje e bagëtisë që ua bën urinën e kuqe si gjaku.

SHUSHÁTNA vetv. Hesht, nuk flas, nuk nxjerr zë. *Ësh shusha:t, Ësh ra: n' hall, hiç s'po dike k'a m' ja ma:jt!*

SHÛSHKT, ndajf. Zbrazët.Thuhet për bishtajat e fasulës që nuk kanë marrë frut, kanë mbetur ka kokrra. *Sivjet krejt pasul'i ka me:t shushkt.*

SHYTËL,-I m.sh.-**A (T)**. mb. Ai që nuk nuk kupton, kokëtrashë. *Besimi i Tafilit âsht nifër shytéli!*

T'HUJÍTNA vetv. Me ngelet hatri. *Kollaj t'hujítet gru:ja e Smâºjlit!*

T'THÓRE,-JA f.sh.- **E(T)**. Njësi për matjen e gjatësisë (afërsisht sa këmba e njeriut). *E mâºta çat lis, e du:l tri: kâºm e n'i t'thóre!*

T'THÛR, ndajf. Rrotull. *Bjeri t'thÛr, mos shko udh's shkurt!*

TAKAHYT,-I mb. Ai që ka është me ngecje mendore. *Ësh nifar' takahyti nuk Ësh pu:n mu mâº:rr vésh me tò.*

TALLAZ,-I m.sh.- **A(T)**. Vrulli, fuqia e erës. Qyteti i Istogut dhe disa fshatra përreth, gjatë vjeshtës dhe pranverës, shpesh goditën nga erëra të fuqishme, që janë mjaft shkatërruese. *Duhet m'ju ru:jt tallázit t' e:r's se t' fshi:n me vét'i!*

TAMARÛK, ndajf. Kapërtthurur, mbërthyer mirë. *E kish li:dh djálin n' djep e kish bâº tamarÛk!*

TÂºMLEBO:R,-A f.v.nj. Qumësht me borë dhe sheqer. *Po e marøj pak tâmlebo:r!*

TÂºN, përem.Të gjithë. *A jôn a:rdh tâºn shoókt? A ini tâºn mi:r?*

TÄPRRÄP, ndajf. Shpejt, papritmas. *Ërdh täpprräp p'i Xhermani:s e e maroj shpi:n!*

TARASHKA:T (me e) folj. Trazon, shqetëson, prish rehatinë. *Kojshia i keç xhithmo:n d'in me t' tarashka:t!*

TEDEËL, mikrotop. Vend ku buron ujë, mikrotoponim në fshatin Vrellë.

TEKÊRRLAÇ,-I m.sh.-**A (T)**. zool. (Picus maior). Pikth, qukapik. *Çyre çysh Ësh nxhi:t n'i tekêrrlaç n' çat mo:ll!*

TERİG,-U m.sh.- **A (T)**. Erë e lehtë, puhizë. *Ësh flladi:t koha, po fryke n'i terig.*

TÊRPIJÂºN N' FJA:L fraz. Ai që flet shumë. *Mos u bõ têrpjijân n'fja:l, se kshtu nuk bân.*

TÊRSKA:T (me u), folj. Përplasht fort, qerrja e kalit në rrugën me gropa. *Kah shkëke n' mal krejt kerri u tërskatke n'ato u:dh t' kçja.*

TÊRTHORÛM/E (i,e) mb. I ngatërruar, i lidhur. *Valla Ismeti â°sht i têrthorÛm pÿ asáj gru:je cÿk nuk guxon me bâ°!*

TERŽÏTE, folj.urdh. Saktësoje, shënjestroje saktë. Rregulloje, siguroje. *Terzite mi:r e tani puno: me maçi:n.*

TÊRRHA:T (me), folj. Kur kali fryn për hyndësh. *U nike tu têrrha:t káli.*

TÊRRME:K (me u), folj. Me mirren mendtë, kam marramendje. *Nuk guxoj me hi:p nalt se têrrmekna.*

TÊRRS-TÊRRS, pasth. Pasthirrmë nxitëse gjatë mbarësimit të deles.

TFU:RK,-A f.sh.-A(T). Mjet druri për vendosjen e shtëllungës së leshit.

TI:SK,-A f.sh.-K(T). Frikë e madhe. *E pava ni xhárpên t' madh e m'ka hi: tíska n'bark!*

TÍKO- TÍKO, pasth. Pasthirrmë ndjellëse për pulat. *Kaméri ish da:l n' bášçe e tíko- tíko i nÿllke púlat e véta !*

TIS,-I m.sh.-A(T). Lloj druri shumë i fortë që rritet në Bjeshkët e Nëmuna. *E maróva nÿ djep tísi.*

TÏTA, folj.urdh. Mos ashtu. Ju thuhet fëmijëve kur urdhërohen apo qortohen për të mos bërë ndonjë të keqe. *Tita, mos bô shërre se t' rre ^h nâna!*

TOLLOXHI:T kal.-A,-I:T. Turbulloj, përziej. *Mos e tolloxhÿt ujt (ujin)!*

TOPÏTET vetv. Trashet tehu i sepatës, thikës, shpatës etj. *Koka topi:t kjo thi:k, po e u dashka me mre^h !*

TRAKANI:C,-A f.sh.-A(T). Mjet druri për mbylljen e derës(ngujore). *A ja nôve trakani:cên dy:rve t' obórrit se po fry:n éra?*

TRĂP,-I m.sh.-A (T). Gropë që hapet në tokë për t'i ruajtur patatet për një kohë më të gjatë. *Ismeti e mloj nÿ trap t' kompírave!*

TRASHU:K,-A f.sh.-A(T)mb. Lopë që është disi e trashë. *E çíta trashukên me kullo:t!*

TRÛJ, folj. Mallkoj, nëm, shaj. *Mos i trûj zojt se ata s'kan faj!*

TRUMHA:Z kal.-A,-A:Z. Përplas, godas, lëndoj fort. *Dauti ish rrxu: pej lísit e ish trumha:z fort sa çÿ i kÿsh thy: edhe bri:t!*

TRÛMHE:LL-A, f.sh.-A(T). mb. Njeri i pagdhendur, kokëtrashë. *Po trumhélla, çÿ ish dhâ°nrri i Izlâ°mit, hăj medet hăj!*

TRÛP, *ndajf*. Shkurt, rrugës më të shkurtër, më afër. *N' dăç me shku: n' Istog hîn trûp se mrrî:n ma shpëjt!*

TRUPOJ *kal.-ÓVA,-U*: Kaloj përmes një rruge më të shkurtër .*E trupóva livádhin e Kadri:s e dóla nat jázit me u:j!* 2. Pres (sharris) lisat në dy ose më shumë pjesë. *Po i trupoj çeta trúpa t' pishave!*

TUFON *vetv*. Lulëzon. *Ka ni:s e po tufon kollomóçi!*

TÚRRA- TÚRRA *ndajf*. Herë-herë, hove-hove, *Po shkon traktóri diçka si me túrra- túrra!*

THÁRBÚN (i,e) *mb*. I tharbët, i thartuar. *Tâ^omél i thárbún.*

THÁRPÇE,-JA *f.sh. -E(T)*. Mollë me shije të thartë. Ka frute të vogla dhe me ngjyrë të kuqe. *Sadíku, midis obórrit e kîsh nî mo:ll thárpçe.*

THATCĂN,-I *m.sh.-A(T)*. *mb*. I dobët nga shëndeti, thatanik. *Djali i Januzit îsh nîfar thătcâni!*

THEKA:T *kal.-A,-A:T*. Ngacmon, qetë apo deshtë therin me brirë njëri- tjetrin. *Kîjet çî i bléva t' êjten n' masxha^h shûm po thekátên midis véti!* 2. Kur dikush e ngacmon dikënd me fjalë. *Ata dy búrra shûm po thekátên me fja:!!*

THELSHTJERRJÛN/NE *mb*. Me thelb të shtjerrur, të vyshkur, të përtharë. *Pasúl thelbshtjerrjûn!*

THELLU:T,-A *f.sh.-A (T)*. 1. Thellësi e madhe. *Kokăn hí lo:p nî thellu:t.* 2. Rrugë pa krye, punë e komplikuar, vështirë e zgjidhshme. *Avnia fôrt po hîn thellútave.*

THEPA:JK,-A *f.sh.-A(T)* *mb*. E zonja, e shkathët, punëtore. *Gru: thepa:jk!*

THÍ I BÍRÍ' THÍUT, *fraz.fig*. Ai që është shumë kokëfortë dhe që vepron vetëm sipas tekave të tij. *Thí i bírî thíut â^osht djali i Smâ^ojlit, xhithmo:n bôn veç çka ti tho:t mênja e vet, nuk ni:n pêr fja:l t' kêrkujt hiç!*

THÎJAS, *ndajf*. Keqas, me vështirësi të mëdha. *Thîjas boll shku:m n' bje:shk.* 2. *Thîjas po e kalojshin nêrmje véti ato dý gra!*

THÍKAZ, *ndajf*. Lloj loje me thika. Shënjohej një vend i caktuar dhe në drejtim të tij gjuhet me thika. Kështu lojtarët garojnë se kush do ta ngulë thikën më afër shenjës së caktuar.

THÏKPÊRPJE:T *ndajf*. Drejt përpjetë, pingul përpjetë. *U:dht e mâ^olit jôn thÏkpêrpje:t*

THÏKTEPO:SHT ndajf. Drejt teposhtë, pingul teposhtë. *Jetóni i Hazírit u lshu: me skíja thÏktepo:sht!*

THÍNCA (me) ndajf. Bisedë, dialog që zhvillohet duke thumbuar (ngacmuar) me fjalë njëri-tjetrit. *Sa nêjta te Xhemîlja, tâºn kohên m' folke veç me thínca!*

THINCA:T kal.-A,-A:T. Përçaj, shkaktoj ndasi. Isméti e MentÓri kishin ni:s mu thinca:t nêrmje véti!

THINE:SH,-A mb.fig. Ajo që shfaq sjellje arrogante. *Gru:ja e Xhavítit po thinéshta çÏ ish, kry:t vesh nuk po i merrke!*

THMIJĂÇ,-I m.sh.-A(T). mb.fig. Mendjelehtë, ia paformuar. *I ka bâº 50 vjet, po pej mênve âºsht thmijăç!*

THÛMT (i,e) mb. I dobët nga shëndeti, hallpak. *Tezáku i Burímit ïsh nÏfar djáli i thÛmt!*

THÛNRÁKE,-JA f.sh.-E(T) mb. Lopë, dele a dhi me thundra të gjata(të mëdha). *Délme thÛnráke!*

THÚPRAXHÍ,-JA m.sh.-I,-I:T. Ai që punon shumë me thupra. *E kÏsh thi:rr thúpraxhi:n me ja thu:r kópshtin!*

THÚRĂS, ndajf. Kur shman rrugën kryesore. *Jemi shku : thúras e jo kâ i kôm ra : xhithmo:n.*

THÝSHÊM ndajf. Kur dikush nuk ka marrëdhënie të mira me dikënd (kur nuk ka raporte miqësore). *Réxha halá ïsh thýshêm me Mustafên!*

U:LZ,- A f.sh.-A,-AT. Lloj druri, jo shumë i fortë, i ngjashëm me ahun. Rritet përgjatë ultësirave, por edhe në zona të larta. *I sharríta dđ dru: úlze.*

UDHTĂRÇE, ndajf.fig. Punë a veprim që kryhet shpejt e shpejt. *Valla çashtu udhtărçe e hojêr pak bÏk, se sa e:rdh pÏ mâºlit, menÏhêr i çíti xhâº:n me kullo:t!*

UFU:LL,-A f.sh.-A(T). Lloj i lepjetës (barishtë) me shije të thartë. Rritet nëpër livadhe dhe shërben për gatim të byrekëve të ndryshëm. *I xhéta dđ ufúlla n' livadh.*

UHÚ pasth. Shpreh mospajtim, kundërshtim, paknaqësi. *Uhú, jo valla hiç nuk po punoj, pse nuk po punon ti?!*

ÛJ,-A f.sh.-E (T). Uria. *Po e ha:m pak bu:k se na ka mâºrr ûja (përdoret edhe: únja).*

UJC-I, m.sh.-A(T). Lëngu amiotik që e liron lopa kur të lindë (të pjellë).

UJCÏTSHÊM/SHME (i,e) mb. Me lagështirë. *Po rrÏn i ujcÏtshêm ky*

UJKI,-A /UJKE:SH f.sh.- **UJKIJA(T)**. Ujk i gjinisë femërore. *Ïsh afriu: ujkia nat kÏnxhave, Ïsh kâ°n ka i ka:p mi hâ°nËr.*

UJS,-I m.sh.-**A(T)**. mb. Kungull shumë i lagësht, që nuk ka shije të mirë. *KÏnujt sivjet na kan' da:l krejt újsa!*

ÚMI, m. 1. Plori i parmendës. *Ja nrróva umíhin pllúgut.* 2. fig. Mos e lsho aç fell umíhin (Mos më prek në sedër).

ÛNT(i,e) mb. I, e uritur, i pangopur. *Dja:l i Ûnt!*

ÛNT, ndajf. Pa u ngopur, me uri. *Jepi bu:k se kôka Ûnt!*

ÚNXHNA vetv. Ulem. *XhafËri â°sht puntór i madh, xhi:th ditên nuk únxhet me púshu trúpin e vet!*

ÛRUP-ÛRUP ndajf.fig. Copa-copa, grima-grima. *E kÏsh çky: çËni tópin ee kÏsh bâ° Ûrup-Ûrup!*

ÚSHÊL,-A f.sh.-**A(T)**. Irritim i lëkurës nga kontakti me ndonjë bimë a insekt. *Ïsh ra: çika n' hítha e Ïsh bâ° úshêl krejt!*

UTRI:N,-A f.sh.-**A (T)**. nga serb. Pronë e pa pronar që shfrytëzohet nga të gjithë. *I lshóva kualt me kullo:t n'utri:n.*

ÛTH,-I m.sh.-**E (T)**. 1. Parazit që i dëmton kulturat bujqësore. *Krejt kollomóçin e kÏsh pri:sh úthi.* 2. fig. Lukthi. *Po m' dhê:m úthi!*

UZDA:,-JA f.sh.-**A (T)**. Rrugëzgjidhje. *Çdo pu:n e ka uzda:n e vet!*

VAKARRIM,-I m.sh.-**E (T)** Ngecje, ngadalësim. *Çdo pu:n i ka edhe vakarrímet e véta!*

VAKARROJ kal.-**ÓVA,-U:**. Ngec, ngadalësoj, ngatërroj një punë dhe nuk ecë mbarë. *Valóni veç po i vakarrôn pu:nt!*

VALVÍTNA vetv., **A (u),-I:T**. Përpëlitem, nuk mund të qetësohem nga ndonjë shqetësim a brengë.

VARGI:S kal.-**A,-I:S**. Rëndit njëri pas tjetrit, i vë në një radhë. *I kÏsh vargi:s dhËt si fÏshekt njâ°nên mas tjetrês.*

VASÊRVA:G,-A f.sh.-**A(T)**. nga gjerm. Mjet pune për matjen e saktësisë së sipërfaqeve të ndryshme. *Pedma vasêrvágên ta shoh çet zit, a â°sht' i nrejt' a i shtrêmt.*

VÁZHGA- VÁZHGA, ndajf. Vijza vija, njolla-njolla. *Ka ra: shí i madh e tóka ish bâ° krejt vázhga- vázhga.*

VAZHGA:T *jokal.,-A,-A:T.* Eci duke zhurmuar, zhapëlloj. *Mos i vazhga:t kâ°mt!*

VAZHGI:N,-A f.sh.-A (T). Gjurmë, shenja, vija, që krijohen në rrugët malore gjatë tërheqjes zvarrë të drunjëve. *Kish çit:trúpa pĩ mâ°lit se vazhgi:n ish bâ° vëni asajde!*

VE:RDH (i,e) l,e gjelbërt. *Krejt bári koka bâ° i ve:rdh!*

VÉGZA-VÉGZA, ndajf. Mënyrë e qendisjes me gjilpër. *Nâ°na e vet ja kish maru: nĩ xhamper e ish vэгza-vэгza!*

VESVÉSE,-JA f.sh.-E(T). mb. Jepet(shprehet), përkushtohet së tepërmi në një gjë. *Vesvésja çĩ â°sht Bésa, nuk e bõn trúpin e vet rahat pa i kry: krejt tjetrt.*

VESHATÓRE,-JA f.sh.-E(T).mb. Ajo që kupton mirë mbi veshjen kombëtare. *Mâ°na â°sht veshatóre e mi:r!*

VESHBA:RDH,-A f.sh.-A (T) mb. zool. Dele e zezë, por që ka vetëm një vesh të bardhë. *E thírra veterinâ°rin se veshbárdha â°sht diçka smu:t!*

VĚSHGA:T,-A f.sh.-A(T). fig. Lloj gjilpëre për qepjen e opingave. *Ku â°sht xhylpâ°na vëshga:t se nâ°na déshti mii ke:p çeto opâ°na?*

VETMEVÉTI- përem. Me vetën, vetmevete. *Jôm bâ° me fo:l vetmevétí!*

VETULLÖSH,-I m.sh. -A(T).mb. Ai që i ka vetullat e trasha, gati të ngjitura njëra me tjetrën. *Sadria, i bíri i Sadíkut ish nĩfar vetullóshi!*

VI:L,-A f.sh.-A (T). Delja që lehtë dallohet nga të tjerat, ka fytyrë me vijëza! *A e ke pa: kũn se u hu:p víla?*

VĚGLU:SH,-A f.sh.-A(T). mb. Delja që ka disa vizla kah këmbët dhe në fytyrë. *Délme vĚglu:sh!*

VĚKA:T kal.-A,-A:T. Bërtet me zë të lartë, lëshon zë të fuqishëm. *VĚka:t bu:rri!*

VINJĚK,-U m.sh.-A(T). gjerm. Gjaketë, pallto e shkurtër me kapelë (veshje dimërore). *Veshe vinjâ°kũn se koka bâ° ftoft!*

VÍSHKŮLL, ndajf. Duarthatë, pa asgjë. *Hamdia ish me:t víshkũll, pa asní páre n' xhep!*

VIZA:JKE,-JA f.sh.-E(T). mb. Lloj molle që e ka lëkurën me viza. *Ráza i mjélli dõ mólla vizájke!*

VIZĂK,-U *m.sh.-A(T)*. Lojë fëmijësh. Vizatojnë disa katrorë në tokë dhe nëpër ta ecin vetëm me një këmbë duke mbajtur një guralec në dorë. *Dri:t a po vjen t'lu:jm' vizăk?*

VÏZLLÓRE,-JA *f.sh.-E(T)*. *mb.* Opinga për femra që shkëlqejnë. *Rába e Hetémit i kışh ble: nř pa:r opâºŋa vïzllóre!*

VLLA:K,-A *f.sh.-A(T)*. Mjet druri për tërheqjen zvarrë të drunjëve. *Me vlla:k i çíta dru:t dej ku i ka:p traktóri.*

VLLAÇI:T *fig.* Pësoj ndonjë të keqe, më ndodhë ndonjë e ligë. *E ka thy: kâºmên, e ka vllaçi:t mi:r!*

VRINJ-T *m.v.sh.* Zingjirët. *E lídha çênin me vrinj!*

VRÔNÇ,-I *m.sh.-A (T)* *mb.* Kalë me qime të murrme. *Ka:l vrônç!*

XÉKÊRR,-I *m.sh.-RRA (T)* *zool.* Zekth. *I kápi xékri lo:pt!*

XEKRRÂN,-I *m.sh.-NA (T)* *mb.* Grindavec, tekanjoz. *Bu:rr xekrrân!*

XI:X,-A *mb.* 1. E re, e sapo prodhuar. *E kışh ble: nř pu:shk' xi:x!* 2. E bukur. *Ajo çi:k řsh xi:x krejt!*

XINXA:R,-I *m.sh.-AR (T)*. Udhëheqës (kryesues) i një grupi njerëzish.

XÏNXÓRE,-JA *f.sh.-E(T)*. E zgjuar, e shkathët, e mençur. *Shqípja âºsht çi:k xïnxóre!*

XÓGÏ- XÓGÏ, *pasth.* Pasthirmë që e përdorin fëmijët për joshjen e zogut. *Xógř- xógř,, hajde ktu more xógu (zógu) i vogël!*

XÚFKE,-JA *f.sh.-E (T)* *mb.* Mollë me shije të thartë. *Arífit i kışh ra: çe:f pêr dô mólla xúfke!*

XHAHÏL,-I *m.sh.-A (T)*. *mb.* Pa ndjenja, i pashpirt. *Xhahil âºsht aj, as thmi:n e vet nuk i don.* 2. *fig.* I, e djegës. *Kjo spe:c koka shũm xhahĩl.*

XHALLNÍ,-A *f.sh.-I: (T).fig.* Pasuria, prona. *A křni far xhallnře?!*

XHALLNOJ *kal.* -ÓVA,-U:. Punoj, siguroj të ardhurat e mjaftueshme për të jetuar. *Xhallnoj vet, pa m' nimu: kêrkush!*

XHENERÍKE *f.sh.-E,-T* . Lloj kajsie që piqet në muajin korrik. *Dru: xheneríkje!*

XHEPARÖSH,-I *m.sh.-A(T)*. *mb.* Hajdut, vjedhës. *Mos u bôn xheparösh se nuk t'ka híje, se as ba:b as babaxhysh nuk i ke pa:s hâºjna.*

XHGÏFT, *ndajf. fig.* Me gjymtyrë të lëshuara teposhtë, varur. *Mos ec ashtu xhgúft po ec pak ma mi:r.*

XHINIÍ,-A *f.sh.- I (T)*. Familja e nusës. *E çu:n nusên n'xhiní t vet!*

XHVO:JS,-A *f.sh.-A(T)*. Mjet i mbrehtë druri a metali për ta qeruar (zhvoshur) misrin. *Merrni xhvójsat e hajdeni n' a:r me çeru: kollomöç!*

XHÝMERT (i,e) *mb.* Dorëlrirë, mikëpritës, bukëdhënës, altruist. *Çíka e Zymerit â°sht shŭm e xhýmert.*

XHYPNER,-I *m.sh.-E:R(T)*. Kërrabëza për të thurur çorapë a veshje të tjera. *Xhýshja i mu:r xhypne:rt me punu: pak se sod sii ka pre:k me do:r!*

ÝMÊRNXI:M/E *mb.* Jetënxirë. *Bu:rr ýmêrbxi:m!*

ÝMÊRSÓSUN/E *mb.* Jetëshkurtër, i pjetët. *Plăk ýmêrsósun!*

YKS, *pasth.* Pasthirmë ndjellëse për delet. *Yks bardho:k, yks!*

YMERLI,-A *m.sh.-I(T)* *mb.* Mbijetues, jetëgjatë. *Ymerli: ish kâ°n' Agr°ni, çfar' taksirátí t' madh páti edhe pshtoj.*

YRRNEK-YRRNEK *ndajf.* Lloj-lloj, llojesh të ndryshme, shumëngjyrësh. *Ka yrrnek-yrrnek njerzish!*

YST,-I *mb.nga turq.* I paparashikueshëm, i jashtëzakonshëm. *Po ýsti çí m'ka da:l djáli i Rrustémit, kŭrr nuk e kışha pa di:t çí â°sht çaç i pabe:s!*

YZÊR,- I *m.sh.-YZRE,-ET.* *turq.* Ndodhi, ngjarje. *Jéta ká xhithfar ýzri!*

ZAGUSHÍTNA *vetv.. ÍTA,-I:T* Ndjej zjarrmi, më zihet fryma, sikletosem. *Sot ka mâ°rr nxe^ht i madh, jôm zagushi:t shŭm.*

ZAMARIS *kal.-ÍTA,-I:T.* Përcjell, ndjek, vështroj me kujdes. *Zamaríte pak çíkên e vogël se po shkon dej n' shitóre!*

ZANOJ *kal. -ÓVA,-ANU: fig.* Lëndo, i bëj dëm dikujt, i shkaktoj një të ligë. *Po ti e paske zanu: dorên moj bij zéza!*

ZANU:M/E (i,e) *mb.* I vrarë, i lënduar. *Çashtu i zanu:m tuj shku: xháku va:d, ish a:rdh pŭ shkŭlle!*

ZÂ°SHTJÉRRUN/E *mb.* Zëngjirur, zëmekur. *Bu:rr zâ°shtjérrun! Gru: zâ°shtjérne!*

ZDÊRHÂ°NA *jokal.* Lëshohem gjymtyrësh. *Çka ish zdêrhâ° ajo çí:k ashtu more?!*

ZDRI:T *kal.- ÍTA,-I:T.* E godas dikë, i bie dikujt shuplakë. *Djáli sa gríma, u çu e ja zdríti një t' mi:r!*

ZDŮHĀN,-I *mb.* I fortë, i qendrueshëm. *Çebesa koxha zdŭhĀn koka ky dja:!!*

ZEMÊRKÓPUN (prej zemër+kopun /plasur) *mb.* Zemërplasur, që vuan shumë. *Agimi u kâºn zemêrkópun me pa: Kosovën e li:r!*

ZGATO:J,-A *m.sh.-A(T).* *mb.* Shumë i gjatë. *Kusheríni i Hamdi:s âºsht nifĀr zgatºje!*

ZGRAPCŎJ *kal.-ÓVA,-CU:* Shkalloj drurin, i bëj shkallëza. *E kĭsh mâºrr shárrĕn e ĭsh kâºn tu e zgrapcu: dérĕn e shpi:s!*

ZGŮRLĀº:J,-A *f.sh.-A (T).* Zgurajë lisi. *Çyre nĭ dhĕlpĕn u mshĕf n' ĉat zgŭrlĀĵ t'ĺísit!*

ZĬMU:K,-A *f.sh.-A(T).* *mb.* Lopë me qime të zeza. *A níve ĉĭ zĭmukĕn e Tahírít, prĀº:m e kĭsh hĀºĝĕr arúsha n' bje:shk?*

ZĬNXHĬN,-I *m.sh.-A(T).* *turq.mb.* I pasur, i kamur. *Avdyłgasht xhithmo:n jôn kâºn zinxhína.*

ZHABLAN,-I *m.sh.-A(T).* *mb.* I papastër , i çrregulluar, i pakrehur. *Ĭsh nĭfar' zhablĀºni, ĭsh sikur mos mu pa la: ku:rr!*

ZHAGIS *kal.-ÍTA,-I:T.* *fig.* Zvarritet, prolongohet kryerja e një pune. *Mos ma zhagĭt bu:rr ĉat pu:n, krýma pak ma shpejt.2. Tërheq zvarrë. I zhagíta dŏ dru: pĭ bjĕshke.*

ZHAGŮT,-I *mb. fig.* Përtac, dembel. *Valoni âºsht nĭfar zhagúti. Për femrĕn thuhet: zhagu:t-a.*

ZHANĜĒRLĬ,-T. *f.* Copëza dhjami të pjekura. *I thĕsh Xhevátit mii kçy:r zhanĝĕrli:t se jôn' mi: shporet e mu:jn muu dje:g!*

ZHANĴĀN *mb.* 1. I pazoti, i ngathët. *Sadíku âºsht zhanĵĀn, nuk âºsht i zoti i kurĉkáfĭt!*
2.*mb.* I papastër. *RamadĀºni âºsht zhanĵĀn se nuk láhet kŭrr! Për femrĕn thuhet: zhanĵa:jk.*

ZHAVELL,-I *m.sh.- A (T).* *mjek.* Sëmundje që vjen nga të ftohtit. *Xhĭth dimĭn nuk na u hŏĉ ky zhavell!*

ZHEGÊR,-A *f.sh.-A(T).* Qafëza druri që u vihen në qafë qeve a kuajve për të tërhequr ngarkesa të ndryshme etj.

ZHGARDHONA *vetv. -ÓVA,-NU:* Lodhem nga pleqëria, rrezbitem. *Iméri krejt u zhgardhnu: pĭ pleĉnje!*

ZHUMÍLE,-JA *f.sh.-E (T).* Mbeturinat e drurit. *I mlédha dŏ zhumíle e i shtína n' zjĕrm.*

ZHURLAVI:C,-A f.sh.- A (T) mb.Llafazane, që flet shumë . *Ajo gru: â'sht zhurlavi:c nuk e din hiç kur duhet mu na:l tu fo:l.*

ZHVJËLLC,-I m.sh.-A (T). Vegël e drunjtë për endjen e penjve. *Nuk vanoј shŭm ee múshi nŭ zhvjëllc pêj!*

Përfundime

Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriperëndimore të Kosovës dhe përfshin 52 fshatra, shumica dërrmuese shqiptare. Parë nga aspekti gjuhësor, e folmja shqipe e këtyre anëve (*Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë*) përkon me grupin e gegërishtes verilindore, por përmban edhe disa veçori e karakteristika vetjake, vënia në pah e të cilave përbën interes të veçantë për dialektologjinë, por edhe për gjuhësinë shqiptare përgjithësisht.

Rëndësia e studimit të të folmeve dhe e dialekteve të shqipes nuk është zbehur as në ditë tona, përkundrazi, studimi i tyre ka marrë vlerë edhe më të madhe, edhe më të rëndësishme, sepse siç ka thënë Çabej: “*gjuha është një prej shenjave të para të kombësisë*”, pra nga gjuha dhe përmes gjuhës shkruhet historia e popullit (kombit) që e flet atë, prandaj në këtë drejtim, edhe shqyrtimi i arealit gjuhësor të Istogut me rrethinë përbën interes të veçantë.

Si përfundim të këtij trajtimi, shkurtimisht do t’i përmbledhim ato tipare e veçori fonetike-fonologjike, morfologjike, fjalëformuese, sintaksore dhe leksikore të arealit gjuhësor të Istogut, të cilat mendojmë se paraqesin rëndësi të veçantë për shkencën e dialektologjisë, andaj meritojnë të vihen në dritë.

Fonetika (theksi).- Shumë fjalë të gurrës orientale, që në gjuhën burimore dalin me theks në rrokjen e fundit, në shqipen e Istogut e kanë zhvendosur theksin për një rrokje para, pra nga theksi fundor në atë parafundor, p.sh.: ***páre (paré), dajre (dajré), ága (agá), xhenâ^a:ze (xhenazé), tenxhére (tenxheré), penxhére (penxheré), tenéçe (teneçé)***. Lëvizja e theksit është e hetueshme edhe te një numër fjalësh me burim sllav, veçmas te një tufë toponimesh dhe mikrotoponimesh, p.sh.: ***Staraséll (Staraselló)***³⁰,

³⁰ Mikrotoponim në malet e fshatit *Mojstir*.

Studeníc (Studenicá), Kashíc (Kashicá), Prigód (Prigodá) etj. Në këtë kuadër, me theks parafundor shqiptohen edhe një dorë emrash të gjinisë femërore të gurrës orientale, që dalin me zanoren **é** të theksuar, p.sh.: **Emíne, Feríde, Hatíxhe** etj. si dhe fjalët e tipit: **sefá, sevdalí, Fazlí, Shukrí**. Nga ana tjetër, te një vistër fjalësh theksi është zhvendosur nga tema e fjalës në prapashtesën përkatëse, p.sh.: **xhānarí, mīlicí, puntorí, bostā^onxhí, specāxhí, laknāxhí** etj.

- E folmja e Istogut ka tri seri zanoresh: a) Zanore të shkurtra që ndeshen në rrokje të tipit të mbyllur: **plēp, lōg, līs, dāsh, fērr, lōg, shtōg, lāgt, mās, hā, punō, kallxō, kcē, pī** etj.

b) zanore të mesme që dalin në rrokje të hapura, me pozicion në mes të fjalës: **djáli, grúni, kērrí, térri, i vōgli, térxela, thési, thérra, lōgu, shtōgu, lágu, máti prágu, krúj, blúj, lívroj, lívdoj** etj.;

c) zanore të gjata që janë përfutur për shkak të pozitës së tyre në fund të fjalës, pra kur ato gjenden në rrokje të hapur si, p.sh.: **tepsi:, kusi:, raki:, shpi:, kojshi:, vlla:, ka:, ha:, pi:** etj., mirëpo zanore të gjata ndeshen edhe te rrokjet që përfundojnë me bashkëtingëlloret **l, ll, r**, p.sh.: **ka:l, za:ll, kuma:r, katuna:r, kulma:r, ba:r, tu:ll, pe:l, shke:l** etj; në emrat e pashquar të gjinisë femërore, ku ka rënë **ë**-ja fundore, p.sh.: **shpa:t, bu:k, thi:k, lo:p, to:k, gro:p, fu:sh** etj; te pjesoret e foljeve, si p.sh.: **berti:t, kosi:t, prashi:t** etj., si dhe në aoristin sigmatik: **pa:sh, dha:sh, la:sh** etj.

- Zanoret e gjata ndeshen edhe në rastet kur kemi të bëjmë me shkrirjen e dy zanoreve, p.sh.: **me: pa: (me e pa), me: sha: (me e sha), me: pru**. Me zanore të gjatë dalin edhe disa emra vetjakë, p.sh.: **Ru:sh, Mâ:l, Ra:m**, mirëpo kur ata shoqërohen me patronime, atëherë zanorja e gjatë kthehet në të shkurtër, (**Rūsh Mehmetja, Māl Sokoli, Rām Alija**) etj.

- E folmja në studim, ashtu sikurse edhe disa pjesë të tjera të gegërishtes, për dallim nga toskërishtja në vete përmban, përveç zanoreve gojore edhe ato hundore, që ndeshen në këto raste:

- kur pas zanores ka ekzistuar një bashkëtingëllore hundore dhe e cila ka rënë, p.sh.: **mullî, fshî, lpî, pê, hû, gû**.

- kur pas zanores gjenden bashkëtingëlloret hundore: **n, m**, p.sh.: **nâ^ona, sâ^ona, brÿma, frÿma, fshî, gatûn, shkrûn** etj. Edhe emrat “**mentë** dhe **dhentë**” theksohen si: **mêt, dhêt**, ngjashëm si në të folmen e Shalën së Bajgorës, por që dallon nga e folmja e Moravës së Epërme e ndonjë tjetër (**Zymberi 1973:80**).

- Hundorësia në këtë të folme është e llojit primar dhe sekondar. Ja disa shembuj: **Nâ^ona, bâ^ona, sâ^ona, thâ^ona, rrfâ^ona, dhâ^omi** etj. Në shembuj e dhënë dhe në të tjerë të këtij lloji, zanorja hundore **â** del me nuancë labializimi dhe për këtë shkak e kemi shënuar kështu (**â^o**).

Prania e zanoreve hundore (**â, ê, î, û, ŷ**) nuk është e natyrës absolute, sepse siç thamë, ekzistojnë edhe përjashtime, p.sh.: labializimi i zanores hundore **â** në **â^o** etj. Nga ana tjetër, kur kemi të bëjmë me zanoren – **ë**, ajo është vetëm e tipit gojor. Ndodh kështu për shkak të natyrës specifike të kësaj foneme të shqipes.

- Zanorja **a** te disa fjalë kalon në **i** dhe **e**, por edhe në zanoret hundore **-ê** dhe **-ô**, p. sh.: **a>e: krevet (krevat), lejthi (lajthi)** **a>i: livroj (lavroj); a> ê: nêl (lart), lêrg- (larg); a> ô: kôm (kam), jôm (jam).**

- Zanorja **e** në disa raste ka kaluar në zanoren hundore **ê**, por edhe në **-i**, p. sh.: **e>ê: pêm (pemë); e>i: shiçer (sheqer), minil (mendil).** Kjo zanore elidohet te nyja e rasës gjinore para një emri të shquar që përfundon me zanoren **a**, p.sh. **zotî shpi:s, drita hâ^ons, zâ^oni nâ^ons, ka:sht gruni, bu:k kollomóçe** etj.

- Zanorja **ë** ruhet mirë te rrokjet nistore të mbyllura të disa fjalëve që formohen me anë parashtesave **stër, nër, nëpër** etj. p.sh.: **stërnip, stërkopil, nërvada, nërmjetza, nëpërmjet** etj.

- Zanorja **ë** bie nga përdorimi në rrokje të mbyllur nistore të fjalëve si, p.sh.: **kta (këta), kto (këto), ksaj (kësaj), ktu (këtu), knej-knena (këndeje), kshtu (kështu)** etj., si dhe në rrokje të mbyllur fundore, p.sh.: **lopt/ lo:pt (lopët), flokt/flok:t (flokët), kraht (krahët)** etj., kurse te një dorë fjalësh bashkë me zanoren **-ë** ka rënë e gjithë rrokja e fjalës, p.sh.: **thmi: (fëmijë), dý mi: (dy mijë), fî (finjë)** etj.

- Zanorja- **ë** nuk dëgjohet edhe te shumësi i emrave të tipit: **ushtar, hoxhallar, student samâ^o:r** etj. si dhe te parafjalët dhe te nyjat e përparme të tipit si: **n’ (në), t’ (të)**

Spikasin edhe raste të tjera të rënies së kësaj zanoreje, p.sh.: disa folje të mënyrës dëftore, koha e tashme, veta e parë dhe e dytë e shumësit, si: **puno:jm, shko:jm, livro:jm, kno:jm, kallzo:jm** etj.

- Zanorja **i** ka kaluar në **y** te fjalët e tipit: **kryp (kripë), rryp (rrip), dyrek (direk), çylum (qilim)**.

- Zanorja **o** në pozitë nistore është delabizliuar në **a (o>a)** p.sh.: **apet (opet)**, por spikasin edhe raste të kalimit të **o** në **y (o>y)** p.sh.: **çyfte (qofte), xhyks (gjoks)** etj.

- Zanorja **u** kur gjendet me pozicion në rrokjet fundore që mbyllen nga bashkëtingëlloret **ll** ose **r** alternohet në **ë (u>ë)** p.sh.: **flutër (flutur), hekër (hekur)** etj.

- Zanorja **y** te një dorë fjalësh delabializohet në **i (y>i)**, p.sh.: **lmer (Ymer), çistek (çystek), tīm (tym), hî (hy)**, kurse te disa tjera, zanorja **-y** kalon në **-u (y>u)** p.sh.: **rushfet (ryshfet), burek (byrek)**.

- Togu zanor **-ue** në të shumtën i është nënshtruar procesit të monoftongimit, p.sh. **gru: (grue), kallxu: (kallxue), me livdu: (me livdue)** etj. ndërkaq, ruhet i plotë vetëm te një numër i kufizuar fjalësh (te brezi i moçëm). Kontraksioni i togut **-ue**, sjell zgjatjen e zanores **-u**, p.sh.: **gru: (grue), thu: (thue), prru: (prruë), me sakatu: (me sakatue)** etj.

- Togu ngjitës **ie** në të shumtën është monoftonguar në zanoren **-i** të gjatë (**i:**), p.sh.: **kam zi: (kam zie), kam ni: (kam nie), di:ll (diell), mi:ll (miell)**.

- Edhe togu **-ie** në të shpeshtë është monoftonguar (reduktuar) në vetëm bashkëtingëlloren e gjatë **i:**, p.sh.: **me zi: (me zie), me përzi: (me përzie), me shti: (me shtie)** etj.

- Togu **ye** në të shpeshtë është alternuar në zanoren **-y** të gjatë: **kry: (krye), me ly: (me lye), me çky: (me çkye)** etj.

- Togun **ae** e ndeshim të monoftonguar (**tha, dha, pa**), por ruhet te brezi i moçëm (**pae, thae, dhae**) etj.

- Grupi **vo** vihet re vetëm të një numër i kufizuar fjalësh: **votër, vorr, voj, vo:k, i vukt**.

- *Sistemi bashkëtingëllor*.- Inventari i fonemave bashkëtingëllore në të folmen e Istogut me rrethinë përmban 27 fonema bashkëtingëllore, prej tyre (17 të zëshme : **b, d,dh, g, j, l, ll,m, n, nj, r, rr , v, x, xh, z, z** dhe 10 bashkëtingëllore të pazëshme (të shurdhëta) siç janë: **c, ç ,f, h, k, p, s, sh, t, th**, kurse çiftet e bashkëtingëlloreve janë: **p-b, t-d, f-v, k-g, ç-xh, s-z, c-x, th-dh, sh-zh**.

- Bashkëtingëllorja **b** shurdhohet në **p** te fjalët e tipit: **i kalpt (i kalbët), i tharpt (i tharbët)** etj.

- Bashkëtingëllorja **t** proklitike kur është në pozicion para bashkëtingëlloreve të zëshme **b, g** shkon e kalon (sonorizohet) në **d**, p.sh.: **d' ba:rd, d' zi, d' gritht, d'grunit** etj.

- E folmja e Istogut në asnjë rast nuk i ka ruajtur bashkëtingëlloret palatale **q** dhe **gj**, në vend të tyre përdoren afrikatat **ç** dhe **xh**.

- Fonema **nj** në pozicion nistor të fjalëve, në të shumtën (me disa përjashtime) jep **n**, p.sh.: **nĩ (një), nĩlloj (njëlloj), nĩsoj (njësoj), nĩmên (njëmen)** etj.

- Bashkëtingëllorja **f** ka kaluar në **th** te fjala: **thmi (fëmijë)**.

- Glotalja **h** kur ndiqet nga bashkëtingëllorja **t** shkon e kalon në **f**, pra bëhet ndërrimi cilësor i këtyre tingujve, p.sh.: **i ftoft (i ftohtë), t' ftoftit (të ftohtit), njófta (njoha), ftófa (ftoha)** etj.

- Bashkëtingëllorja **s** prapa bashkëtingëlloreve të tipit: **l, ll, m, n, t, r** kalon në konsonanten **c (s>c)** p.sh.: te disa emra mashkullorë që dalin me **ës** si: **rjepc (rjepës), pshtjellc (pshtjellës), rrënc (rrënës)** etj. Bashkëtingëllorja **s** kalon në **c** edhe kur është në pozitë nistore të fjalëve p.sh.: **ci:c (sisë)**, ndërkaq, në një rast **s** në pozitë fundore ka kaluar në **z** p.sh.: **taz (tas)**. Bashkëtingëllorja **s** para buzoreve **b,v** dhe para bashkëtingëllores **d**, nën ndikimin e disimilimit, sonorizohet në **z**. Kjo ndodh kur **s** e kryen funksionin e pjesës mohuese (Ibrahimi 2005:93).

p.sh.: **z' bashkóhet (s'bashkohet), z' vjen (s' vjen), z'duhet (s'duhet), z'díhet (s'dihet), z'dal (s'dal)** etj.

- Bashkëtingëllorja **z** në pozicion para bashkëtingëlloreve të zëshme kalon në afrikaten **x**, p.sh.: **menxi, kallxoj** etj.

- Te shumë fjalë, veçmas tek ato me gurrë orientale, bashkëtingëllorja faringale – *h*, dëgjohet fare pak, p.sh.: *njo^h*, *sho^h*, *Alla^h*, *xhyn^ha* etj.

- Bashkëtingëllorja *g* jotizohet në *j* te fjala: *zoj (zog)*, kurse afrikatizohet te fjalët: *bríxhe (breg)*, *shtíxhe (shteg)* etj.

- Grupet e vjetra konsonantike të shqipes, përgjithësisht nuk ruhen. Grupet *nd* e *mb* në pozicion nistor janë rrudhur në bashkëtingëlloren *m*, përkatësisht *n*, p.sh.: *mre:ti (mbreti)*, *mle:dh, nrýshe (ndryshe)*.

- Dukurisë se metatezës i janë nënshtruar fjalët e tipit: *pshtú (shpëtu)*, *hamak (ahmak)*, *trùbull (turbull)*, *i trùbullt (i turbullt)*, *hulát (luhat)*, *Mejrem (Merjem)* *pshtëj (shpëtoj)*, ndërkaq proteza ka vepruar te fjalët: *çatje (atje)*, *çanej (andej)*, *çatýne (atyre)*, *çeknej (këndej)*, *çáta (ata)*, *çásajde (asajde)* etj.

- Epitezë kanë pësuar disa folje të kohës së tashme, të mënyrës dëftore, në numrin njëjës, p.sh.: *mshélí (mshel)*, *thérí (ther)*, *nxérrí (nxjerr)*, por edhe disa përemra dhe disa ndajfolje: *atína (atij)*, *asájna (asaj)*, *dikújna (dikujt)*, *knéjna (këndej)*, *anéjna (andej)* etj. Nga ana tjetër, dukurisë së sinkopës (rënies së tingujve në trup të fjalës) i janë nënshtruar fjalët e tipit: *lóve (lopve)*, *kuále/kuaje (kuajve)*, *shpí (shtëpi)*, *vétlla (vetulla)*, *pétlla (petulla)*, *asimtári (arsimtari)*, *kpút (këputë)*, *kněj (këndo)*, *kcèj (kërcej)* etj., kurse apokopë (rënie në fund të fjalës) kanë pësuar fjalët, si:: *Nur (Nuridin)*, *Llúk (Llukman)*, *mên (mend)*, *vên (vend)*, *krym (krimb)* etj.

Morfologji.- Ndryshimet morfologjike në arealin gjuhësor të Istogut me rrethinë janë më të pakta se ato fonetike, ndërkaq edhe ato, që ekzistojnë janë të ngjashme me grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore, megjithëkëtë kemi vënë re edhe disa veçori me interes dialektor. Ja disa nga këto tipare dalluese:

- Në të folmen e Istogut, për dallim nga disa pjesë të gegërishtes, por ngjashëm me të folmen e Deçanit (Mehmetaj 2006:181) i takojnë gjinisë femërore emrat e tipit: *néra*, *líbra*, *pjépna* etj.

- Ruhen disa emra asnjandës, sidomos kur shoqërohen me përcaktorë, p.sh.: *kta djath*, *kta kos*, *kta uj*, *kta kos*, *çata mish*, *çata mi:ll* etj.

- Emrat asnjnës prejfoljorë, të tipit: ***t bërtítnit, t íknit, t nxhéshnit, t écnit, t hâºñrit, t pímit*** etj., por edhe ata prej mbiemërorë të tipit si: ***t zít, t kèçt*** etj., nuk kanë numër shumës, sepse kur përdoren në plural, kalojnë në gjininë femërore, por vihen re edhe përdorimet paralele të gjinisë femërore, si: ***dý t bërtítne, dý t íkne, dý t nxhéshme, dý t écne, dý t hâºñre, dý t píme*** etj.

- Shumësi i emrave mashkullorë del përmes trajtash të ndryshme. Më i shprehuri është shumësi mashkullor me mbaresën ***-a*** që është karakteristikë edhe e të folmeve fqinjësore, p.sh.: ***doktorra, profesora, inzhinjera, shofera, autobusa*** etj.

- Përveç 5 rasave të shqipes letrare, këtu përdoret edhe rasa thirrë, e cila ka pamjen e rasës emërore në trajtën e pashquar, por që shoqërohet me pasthirrmat përkatëse për të dy gjinitë. Për mashkullorë: ***o, ore, more***, ndërkaq për femërore përdoren pasthirrmat: ***oj, moj, mori***, p.sh. // ***O Hysen o/ñutu more/ se na nxuni nâºta// Oj Hatíxhe/ moj po a po nî:n mori/ bîna dõ u:j t ftõft oj//*** etj.

- Te shkallët e mbiemrit, përveç sipërores, mjaft dendur përdoren edhe disa fjalë (zakonisht emra) që nuk emërtojnë ndonjë send, por shërbejnë për të vënë në pah karakteristikat e atyre sendeve, p.sh.: // ***i rí ganz/ e re fla:k/ e ftõft ákull/ e nxe:t va:!*** etj.

- Përemrat pronorë të vetës së parë njëjës, kur prona dhe pronari janë në njëjës, dalin me ***-j*** (me funksion hiati). Ky tip përemrash u ngjitet emrave, p.sh.: ***shpja jême, nâºna jême, vllau jêm*** etj.

- Përemrat pronorë-vetvetorë – ***vet, i véti, e vet, e vétja (e véta), d vett, d vétat*** përdoren në vend të përemrave pronorë e mbiemrave të vetës së tretë: ***i, e sáj; i,e tij; i,e týne***, p.sh.: // ***Shkoj n katun t vet// Nuk âºsht mi:r me harru: njeri t vétin// Âºsht mi:r çí secilli mǐ kçy:r pu:nt e véta// Krejt Krasniçen i ka t vett//***. Këtu spikasin edhe trajtat e përemrave pronorë të tipit si: ***i tíj, i sáj, i týne*** të cilët, në vetën e tretë të njëjësit e zgjerojnë formën me ***-na***, p.sh.: ***i, e atína; i, e asájna (sájna)***, p.sh.: // ***I kallxóva Ismetit çí kjo to:k âºsht e atína t prigódsit// Djálit têm ja bâºna me díje se ky livadh âºsht i asájna çí e patêm pa: nǐ her n' pazár!*** etj.

- Sistemi foljor i këtij areali gjuhësor përmban shumësi trajtash foljore, por që në rrymë të moteve, shumë prej tyre i janë nënshtruar procesit të analogjisë dhe, kështu, janë krijuar trajta të reja. Parë nga aspekti i kategorisë gramatikore të kohës së foljes, në ligjërimin e zakonshëm (kallëzimor) përdorim më të dendur kanë kohët e përbëra, veçmas koha e kryer dhe e kryera e plotë (më së e kryer), ndërkaq kohët tjera foljore, p.sh. koha e ardhme e përparme, e tipit **do të kem lexuar** etj., si dhe koha e tashme e mënyrës kushtore kanë përdorim shumë të rrallë.

- Disa trajta foljore të diatezës pësore-vetvetore, në kohën e kryer të mënyrës dëftore kanë dy trajta (forma) të përdorimit, p.sh.: **pjéka-póça, njéka-nóça, nxérra-nxóra, vjéla-vóla, pshtjélla-pshtólla, vjélla-vólla, pshtýva-pshtéva** etj.

- Përdorimi i pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në të folmen tonë, gjithherë e më shumë po bëhet më i dendur dhe më i zakonshëm, çka do të thotë se kjo e folme, por edhe të folmet e tjera të shqipes përditë e më shumë po ndikohen nga shqipja letrare (standarde).

Fjalëformimi.- E folmja në shqyrtim edhe në fushën e fjalëformimit paraqet interes dialektor, sepse përmes shqyrtimit dhe analizimit të mënyrave dhe mjeteve fjalëformuese mund të hetohen më imtësisht shumë aspekte dhe veçori dialektore të këtij krahu të shqipes.

Mënyrat më të shpeshta fjalëformuese në trevën gjuhësore të Istogut janë:

- *Parashtesimi.*- Parashtesat më të shpeshta në të folmen e Istogut janë: **ç, këca (kaça), këla, këra, m, mí, n, nër, pa, përa (për), për (për), s, çpër, k (ka), z.**

- *Prapashtesimi.*- Formimi i fjalëve me anë prapashtesash është mënyra më e shpeshtë dhe më prodhimtarja nga të gjitha format e tjera, prandaj edhe më kryesorja.

